

133

EDUKATA ISLAME

viti  
LIV

# EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE  
ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

133

çmimi: 5€

Prishtinë  
2024

# EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE  
ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LIV nr. 133 / 2024

Boton: KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME E KOSOVËS

## EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE

ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

**[www.edukataislame.net](http://www.edukataislame.net)**

e-mail: [edukataislame@yahoo.com](mailto:edukataislame@yahoo.com)

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182

**Tel & fax: 038 / 224-024**

*Redaksia:*

Ramadan Shkodra - kryeredaktor,

Dr. Ajni Sinani - redaktor

Dr. Sadik Mehmeti - redaktor

Dr. Sedat Islami - redaktor

Mr. Besnik Jaha - redaktor

*Redaktor gjuhësor:*

Besnik Jaha

*Redaktor teknik & ballina:*

Nuhi Simnica

*Shtypi:*

"Printing press" - Prishtinë

Tirazhi: 300

# EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE  
ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LIV nr. 133 / 2024

Prishtinë  
2024



## **I. EDITORIAL**



## **TA RUAJMË FAMILJEN ME LIGJET E ZOTIT QË JANË TË PËRHERSHME DHE NUK NDRYSHOHEN DOT!**

Trajtimin e një teme të caktuar nga aspekti shkencor, fetar, letrar etj., shpeshherë ta imponon koha, kushtet konkrete, rrethanat dhe atmosfera e përgjithshme shoqërore. Mirëpo tema e familjes bën përjashtim, për të nuk ka kohë dhe rrethana të caktuara, sepse ajo, pra familja, të imponohet të merresh me të në vazhdimësi për shkak të rëndësisë që ka ajo dhe për shkak të rolit që ajo luan në formimin e shoqërisë. Megjithatë, në ditët tona, të imponohet të merresh me familjen edhe më shumë, pikërisht nga nevoja dhe kërkesa e kushteve shoqërore, në të cilat ndodhemi ne, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajon. Kjo sepse po bëhen përpjekje dhe ka tendenca që të futen duart edhe në familje dhe të preken themelet e saj, që familja të ndryshohet, të mos mbetet ajo siç ka qenë që nga kur njerëzimi zbriti në tokë.

Është detyrë e intelektualëve tanë në përgjithësi, dhe edhe e jona, që vlerat e familjes sonë t'i ruajmë dhe t'i kultivojmë përgjithmonë, për to të flasim e të shkruajmë në vazhdimësi, sepse familja është baza themelore mbi të cilën është ngritur komuniteti dhe shoqëria në përgjithësi; ajo celula e parë e formimit dhe formësimit të shoqërisë, e pse jo edhe të organizimit shoqëror e social.

Së këndejmi, familja ne vetvete, por edhe si organizim institucional është e vjetër sa edhe vetë shoqëria. Ajo zë fill që me njeriun e parë, Ademin a.s. dhe bashkëshorten e tij, Havanë, me të cilët zë fill raca njerëzore në këtë tokë dhe me të cilët fillon historia e familjes dhe e njerëzimit mbarë.

Edhe në rendet e ndryshme shoqërore e deri të krijimi i mbretërive, dinastive e perandorive, ndërliidhen ngushtë kontributet e familjeve të mëdha, pra edhe te ne shqiptarët. Aty ku ka pasuar një rend e një rregull, në ato kushte e rrethana është krijuar një familje e konsoliduar, ku më pas ka pasur hierarki, ide, plan e zhvillim.



Po kush e përbën familjen, si funksion familja dhe si duhet të jetë ajo, janë pyetje të cilat bëhen në vazhdimësi dhe për to debatohet e diskutohet në qarqe e rrethe nga më të ndryshmet.

Dihet tashmë se baza e familjes janë një mashkull e një femër, të cilët lidhin ligjërisht kurorë për të jetuar, vepruar e punuar bashkërisht në ngritjen së pari të familjes e pastaj edhe të mirëqenies socio-ekonomike të saj.

Në Kuranin fisnik thuhet qartë se familja fillon me një mashkull dhe një femër, se ajo është baza e shoqërisë njerëzore dhe po ashtu porositemi që ta ruajmë atë.

Allahu xh.sh. thotë: **“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”** (En Nisa, 1).

Pra, jeta në këtë botë filloi me një mashkull dhe një femër, një burrë e një grua, dhe që të dy këta kanë rolin primar në formimin e shoqërisë.

Në një ajet tjetër kuranor ndërkaq thuhet: **“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”** (El Huxhurat, 13).

S'ka dyshim se roli i familjes në shoqëri është i pazëvendësueshëm, dhe përveç rolit të pashmangshëm të riprodhimit biologjik, roli i familjes është determinues edhe në edukimin, formësim e formimin e drejtë e të duhur, si në aspektin kulturor, fetar, nacional, human e edhe shtetëror.

Është institucioni i familjes ai që pasardhësve të tyre-fëmijëve, përpos që u siguron strehim, edukim, shkollim, udhëzime e mbikëqyrje për punë të mira, me të vetmin qëllim që të arrijë më të mirën e mundshme në jetë, atyre, si askush tjetër, u siguron edhe ngrohtësinë, dashurinë e kujdesin e veçantë pa asnjë kusht e pa asnjë hezitim, dhe mu në këto virtyte që i ofron vetëm ambienti familjar, lindin e kultivohen edhe premisat për zhvillimin e shoqërisë së shëndosh e me vlera.

Përgjatë historisë së njerëzimit është i njohur roli, kontributi dhe të bëmat e familjeve të mëdha, të cilat kanë determinuar zhvillimet historike, kulturore e edhe socio-politike, dhe në bazë të këtyre familjeve kemi edhe rende shoqërore dhe krijim të elitave gjatë historisë.

Në anën tjetër, feja islame, familjes i kushton rëndësi të veçantë dhe meritore. Në doktrinën e besimit islam, janë të përligjura detyrat dhe obligimet e prindit ndaj fëmijëve, të fëmijëve ndaj prindërve, pas-taj obligimet ndaj të moshuarve, si dhe obligimet ndaj rrethit. Sa e sa herë ulemaja jonë në ligjërimet e tyre, duke u bazuar në mësimet kuranore dhe në traditën profetike, kanë folur për rolin e familjes, për obligimet e ndërsjella dhe në këtë mënyrë kanë krijuar një edukatë krejt të veçantë që ka funksionuar jashtëzakonisht mirë ndër breza, dhe si e tillë edhe ka krijuar kod etik e moral brenda familje. Është shumë e njohur ndër ne porosia kuranore dhe e Pejgamberit a.s. për kujdesin që duhet të kenë fëmijët ndaj prindërve e sidomos ndaj nënës, familjes e shoqërisë në përgjithësi.

Edhe në traditën tonë të ndritshme familja ka pasuar rolin kryesor në mbrojtjen, ngritjen dhe avancimin e statusit të shoqërisë sonë.

Është institucioni i familjes te ne që ka sakrifikuar veten për mbijetesën tonë, është familja ajo që ka bërë që ne të shkollohemi në kushte e rrethana të vështira, po ashtu është institucioni i familjes te ne që ka ditur të jetë solidar e të mbështes tjetrin në rrethanat kur është kërkuar.

Më këtë rast, të kujtojë vetëm vitet '90 të shekulli të shkuar kur populli i Kosovës u përball me segregacion, dëbim nga vendet e punës dhe riokupim klasik të Kosovës, qe institucioni i familjes ai që shtrëngoi radhët dhe krijoi premisat fillimisht për mbijetesën tonë si popull, më vonë për përballje me armikun për të fituar të drejtën tonë për liri e pavarësi.

Përveç kësaj, populli ynë, e ka për nder e krenari identifikimin me familjen, kjo për faktin sepse familjet kanë qenë bartëse kryesore të rrugëtimit të popullit e vendit tonë, dhe në këtë rrafsh kemi familje të respektuara me emër e me nam përgjatë historisë sonë.

Këtë status këto familje nuk kanë mundur në asnjë formë ta krijojnë pa një rend e një rregull, pa një edukim e fisnikërim, pa kod, pa ahlak, e pa një taban të shtresuar thellë në të kaluarën e tyre.

Familja ka pasuar rendin e vet, gjysh e gjyshe, babë e nënë, bijë e djalë, mbesë e nip, re e vjehërri. Përmendem këtu tri gjenerata të një familjeje, të cilat gjatë historisë të ne kanë përbërë bërthamën e familjes, oxhakun e familjes, kanë funksionuar në parime krejt fisnike e të suksesshme.

A i jep dikush dashuri, edukatë e etikë më shumë se gjyshi apo gjyshja nipit-mbesës, a kujdeset më shumë e më mirë sikush më shumë se babai e nëna për të fëmijët e tyre, apo a i do dikush të mirën e suksesin dikujt më shumë se pasardhësve të tij?!

Është e njohur te ne sintagma *“po mundohem për fëmijët, se e jona e pati”*. Madje, edhe luftën për lirinë e vendit, brezat para nesh e kanë bërë që pasardhësit e tyre të jenë të lirë e zot në vendin e vet.

Mirëpo, kohëve të fundit, të ndikuar nga shumë faktorë, institucioni i familjes sikur po atakohet dhe sikur ka filluar të zbehet, dhe kjo për disa arsye. Jemi të vetëdijshëm se shoqëria jonë tani në kushtet dhe rrethanat e krijuar përballet me shumë sfida, mirëpo kjo nuk do të thotë që të dëmtohet embrioni i shoqërisë - familja. Fatkeqësisht viteve të fundit kemi një numër në shtim e sipër të divorceve, një fenomen tjetër është bashkëjetesa pa obligime, pastaj numri i vogël i lindjeve, e për më keq kemi edhe nisma e iniciativa për birësime e adoptime të fëmijëve, si dhe lindje artificiale pa prindër biologjik.

Këto fenomenet e nisma përveç që janë të dëmshme dhe zbehin rolin e familjes, heqin lidhjen emocionale e humane brenda familjes, s’ka dyshim se janë edhe kundër misionit parësor që ka një mashkull e një femër, misionit që ka familja në vetvete, janë edhe kundër natyrës së njerëzimit dhe kundër mësimave të feve, e edhe të fesë islame. Këto nisma e veprime krijojnë familje e rrjedhimisht edhe komunitet e rreth pa identitet, krejt të ftoftë e artificial, e madje edhe e dehumanizojnë shoqërinë, për të mos thënë, se edhe e kriminalizojnë atë.

Andaj është detyrë e institucioneve tona, e prindërve tanë, e ulëmasë sonë, e përfaqësuesve tanë, që të krijohen premisa e politika të

mira që mbrojnë institucionin e familjes, sepse në atë shoqëri ku institucioni bazë - familja, funksionon në parime normale, edhe shoqëria do të funksionon, rritet e zhvillohet normalisht.

Ta ruajmë familjen, mos të lejojmë atakimin e vlerave mbi të cilat jemi rritur, edukuar e zhvilluar!

Dhe të mos harrojmë asnjëherë se Ligjet e Zotit janë të përhershme, ato nuk ndryshojnë, ato janë të drejta dhe ato janë në funksion të njeriut, sepse Zoti është Krijuesi ynë dhe Ai e di më së miri se ç'na duhet neve për të funksionuar e për të jetuar si njerëz normal. Çdo përpjekje për të ndërhyrë në këto ligje, sigurisht që ka për të pasur pasoja dhe ka për të dëmtuar llojin njerëzor.

**Ramadan Shkodra**



## **II. ISLAMISTIKË**



Dr. Lulzim ESATI

## VEÇORITË E PEJGAMBERIT, A.S., NË KURANIN FAMËLARTË

### Abstrakt

Pejgamberi, a.s., ishte Kuran i gjallë që ecte mes njerëzve. Pa dyshim që kjo është veçoria e tij kryesore, e që i përmbledh në vete edhe veçoritë që do t'i përmendim më poshtë. Duke u nisur nga ky realitet, studimi ynë në këtë punim synon t'i nxjerrë në pah veçoritë më të theksuara të Pejgamberit tonë, a.s., në Kuranin fisnik, e që e vizatuan portretin më të lartë në moral, si dhe e bënë atë shembull të përkryer për mbarë besimtarët. Kjo na e mundëson që ta njohim edhe më tepër personalitetin fisnik të Pejgamberit, a.s., duke i mësuar edhe disa arsye shtesë që e bënë atë pejgamber për mbarë njerëzinë, si dhe shpalljen e tij përmbyllje të të gjitha shpalljeve.

*Fjalët çelës: moral, mirësi, butësi, siguri, mëshirë, tolerancë.*

### 1. Morali i lartë i Pejgamberit, a.s.

Për moralin e Pejgamberit, a.s., i Lartëmadhërishmi thotë në Kuran:

﴿وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ﴾

*“Ti vërtet je në një shkallë të lartë të moralit!”<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> El Kalem: 4.



Veçoria që mori theks të veçantë në mesin e veçorive të shumta të Pejgamberit, s.a.v.s., që u përmendën në Kuran është “moralit i lartë” me të cilin u dallua Pejgamberi, a.s., i dalluar pothuajse nga të gjitha krijesat; ai kishte arritur shkallën më të lartë të moralit, siç dëshmon ajeti sipër.

Ebu Suudi, e komenton kështu ajetin, “*Ti vërtet je në një shkallë të lartë të moralit!*”, të cilën shkallë, sipas tij, nuk mund ta arrijë askush prej krijesave.<sup>2</sup>

Zemehsheriu për këtë ajete, “*Ti vërtet je në një shkallë të lartë të moralit!*”, thotë: “Allahu e lartëson moralin e tij për shkak të tolerancës së tepruar ndaj mundimeve të popullit të tij, e të cilat i përballoi me sjellje të mira dhe tretman të bukur me ta. Prandaj thuhet se ky është moralit që e urdhëroi Allahu, xh.sh. në thënien e Tij:

﴿خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ الْجَاهِلِينَ﴾

**“Bëhu i matur (në sjellje ndaj tyre), urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga xhahilët (injorantët)!”<sup>3</sup>.**

Said bin Hishami e kishte pyetur Aishen, r.a., për moralin e Pejgamberit, s.a.v.s., e ajo u përgjigj: “*Moralit i tij, ka qenë Kurani.*”. *A nuk e lexon Kurantin?* “*Është e sigurt se besimtarët kanë shpëtuar.*”<sup>4, 5</sup>.

Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: “*Asgjë nuk do të jetë më e rëndë në peshoren e besimtarit në Ditën e Kiametit sesa karakteri i mirë.*”<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> Ebus Suud, Muhamed bin Muhamed, (v. 951 h) *Irshadul Aklis Selim Ila Mezajal Kurani Kerim*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, Bejrut.vëll: 15, f. 212.

<sup>3</sup> El Earaf: 199.

<sup>4</sup> Fjala është për nëntë ajete e para të sures “El Muminun”.

<sup>5</sup> Ez-Zemahshari, Mahmud Ibën Omer, (v. 538 h), *El Keshaf*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, botimi i I<sup>re</sup>, 1997 Bejrut. Vëll: 3, f. 223.

<sup>6</sup> Et Termidhi, Muhamed Ibën Isa Ibën Sureh, (v.275h), *Sunen Et Termidhi*, recensent: Mustafa Muhamed Husejn edh-Dhehbi, sh.b: Darul Hadith, botimi I, 1999 Kajro. vëll: 6, f. 626. Ebu Daudi, Sulejman bin El Eshëath, (v. 275 h), *Kitab Essunen*, botimi I, sh.b: Darul Mearifë, Bejrut.nr: 4799. Ebu Abdullah, Ahmed Ibën Hambel, (v. 241h). *Musned Imam Ahmed*, recensent: Ahmed Aburrezzak dhe Ejmen Ibrahim the të tjerë, sh.b: Dar Alemul Kutub, botimi I, 1998 Bejrut.nr: 27517. El Mudhiri, *Et Tergib vEt Terhib*, vëll:3, f. 35.

Xhabiri, r.a., transmeton prej Pejgamberit, s.a.s.v.: “Ata që janë më të dashur për mua dhe më afër meje në Ditën e Kiametit, ata do të jenë më të mirët prej jush në moral; – tha: dhe më i urryeri prej jush për mua dhe më i larguari prej meje në Ditën e Kiametit do të jenë: llafazanët, ata që tallen me njerëzit dhe mendjemëdhenjtë.”<sup>7</sup>

Vlera e kësaj dhe veçoria shihet qartë këtu, sikurse dhe dëshmojnë shumë ajete e hadithe të tjera për këtë. Pa dyshim se morali dhe karakteri i Pejgamberit, a.s., që shfaqej përmes sjelljes së bukur, ishte perla më e çmueshme që binte në syrin e secilit. E si mos të ishte kështu kur të gjitha veprat dhe thëniet e tij shkriheshin dhe transferoheshin në moral, para se ato të dëgjoheshin prej të tjerëve?!

## 2. Pejgamberi, a.s., ishte mëshirë për të gjitha krijesat

﴿ وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ﴾

“E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”<sup>8</sup>

Veçoria e radhës me të cilën u përgëzua Pejgamberi ynë, a.s., ishte “mëshirë për të gjithë krijesat”. Ky ishte edhe objektivi kryesor i dërgimit të Muhamedit, a.s.

Imam Taberiu, r.a., gjatë interpretimit të këtij ajeti, thotë: “Thënia e tij: “Dhe Ne nuk të dërguam ty vetëm se si mëshirë për botët”, thotë Zoti i Madhëruar për pejgamberin e Vet, Muhamedin, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të. Pra, Zoti sikur i thotë se nuk të dërguam ty, o Muhamed, te krijesat Tona, vetëm se si mëshirë për ata që të dërguam. Pastaj interpretuesit ishin në dilemë se bota në të cilën u dërgua Muhamedi, a.s., i ka për qëllim besimtarët e tyre, dhe jobesimtarët e tyre! Apo, a mos i ka për qëllim vetëm ata prej tyre që besuan, duke mos i përfshirë ata që e refuzuan mesazhin e tij? Disa kanë thënë se mëshira e tij i mbulon besimtarët dhe jobesimtarët... Disa të tjerë thonë: “Muhamedi, a.s., është mëshirë vetëm për ata që e besuan.”. Kjo pasi i paraqet emrat e ithtarëve nga të dy

<sup>7</sup> Termidhiu, (hasenun Garib).

<sup>8</sup> El Enbija: 107.

grupet. Imam Taberiu e jep këtë konstatim: “Mendimi më i saktë nga këto dy mendime është ai që transmetohet prej Ibën Abbasit, se Allahu e dërgoi Pejgamberin, a.s., mëshirë për gjithë botën, për besimtarët dhe jobesimtarët.”<sup>9</sup>

### 3. Dhuntia dhe mirësia e madhe e Allahut, xh.sh., ndaj

#### Pejgamberit, a.s.

وَأَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكَ وَرَحْمَتُهُ هَمَّتْ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ أَنْ يُضِلُّوكَ وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ ۗ وَمَا يَضُرُّونَكَ مِنْ شَيْءٍ ۗ وَأَنْزَلَ اللَّهُ عَلَيْكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَكَ مَا لَمْ تَكُن تَعْلَمُ ۗ وَكَانَ فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكَ عَظِيمًا

*E sikur mos të ishte dhuntia e Allahut dhe mëshira e Tij ndaj teje, një grup prej tyre do të të humbte ty, por ata nuk humbin tjetër përveç vetes së tyre. Ty nuk mund të të dëmtojnë asgjë. Allahu ta shpalli ty librin dhe sheriatin, të mësoi çka nuk dije. **Dhuntia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe.**<sup>10</sup>*

Prej veçorive të Pejgamberit, a.s., është mirësia e madhe që ia dha Zoti Fuqiplotë, përveç të tjerëve. Kjo e bën Pejgamberin, a.s., krijesën më të privilegjuar tek Allahu, xh.sh. “*Dhe mirësia e Zotit ndaj teje ishte e madhe*”. Kjo do të thotë se mirësia e Zotit ndaj tij, a.s., do të vazhdon të jetë e madhe, prandaj duhet falënderuar Atë për mirësinë që e dhuroi dhe për profetësinë dhe diturinë me të cilën e begatoi atë, a.s. Ajo që i është shpallur nga libri dhe urtësia e Tij, si dhe mbrojtja prej atyre që u përpoqën ta mashtrojnë, ishte prej Zotit, xh.sh., sepse Zoti, xh.sh., është Ai që e ka marrë me mirësinë e Tij nën mbrojtje dhe e ka mbuluar me mirësinë e Tij. E, kjo mjafton për t’i dëbuar nga ai keqbërësit e tij. Në këtë ajet ka një paralajmërim prej Zotit të Plotfuqishëm për pejgamberin e Tij, Muha-

<sup>9</sup> Et Tabriri. Muhamed bin Xheri, (v. 310 h), *Xhamiul Bejan Ante'vil Ajil Kuran*, sh.b: Darul Fikër, 1985 Bejrut, vëll: 8, f. 354.

<sup>10</sup> En Nisa: 113.

medin, a.s, për mirësinë që ai e donte dhe hirin dhe mirësinë me të cilin e përfshiu atë për ta përmbushur detyrën e drejtë, ashtu siç duhet.<sup>11</sup>

Mirësia dhe të mirat e Allahut, xh.sh., për të dërguarin e Tij Muhamedin, s.a.v.s., ishin aq të mëdha, sa nuk mund të përshkruhen prej askujt. Mirëpo këtu, në këtë ajet, kjo mirësi e madhe përkufizohet në tri dhunti: 1) Shpallja e Librit (Kuranit); 2) Dhënia e Urtësisë, dhe; 3) Mësimi i asaj që nuk e dinte. Dhe, si rezultat i këtyre tri dhuntive vjen në pah edhe kjo veçori; mbrojtja nga humbja e lajthitja që kurdisin kundërshtarët.

**4. Zoti - Lavdi qoftë - nuk e ka thirrur me emrin e tij në Kuranin madhështor,** dhe nuk është përmendur asnjë ajet në formën (o Muhamed), siç është përmendur pjesa tjetër e pejgamberëve, a.s., si në thënien e të Plotfuqishmit:

﴿يَا إِبْرَاهِيمُ أَعْرِضْ عَنْ هَذَا﴾

“O Ibrahim, largohu nga kjo!”<sup>12</sup>, apo thënia e të Madhëruarit:

﴿قِيلَ يَا نُوحُ اهْبِطْ بِسَلَامٍ﴾

“U tha: O Nuh, zbrit në paqe!”<sup>13</sup> apo thënia e Tij:

﴿إِذْ قَالَ اللَّهُ يَا عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ خُذْ هَذَا الصُّلْبَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ بِسَلَامٍ﴾

“Kur Zoti tha: O Isa, me të vërtetë unë do të të bëj të vdesësh, dhe do të të ringjall tek unë!”<sup>14</sup>

Dhe kështu është me të gjithë pejgamberët. E, kur emri i tij, s.a.v.s., u përmend, në formën e informacionit, u pasua nga përshkrimi për të. Zoti i Madhëruar tha:

﴿مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ﴾

“Muhamedi është i Dërguari i Zotit.”<sup>15</sup>

<sup>11</sup> El Hazini, alaudin Ibën Muhamed, (v, 741 h), *Lubabu Te'vil fi Meani Tenzil*, sh.b: Darul Kutub El Ilmije, Bejrut 1994, vëll: 1, f. 556.

<sup>12</sup> Hud: 76.

<sup>13</sup> Hud: 48.

<sup>14</sup> Ali Imran: 55.

<sup>15</sup> El Fet'h: 29.

Nuk ka dyshim se adresimi i tij në Kuranin famëlartë është gjithmonë në formën e një mesazhi:

﴿يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ لَا يَحْزُنكَ الَّذِينَ يُسَارِعُونَ فِي الْكُفْرِ﴾

“O i Dërguar, mos të të pikëllojnë ata që nxitojnë në mosbesim!”<sup>16</sup>, ose në cilësi të pejgamberisë, siç thotë i Plotfuqishmi:

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَسْبُكَ اللَّهُ﴾

“O pejgamber, ty të mjafton Zoti!”<sup>17</sup>. Kjo është nga shenjat e ngritjes së emrit të tij dhe lartësimit të pozitës së tij, s.a.v.s.<sup>18</sup>

El Zerkashi ka thënë: “Në Kuran nuk është përmendur se është thirrur me “O Muhamed”, por “O pejgamber” dhe “O i dërguar”; në shenjë nderi dhe respekti, për ta veçuar atë nga kushdo tjetër.”<sup>19</sup>.

### 5. Butësia e Pejgamberit, a.s., me besimtarët

﴿فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ ۖ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ ۗ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ ۗ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ﴾

“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemër fortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, prandaj ti falua atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten!”<sup>20</sup>

Ky ajet fisnik na e mëson një veçori tjetër që iu dha Pejgamberit tonë, a.s., e ajo është sjellja e butë me sahabët (shokët). Kjo veçori e ndihmoi Pejgamberin, a.s., që t’i mbante shokët e tij afër. Sikur mos të ishte kjo

<sup>16</sup> El Meide: 41.

<sup>17</sup> El Enfal: 64.

<sup>18</sup> Zavavi, Ahmed Abdul Fetah, sh.b: Darul Kimeh, **Shemail en-Nebij, s.a.v.s.**, Aleksandria ,vëll: 1, f. 547.

<sup>19</sup> Ez Zerkeshi, El Burhan fi Ulumil Kuran, vëll: 2, f. 228.

<sup>20</sup> Ale Imran: 159.

veçori, ata do të shkapërderdheshin dhe nuk do të rrinin me të. Prandaj, me plot të drejtë themi se kjo veçori ishte një cilësi nga cilësitë që gëzuan theks të veçantë në librin e Allahut, xh.sh.

Disa prej shokëve e meritonin të fajësoheshin dhe të qortoheshin, sipas natyrës njerëzore. Kur lufta u intensifikua, ata e braktisën dhe vendosën për disfatë, ndërsa lufta ishte ende në vazhdim. Mirëpo, ai, a.s., u tregua mirëdashës ndaj tyre dhe u solle me mirësi, për shkak të një mëshire që Zoti, xh.sh., ia kishte vendosur në zemrën e tij, duke e ka veçuar. Zoti i Madhëruar e ka lavdëruar të Dërguarin e Tij, s.a.v.s. për sjelljet e tij të mira, dhe këtë e ka bërë në shumë vende në librin e tij të shtrenjtë. Pastaj tha se po të ishte i vrazhdë dhe i ashpër në marrëdhëniet me ta, ata do të ndaheshin prej teje dhe do të kishin ikur prej teje, dhe nuk do të qëndronin të qetë rreth teje. Mirëpo Zoti i solli te ti, dhe të bëri të butë për ta, për t'i harmonizuar zemrat e tyre! Pastaj Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij, s.a.v.s., që t'i tejkalojë mëkatet e tyre dhe lëshimet, dhe e urdhëroi të kërkonte falje te Zoti për ta. Gjithashtu e urdhëroi që të konsultohet me ta për çështje të rëndësishme, për të treguar respekt për ta, ngase kjo i rehabiliton zemrat e tyre, si dhe i mpreh mendimet e tyre. Më pastaj Zoti i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij që, nëse konsultohet me ta për ndonjë çështje dhe vendos ta zbatojë atë, atëherë të mbështetet në Zotin për atë, sepse Zoti e do atë që i mbështetet Atij!<sup>21</sup>

### **Rasti i zbritjes së këtij ajeti**

Ajetet flasin për betejën e Uhudit, pasi Zoti i Madhëruar e përmend disfatën e myslimanëve dhe shqetësimin e trazirat që ata i pësuan, dhe se si i udhëzoi ata në vendin e sëmundjes, duke ua përshkruar edhe ilaçin. Dhe, në këto ajete fisnike ka edhe një lavdërim për udhëheqjen e urtë-të Pejgamberit, a.s., me disa shokë që i shkelën urdhrat e tij; ai e pranoi me zemërgjerësi atë që ndodhi, dhe me sjelljen e tij fisnike dhe zemrën e mëshirshme e menaxhoi. Ai nuk iu drejtua atyre me vrazhdësi e ashpërsi, por, përkundrazi ai iu drejtua atyre me mirësi dhe butësi. Prandaj, zemrat u mblodhën rreth thirrjes së tij dhe u bashkuan nën udhëheqjen e tij.

<sup>21</sup> Dr. Esad Humid, *Ejser Et Tefasir*, sh.b: Mexheletul Ummeh, 2009, vëll: 1, f. 232.

Ajetet flasin edhe për moralin e profecisë, bekimin e madh të misionit të të Dërguarit të mëshirshëm dhe udhëheqjen e tij të urtë, si dhe për ngjarjet e tjera të rëndësishme në atë betejë.<sup>22</sup>

## 6. Prezenca e Pejgamberit, a.s., ishte siguri për shoqërim

﴿وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ وَأَنْتَ فِيهِمْ ۚ وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ يَسْتَغْفِرُونَ﴾

*“Po Allahu nuk do t'i dënojë ata derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre, dhe Allahu nuk do t'i dënojë derisa ata kërkojnë falje (istigfar).”<sup>23</sup>*

Prej veçorive të Pejgamberit, a.s., është shmangja e dënimit të shoqërisë ku ai jetonte. Edhe pse ata e meritonin një dënim nga dënimet që i përjetuan popujt e mëhershëm, si pasojë e përgënjeshtimit të të dërguarve të Allahut, xh.sh., dënime këto që gati se nuk kalon asnjë sure nga sur-et e Kuranit fisnik e mos të përmenden ato me një theks të veçantë, prapë Zoti, xh.sh., nuk i dënoi. Dhe për çdo shoqëri kishte dënim të veçantë, siç njofton Kurani: *“Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet; disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërroam me krismë nga qielli, kurse disa të tjerë i sharruam në tokë dhe disa i përmbytëm në ujë. Allahu nuk u bëri atyre ndonjë padrejtësi, por ata vetës së tyre i bënë padrejtësi.”<sup>24</sup>* Në këto lloje të dënimeve nuk bëri përjashtim asnjë shoqëri, përveç umetit të Muhamedit, a.s. Kjo ndodhi vetëm për një arsye. E, ajo ishte se nderimi dhe respekti për Pejgamberin, s.a.v.s., siç thotë mufesiri i njohur i Andaluzisë, Ibën Xhuzej El Garnati, se po, *“Allahu nuk do t'i dënojë ata përderisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre.”* Pra, për nder të Pejgamberit, a.s.<sup>25</sup>

Kurse për komentimin e pjesës së mbetur nga ajeti, *“...dhe Allahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfar)”*, thotë: *“Domethënë, nëse*

<sup>22</sup> Es Sabuni, Muhamed Ali, *Safvetu Tefasir*, sh.b. Mektebetul Asreije, 1997 Kajro, vëll: 1, f. 231.

<sup>23</sup> El Enfal: 33.

<sup>24</sup> El Ankebut: 40.

<sup>25</sup> Ebul Kasim, Muhamed bin Ahmed, El Garnati (v,741 h), Et Tes'hil li Ulumi Tenzil, sh.b: Drul Erkam, 1995 Bejrut, vëll: 8, f. 345.

*ata besuan dhe kërkonin falje, atëherë kërkitimi i faljes është siguri nga dënimi.*”. Disa prej paraardhësve thanë: “Ne kishim dy siguri nga dënimi, përkatësisht praninë e Pejgamberit, a.s., dhe duke kërkuar falje. Kur Pejgamberi, s.a.v.s., vdiq, njëra siguri u zhduk, dhe tjetra mbeti”.<sup>26</sup>

Të gjithë popujt që e përgënjeshtroan thirrjen e pejgamberëve e shijuan dhembshëm nga një lloj të ndëshkimit të lartpërmendur, përveç umetit të Muhamedit, s.a.v.s. Edhe pse ata e kërkonin prej tij ngutjen e ndëshkimit të tyre në këtë botë, Zoti nuk i ndëshkoi. “*Ata kërkojnë prej teje ngutjen e ndëshkimit, e sikur mos të ishte afati i caktuar, atyre do t’u vinte ndëshkimi, po ai patjetër do t’u vijë atyre befaz ashtu që ata nuk e hetojnë*”.<sup>27</sup>

Megjithatë, Allahu Fuqplotë nuk zbriti mbi ta dënim për t’i shfarosur, siç veproi me popujt para tyre. Allahu e vonoi dënimin e tyre përderisa në mesin e tyre të ishte Muhamedi, a.s. Kjo tregon që Allahu, xh.sh., do ta ngadalësojë ndëshkimin e tyre deri në Ditën e Kiametit, mirëpo nuk do ta ngadalësojë përgjithmonë.<sup>28</sup>

## 7. Pozita dhe ndjeshmëria e Pejgamberit, a.s., ndaj besimtarëve

﴿النَّبِيُّ أَوْلَىٰ بِالْمُؤْمِنِينَ مِنْ أَنفُسِهِمْ وَأَزْوَاجُهُ أُمَّهَاتُهُمْ﴾

*“Pejgamberi është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre.”*<sup>29</sup>

Ky ajet tregon gjerësinë e personalitetit të Pejgamberit, a.s. Kjo gjerësi e bëri Pejgamberin, a.s., të denjë për t’i nxënë të gjithë besimtarët, siç e bëri të denjë që të ketë ndjeshmëri për ta më tepër sesa që ata kanë për veten e tyre! Kjo gjerësi duhej të ruhej në mënyrë të vazhdueshme, e për këtë dhe ishte i urdhëruar prej Allahut të Gjithëmëshirshëm:

<sup>26</sup> I njëjti burim, vëll: 8, f. 345.

<sup>27</sup> El Ankebut: 53.

<sup>28</sup> Abdulvehab Abdul Ati Abdullah, *Menahixh ulili azem minerar Rrusul*, sh.b. Universiteti i Ez’herit, 1991, Kajro, F. 46.

<sup>29</sup> El Ahzab: 6.



﴿فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ﴾

“Prandaj ti falua atyre, dhe kërko ndjesë për ta!”<sup>30</sup>

﴿فَاصْفَحِ الصَّفْحَ الْجَمِيلَ﴾

“E ti (Muhamed) sillu me njerëzshmëri.”<sup>31</sup>

Zoti i Plotfuqishëm e ka njohur dhembshurinë e të Dërguarit të Tij për umetin e tij. Ai e bëri atë më të rëndësishme për ta sesa ata për veten e tyre. Dhe, gjykimin e tij për ta e vuri para zgjedhjes së tyre për vetveten, siç njofton Zoti, xh.sh., në këtë ajet: “Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty, as të asaj para teje) derisa mos të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) mos të ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) mos të binden sinqerisht.”<sup>32</sup> “<sup>33</sup>

Në hadithin e saktë thuhet: “Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, askush prej jush nuk beson derisa mos të jem më i dashur për të sesa shpirti i tij, paratë e tij, fëmijët e tij dhe të gjithë njerëzit!”<sup>34</sup>

Buhariu transmeton për këtë ajet fisnik, prej Ebu Hurejres, r.a., prej Pejgamberit, a.s., i cili ka thënë: “Nuk ka besimtar përveçse kur unë jam më i afërti me të në këtë botë dhe ahiret. Lexoni nëse dëshironi: “Pejgamberi është me i merituar për besimtarët sesa vetja e tyre”.<sup>35</sup>”

Pejgamberi, a.s., është më i denjë për besimtarët në bindje ndaj tij (sesa ata vetë), domethënë ndaj njëri-tjetrit.<sup>36</sup>

<sup>30</sup> Ale Imran:159.

<sup>31</sup> El Hixhër: 85.

<sup>32</sup> En Nisa: 65.

<sup>33</sup> Ibën Kethir, Ebul fida, Ismail ibën Kethir, v 774 h, *Tefsirul Kur'anil Adhim.*, sh.b: Darul Merifeti, Bejrut, 1983, vëll: 2, f. 450 vëll: 2, f. 450.

<sup>34</sup> Buhariu, kitabul Ijman, bab: huburresul, s.a.v.s., nr: 15.

<sup>35</sup> El Ahzab: 6.

<sup>36</sup> Mukatil, Ibën Sylejman, (150 h), www.altafsir.com/tefesirmukatil.

### 8. Mbrojtja e Pejgamberit, a.s., prej njerëzve

﴿يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۗ وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَغْتَ رِسَالَتَهُ ۗ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ﴾

*“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen)! Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon”<sup>37</sup>*

Sejid Tantavi thotë: “Mbrojtja këtu është mbrojtje e shpirtit dhe e trupit të tij, s.a.v.s., që mos të vritet ose mos të shkatërrohet, dhe mbrojtja e thirrjes së tij që mos të pengohet suksesi i saj nga ndonjë faktor. Kjo nuk bie ndesh me atë që u sprovua ai, s.a.v.s., në aspektin e vuajtjeve dhe torturave e lëndimit trupor, sepse mushrikët e gjuanin me gurë derisa i rridhte gjaku e iu pre fytyra, dhe iu thye edhe dhëmballa gjatë betejës së Uhudit.

Ajo që nënkuptohet me njerëzit këtu është se janë mushrikët, hipokritët, çifutët dhe ata që janë të ngjashëm me ta në mosbesim, devijim dhe kokëfortësi që e donin të vdekur Pejgamberin, a.s., pasi nuk ka asnjë prej besimtarëve të vërtetë, përveçse që e do Zotin dhe të Dërguarin e Tij. Dhe, ky ajet fisnik e përfshinte një mrekulli të madhe të të Dërguarit, s.a.v.s., ku tregohet se Zoti i Plotfuqishëm e mbrojti jetën e të Dërguarit të tij që mos të vritet apo të shkatërrohet nga duart e njerëzve, sado që ata mund të trillonin dredhi e kurthe me dinakëri për të. Ai u shpëtua nga komplotet e tyre kur u mblodhën për ta vvarë në Dar Al Nedva, në natën e shpërnguljes së tij në Medine. Dhe ai u shpëtua edhe nga komploti i hebrenjve, kur ata donin ta hidhnin një gur mbi të, derisa ai ishte ulur nën strehën e një shtëpie të tyre. Dhe ai u shpëtua nga dinakëria e tyre kur njëra prej grave të tyre futi helm në ushqimin që u përgatit për të, s.a.v.s., si dhe shumë ngjarje të tjera që Pejgamberi, s.a.v.s., u ekspozua nga armiqët e tij. Mirëpo, Zoti i Plotfuqishëm e shpëtoi prej tyre.”<sup>38</sup>

<sup>37</sup> El Maide: 67.

<sup>38</sup> Et Tantavij, Muhammad Sejjid, *Et Tefsir El Vasit lil-Kuranil Kerim*, sh.b: Dar Nahdatu Miser, 1998 Kajro, vëll: 6, f. 175.

## 9. Allahu, xh.sh., është betuar në jetën e Pejgamberit, a.s.

﴿لَعَمْرُكَ إِنَّهُمْ لَفِي سَكْرَتِهِمْ يَعْمَهُونَ﴾

*“Pasha jetën tënde (Muhamed), s’ka dyshim se ata (populli i Lutit) ishin të humbur në dehjen e tyre!”<sup>39</sup>*

Ibën Abbasi, tha se Zoti nuk ka krijuar dhe nuk ka shpërndarë në ekzistencë asnjë shpirt që është më i nderuar te Ai sesa Muhamedi, a.s., dhe kurrë nuk e kam dëgjuar Zotin të betohet për jetën e dikujt tjetër, përveçse në të. Zoti i Madhëruar ka thënë: “Për jetën tënde, ata verbohën në dehjen e tyre!”<sup>40</sup>

I Plotfuqishmi u betua për jetën e Pejgamberit, a.s., dhe në këtë ka nder të madh për të dhe tregon një pozitë të lartë dhe prestigj të madh<sup>41</sup> me të cilin u veçua Pejgamberi ynë, a.s. Në Kurani kerim nuk mund të gjejmë ndonjë ajet që tregon se i Lartëmadhërishti është betuar në jetën e dikujt tjetër përveçse në jetën e Muhamedit, a.s.

## 10. Edukata e Pejgamberit, a.s., gjatë qëndrimit në shtëpi

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتَ النَّبِيِّ إِلَّا أَنْ يُؤْذَنَ لَكُمْ إِلَى طَعَامٍ غَيْرٍ نَاظِرِينَ إِنَاهُ وَلَكِنْ إِذَا دُعِيتُمْ فَادْخُلُوا فَإِذَا طَعِمْتُمْ فَانْتَشِرُوا وَلَا مُسْتَأْنِسِينَ حَدِيثٍ ۚ إِنَّ ذَلِكُمْ كَانَ يُؤْذِي النَّبِيَّ فَيَسْتَحْيِي مِنْكُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يَسْتَحْيِي مِنَ الْحَقِّ ۗ وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ مَتَاعًا فَاسْأَلُوهُنَّ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ ۚ ذَلِكُمْ أَطْهَرُ لِقُلُوبِكُمْ وَقُلُوبِهِنَّ ۗ وَمَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُؤْذُوا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا أَنْ تَنْكِحُوا أَزْوَاجَهُ مِنْ بَعْدِهِ أَبَدًا ۚ إِنَّ ذَلِكُمْ كَانَ عِنْدَ اللَّهِ عَظِيمًا﴾

*“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë*

<sup>39</sup> El Hixhër: 72.

<sup>40</sup> Taberi, vëll: 14, f. 155.

<sup>41</sup> Ibën Kethir: vëll: 2, f. 273.

*shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) e mendojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; Allahu nuk i turpërohet realitetit! E kur kërkoni prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e Allahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto janë tek Allahu mëkat i madh.*<sup>42</sup>

Kuptimi është ky: O ju që e keni besuar Zotin e Lartmadhëruar - me besimin e drejtë, në asnjë rast mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit, a.s., nëse nuk ju jepet leje për t'u futur në to për të marrë pjesë në ushqimin që jua fton për të ngrënë. E, prania juaj le të jetë në kohën e duhur për ta ngrënë atë, dhe jo më parë, duke hyrë para se të përgatitet ushqimi për një kohë të gjatë. Duke pritur aty derisa të piqet e t'u servohet para për të ngrënë. Disa prej atyre e kishin zakon, në kohën paraislame, që të hyjnë në shtëpi pa leje, dhe nëse gjenin ushqim duke u përgatitur, prisnin derisa të ishte gati për ta ngrënë. Ndalimi në ajetin fisnik është për ata që kanë hyrë pa ftesë dhe për ata që kanë hyrë me ftesë, mirëpo që kanë qëndruar në pritje të ushqimit derisa të jetë gati, pa pasur nevojë për këtë pritje.<sup>43</sup>

Mufesiri i njohur Alusi, për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thotë: “O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit, a.s., nëse nuk ju është dhënë leja!”. Ky ajet fillon për t'i shpjeguar disa detyrime të njerëzve, e që lidhën me Pejgamberin, s.a.v.s., kur është me gratë e tij, si dhe rasti kur edhe u shpall ky ajet, e që është martesë e tij me Zejneben, vajzën e Xhahshit. Imam Ahmedi, El Buhariu, Muslimi, Nesaiu, Ibën Xheriri, Ibën El Mundhiri, Ibën Ebi Hatimi, Ibën Mardevejhi dhe El Bejhakiu në Sunenin e tij kanë transmetuar prej Enesit, r.a., i cili ka thënë se, kur i Dërguari, s.a.v.s., u martua me Zejneb bint Xhahshin, i thirri njerëzit dhe ata u ushqyen, pastaj u ulën duke biseduar, dhe ai u bë kinse bëhej gati për t'u ngritur, mirëpo ata prapë vazhduan bisedën dhe nuk u ngritën. Kur e pa se nuk po ngriheshin, ai u çua dhe ata u çuan bashkë me të dhe dolën nga aty, mirëpo përsëri tre veta kishin mbetur ulur brenda pa u larguar

<sup>42</sup> El Ahzab: 53.

<sup>43</sup> Et Tantavi, *Et Tefsir El Vasit lil-Kuranil Kerim*, vëll: 12, f. 278.

ende! Pejgamberi, a.s., priti jashtë më pas, derisa të largohen edhe ata tre të fundit. Kur këta u larguan. Enesi, r.a., thotë: “Shkova dhe i thashë Pejgamberit, a.s., se ishin nisur, dhe ai erdhi dhe hyri. Kur desha me hy, u hodh mbulesa mes meje dhe tij; “O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit”, dhe ajeti me ndalimin!”<sup>44</sup> Pra, ua ndaloi që të hynin brenda pa leje.

### 11. Pejgamberi, a.s., vulë e të gjithë pejgamberëve

﴿مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا﴾

*“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguar i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e Allahu është i dijshtëm për çdo send.”<sup>45</sup>*

Fjala e Lartëmadhërishmit: (Dhe Vula e Pejgamberëve), ka kuptimin; dhe i fundit prej tyre që i vulosi, ose u vulosën me të. Dhe nëse ai do ta kishte një djalë të rritur, do të kishte qenë në pozitën e tij për të qenë pejgamber, siç tha ai, s.a.v.s., për Ibrahimin kur vdiq: “Po të kishte jetuar, do të kishte qenë pejgamber.”. Kjo nuk bie në kundërshtim as me zbritjen e Isait pas tij, sepse nëse ai zbret, ai është në fenë e tij (Muhamedit), edhe pse ajo që nënkuptohet me të është se (Isa) ai ishte i (para)fundit prej pejgamberëve. (Dhe Zoti është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë) Ai e di se kush është i denjë të vuloset pejgamberia me të, dhe si duhet bërë.<sup>46</sup>

<sup>44</sup> El Alusi, Shihabedin, Es Sejjid Mahmud, (v.1270 h), *Ruhul Meani*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, Bejrut, vëll: 3, f. 313.

<sup>45</sup> El Ahzab: 40.

<sup>46</sup> El Bejdavi, (v.791 h), *Tefsir El Bejdavi*, recenzt: Abdulkadir Hasune, sh.b: Darul Fikër, 1996 Bejrut, vëll: 4, f. 345.

## 12. I dërguar për mbarë njerëzimin

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا﴾

*“Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguar i Allahut te të gjithë ju.”!*”<sup>47</sup>

I Plotfuqishmi i thotë pejgamberit dhe të dërguarit të Vet, Muhamedit, alejhi selam: “Thuaj, o Muhamed: “O njerëz!”, - dhe kjo është njoftim për të kuqtë, të zinjte, arabët dhe joarabët, - “unë jam i Dërguari i Zotit për të gjithë ju”; që do të thotë të gjithë ju, dhe kjo është nga nderimi dhe madhështia e tij, paqja e Zotit qofshin mbi të, se ai është vula e pejgamberëve, dhe se është dërguar për të gjithë njerëzit, siç ka thënë Zoti i Madhëruar.<sup>48</sup>

﴿وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ﴾

*“Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit.”*<sup>49</sup>

﴿تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَىٰ عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا﴾

*“I lartë është Ai që ia ka shpallur Kuranin (i cili ndanë të vërtetën prej të pavërtetës) robit të Vet (Muhamedit), që të jetë paralajmërues për botët (njerëzit)!”*<sup>50</sup>

## 13. Zotimi i marë prej të gjithë pejgamberëve për ta besuar Pejgamberin, a.s.

﴿وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ النَّبِيِّينَ لَمَا آتَيْتُكُمْ مِنْ كِتَابٍ وَحِكْمَةٍ ثُمَّ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مُّصَدِّقٌ لِّمَا مَعَكُمْ لَتُؤْمِنُنَّ بِهِ وَلَتَنْصُرُنَّهُ قَالَ أَأَقْرَرْتُمْ وَأَخَذْتُمْ عَلَىٰ ذَلِكُمْ إِصْرِي قَالُوا أَقْرَرْنَا قَالَ فَاشْهَدُوا وَأَنَا مَعَكُمْ مِنَ الشَّاهِدِينَ﴾

*Allahu ua ka marrë besën profetëve, kur u ka dhënë Libër dhe urtësi. “Pastaj ju vjen një pejgamber, i cili e vërteton se është e saktë*

<sup>47</sup> El Earaf: 158.

<sup>48</sup> Ibën Kethir, vëll: 1, f. 554.

<sup>49</sup> Sebe: 28.

<sup>50</sup> El Furkan: 1.

*ajo çka e keni, a gjithsesi do t'i besoni dhe patjetër do ta ndihmoni? A e pranoni, - tha, se me këtë merrni obligimin tim?” Ata thoshin “E pranojmë”! “Atëherë, pra, dëshmojeni, - u thotë – se edhe unë jam me ju, një prej dëshmitarëve”.<sup>51</sup>*

Ky ajet fisnik na njofton se Zoti, xh.sh., e mori besëlidhjen prej të gjithë pejgamberëve dhe të dërguarve, qysh nga Ademi, a.s., e deri tek Isai, e që nëse pejgamberi Muhamed, a.s., do të shfaqej gjatë besëlidhjes së tij dhe do të dërgohej, ata e kishin obligim për të besuar në të dhe për ta ndjekur atë.

#### 14. Falja e gabimeve të mëparshme dhe atyre të ardhshme

﴿إِنَّا فَتَحْنَا لَكَ فَتْحًا مُّبِينًا﴾ ﴿١﴾ لِيُغْفِرَ لَكَ اللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِن ذَنْبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ  
وَيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَيَهْدِيكَ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا﴾ ﴿٢﴾

*“Ne ta dhamë ty fitoren e qartë, (1) për t'i falur ty Perëndia gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të udhëzuar ty në rrugën e drejtë. (2)”<sup>52</sup>*

Prej veçorive të Pejgamberit, a.s. është falja e gabimeve të mëparshme dhe të ardhshme. Fitorja ishte për shkak të nderit të Pejgamberit, a.s., prej Zotit të tij, siç ishte nga arsyet e tij se Zoti do ta falë Pejgamberin, a.s., me një falje të përgjithshme, në mënyrë që ta plotësojë nderin. Kjo është një falje e veçantë e Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të.<sup>53</sup>

<sup>51</sup> Ali Imran: 81.

<sup>52</sup> El Fet’h: 1-2.

<sup>53</sup> Ibën Ashur, Muhamed Tahir. *Et Tahrir ve-t- Tenvir*, Tunis: Dar tunisije, 1984, vëll: 26, f. 342.

### 15. Veçoria e fundit e Pejgamberit, a.s., është se ai ishte njeri

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهُ وَاحِدٌ ۚ فَمَن كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾

*“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij mos ta përziejë askënd.”!*”<sup>54</sup>

Thënia e Plotfuqishmit: *“Thuaj: “Unë jam vetëm një njeri si ju, më është shpallur se Zoti juaj është vetëm një Zot...”*. Ibën Abbasi ka thënë: “Zoti ia mësoi të Dërguarin e Tij përulësinë, që mos të krenohej me krijimin e tij, prandaj e urdhëroi që të pranojë dhe të thotë: “Unë jam njeri si ju, vetëm se unë u veçova për shpallje dhe Zoti më nderoi me të.”<sup>55</sup>

I Plotfuqishmi I thotë: *“Thuaj: “Unë jam vetëm një njeri si ju, e më është shpallur se Zoti juaj është një Zot!”*. Kufizimi i parë është se ai, s.a.v.s., kishte ngjashmëri të plotë në aspektin njerëzor sikurse të gjithë njerëzit; ai nuk dallon nga ata me asgjë, dhe nuk pretendoi për vete përballë asaj që pretenduan ata se, nëse ai e pretendon profetësinë, duhet ta pretendojë të qenët një qenie hyjnore dhe një fuqi e padukshme. Për këtë arsye ata e kërkonin prej tij atë çka nuk e dinin as ata e as ai, a.s., por që e di vetëm Zoti, dhe që nuk mundet ta bënte askush përveçse vetëm Zoti. Mirëpo, ai s.a.v.s., i mohoi të gjitha këto, me urdhrin e Zotit dhe në emër të Tij, dhe ai nuk ia vërtetoi vetes asnjë nga ato pretendime, vetëm se atij i ishte shpallur shpallje.<sup>56</sup>

Thuaj: *“O Muhamed!”*, - dhe kjo është një fjalë e re! *“Thuaj: “Unë jam vetëm një njeri si ti...”!*”, - e që, sikur do të thotë: Më merrni si shembull, se unë nuk jam melek, por unë jam një qenie njerëzore si ju, dhe e ngarkova veten ta ndjek atë që ju urdhëroj ta ndiqni, sepse nuk ju urdhë-

<sup>54</sup> El Kehf: 110.

<sup>55</sup> El Begevij, Muhamed El Husejn Ibën Mesud, (v, 516 h), *Mealimut-Tenzil*, sh.b, Darul Kutub El Ilmije, Bejrut, 2004, vëll: 4, f. 434.

<sup>56</sup> Muhamed Husejn Et Taba Tabai, *El Mijzan fi tefsiril Kur’an*, sh.b: El buharijetu, Beirut, vëll: 19, f. 87.



roj me diçka që unë jam jashtë saj! Përkundrazi, ai, s.a.v.s., ishte më pak fatlumi i njerëzve nga kënaqësitë dhe zbukurimet e jetës.<sup>57</sup>

Në mesin e besimtarëve ishin të pasurit që e shijonin ushqimin e shijshëm dhe i vishnin rrobat më të shtrenjta, ndërsa ai, s.a.v.s., kalonte një muaj e dy muaj pa e ndezur zjarrin në shtëpinë e vet, pra, për ushqim. Fëmijët e tij nuk lejohet që ta trashëgojnë siç trashëgojnë njerëzit e tjerë, ashtu siç nuk u lejohet që ta marrin zekatin ashtu sikurse gjithë të tjerët, kështu që ata janë të privuar nga një e drejtë që e kanë gëzuar të tjerët. Prandaj, Pejgamberi, lavdërimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të, ishte më pak i ekspozuar ndaj kënaqësive dhe zbukurimeve të jetës. Kjo na tërheq në faktin se Muhamedit, a.s., mesazhi nuk i solli dobi të kësaj bote, si dhe nuk e dalloj prej të tjerëve në këtë bote, por më tepër e dalloj në vlera dhe virtyte.

Kjo vihej re edhe nga idhujtarët e Mekës, që e kundërshtonin ngjashmërinë e të Dërguarit të Allahut me ta në çështjet normale të jetesës. Ata thanë:

﴿وَقَالُوا مَا لِي هَذَا الرَّسُولِ يَأْكُلُ الطَّعَامَ وَيَمْشِي فِي الْأَسْوَاقِ﴾

*E ata thanë: “Ç’është me këtë të dërguar, i cili ha ushqim dhe ecën nëpër tregje?”<sup>58</sup>*

## Përfundimi

Në përmbyllje të këtij punimi themi se njohja e veçorive të Pejgamberit, s.a.v.s., e ngre ndjenjën e vlerësimit të tij në zemrat e besimtarëve myslimanë. Nuk ka dyshim se Pejgamberi, a.s., gëzon një respekt të veçantë te myslimanët. Megjithatë, kjo do të kontribuojë në ngritjen edhe më tepër të pozitës së Pejgamberit, a.s., te myslimanët. Ne shpresojmë se lexuesi, përmes njohjes me këto veçori, e ka më të lehtë t’i kuptojë objektivat kryesore të shpalljes së fundit (Kuranit) dhe misionin e Islamit në shoqëri. Këto veçori shërbejnë edhe si udhëzues për ta kuptuar sa më drejt Su-

<sup>57</sup> Muhamed Muteveli, Esh Shaaravij, *Tefsir El Havatir*, sh,b, Ahbar El Joum, Kajro 1997, vëll: 21, f. 234.

<sup>58</sup> El Furkan: 7.

netin/traditën e Pejgamberit, a.s., duke siguruar kështu një frymë reale e praktike të fesë sonë, nëse ajo drejtohet sipas kornizës që e përcaktojnë veçoritë e lartpërmendura, më të cilat është dizajnuar e konceptuar personaliteti i Pejgamberit, a.s., prej të Plotfuqishmit dhe të Gjithëmëshirshmi, Allahut, xh.sh. (*Allahume Sali ve selim ala sejidina Muhamedin ve ala ali Muhamed, teslimen kethiren!*).

---

### Literatura:

#### *Kurani Kerimi.*

1. Prof. Hasan. I. Nahi, *KUARNI i madhërishtëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe. AIITC, 2006 Tiran.
2. Sh. Ahmeti, *KURANI* –përkthim me komentim në gjuhën shqipe. I shtypur në kompleksin e hsëbyesit të dy haremeve, në Medine 1413 h.
3. Dr. Esad Humid, *Ejser et-Tefasir*, sh.b: Mexheletul Ummetul Arabije, 2009.
4. Ebu Abdullah, Ahmed bin Hambel, (v.241h). *Musned Imam Ahmed*, recensent: Ahmed Aburrezzak dhe Ejmen Ibrahim the të tjerë, sh.b: Dar Alemul Kutub, botimi I, 1998 Bejrut.
5. Ebu Daudi, Sulejman bin El Esh'ath, (v.275h), *Kitab Essunen*, botimi I, sh,b: Darul Mearife, Bejrut.
6. Ebus Suud, Muhamed bin Muhamed, (v.951h) *Irshadul Aklis Selim Ila Mezajal Kuranil Kerim*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, Bejrut.
7. El Kasimi, Xhemaludin bin Muhamed, (v.1332h), *Mehasinu Te'viil*, botimi I, sh,b. Muessesetu Tarih El Arabij, Bejrut, 1994.
8. El Alusi, Shihabedin, es-Sejjid Mahmud, (v.1270h), *Ruhul Meani*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, Bejrut.
9. El Begevij, Muhamed El Husejn bin Mesud, (v.516h), *Mealimut –Tenzil*, sh.b, Darul Kutu bEl Ilmije, Bejrut, 2004.
10. El Bejdavi, (v.791h), *Tefsir El Bejdavi*, recensent: Abdulkadir Hasune, sh.b: Darul Fikër, 1996 Bejrut.

11. Ebul Kasim, Muhamed bin Ahmed, El Garnati (v.741h), *Et Teshil li Ulum Et Tenzil*, sh.b: Drul Erkam, 1995 Bejrut.
12. El Hazini, Alaudin bin Muhamed, (v.741h), *Lubabu Te'vil fi Meani Tenzil*, sh.b: Darul Kutub El Ilmije, Bejrut 1994.
13. El Maturidi, Muhamed bin Muhamed bin Muhamed, (v.333h), *Te'vilat Alu Suneh*, sh.b: Darul Kutub El Ilmije, Bejrut 2005.
14. Es Sabuni, Muhamed Ali, (v.2021), *Safvetu Tefasir*, sh.b. Mektebetul Asreije, 1997 Kajro.
15. Et Taberi, Muhamed bin Xheri, (v.310h), *Xhamiul Bejan Ante'vil Ajil Kuran*, sh.b: Darul Fikër, 1985 Bejrut.
16. Et Tantavij, Muhammad Sejjid, *et-Tefsir El Vasit lil-Kuranil Kerim*, sh.b: Dar Nahdatu Miser, 1998 Kajro.
17. Et-Termidhi, Muhamed bin Isa bin Sureh, (v.275h), *Sunen et-Termidhi*, recensent: Mustafa Muhamed Husejn edh-Dhehbi, sh.b: Darul Hadith, botimi I, 1999 Kajro.
18. Ez-Zemahshari, Mahud bin Omer, (v.538h), *El Keshaf*, sh.b: Dar Ihja Et Turath El arabij, botimi I, 1997 Bejrut.
19. Ibën Ashur, Muhamed Tahir. *Et-Tahrir ve-t- Tenvir*, Tunis: Dar tunisije, 1984.
20. Ibën Kethir, Ebul fida, Ismail bin Kethir, (v.774h)A, *Tefsirul Kuranil Adhim*. vëll: 2, f: 450, sh.b: Darul Merifeti, Bejrut, 1983.
21. Muhamed husejn et- Taba tabai, (v.1981), *El Mijzan fi tefsiril Kuran*, sh,b: El buharijetu, Beirut.
22. Muhamed Muteveli, esh-Shaaravij, (v.1998), *Tefsir El Havatir*, sh,b, Ahbar El Joum, Kajro 1997.

Dr. Lulzim ESATI

## **THE CHARACTERISTICS OF THE PROPHET (PBUH) IN THE NOBLE QUR'AN**

### **Abstract**

The Prophet, peace be upon him, was a living Qur'an, who walked among people. There is no doubt that this was the main characteristic of his and it encompassed in itself other characteristics as well, which we will mention below. Based on the aforementioned, in this paper, we aim to highlight the most prominent characteristics of the Prophet in the noble Qur'an, which depicted him as a person who possessed the highest moral excellence and made him a perfect example for all believers. This enables us to further understand the noble personality of the Prophet by teaching us additional reasons that made him a prophet for all mankind, as well as the proclamation of his message as the culmination of all revelations.

**Keywords:** *morality, kindness, gentleness, security, mercy, tolerance*



Dr. Ajni SINANI

## **PRETENDIMET E PAPRANUESHME TË ORIENTALISTËVE LIDHUR ME KURANIN FISNIK**

### **Abstrakt**

Shumë autorë jomyslimanë e kanë lavdëruar Kuranin dhe Muhamedin, a.s. Mirëpo sikurse më herët, edhe në ditët tona ata gjithmonë janë përpjekur t'i bishtojnë të vërtetës në lidhje me Islamin. Kështu ata kanë dalë me shumë pandehje dhe pretendime lidhur me Pejgamberin, a.s., dhe Kuranin fisnik. Një sërë orientalistësh janë kapur pas ca pretendimeve që bien ndesh me logjikën dhe arsyen. Disa të tjerë thanë se Kurani është shkruar prej Muhamedit, a.s., dhe nuk është shpallje e Zotit. Informacionin e gjetur në Kuran ia atribuuan priftit Behira, apo pretenduan se informacioni i erdhi nga nënvetëdija. Ca sosh dolën me përfundimin se ai ishte i sinqertë, sepse besonte vërtet në pejgamberinë e tij, mirëpo ishte në lajthitje! Apo misionin e Muhamedit, a.s., e reduktuan në të qenët e tij një nacionalist që desh t'i reformojë dhe t'i bashkojë arabët. Disa pretenduan se situata e shpallës e përjetuar prej Pejgamberit, a.s. ishte një krizë epilepsie.<sup>1</sup> Në vazhdim do t'i shqyrtojmë këto pretendime.

***Fjalët çelës:** Kurani fisnik, shpallja, Xhibrili, a.s., Muhamedi, a.s.*

---

<sup>1</sup> Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa I, Shkodër, 2012, f. 158.

### Kurani nuk është shkruar prej Muhamedit, a.s.

Disa autorë jomyslimanë, që nuk e pranojnë dot lartësinë sublime të Kuranit fisnik, thonë se Kurani nuk është shpallje prej Zotit, por është shkruar prej Muhamedit, a.s. Këtë pikëpamje e kishin: Richard Bell, Arberry, Kenneth Cragg<sup>2</sup> etj.

Mirëpo, pretendimi se Kurani është prej Muhamedit, a.s., siç vëren edhe **Montgomery Watt**, “në vetvete ngre shumë pyetje. Nëse Muhamedi, a.s., ishte falsifikues, a po e bënte këtë falsifikim me qëllim të keq? Ndërkaq, ai nuk njihej si një person i pandershëm dhe një person që shërbehej me gënjeshtër?! Pastaj, çfarë e solli befasi atë ndryshim tek ai nga një njeri i ndershëm në një njeri gënjeshtar?! Nëse ai me të vërtetë e ka bërë me qëllim të keq, nga i ka marrë të gjitha ato informacione që gjenden në Kuran, veçanërisht nëse kemi parasysh se ai ka jetuar në një vend shkëmbor e shkretinor sikurse Meka?! A kishte mësues Muhamedi, a.s.? Nëse po, kush ishin ata, dhe ku dokumentohet se ai kishte mësues?!<sup>3</sup>. Pra, janë shumë pyetje të cilave nuk mund t’u japin përgjigje ata që pretendojnë se Muhamedi, a.s., është autor i Kuranit.

Teologët e hershëm të krishterë, sikurse Bede (v. 735), Johannes Damascenus (Juhanna Ed Dimashki (v. 749) dhe nxënësi i tij Theodore Ebu Kurre (v. 825), janë mendimtarët e parë që kanë folur për Islamin, Kurandin dhe Pejgamberin, a.s. Dimashkiu është teologu i parë i rëndësishëm i perceptimit teologjik për Islamin. Sipas tij, Muhamedi, a.s., ishte një “pejgamber jo i vërtetë, rastësisht e ka parë Testamentin e Vjetër dhe atë të Riun, ka pretenduar se është takuar me një prift pasues të Ariusit (ka për qëllim priftin Bahira), dhe kështu e ka themeluar sektin e vet të devijuar.”. Dimashkiu do ta cilësonte Muhamedin, a.s., si “lajmëtar të Anti-

<sup>2</sup> Richard Bell në *The Qur'an: Translated With a Critical Re-arrangement of the Surahs*; Arberry në parathënien e tij për përkthimin e tij të Kuranit; Kenneth Cragg në *The Call of the Minare, ad nauseum*, shih: Nadnaravni Kur'an, pjesa II.: Kuran naspram orjentalista, shih: epilepsija | Upoznaj islam (wordpress.com).

<sup>3</sup> Nadnaravni Kur'an, pjesa II, op. cit.

krishtit". Kjo mënyrë perceptimi do të vazhdonte përgjatë Mesjetës, e deri në ditët tona.<sup>4</sup>

Prandaj, Muir dhe Margoliouth ia atribuuan informacionin e gjetur në Kuran priftit Behira, të cilin Pejgamberi, a.s., e takoi në Siri, vetëm një herë, në moshën 12 vjeçare, së bashku me xhaxhanë, si pjesëtar i një karvani tregtie! Mirëpo, ky pretendim është parë si joserioz, i palogjikshëm dhe krejtësisht i papranueshëm.<sup>5</sup>

Tomas Karlajl i refuzon legjendat qesharake rreth Muhamedit mashtrues, si dhe atë të pëllumbit të stërvitur dhe të demit.<sup>6</sup> Sipas Karlajlit Muhamedi, a.s., nuk është një njeri i rremë, sepse si mundet që një njeri i rremë të themelonte një fe?! Një njeri i madh nuk mund të jetë tjetër vetëm se i sinqertë.<sup>7</sup>

Shumë kritikë u detyruan të thonë se Muhamedi, a.s., ishte një person jashtëzakonisht i sinqertë dhe i ndershëm. Ata vunë re gjithashtu edhe faktin se ai nuk kishte asnjë përfitim material, pasi vazhdonte të bënte një jetë të ndershme dhe modeste edhe pas pranimit të shpalljes. Mirëpo, për të mos e pranuar të vërtetën, ata dolën me përfundimin se ai ishte i sinqertë, por se ishte në lajthitje!<sup>8</sup>

Nëse Muhamedi, a.s., ishte në lajthitje, atëherë nga i mori gjithë ato informacione?! Disa thanë se këto i erdhën **nga nënvetëdija (subkoshienca)**. Mirëpo, këto pretendime bien poshtë kur shohim aq shumë informacion në Kuran se sa është e pamundur që Kurani të mundet të jetë rezultat i nënvetëdijes (subkoshienca) së një individi.<sup>9</sup>

<sup>4</sup> Ibrahim Kallën, Islami dhe Perëndimi, Logos-A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2011, f. 50-51.

<sup>5</sup> Nadnaravni Kur'an, pjesa II, op. cit.

<sup>6</sup> Në mesjeten e hershme murgu Serius, kishte shkruar se Muhamedi (a.s.) kishte stërvitur një pëllumb që i çukëste veshin, apo se kishte lidhur Kuratin në brirët e një demi. Claude Savary, Le Coran..., sipas, *John Tolan, Muhamedi i romantizmit evropian, shih: Muhamedi i romantizmit evropian* » Erasmus (erasmusi.org).

<sup>7</sup> Thomas Carlyle, On Heroes, Ibid.

<sup>8</sup> Nadnaravni Kur'an, pjesa II, op. cit.

<sup>9</sup> Ibid.



Andersson tha: “Shpallja ishte të kredhurit në mendime (“wishful thinking”)”.<sup>10</sup>

Claude Savary, përkthyesi i Kuranit në frëngjisht, nuk e përdori asnjëherë termin mashtrues (impostor) për ta përshkruar Muhamedin, a.s., ndonëse ai mendonte se Muhamedi, a.s., u shtir se e mori revelatën. Një njeri dhe ligjvënës madhështor si Muhamedi, (a.s.), sipas **Savaryt**, duhet të shpikte një burim hyjnor për ligjin e tij, dhe ta krijonte një mit të origjinës për një komitet të ri.<sup>11</sup> Prandaj, Savary ndonëse besoi se Muhamedi, a.s., u shtir si pejgamber, prapë nuk e kritikoi!

Lamartini nuk e konsideron Muhamedin, a.s., si mashtrues (impostor) apo hipokrit. Për Lamartinin (sikurse edhe për Napeleonin), një njeri i madh është detyrimisht i sinqertë.<sup>12</sup> Mirëpo, ai nuk e pranon as pikëpamjen myslimane të origjinës hyjnore të shpalljes. Lamartini i rikthehet legjendës së epilepsisë, që sipas tij nuk është negative, por që është diçka që “Muhamedi, (a.s.), e ka të përbashkët me njerëz të tjerë të mëdhenj, sikurse Jul Çezari, dhe është një pasojë e fuqisë së mendimit të tij. Vegimet dhe ëndrrat e tij, që janë pjesërisht rezultat i këtyre krizave epileptike, ai i mori me plot sinqeritet si shpallje nga Zoti, të cilat më pas i thuri me elokuencë në Kuranin e tij, duke treguar gjenialitetin e tij si predikues dhe ligjvënës.”<sup>13</sup>

### **Shumë gjenive të famshëm u atribuohet çmenduria dhe epilepsia**

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, sidomos në gjysmën e dytë të tij, shumë shkencëtarë të njohur psikoanalitikë gjenive të famshëm u atribuonin çmendurinë dhe epilepsinë, sikurse, për shembull: Aleksandrit të Maqedonisë, pastaj filozofit grek Sokrati, Jul Çezarit, Napoleon Bonapartit, piktorit të famshëm Michelangelo, Nietzsches, poetëve të famshëm Fri-

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Claude Savary, *Le Coran...*, sipas, *John Tolan, Muhamedi i romantizmit evropian, op. cit.*

<sup>12</sup> Shih më shumë: Ajni Sinani, *Të tjerët për islamin*, Prishtinë, 2015, f. 115!

<sup>13</sup> Ibid.

edrich Helderlin, Charles Pierre Baudelaire, Wilhelm von Kleist, Dostoevsky, piktorit danez Van Gogh, shpikësit të dinamitit Alfred Nobel etj. Në mesin e atyre që ua atribuuan epilepsinë ishte edhe Muhamedi, a.s.<sup>14</sup>

Në vitin njëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy (1892), Max Nordau e shkroi librin e tij në dy pjesë në gjermanisht *Entartung* (Degjenerimi), ku tha se, pothuajse të gjithë gjenitë e famshëm mund të shpjegohen nga aspekti i çmendurisë dhe epilepsisë.<sup>15</sup>

### **Muhamedi, a.s., u akuzua në mënyrë absurde se vuante nga epilepsia**

Një pjesë e orientalistëve thanë se Muhamedi, a.s., vuante nga epilepsia dhe se shpallja ishte rezultat i krizave epileptike. Akuza për epilepsi ndaj Pejgamberit, a.s., është mjaft e hershme. Kjo i adresohet Theophanes, historianit bizantin, i njohur edhe si Theophanes Rrëfimtari (758-817). Theophanes në analet e tij për Muhamedin, a.s., shkroi: “Ai ishte i prekur nga epilepsia. Kur gruaja e tij (Hadixheja) e kuptoi këtë, ajo ishte shumë e shqetësuar, pasi ajo, një fisnike, ishte martuar me një burrë të tillë, i cili ishte jo vetëm i varfër, por edhe epileptik. Ai u përpoq me mashtrim ta qetësonte atë, duke thënë: “vazhdoj të shoh një vegim të një engjëlli të quajtur Gabriel, dhe duke qenë i paafte për të duruar shikimin e tij, më bie të fikët dhe bie përtokë”.”<sup>16</sup>

Kjo akuzë bajate e absurde ndaj Pejgamberit, a.s, u përsërit prej shumë orientalistëve, deri në ditët tona.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Shih: Vahj-un em Sira-un, shih: Adnan Ibrahim <http://www.adnanibrahim.net/>

<sup>15</sup> Ibid. ...

<sup>16</sup> Roger Pearse, Theophanes in English, on Mohammed, shih: Theophanes in English, on Mohammed – Roger Pearse ([roger-pearse.com](http://roger-pearse.com)).

<sup>17</sup> Theophanes the Confessor, The Chronicle. Ky historian bizantin ishte një prift fanatik, sepse shkroi në një frymë fanatike për Pejgamberin a.s. në librin e tij të njohur si Kronika, shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit.

### **Gustave Le Bon**

Orientalisti dhe sociologu i famshëm francez Gustave Le Bon, pohoi se: “Muhamedi, a.s., kur e pranonte shpalljen, tregonte simptoma të epilepsisë!”<sup>18</sup>

### **Aloys Sprenger**

Aloys Sprenger orientalist austriak, pretendonte se: “Pejgamberi, a.s., ishte prekur nga histeria dhe epilepsia.” Sprenger jetoi në mesin e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur zëri i shkencëtarëve psikanalitikë ishte i zhurmshëm. Në këtë kohë gjenialiteti dhe kreativiteti shpjegoheshin gjithmonë nga epilepsia dhe marrëzia/çmenduria. Sprenger fliste i frymëzuar nga pretendimet e kohës së tij, por njëkohësisht ishte i shtyrë edhe nga fanatizmi i urrejtjes.<sup>19</sup>

### **William Gordon Lennox**

Midis akuzuesve është edhe neurologu amerikan, William Gordon Lennox. Fatkeqësisht edhe ky pretendoi në mënyrë absurde se: “Pejgamberi, a.s., vuan nga epilepsia dhe se shpallja ishte pasojë e saj.”<sup>20</sup>

### **Allan Menzies**

Allan Menzies e akuzoi Pejgamberin, a.s., padrejtësisht për dy gjëra: epilepsi dhe histeri!<sup>21</sup>

<sup>18</sup> Gustave Le Bon “Qytetërimi Arab”, edhe pse ky libër është një libër i mirë në përgjithësi, objektiv në masë të madhe për myslimanët, dhe i drejtë ndaj Islamit, ku flet pozitivisht për Pejgamberin a.s., ai mbase i mposhtur nga fanatizmi i tij fetar do të përmendë epilepsinë. Shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit.

<sup>19</sup> Aloys Sprenger, orientalisti i famshëm austriak në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Autori i librit *Die Leben und die Lehre des Mohammed*, (*Jeta dhe mësimet e Muhamedit*), shih: Ibid.

<sup>20</sup> William Gordon Lennox *Epilepsy and related disorders*, autori i librit *Epilepsia dhe çrregullimet e lidhura me të*, shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit.

<sup>21</sup> Ibid.

### Fyodor Dostoevsky

Romancieri rus Fyodor Dostoevsky, i cili vuante nga epilepsia, kur foli për *Aura* dhe *Epileptic* aura-aurën epileptike, e përmendi Muhamedin, a.s., gjë që tregon se ai besonte se Pejgamberi, a.s., ishte gjithashtu njëri prej atyre që ishin të prekur me këtë sëmundje ose me këtë sindromë.<sup>22</sup>

### Orientalistë dhe historianë që e refuzuan akuzën për epilepsi ndaj Muhamedit, a.s.

Një grup studiuesesh perëndimorë, veçanërisht orientalistë dhe historianë, u përballën me akuzën për epilepsi ndaj Muhamedit, a.s. Ata e refuzuan këtë shpifje. Ndër autorët që e hodhën poshtë epilepsinë do t'i përmendim:

**Caesar E. Farah:** “Këto pretendime dhe insinuacione për Pejgamberin, (a.s.), se kishte epilepsi rezultuan nga një magjepsje me teoritë shkencërisht sipërfaqësore të psikologjisë së shekullit të nëntëmbëdhjetë.”<sup>23</sup>

**Edward Gibbon:** “Akuzën se Muhamedi a.s. vuante nga epilepsia e përshkruan si shpifje absurde, dhe si një mit nga mitet e grekëve. Madje Gibbon i referohet historianit bizantin, Theophanes, dhe thotë se kjo është një nga legjendat e tij”<sup>24</sup>

**Alfred Guillaume** shkruan: “Bazuar në rezultatet e kërkimeve psikologjike në epokën dhe kohën e Muhamedit, (a.s.), është shumë e vështirë të pranojmë se ai ishte një personalitet epileptik, ose se ai vuante nga epilepsia! Pse? Sepse ai ishte koherent në karakter, ai ishte i fortë nga shpirti dhe mendja. Guillaume thotë, gjithashtu, se eksperimentet psikologjike

<sup>22</sup> Ibid.

<sup>23</sup> Caesar Farah, Profesor i Historisë në Universitetin Minnesota, nw “Islam: Beliefs and Observances” (2003), Barron's Educational Series, shih: Shubhetu es-sera, Er-redu ala shuhbeti isabeti en Nebij sala Alahu ves-selem bis serai, ([eltwhed.com](http://eltwhed.com)).

<sup>24</sup> Edward Gibbon, historiani më i famshëm anglez në *The History of the Decline and Fall of the Roman Empire* (Historia e Rënies dhe Shkatërrimit të Perandorisë Romake). Ky libër është një nga librat më të mrekullueshëm në historinë e Perandorisë Romake. Shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit.

që merren me përvojën fetare (Religious experience) me studimin dhe hulumtimin e saj na konfirmojnë se Muhamedi, (a.s.), është shumë larg të qenit një personalitet me simptoma epilepsie. Pra kjo sipas studimeve psikologjike të përvojave dhe varieteteve të përvojave fetare.”<sup>25</sup>

**Will Durant** pasi e ekspozon akuzën për epilepsi, përfundon duke thënë: “Nuk gjejmë prova përfundimtare se ajo që po i ndodhte Pejgamberit Muhamed ishte epilepsi.”<sup>26</sup>

**Maksim Rodinson** në parathënien e librit të tij “Muhamedi” (botimi francez), mohoi gjithashtu se fenomeni i pranimit të shpalljes është diçka që mund të shpjegohet nga epilepsia, skizofrenia, halucinacionet, apo ndonjë gjë e ngjashme. Ajo është diçka krejt ndryshe.<sup>27</sup> Pa dyshim se shpallja është larg këtyre fenomeneve patologjike.

**Tor Andrea** orientalisti suedez është një nga ata që iu kundërpërgjigjën **Sprengerit** për epilepsinë. Andrea vërtetoi se fjalët e Sprengerit janë jo koherente dhe të hedhura poshtë.<sup>28</sup>

**Frants Buhl** orientalist danez gjithashtu iu kundërpërgjigj **Sprengerit** në një libër që u shfaq më pak se pesëmbëdhjetë vjet pas librit të Sprengerit, në vitin një mijë e nëntëqind e tre.<sup>29</sup>

**Maurice Gaudefroy-Demombynes** francezi mohoi akuzën për epilepsi ndaj Muhamedit, a.s. Ai tregoi pavlefshmërinë dhe inkoherencën e saj. Ai shkroi se epilepsia ia rrëmben pacientit kujtesën, domethënë mbamendjen! Kur pacienti vetëdijësohet, qoftë nëse epilepsia është një epile-

<sup>25</sup> Alfred Guillaume, orientalisti i famshëm britanik, nga Uellsi. Në librin e tij mbi të Dërguarin e Zotit iu kundërpërgjigj kësaj shpifjeje, bazuar në njohuritë e kohës së tij. Ai vdiq afërsisht në një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë. Ishte pak më vonë në kohë se paraardhësit e tij, për shembull si Sprenger dhe Gustav Le Bon. Shih: Ibid.

<sup>26</sup> Will Durant, historian i famshëm amerikan i qytetërimit dhe filozofisë. Autori i historisë së filozofisë dhe historisë së qytetërimit - një vepër enciklopedike historike e shkencës, e cila përbën një piketë të vërtetë në librat e historisë së qytetërimit. Shih: Ibid.

<sup>27</sup> Maksim Rodinson, orientalist dhe mendimtar i madh francez majtist, autori i librit Muhamedi mes Lindjes dhe Perëndimit. Shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit.

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Ibid.

psi e madhe *major*, ose një epilepsi më e vogël *minor*, ai nuk mban mend asgjë! Ndërkaq, kjo nuk i ka ndodhur Pejgamberit, a.s., përkundrazi. Sipas Demombynes: “Kurani është një libër fisnik dhe prestigjioz. Pretendimi se Kurani është rezultat i këtyre rasteve epileptike, është pretendim i çuditshëm. Epileptiku kur vetëdijesohet nuk mban mend asgjë, prandaj si mund të kujtonte Muhamedi, (a.s.), gjithçka dhe të na sillte fjalë që tregojnë elokuencë dhe forcë, që është një fjalim domethënës!”<sup>30</sup>

**Claude Cahen** është më i afërt me qëndrimet islame. Ai shkroi: “...ka kaluar koha kur ne mund t’i miratojmë këto akuza absurde që gjithmonë kemi ngritur kundër Pejgamberit Muhamed, (a.s.). Këto akuza qesharake u shkaktuan nga grindjet ideologjike. Domethënë nuk bëhet fjalë fare për studim shkencor, shqyrtim dhe kërkim shkencor, por për mosmarrëveshje fetare. Ngase ne e urrejmë Islamin, për këtë arsye e urrejmë edhe Pejgamberin e Islamit, kështu që duam t’i ngjitim atij çdo akuzë dhe çdo mynxyrë.”. Pastaj ai përmend edhe akuzën qesharake për epilepsi ndaj Pejgamberit, a.s.<sup>31</sup>

### **Muhamedi, a.s., nuk ishte poet dhe nacionalist reformator**

Shumë shkrimtarë romantikë Muhamedin, a.s., e portretizuan si poet të frymëzuar, ligjvënës e gjeni të kombit arab. Për ta Muhamedi, a.s., ishte një gjeni dhe një reformator, dhe kjo madje vetëm për kombin e tij arab.<sup>32</sup>

Prandaj, sipas tyre Muhamedi, a.s. ishte një lloj “nacionalisti” qëllimi kryesor i të cilit ishte bashkimi i arabëve. Një mënyrë tipike e këtij mendimi pasqyrohet në “Enciklopedia e Re Katolike” (The New Catholic Encyclopedia), ku thuhet: “Rreth moshës 40-vjeçare ai mori një “thirrje pejgamberike” për të bashkuar arabët nëpërmjet monoteizmit.”<sup>33</sup> Kjo qasje mund të konsiderohet më e avancuar në raport me qëndrimin e mëher-

<sup>30</sup> Ibid.

<sup>31</sup> Claude Cahen, historian i famshëm francez. Shih: Ibid!

<sup>32</sup> Claude Savary, *Le Coran...*, sipas, *John Tolan, Muhamedi i romantizmit evropian, shih: Muhamedi i romantizmit evropian*, op. cit.

<sup>33</sup> Nadnaravni Kur’an, pjesa II, op. cit.

shëm, pasi në një farë mënyre pranon se Muhamedi, a.s., kishte pranuar një thirrje pejgamberike. Megjithatë, kjo qasje nuk është e plotë sepse Islami është jo vetëm për arabët, por mbarë njerëzimit.

### Çka është epilepsia?

Në mënyrë që të mohohet akuza për epilepsi ndaj të Dërguarit të Allahut dhe të vërtetohet se ajo që ai përjetonte është diçka krejt ndryshe, është me rëndësi të kuptojmë dhe shpjegojmë çfarë është epilepsia. Sepse, gjykimi i diçkaje është një degë e konceptimit të tij.<sup>34</sup>

Epilepsia njihej prej mijëra vjetësh dhe quhej sëmundja hyjnore, ose sëmundja e shenjtë, sepse origjina e saj është e paqartë. Për shkencëtarët dhe studiuesit, po edhe ata besonin se xhindet dhe demonët, nuk ishte e qartë gjithashtu se kanë një marrëdhënie me të, ose engjëjt dhe qiellin. Prandaj, ajo u quajt sëmundja e shenjtë *sacred disease*, ose sëmundja hyjnore *divine disease*.<sup>35</sup>

### Përkufizimi i epilepsisë

Epilepsia është “një grup sëmundjesh të karakterizuara nga shqetësimet të përsëritura në funksionet nervore të trurit si rezultat i shqetësimeve në aktivitetet elektrike të trurit”.<sup>36</sup>

Në “Enciklopedia e Re Britanike”, epilepsia përkufizohet më këto fjalë: “Shqetësime të papritura e të vazhdueshme të funksioneve mendore, të gjendjes shpirtërore, të veprimtarisë shqisore apo të lëvizjes trupore, të cilat shkaktohen nga një keqfunksionim paroksimal i qelizave nervore ce-

<sup>34</sup> Shih: Vahj-un em Sira-un, op. cit!

<sup>35</sup> Ibid.

<sup>36</sup> Epilepsia është: “Grup sëmundjesh të karakterizuara nga ndryshime paroksizmale në funksionin neurologjik të shkaktuara nga anomalitë në aktivitetet elektrike të trurit.” Shih: Shubhetu es-sera, Er-redu ala shuhbeti isabeti en Nebij sala Alahu ves selem bis serai, ([eltewhed.com](http://eltewhed.com))!

lebrare.” Ndërsa në titullin “Llojet e krizave” jepen katër kategori: *granular, petit mal, psikomodore dhe spazm infaktike*.<sup>37</sup>

Te “*grand mal*” përfshihen konvulsione të përgjithësuara që shoqërohen me të fikët e papritur, rënie dhe dridhje e gjymtyrëve. Rënia në tokë në këto momente paraprihet nga një klithmë e mprehtë. Pasi trupi bie në tokë ai ngrin dhe pushon së marri frymë, kjo gjë shoqërohet me dridhje të parregullta në gjithë gjatësinë e këmbëve dhe duarve. Personi i caktuar nuk mban mend aspak se çfarë i ka ngjarë.<sup>38</sup> Është e dukshme se këto simptoma nuk janë të zbatueshme për Pejgamberin, a.s.

“*Petit mal*” përfshin kapërcime të çastit të vetëdijes dhe mbi 70% e pacienteve e kanë krizën e parë përpara moshës 20 vjeç. Pra, është e pamundur të barazosh *petit mal* me shpalljen hyjnore të Muhamedit, a.s. Shpallja hyjnore filloi t’i zbriste në moshën 40 vjeçare. Shpallja vazhdon-te disa minuta, pra krejt ndryshe nga *petit mal* e cila ka vetëm disa kapërcime momentale të vetëdijes.<sup>39</sup>

Krizat “*Psikomodore*” dhe “*fokale*” mund të përfshijnë konvulsione të përgjithësuara. Shpërthimet fokale (vatrore) mund të manifestohen nga lëvizje ose ndijime të lokalizuara në një pjesë të caktuar të trupit ose nga paralajmërime të përjetuara subjektivisht që quhen *aura* dhe e kanë një kohëzgjatje nga një fraksion sekonde në disa sekonda. Aurat<sup>40</sup> që lindin nga zona të caktuara të trurit përfshijnë iluzionet se mjedisi rrethues është i njohur, halucinacionet<sup>41</sup> vizuale apo auditive, gjëmimin e veshëve dhe erëra apo shije të pakëndshme.<sup>42</sup>

<sup>37</sup> Hamza Mustafa Njazi, *Burimet e Kuranit, një pasqyrë kritike e teorive të Autorësisë së Kuranit*, Tiranë 1993, f. 34-35.

<sup>38</sup> Ibid, f. 34-35.

<sup>39</sup> Ibid, f. 34-35.

<sup>40</sup> Aura ka halucinacione dëgjimore dhe vizuale. Aurë, ndjenë subjektive përpara fillimit të një ataku paroksizmal, në rastin konkret në epilepsi. Shih: Ibid, f. 34-35!

<sup>41</sup> Përkufizimi i halucinacionit është “një ndjesi subjektive pa stimul të jashtëm.” Shih: Shubhetu es-sera, *Er-redu ala shuhbeti isabeti en Nebij sala Alahu ves selem bis serai*, op. cit!

<sup>42</sup> Hamza Mustafa Njazi, op. cit., f. 34-35.



Krizat psiko-motorike nuk kanë asgjë të përbashkët me shpalljen hyjnore që i zbriti/iu shpall Muhamedit, a.s. Kurani nuk ngjan me asnjë nga përçartjet e një epileptiku.

Sikur të kishim të bënim me epilepsi dhe forma të saj, ato do preknin funksionet mendore të Muhamedit, a.s., duke e bërë të paaftë për të kontrolluar mendimin. Ndërkaq, Pejgamberit, a.s., kur i shpallej fjala hyjnore vazhdonte ta kishte veten plotësisht në kontroll dhe ishte plotësisht i aftë për t'i mbajtur mend e për t'i regjistruar pjesët e shpalljes më vonë saktësisht.<sup>43</sup>

Në të vërtetë Kurani është mjaft i lehtë për t'u mbajtur mend. Ai mësohet përmendësh nga miliona njerëz të moshave të ndryshme, pavarësisht nëse ata dinë apo nuk dinë arabisht. Kjo e vërtet përmendet në Kruan: *“Ne Kuranin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësim?”* (El Kamer, 17).

### Mënyrat e pranimit të shpalljes

Hazreti Aisheja, r.a., tregon se Harith bin Hishami e ka pyetur të dërguarin e Allahut: *“Si të vjen shpallja?”* I Dërguari i Allahut i është përgjigjur: *“Nganjëherë më vjen sikur tingujt e ziles dhe ky lloj është më i vështirë për mua, pasi t'i kem kushtuar kujdes atij se çka tha. Nganjëherë më paraqitet meleku në formë të njeriut, më flet e unë i kushtoj kujdes se çka më thotë.”*<sup>44</sup> Hadithi në fjalë tregon mënyrën praktike të zbritjes së shpalljes, kurse mënyrat të cilat përmenden në hadith janë:

- 1) Shpallja i zbret të Dërguarit në formë shushurime të zërit, ose si tingujt e ziles. Kjo mënyrë është më e vështirë për të Dërguarin, a.s.
- 2) Meleku i vjen në formën e njeriut, dhe i flet fjalë me lejen e Allahut, xh.sh.<sup>45</sup>

Muhamedi, a.s., gjatë zbritjes së shpalljes (*gjatë frymëzimit*), haste në vështirësi, skuqej, ngushtohet, lodhej. Kjo gjë ishte normale, sepse ai

<sup>43</sup> Ibid, f. 34-35.

<sup>44</sup> Mënyrat dhe llojet e shpalljes, shih: *Mënyrat dhe llojet e shpalljes – Urtesi.al*.

<sup>45</sup> Ibid.

ishte i vetëdijshëm se nga vinte shpallja, me kë bisedonte, kush ia sillte shpalljen dhe i çfarë po i zbriste atij. Sesa ndiente lodhje Muhamedi, a.s., kur i zbritej shpallja, këtë më së miri na e përshkruan Aisheja, r.a., e cila thotë: *“E kam parë të Dërguarin duke i zbritur shpallja në ditën më të ftohtë të dimrit, kur i ndërpritej, vetullat e tij ishin të mbushura me djersë.”*<sup>46</sup>

### Llojet e shpalljes

Sa i përket llojeve të shpalljeve, Allahu, xh.sh., thotë: *“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, veçse me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai. Ai vërtet është më i Larti, më i Urti!”* (Esh Shura:51).

**Ibën Kajjimi**, ka numëruar 7 lloje të shpalljes:

**Lloji i parë:** Ëndrra e vërtetë me të cilën i filloi shpallja Muhamedit, a.s

**Lloji i dytë:** Shpallja të cilën Resulullahu e ka pranuar nga Xhibrili përmendsh, duke mos e parë atë, siç tregon vetë Pejgamberi, a.s.: *“fryma e melekut i ka frymëzuar mendjes sime se asnjë njeri nuk do të vdesë përderisa nuk e harxhon nafakën e vet...”*<sup>47</sup>

**Lloji i tretë:** Xhibrili vjen në figurën e njeriut, bisedon me të derisa Resulullahu e mësonte përmendsh gjithë bisedën. Edhe sahabët e kanë parë atë.<sup>48</sup>

**Lloji i katërt:** Shpallja ndonjëherë i vinte në trajtën e tingujve të ziles. Kjo metodë e shpalljes ka qenë më e vështira për Pejgamberin, a.s. Prandaj, djersët ia bënë qull ballin, edhe kur dita ishte e ftohtë. Nëse ishte hipur në deve, deveja nga pesha e madhe ulej zvarrë në tokë. Një herë i erdhi shpallja ndërsa ishte i mbështetur në këmbën e Zejdit. Zejditi, iu rëndua këmba aq shumë, aq rëndë saqë mezi duroi.<sup>49</sup> Mervani bin Hakemi, thotë: *“...Allahu i shpalli Pejgamberit, a.s., (shpall-*

<sup>46</sup> Ibid.

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> Ibid.

<sup>49</sup> Ibid.

jen). *Këmba e tij ishte në këmbën time; aq shumë më shtypi saqë mendova se do të ma copëtonte kofshën...*<sup>50</sup>.

Prandaj, si mund të pretendohet epilepsia, kur ai që do të ishte ulur pranë Pejgamberit, a.s., nuk do të gjente gjë më të rëndë nëse kofsha e tij do të ishte nën kofshën e Muhamedit, a.s., gjatë pranimit të shpalljes apo kur deveja e Pejgamberit, a.s., nga pesha do të ulej zvarrë në tokë.<sup>51</sup>

**Lloji i pestë:** Muhamedi, a.s., e kishte parë Xhibrilin, a.s., në formën e vërtetë, dhe ai i shpjegonte çka i kishte urdhëruar Allahu, xh.sh. Në këtë mënyrë e ka parë vetëm dy herë.

**Lloji i gjashtë:** Mënyra e drejtpërdrejtë e pranimit të shpalljes nga Allahu, xh.sh., në natën e Miraxhit, në lidhje me namazin.

**Lloji i shtatë:** Allahu, xh.sh., i flet drejtpërdrejt të dërguarve pa ndërmjetësimin e engjëllit, siç i ka folur Musait, a.s., më herët dhe Muhamedit, a.s., me rastin Israsë dhe Miraxhit.<sup>52</sup>

### **Kundërpërgjigje atyre që thonë se Pejgamberi, a.s., vuante nga epilepsia**

Çdo pretendim se Pejgamberi, a.s., ishte i prekur nga epilepsia, është thjesht hamendje dhe konfuzion. Ky pretendim vjen nga ajo që transmetohet se Pejgamberi, a.s., ka ndjerë mundime kur i ka ardhur shpallja.<sup>53</sup>

Premisa e këtyre pretenduesve është se njerëzit me epilepsi i ekspozohen simptomave që iu paraqitën edhe Pejgamberit, a.s., kur atij i vinte shpallja. Për shembull, thënia e tyre se epileptikut mund t'i rrjedhë djersë në ballë. Ai ka gjithashtu halucinacione vizuale (vegime), sipas pretendimit të tyre, të tilla si ato që i pati Pejgamberi, a.s., kur e pa Xhibrilin, si dhe halucinacione dëgjimore, sikurse tingëllimi i një zileje, ngjashëm me

<sup>50</sup> Imam Buhariu, L. 6, hadithi 4592.

<sup>51</sup> Shubhetu es-sera, *Er-redu ala shuhbeti isabeti en Nebij sala Alahu ves selem bis serai*, op. cit.

<sup>52</sup> Llojet (mënyrat) e shpalljes Pejgamberit Muhamed sala Allahu ve selem, op. cit.

<sup>53</sup> Shubhetu es-sera, *Er-redu ala shuhbeti isabeti en Nebij sala Alahu ves selem bis serai*, op.cit.

atë që Muhamedi, a.s., e dëgjonte kur i vinte shpallja. Apo, njeriu me elipsi dridhet dhe frikësohet, ngjashëm me atë që i ndodhi Muhamedit, a.s., në shpellën Hira, kur i erdhe shpallja e parë.<sup>54</sup>

Duke ndërtuar qëndrimin e tyre mbi këto pretendime disa kritikë jomyslimanë gjurmuan disa simptoma ose gjendje që ngjasojnë me simptomat e epilepsisë që janë përmendur në rastet e pranimit të shpalljes. Mirëpo, analiza mjekësore e epilepsisë dhe llojeve të ndryshme të saj, duke përfshirë të ashtuquajturat *temporal lobe epilepsy* është e mjaftueshme për të minuar këto pretendime.<sup>55</sup>

Përfundimi është se asnjë nga llojet e ndryshme të epilepsisë, kur merren parasysh simptomat ose fotografia klinike që shoqërojnë ose dallojnë secilën prej tyre, nuk mund të zbatohet në asnjë mënyrë për gjendjen e Pejgamberit, a.s, gjatë pranimit të shpalljes.<sup>56</sup>

Pastaj ngjashmëria thjesht ndërmjet disa prej simptomave të llojeve të ndryshme të epilepsisë dhe asaj që iu ekspozua Pejgamberi, a.s., kur pranonte shpalljen, sikurse ishin djersët që ia bënëin qull ballin, apo rëndesa që ndiente Pejgamberi, a.s., vinin, siç përmend imam En-Neveviu, nga madhështia e melekut Xhibril dhe barra e rëndë e shpalljes. Kjo nuk nënkupton se Pejgamberi, a.s., ishte goditur me ndonjë lloj epilepsie, dhe kjo është një çështje e dukshme.<sup>57</sup>

Pejgamberi, a.s., gjatë leximit të Kuranit nga Xhibrili, a.s., duke u përkujdesur që ta nxinte përmendësh Kuranin, i lëvizte buzët gjatë pranimit të shpalljes edhe nga frika se mos harronte diçka. Kështu që, Zoti e urdhëroi Muhamedin, a.s., që ta dëgjonte shpalljen derisa ta përfundonte Xhibrili leximin e saj: ***“Ti (Muhamed) mos e shqipto atë (Kuranin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi detyrë tubimin dhe leximin e tij! E kur ta lexojmë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. Dhe pastaj është obligim yni që ta shkoqisim atë.”*** (El Kijame, 16-19).

<sup>54</sup> Ibid.

<sup>55</sup> Ibid.

<sup>56</sup> Ibid.

<sup>57</sup> Ibid.

**Ibën Kethiri** thotë: “Zoti në ajetin kuranor e udhëzoi të Dërguarin e Tij, a.s., në lidhje me mënyrën se si ta pranonte shpalljen nga meleku Xhibril, sepse Pejgamberi, a.s., nxitonte ta merrte atë dhe të bënte garë me Xhibrilin kur ia sillte shpalljen. Zoti ia bëri me dije atij, se nuk duhet ta ngarkonte veten dhe të mos kishte frikë se mund t’i ikte diçka nga Kurani, sepse Ai do t’ia tubonte Kuranin në gjoks, do t’ia lehtësonte dhe shpjegonte atë.”<sup>58</sup>

Prandaj Allahu kërkoi nga ai që ta përcillte me dëgjim leximin e Kuranit nga Xhibrili, deri sa të përfundonte leximin e tij: **“I lartë është Allahu, Sundimtar i vërtetë. Ti mos nxito me Kuranin para se të përfundojë shpallja e tij te ti ...”** (Ta ha, 114).

**Frank R. Freemon** thotë: “Studiuesit perëndimorë të Islamit në epokën moderne kanë hedhur poshtë diagnozën se Pejgamberi (a.s.) vuante nga epilepsia. Lidhur me provat që kundërshtojnë këtë diagnozë Fremont, përmend moshën e vonë të shfaqjes së simptomave (40 vjeç), dështimin e bashkëkohësve të tij për t’i njohur ose përshkruar krizat si kriza epileptike dhe në fund fjalitë poetike të rregulluara që ai diktoi menjëherë në periudhën në vijim, pas pranimit të shpalljes.”<sup>59</sup>

### **Arabët paraislamikë asnjëherë nuk e akuzuan Muhamedin, a.s., për epilepsi**

Epilepsia ishte një sëmundje e njohur për arabët në kohën e Muhamedit, a.s., dhe madje edhe shumë më herët. Idhujtarëve arabë nuk do t’u shpëtonte vërejtja nëse Pejgamberi, a.s., do të ishte prekur vërtetë nga ajo. Ata asnjëherë nuk e akuzuan Muhamedin, a.s., për epilepsi. Kemi rastin e gruas e cila kërkoi nga Pejgamberi, a.s., lutje për t’u shëruar nga epilepsia. Ata bin Ebi Rebah ka thënë: Ibën Abasi më ka thënë: “A dëshiron të të tregoj për një grua, e cila është prej banorëve të Xhenetit?!”. “Po.”, – i thashë. Ai tha: “Njëherë kjo grua e zezë erdhi te Pejgamberi,

<sup>58</sup> Ibid.

<sup>59</sup> R. Freemon, A Differential Diagnosis of the Inspirational Spells of Muhammad the Prophet of Islam, Journal of Epilepsia, 17:4 23-427, 1976, ibid.

a.s., dhe tha: “Mua më kap epilepsia, dhe si shkak i saj edhe zbulohem. Lute Allahun e Lartësuar për mua!”. Pejgamberi, a.s., i tha: “*Nëse bën durim, do të shpërblehesh me Xhenet. Mirëpo nëse dëshiron, e lus Allahun e Lartësuar që të të shërojë!*”. Ajo tha: “Do të bëj durim”, - dhe më pas vazhdoi: “Unë zbulohem, prandaj lute Allahun që mos të zbulohem!”. Atëherë ai, a.s, u lut për të.”.<sup>60</sup>

### **Epilepsia çon në degjenerim mendor dhe fizik**

Siç dihet edhe nga ana mjekësore, personi që kalon krizë epilepsie, i humb aftësitë e mendimit, të perceptimit dhe të njohjes, për pasojë, nuk është i vetëdijshëm për çka ndodh përreth. Vetëdija e tij është e mbyllur. Kurse Pejgamberi, a.s., sapo pranonte shpalljen, ia kumtonte shokëve të tij ajetet kuranore që përmbanin modelet më të përsosura të shumë specifikave, si drejtësia dhe e drejta juridike, morali dhe etika, adhurimi, etj.<sup>61</sup>

Në rastet e epilepsisë, fuqitë e pacientit përkeqësohen, prognoza e pacientit dhe parashikimi janë shumë të këqija, ndodh një përkeqësim i vazhdueshëm në fuqitë mendore dhe psikologjike të pacientit, dhe kjo madje mund të pasojë dhe ndikimin në fuqinë e tij fizike.<sup>62</sup>

**Will Durant** thotë: “Nuk ka asgjë në historinë e Muhamedit (a.s.) që tregon një rënie të forcës së mendjes në të cilën zakonisht çon epilepsia. Përkundrazi, ne shohim se mendja e tij bëhej më e qartë, i shtohej aftësia e tij për të menduar dhe besimi i tij në vetvete. Forca e tij në trup, shpirt dhe udhëheqje rriteshin, sa më shumë që i kalonin vitet, derisa arriti moshën gjashtëdhjetë vjeç. Shkurtimisht, nuk gjejmë prova përfundimtare se ajo që po i ndodhte Pejgamberit, a.s., ishte diçka si epilepsi.”<sup>63</sup>

**Montgomery Watt** e kundërshton pretendim për epilepsi, duke thënë: “Epilepsia çon në degjenerim fizik dhe mendor, dhe nuk ka asnjë she-

<sup>60</sup> Imam Buhariu, nr: 5652 dhe imam Muslimi, nr: 2576.

<sup>61</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 159.

<sup>62</sup> Vahj-un em Sira-un, op. cit.

<sup>63</sup> Montgomery Watt, Historia e Qytetërimit, Epoka e Besimit, Muhamedi në Mekë, shih: Shubhetu es-sera, Er-redu ala shubheti isabeti en Nebij sala Alahu ves selem bis serai, op. cit.

një për këtë të Muhamedi (a.s).” Më pas ai shkon më tej dhe thotë se Muhamedi, a.s., ishte psikologjikisht i shëndoshë në përgjithësi: “ai (Muhamedi) ishte qartësisht në zotërim të plotë të aftësive të tij deri në fund të jetës së tij.”<sup>64</sup>

**Montgomery Watt** përfundon duke thënë: “Është e pabesueshme që një person që i nënshtrohet epilepsisë, histerisë, apo edhe sulmeve të pakontrollueshme të emocioneve, mund të ketë qenë udhëheqësi aktiv i ekspeditave ushtarake ose udhërrëfyesi largpamës i një qyteti-shteti dhe i një komuniteti fetar në rritje. Të gjitha këto zotësi ne e dimë se Muhamedi, (a.s), i ka poseduar.”<sup>65</sup>

### I sëmuri epileptik ka vuajtje fizike dhe shpirtërore

I sëmuri epileptik ka dridhje të forta, të cilat nuk shfaqen gjatë pranimit të shpalljes. Epileptiku pas krizës, duke ndjerë një dobësi dhe dhimbje të madhe, kalon një periudhë relativisht të gjatë vuajtjesh fiziko-shpirtërore gjersa të normalizohet. Ndërkaq, i Dërguari i Allahut jo vetëm që nuk pati përjetuar kurrë simptoma, vuajtje, shqetësime dhe pasoja të një krize të tillë, por, duke e konsideruar periudhën midis dy zbulimeve hyjnore pothuaj si një periudhë ndërprerjeje, me dëshirë të thellë e priste ardhjen e shpalljes tjetër dhe, me ardhjen e saj, pati përjetuar një gëzim të papërshkruar.<sup>66</sup>

### Histeri

Disa prej autorëve jomyslimanë shpalljen që e pranonte Muhamedi, a.s., e përshkruan si një lloj histerie. Kjo nuk është reale, sepse përçartja apo jermi histerik shoqërohet me simptoma të rënda sikurse hutimi, çrregullimi, bërtitma, qarja me zë, e të tjera që nuk i kishin ndodhur asnjëherë Muhamedit, a.s., madje edhe në rastet më të vështira gjatë pranimit të shpalljes. Ajo që i vinte Muhamedit, a.s., ishte një e vërtetë, ekzistenca e

<sup>64</sup> Ibid.

<sup>65</sup> Ibid.

<sup>66</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 159.

së cilës vërehej në realitetin e jashtëm. Ajo nuk ishte një fantazi, apo shfaqje e sëmundjeve nervore, ose histeri që nuk përkonte me realitetin.

Përçartja ose jermi që i përshkruhen histerisë<sup>67</sup> i ndodhin të sëmurit gjatë gjendjes në koma-atak, e kur i sëmuri këndellet nuk kujton asgjë nga ajo çfarë i kanë thënë më herët. Pejgamberi, a.s., gjatë pranimit të shpalljes nuk fliste asgjë dhe vetëm pas pranimit të plotë të saj e thoshte atë që i ishte shpallur dhe kërkonte nga shokët e tij ta shkruanin atë. Përmbajtjet e jermit ose përçartjes historike vijnë nga perceptimet imagjinare që rezultojnë me nervat e stërlodhura e të sëmura, si p.sh. kur i sëmuri imagjinon se është duke e parë një shpirt të keq që është duke e kërcënuar, ose duke e frikësuar se do ta mbysë, duke i shkaktuar ndonjë dëm, stres e shqetësim.<sup>68</sup>

Nuk ka ndodhur asnjëherë që një njeri me përçartje të thotë gjëra me vlerë apo t'i udhëzojë njerëzit. Gjatë krizës, i sëmuri epileptik thotë fjalë të kota e pa kuptim. Ndërkaq, te Pejgamberi, a.s., nuk është vënë re ndonjëherë një gjendje e tillë. Ai gjithnjë dhe pa përjashtim, ka thënë fjalët më me kuptim duke u shprehur në mënyrën më të qartë dhe oratorike që ka dëgjuar njerëzimi!<sup>69</sup>

## I sëmuri psikik

Madje duke u nisur nga ndryshimet e ndodhura në gjendjen e Pejgamberit, a.s., gjatë pranimit të vahjit, ka orientalistë që kanë pretenduar paturpësisht se Pejgamberi, a.s., ka qenë një i sëmurë psikik dhe kanë siguruar trajtimin e çështjes në Akademinë Mjekësore Franceze për të arritur në një vendim shkencor-zyrtar mbi këtë. Në këtë kuadër, në vitin 1842, një ekip mjekësh të zgjedhur kanë shqyrtuar pretendimet në fjalë, dhe në përfundim, kanë përgatitur një raport të gjatë e të argumentuar du-

<sup>67</sup> Histeria është sëmundje nervore simptomat e së cilës janë çrregullimet emocionale të atij që goditet me këtë sëmundje. Për pasojë ai qesh apo qan pa ndonjë arsye të dukshme. Shih: Afif Abdul Fetah Tabbareh, Shpirti i fesë islame, Prishtinë, 2020, f. 30!

<sup>68</sup> Ibid, f. 30.

<sup>69</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 159.



ke hedhur poshtë mundësinë e hipotezës mbi gjendjen e sëmurë psikike të Pejgamberit, a.s.<sup>70</sup>

### **Kurani nuk është pasojë e “epilepsisë dhe halucinacioneve”!!!**

Disa enciklopedi dhe autorë jomyslimanë pretendojnë se Kurani është pasojë e halucinacioneve që i provoi Muhamedi, a.s. Në qoftë se këto hamendje do të ishin të vërteta, pas shfaqjes së atyre “halucinacioneve”, ai nuk do të kthehej nga shpella i shqetësuar dhe i frikësuar, sikurse tregojnë librat e biografisë së Pejgamberit, a.s. Ai u kthye dhe kërkoi që ta mbulojnë. Kur Hadixheja, r.a., e pyeti se çfarë i kishte ndodhur, Muhamedi, a.s., ia rrëfeu gjithçka dhe ajo e qetësoi. Në qoftë se Kurani me të vërtetë e ka origjinën prej disa problemeve psikologjike në mendjen e Muhamedit, a.s., atëherë halucinacionet do të ishin të qarta në Kuran.<sup>71</sup>

### **Shpallja nuk është ndriçim i brendshëm shpirtëror që lind nga meditimi**

Orientalistë, të cilët mohojnë se Kurani është një libër hyjnor, kanë parashtruar disa pretendime të shtrembra, ndër të cilat pretendime se vahji përbëhet nga frymëzime të lindura në zemrën e Pejgamberit, a.s., si rezultat i procesit të meditimit dhe të ekstazës spiritualë zbuluese.<sup>72</sup>

Sipas fantazisë së tyre, Muhamedi, a.s., vazhdoi të mendonte e meditoonte deri sa në brendinë e tij, nëpërmjet zbulimit gradual e të vazhdueshëm, u krijua një besim të cilin e shihte si të përshtatshëm për zhdukjen e paganizmit.<sup>73</sup>

<sup>70</sup> Për këtë mund të shihet vepra e botuar me titullin “Rapor” si përkthim në turqisht nga Prof. Dr. Feridun Nafiz Uzluk. Kjo vepër është botuar në vitin 1996 në Stamboll nga shtëpia botuese Sebil Yayinevi, sipas Osman Nuri Topbash, op. cit., fusnota 144, f. 159.

<sup>71</sup> Gary Miller, Kurani i mrekullueshëm (2), Dituria Islame, Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht Prishtinë 2021, Dhul Hixhhe-Muharrem, 1442/1443, f. 21.

<sup>72</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 151.

<sup>73</sup> Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti, Fikhu Sire, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit alejhi selam, Shkup, 2018, f. 82.

Fakti se Pejgamberi, a.s., kur i erdhi shpallja, e pa Xhibrilin, tregon fare qartë se vahji nuk ishte një çështje e brendshme dhe vetjake e cila, siç pretendojnë disa orientalistë, mund t'i ngarkohet halucinacionit. Pranimi i shpalljes ishte nga një burim i jashtëm që s'kishte të bënte me psikikën dhe egon e tij. Xhibrili e shtrëngoi Muhamedin, a.s., duke i thënë "lexo". Kjo tregon se shpallja i erdhi jo nga bota e tij e brendshme, por nga jashtë, prej Allahut, xh.sh.<sup>74</sup>

### Ndërprerja e shpalljes

Edhe ndërprerja e përkohshme e shpalljes i hedh poshtë pretendimet sipas të cilave vahji është një ngjarje psiko-fiziologjike dhe shpirtërore e vetë Pejgamberit, a.s., e krijuar si rezultat i meditimit të tij të thellë. Ndërprerja e vahjit dhe pritja e gjatë prej Pejgamberit, a.s., dhe dëshira shumë e madhe nga ana e tij për rikthimin e shpalljes, tregon se shpallja ishte një ndodhi e jashtme e ndodhur jashtë vullnetit të Muhamedit, a.s.<sup>75</sup>

Ndërprerja e Shpalljes që zgjati gjashtë muaj, sikurse shkruan Dr. Ramadan Buti, përmban mrekulli hyjnore. Kjo ndërprerje e shpalljes është kundërargument i fuqishëm ndaj atyre që shpalljen e Pejgamberit, a.s., e komentojnë se ishte ndriçim i brendshëm shpirtëror, që lindi nga meditimi i gjatë dhe i përsëritur dhe se ajo është çështje e brendshme që lind vetvetiu. Muhamedi, a.s., filloi të shqetësohej për shkak të ndërprerjes së Shpalljes. Më pas u frikësua se Allahu, xh.sh., mos po e braktiste, pasi e nderoi me shpallje. Ai dilte i mërzhitur dhe ngjitej në një kodër. Derisa e pa përsëri Xhibrilin, i cili e mbuloi hapësirën mes tokës e qiellit duke i thënë: "O Muhamed, ti je i dërguari i Allahut për mbarë njerëzimin."<sup>76</sup>

<sup>74</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 151.

<sup>75</sup> Ibid, f. 151.

<sup>76</sup> Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti, op. cit., f. 84.

### Muhamedi, a.s., u frikësua kur e pa Xhibrilin

Frika që e pushtoi Pejgamberin, a.s., në fillim të shpalljes nuk ishte një dukuri e përsëritur, por ishte e kufizuar në shikimin e kryemelekut Xhibrilit në shpellën Hira, për herë të parë ose të dytën. Kjo është një çështje e natyrshme. Për çdo person të ekspozuar në një situatë të tillë është e natyrshme që ai të ndiejë gjendje frike dhe paniku.

Muhamedi, a.s., u kthye në shtëpi përsëri i frikësuar. Prandaj i zbriti fjala e Allahut: *“O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen (duke i thirrur).”*. Fakti se Muhamedi, a.s., kaloi nëpër gjithë këto situata dhe gjendje tregon se është absurde të mendohet se shpallja ishte inspirim i brendshëm shpirtëror. Sepse pronari i inspirimeve shpirtërore dhe meditimeve ideologjike nuk kalon gjendje të tilla.<sup>77</sup>

Kur e analizojmë atë që i ndodhi Muhamedit, a.s., vërejmë qartë urtësinë e madhe hyjnore. Përse e pa Muhamedi, a.s., Xhibrilin, a.s., me sytë e ballit herën e parë, kur ishte e mundur që shpallja t’i vinte atij nga prapa perdes?! Pse Allahu hodhi frikë në zemrën e Muhamedit, a.s., kur e pa Xhibrilin, a.s., dhe pse ishte i hutuar në të kuptuarit e realitetit të tij, kur e dimë se dashuria e Allahut ndaj Muhamedit, a.s., nënkupton se është dashur t’ia zbresë qetësinë dhe ta përforconte zemrën e tij, që ai të mos frikësohej e as të mos dridhej? Pse Muhamedi, a.s., u frikësua për veten e tij, nga ai që iu paraqit në shpellën Hira, se vallë mos ishte prej xhinëve dhe nuk i shkoi mendja që mund të ishte melek i besueshëm prej Allahut, xh.sh.<sup>78</sup>

Kjo ndodhi që të mos biem pre e sulmeve dhe akuzave të pabaza. Xhibrili, a.s., i doli befas kur Muhamedi, a.s., ishte duke qëndruar në shpellën Hira. Ai e pa me dy sytë e ballit. Xhibrili i tha “lexo”, që të bëhet e qartë se dukuria e shpalljes nuk është çështje e brendshme individuale, e cila mbështetjen e ka në pëshpëritjen shpirtërore, por është pranim i një realiteti të jashtëm që nuk ka lidhshmëri me pëshpëritjen shpirtërore dhe me brendësinë individuale. Shtrëngimi i Muhamedit, a.s., nga Xhibri-

<sup>77</sup> Ibid, f. 84.

<sup>78</sup> Ibid, f. 83.

li, a.s., duke i thënë “lexo”, konsiderohet vërtetim i këtij pranimi nga jashtë dhe mohim i pretendimeve të gjithë atyre që supozojnë se çështja nuk është më shumë se një fantazi e brendshme.<sup>79</sup>

Ai u frikësua dhe prej asaj që kishte parë dhe dëgjuar, deri sa e ndërpreu vetminë në shpellë dhe me shpejtësi u kthye në shtëpi, duke iu dridhur zemra. Ndodhi kështu me qëllim që t’i bëhet e qartë çdo personi që logjikon se Pejgamberi, a.s., nuk ishte i flaktë për mesazhin për të cilin do të zgjidhej për ta bartur dhe për ta shpërndarë në botë. Dukuria e shpalljes nuk erdhi për të plotësuar diçka të cilën e kishte imagjinuar ose që atij i kishte shkuar ndërmend, por i erdhi befas prej melekut, dhe as që kishte menduar ndonjëherë në të kaluarën një fenomen të tillë.<sup>80</sup> Zoti thotë në Kuran: **“Ti nuk shpresoje (mendoje) se do të të zbritej ky libër ...”** (*El Kasas, 86*).

Kjo nuk ishte rezultat i meditimit dhe i kërkimit të një individi i cili gradualisht do të formonte një besim dhe fe që t’i ftonte njerëzit. Në rastet e inspirimit, pëshpëritjes shpirtërore ose meditimit të lartë, nuk ndodh që njeriu të frikësohet dhe shqetësohet. Përndryshe të gjithë mendimtarët do të duhej të jetonin nën presionin e frikës së vazhdueshme e të pandërprerë.<sup>81</sup>

Pastaj edhe më shumë qartësohet fotografia befasuese dhe frikësuese për Muhamedin, a.s., kur mendoi se atë që e kishte parë, që e kishte shtrënguar dhe me të cilin kishte biseduar në shpellë, ndoshta ishte prej xhinëve. Prandaj i tha Hadixhesë; “Prandaj u frikësova për veten time”. Mirëpo ajo e qetësoi. Allahu xh.sh ka pasur mundësi që ta përforconte zemrën e të Dërguarit të Tij dhe ta qetësonte atë, se ai që i foli nuk ishte tjetër përpos Xhibrililit, një melek prej melekëve të Allahut, i cili erdhi që ta lajmëronte atë se ishte i dërguari i Allahut për mbarë njerëzimin. Urtësia e Allahut, xh.sh., desh të nxjerrë në shesh ndarjen e plotë të personalitetit të Dërguarit, a.s., para shpalljes me personalitetin e tij pas shpalljes dhe të

<sup>79</sup> Ibid, f. 83.

<sup>80</sup> Ibid, f. 82.

<sup>81</sup> Ibid, f. 82.

sqarojë se elementet e besimit islam nuk ishin përgatitur më parë në kërkim të tij dhe as që kishte menduar ndonjëherë të ftonte në to.<sup>82</sup>

### **Ardhja e shpalljes shtyhej**

Disa herë Muhamedi, a.s., është dashur të jepte përgjigje në çast, por ardhja e vahjit shtyhej. P.sh. rasti i shpifjes ndaj hazreti Aishes, r.a., dhe në rastin e disa pyetjeve që i kishin bërë çifutët. Pejgamberit, a.s., iu desh të pristete me ditë që të vinte shpallja, që të mund të jepte përgjigje. Sikur Kurani të ishte produkt i meditimit dhe ekstazë spirituale zbuluese e vetë Pejgamberit, a.s., ai nuk do të vihej në vështirësi dhe të pristete me ditë të tëra ardhjen e shpalljes. Disa herë shpallja do ta qortonte Pejgamberin, a.s. Kemi rastin e Abdullah bin Umm Mektumit etj. Të gjitha këto dëshmojnë se Kurani nuk është produkt i meditimit dhe i ekstazës zbuluese të Pejgamberit, a.s.<sup>83</sup>

### **Shkuarja e hazreti Hadixhesë te Veraka, që ta paraqiste çështjen para tij**

Përveç kësaj, ajo që Allahu e inspiroi Hadixhenë që të shkonte me Muhamedin, a.s., te Veraka që ta paraqiste çështjen para tij, është një konfirmim tjetër se ajo me të cilën u befasua Pejgamberi, a.s., është me të vërtetë shpallje e Allahut, e cila u kishte zbritur edhe pejgamberëve që ishin para tij dhe sqarim i paqartësisë që ishte shoqëruar me frikë e dyshime rreth asaj që kishte parë e dëgjuar.<sup>84</sup>

Ata që mbjellin dyshime mbi Shpalljen harxhojnë energji të madhe ideore, duke bërë një angazhim të madh me pretekst për ta errësuar realitetin e shpalljes, si dhe për të bërë përzierjen mes shpalljes, inspirimit dhe pëshpëritjes shpirtërore, madje edhe epilepsisë.<sup>85</sup>

<sup>82</sup> Ibid, f. 84.

<sup>83</sup> Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 151.

<sup>84</sup> Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti, op., cit., f. 84.

<sup>85</sup> Ibid, f. 84.

Një grup çifutësh, sikurse tregon Ibën Abasi, kishin hyrë te Muhamedi, a.s. Pejgamberi, a.s., i kishte thënë atyre se ju e dini se unë jam i Dërguar i Allahut. Ndërkaq, ata kishin mohuar duke thënë se nuk e dimë, prandaj Allahu, xh.sh., shpalli ajetin kuranor: ***“Por Allahu dëshmon për atë që t’u zbrit ty, atë ta zbriti sipas dijes së Vet, edhe engjëjt dëshmojnë, dhe është i mjaftueshëm Allahu për dëshmues.”*** (En Nisa, 166).

Dr. Ajni SINANI

## **UNACCEPTABLE CLAIMS MADE BY ORIENTALISTS REGARDING THE NOBLE QUR'AN**

### **Abstract**

Many non-Muslim authors have praised the Qur'an and Muhammad, peace be upon him. Nonetheless, they have also tried to twist the truth about Islam making different assumptions and claims regarding the Prophet and the noble Qur'an. Some orientalist have adopted certain claims that contradict logic and reason. Some claim that the Qur'an was written by Muhammad and is not a revelation from God. Some attribute the information found in the Qur'an to Bahira, the monk, or claim that Muhammad authored it in his subconscious mind. Others claim that he was sincere because he truly believed in his prophethood, but was wrong! Or, they reduced Muhammad's mission to merely being a nationalist who wanted to reform and unite the Arabs. Some claim that the experiences of revelation encountered by the Prophet were epileptic seizures. Below, we will examine these claims.

**Keywords:** *Noble Qur'an, revelation, Gabriel, Muhammad, peace be upon him.*

### **III. TEMA E NUMRIT: AGJËRIMI**





Dr. Muhamed STUBLLA

## **VLERA DHE NORMAT JURIDIKE TË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT**

### **Abstrakt**

Rëndësia e një teme vlerësohet në bazë të rangimit të saj në fushën përkatëse. Agjërimi është kusht prej kushteve përbërëse të Islamit. Rëndësia e kuptimit dhe e saktësisë së agjërimit rezulton me plotësimin apo kuptimin e vetë Islamit. Adhurimet janë të ndërlidhura edhe me kohë të caktuara. Agjërimi është obligim në kohën e muajit Ramazan, me fillimin e muajit, kohë kur fillon edhe obligueshmëria e tij. Bazuar në rëndësinë e kohës së muajit dhe ditëve përkatëse, rëndësinë e unifikimit të shoqërisë islame, kemi shpjeguar në formë të detajuar se si fillon Ramazani dhe ditët e agjërimin, ashtu sikurse kemi shpjeguar edhe përfundimin e agjërimin të ditëve përkatëse dhe të përfundimit të Ramazanit. Sigurisht se Ramazani është muaji i mirësive, dhe atë e kanë obligim vetëm disa kategori. Megjithatë, të gjithë besimtarët duhet të garojnë në vepra të pëlqyera përmes formave të ndryshme. Saktësia e agjërimin kushtëzohet me plotësimin e kushteve të agjërimin dhe largimin nga ato që e prishin atë. Prandaj, është e rëndësishme së veçantë përpjekja për të vendosur parime apo rregulla të qarta dhe të detajuara për të kuptuar si se agjërohet dhe kur mund të priset agjërimi. Plotësohet apo ngrihet niveli i agjërimin, aq sa largohemi nga të dyshimtat dhe i veprojmë të preferuarat gjatë agjërimin. Muaji Ramazan është muaji i mëshirës. Nga mëshira e Mëshiruesit është se i ka liruar nga agjërimi disa kategori. Ato kategori që i ka liruar, nuk i ka privuar nga arritja e shpërblimit të agjërimi, duke

ua mundësuar që të agjërojnë kurdo që do të kenë mundësi, dhe shpërblimin, me emrin e Zotit, do ta kenë sikurse në Ramazan. Mirëpo jo vetëm kaq. Ai që nuk mund ta kompensojë, me pagesën e një vlere simbolike do ta arrijë shpërblimin e kërkuar të Ramazanit, sigurisht se duke u mbështetur në nijetin dhe dëshirën e tij për agjërim. Ndërsa ata që nuk kanë agjëruar, qoftë edhe pa arsye, derën e pendimit, kthimit të Zoti, xh.sh., dhe kompensimit të asaj që e kanë humbur e kanë të hapur tek Allahu, xh.sh.

*Fjalët çelës: agjërim, Ramazan, muaj, Pejgamberi, a.s..*

## Hyrje

Allahu, xh.sh., është Krijues i çdo gjëje. Ai krijoi çdo gjë. Prej krijesave më të bukura dhe më të dashura të Zotit është njeriu. Atij i dërgoi pejgamber, në çdo kohë dhe vend, që ta mësojë se si të besojë dhe se si ta falënderojë Krijuesin e vet, si të jetojë dhe se si ta kalojë transitin e kësaj bote.

Pjesë e obligimeve ndaj popujve të hershëm ishte edhe agjërimi. Për këtë Zoti, xh.sh., në Kuran thotë: ***“O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, me shpresë që të bëheni të devotshëm!”*** (El Bekare: 183).

Sigurisht se shpallja e fundit ishte për Muhamedin, a.s., respektivisht për gjithë njerëzimin. Zoti, xh.sh., po na tregon që këto obligime nuk janë ngarkesë dhe të veçanta vetëm për ne, pasi këso obligimesh ishin të kërkuara edhe për ata që ishin para nesh, dhe pa dyshim se ato janë në dobinë tonë. Gjithashtu, Zoti, xh.sh., thotë: ***“...Pra, kushdo prej jush që e zë këtë muaj, le të agjërojë...”*** (El Bekare: 185).

Abdullah bin Omeri, r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut, a.s., ka thënë: ***“Islami është ngritur mbi pesë (shtylla): dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguar i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e Ramazanit dhe kryerjen e haxhit.”***<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Muslimi, Ibën Haxhaxh En Nejsaburi, *Sahih Muslim -El Musned Es Sahih El Muthesar Binakl El Adël Ani El Adël Ila Resulullahi, s.a.v.s.*, recensent: Muhamed Fuad Ab-

Nga qartësia tekstuale e teksteve hyjnore lehtësisht e kuptojmë konsensusin e myslimanëve për obligueshmërinë apo detyrueshmërinë e agjërimin të muajt Ramazan<sup>2</sup>. Prandaj, agjërimi i muajt Ramazan jo vetëm që është një nga obligimet islame, por ai është edhe shtyllë bazë në fenë Islame. Nëse refuzohet obligueshmëria e agjërimin, atëherë është kundërshtuar Kurani, Suneti dhe konsensusi i dijetarëve. Prandaj, me konsensusin e tyre, ai që refuzon edhe del nga feja Islame! Dallimi mes atij që nuk agjëron nga dembelia dhe atij që e mohon obligueshmërinë e agjërimin është: Ky i fundit ka dalë nga feja, ndërsa dembeli ka humbur mirësi të pakonpensueshme dhe meriton dënim të dhembshëm.

**Kuptimi i nocionit “agjërim”:** Në aspektin gjuhësor me “agjërim” nënkuptojmë: abstenim, përmbajtje, largim apo frenim nga diçka<sup>3</sup>. Ndërsa, në kuptimin terminologjik e ka këtë kuptimin:

*“Abstenim apo stopimi nga ushqimet, pijet, dhe intimiteti bashkëshortor në aspektin kuptimor dhe real, për persona të caktuar, nga imsaku deri në hyrjen të kohës së namazit të akshamit, me nijet për agjërim.”*

**Shpjegim i definicionit:** Ndalim apo abstenim nga ushqimet, pijet, dhe çdo gjë që e prish agjërimin. *Intimiteti bashkëshortor*, çdo kontakt intim ndalohet nga imsaku deri pas hyrjes së akshamit. *Në aspektin kuptimor dhe real* këto veprime mos të bëhen me qëllim, ndërsa nëse veprohen nga harresa, atëherë vetëm kuptimisht është kryer një veprim, mirëpo llogaritet sikur nuk ka ndodhur. *Për persona të caktuar*, ka lirim nga agjërimi, sikurse për gratë në ciklin mujor dhe në kohën e lehonisë (pas lindjes), fëmijët që nuk kanë hyrë në moshën madhore etj. *E qartë është se agjërimi fillon nga imsaku, dhe përfundon me hyrje e namazit të akshamit. Me nijet për agjërim*, duke bërë nijet me zemër se e dëshiron agjërimin e ditës në fjalë.

---

dul Baki, (Liban, Bejrut, Dar Ihja Et Turath El Arabij), nr. 16, 1/45. Ky hadith gjendet te të gjitha koleksionet e njohura të Hadithit.

<sup>2</sup> Ez Zejlaj, Othman bin Alij, *Tebijn El Hakaik Sherh Kenz Ed Dakaik ve Hashijetu Esh Shibliji*, (Kajro, El Matba El Kubra El Emirijeh, 1313 h), 1/313.

<sup>3</sup> Omer, Dr. Ahmed Muhtar Abdul Hamid, *Muxhem El Lugah El Arabijeh El Muasirah*, (Bejrut: Alim El Kutub), 2/1338.

## Vlera dhe rëndësia e agjërimit

Vlera dhe rëndësia e kohës dhe e vendeve është e ndërlidhur me bekimin e Zotit, xh.sh. Sigurisht se kjo rëndësi ndërlidhet edhe me ngjarjet që kanë ndodhur në atë kohë apo në atë vend.

Krahas ajeteve të lartcekura, do t'i veçojmë edhe disa hadithe që flasin për vlerën e muajit dhe agjërimit, Ramazanit. Ebu Hurejra, r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut, a.s., ka thënë: *“Allahu, xh.sh., ka thënë: “Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij, përveç agjërimit. Ai është i Imi, dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë. Kur dikush prej jush agjëron, mos të flasë fjalë të ndyta (të pista) dhe as mos të bërtasë! E nëse dikush e shan, apo e sulmon, le t'i thotë: “Unë jam agjërueshëm.”! Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa era e miskut (parfumit)! Agjëruesi i ka dy gëzime: kur bën iftar, dhe kur do ta takojë Zotin e tij e gëzohet me agjërimin e vet.”<sup>4</sup>*

Zoti, xh.sh., agjërimit ia atribuon Vetvetes, për shkak të nivelit të lartë të sinqeritetit të agjëruesit. Njerëzve u janë shpalosur shpërblimet e tyre për veprat e mira, me përjashtim të agjërimit, shpërblimin e të cilit nuk e di askush përveç Allahut. Agjërimi ndihmon që të mbrohesh nga veprat e këqija, dhe përderisa mbron nga veprat e këqija, ai mbron edhe nga zjarri i Xhehenemit. Agjëruesi, sikurse privohet nga gjërat që e prishin agjërimit, ai duhet të përmbahet edhe nga provokimet, cytjet dhe ngacmimet me të cilat atakohet. Nëse dikush e ofendon, ai duhet të sillet me maturi dhe pjekuri, ngase duhet të agjërojë edhe nga gjërat negative. Kështu agjërimit do të jetë funksional në aspektin shpirtëror, shoqëror dhe shëndetësor. Për ata që agjërojnë me një agjërimit të tillë, Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: *“Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe përkushtim, duke i shpresuar shpërblimet e Allahut, i falen të gjitha mëkatet.”<sup>5</sup>* Ndërsa në

<sup>4</sup> Muttefekun alejhi. Teksti nga *Sahih Muslimi*, nr. 1151, 2/807.

<sup>5</sup> El Buhari, Muhamed bin Ismail, *Sahih El Buari*, (Dar Ibën Kethir, Dar El Jemameh 1993) nr. 38, 1/16.

një hadith tjetër thotë: “...*Agjërimi i Ramazanit deri në Ramazanin tjetër i fal mëkatet, nëse u shmangeni mëkateve të mëdha.*”<sup>6</sup>.

Ndikimi i agjëritimit në aromën e besimtarit është i pakonsideruar, veçanërisht përderisa te Zoti, xh.sh., aroma e tij është e dashur, sa simbolikisht e ka krahasuar me aromën e parfumit. Agjëruesi në iftar gëzohet që suksesshëm e përfundoi një obligim dhe shtyllë islame, për të cilën me siguri se do të gëzohet prapë, kur do të jetë kurora e shpërblimit në botën tjetër.

Në Ramazan, mundësia e përfitimit të Xhenetit dhe largimi nga Zjarri janë objektiva që shumë më lehtë arrihen. Pejgamberi, a.s., thotë: “*Kur vjen Ramazani, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe djajtë (shejtanët) prangosen.*”<sup>7</sup>.

Në këtë muaj ka filluar zbritja e Kuranit. Zoti, xh.sh., thotë: “***Muaji i Ramazanit, në të cilin (filloi të) shpallet Kurani, është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë, dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria).***” (*El Bekare: 185*). Ndërsa, në një ajet tjetër Zoti, xh.sh., e precizon natën dhe vlerën e saj, e cila sigurisht se është në muajin Ramazan: “***Pa dyshim se Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit. Nata e Kadrit është më e mirë (vlefshme) se një mijë muaj.***” (*El Kader 2,4*). Vlëra e asaj nate, reflekton edhe në rëndësinë e muajit Ramazan.

Gjithashtu, ngjarjet historike ndikojnë në imazhin e madhështisë së muajit të agjëritimit. Në këtë muaj myslimanët e arritën fitoren e parë ushtarake, në Bedër<sup>8</sup>, si dhe çlirimin e Mekës<sup>9</sup>.

<sup>6</sup> *Sahih Muslim*, nr. 233, 1/209.

<sup>7</sup> Burimi paraparak, nr. 1079, 2/758.

<sup>8</sup> El Kurtubij, Ebu Muhamed, Alij bin Muhamed bin Seid, *Xhevamiu Es Sijertu En Nebevijeh*, (Bejrut, Dar El Kutub El Ilmijeh), 1/81.

<sup>9</sup> El Vakidij, Muhamed bin Omer bin Vakid, *El Megazi*, (Bejrut, Dar El Alemij, 1989), 3/889.

## Kushtet e obligueshmërisë dhe të praktikimit të agjërimit

Agjërimitin e Ramazanit e kanë obligim myslimanët. Jobsimtarët, edhe nëse agjërojnë, agjërimiti i tyre nuk pranohet. Allahu, xh.sh., thotë në Kuranin fisnik: **“O ju që besuat, agjërimiti ju është bërë obligim...”** (El Bekare: 183). Pra, urdhri për agjërimit është vetëm për besimtarët.

Myslmanët që obligohen me agjërimit duhet të jenë në moshën madhore. Fëmijët është e preferuar që të agjërojnë, qoftë edhe vetëm disa ditë, në mënyrë që të mësohen apo të kaliten me agjërimit. Kjo do t’ju shërbejë atyre, që përveçse shpërblehen për ato ditë, edhe do të jenë të gatshëm të agjërojnë kur do të arrijnë në moshën madhore, atëherë kur do ta kenë obligim agjërimitin. Agjërimiti në fazën e fëmijërisë është esencial që i riu të trajnohet apo të mësohet me agjërimit.

Nga agjërimiti i muajit Ramazan lirohen ata që gjatë gjithë muajit Ramazan nuk e kanë mendjen e shëndoshë, të çmendurit. Zoti, xh.sh., thotë: **“...Kush prej jush që e zë këtë muaj, le të agjërojë!”**. (El Bekare: 185). Ai që nuk është i shëndoshë mentalisht qysh para fillimit të Ramazanit, dhe nuk shërohet deri pas përfundimit të Ramazanit, praktikisht nuk konsiderohet se e ka takuar muajin Ramazan<sup>10</sup>. Të tillët janë të liruar, dhe jetojnë por nuk kuptojnë, e urdhri nuk është i vlefshëm për ta. Disa dijetarë thonë se në këtë grup mund të hyjnë edhe ata që janë të sëmurë dhe sëmundja e tyre ndikon që gjatë tërë kësaj kohe janë pa vetëdije, apo që janë në gjendje kome. Këto kategori nuk kanë qenë të pranishme me mendjen e tyre në këtë muaj, dhe konsiderohet se nuk e kanë zënë apo jetuar muajin Ramazan, qoftë edhe për disa çaste. Ndërsa nëse vetëm në një pjesë të Ramazanit u rikthehet mendja, pas shërimit, do të obligohen me agjërimitin e tërë Ramazanit.

Nëse ndonjë besimtar i ri jeton në shoqëri joislame dhe nuk e ka ditur që agjërimiti është obligim, ramazanët që kanë kaluar nuk kërkohet t’i kompensojë, sepse mosnjohuria e tij për Ramazanin në një ambient të tillë është arsye e konsideruar. Zoti, xh.sh., nuk i dënon ata që nuk i besuan, përderisa nuk u ka arritur informacioni i shpalljes. Allahu, xh.sh., thotë:

<sup>10</sup> El Xhesas, Ahmed bin Alij, *Sherh Muhtesar Et Tahavi*, (Bejrut, Dar El Beshair El Islamiyeh dhe Libi, Dar Es Serraxh Lineshri ve Et Tvziië, 2010) 2/448.

“...E Ne nuk e dënuam askënd para se t’ia dërgonim të dërguarin” (*El Isra: 15*). Nëse dikush arsyetohet për mosbesim për shkak të paditurisë, respektivisht mosarritjes së mesazhit të shpalljes, mundësia e mosnjohjes së obligueshmërisë së agjërimit, respektivisht arsytimi i tij është edhe më i shëndoshë. Ndërsa, arsytimi për mosdije se agjërimi është obligim për ata që janë mysliman dhe jetojnë në shoqëri islame është i papranueshëm. I tilli ka qenë neglizhent dhe jo i interesuar për mësimin e fesë, gjë për të cilën mban përgjegjësi, prandaj obligohet për agjërimin dhe kompensim të atyre ditëve.

### **Gjendjet dhe trajtimet në të cilat besimtari gjendet në Ramazan**

Nëse plotësohen kushtet në vijim, besimtari obligohet ta agjërojë Ramazanin:

1. Shëndeti i mirë. Besimtari është i obliguar të agjërojë përderisa gjendja shëndetësore e tij (apo e saj) ia mundëson agjërimit. Mirëpo, nëse frikësohet se për shkak të agjërimit mund të sëmuret apo t’i rikthehet sëmundja; ose është i sëmurë dhe mund të agjërojë, mirëpo agjërimi do t’ia përkeqësojë gjendjen, ose do ta zgjasë *kohën e shërimit, atëherë lirohet nga agjërimi. Zoti, xh.sh., thotë: “...e kush është i sëmurë prej jush, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë.”.* (*El Bekare: 184*).

**(Vëmendje):** Vlerësimet e gjendjes shëndetësore i bën mjeku kompetent për sëmundjen tuaj, i cili është mysliman, i drejtë, besnik, dhe i cili e di vlerën e agjërimit. Përndryshe, obligohesh që çdo ditë të fillosh të agjërosh, e nëse gjatë ditës të përkeqësohet gjendja aq sa e rrezikon shëndetin, agjërimi mund të priset. E nëse praktika e disa sëmundjeve është e atij lloji që nuk paramendohet që besimtari të ketë mundësi të agjërojë, vlen e njëjta përgjigje.

Gjithashtu këtu akomodohet edhe përgjigjja për ata që thonë se natyra e punës është e vështirë, prandaj a lejohet që mos të agjërohet. Këtyre u thuhet, fillojeni agjërimitin çdo ditë, e nëse gjatë ditës hasni në vështirësi të papërballueshme, e prishni agjërimitin në atë çast, sepse atëherë funksionon parimi i lejueshmërisë për lirim nga agjë-



rimi, mirëpo jo para se të bëhet e nevojshme. Kush e di, ndoshta Allahu të jep forcë dhe agjëron, përfiton nga puna që bën, dhe e merr edhe shpërblimin e agjëritimit njëkohësisht, i cili për ty do të jetë edhe për shkak të vështirësisë.

2. Që të jetë agjërimi i vlefshëm nga gjinia femërore, kërkohet pastërtia nga cikli mujor dhe e lehonisë. Ndalohet, pra është mëkat, agjërimi gjatë ciklit mujor (hajzit) dhe lehonisë (nifasit). Megjithatë, obligohet kompensimi i atyre ditëve. Aisheja, r.a., tregon se përderisa ishin në hajz, nuk agjëronin dhe nuk falnin namaz. Ajo thotë: “...*jemi urdhëruar ta kompensojmë agjërimin, dhe nuk e kompensojmë namazin.*”<sup>11</sup>.

**Vëmendje:** Dëshira e madhe e besimtareve për të agjëruar i shtyn të bëjnë vepra të ndryshme, sa që edhe e dëmtojnë shëndetin e tyre. Ndër këto vepra është edhe përdorimi i medikamenteve të ndryshme, me qëllim të shtyrjes së ciklit mujor, duke dashur që ta agjërojnë Ramazanin. Kjo nuk është e nevojshme, por mund të arrijë edhe në ndalesë të prerë, varësisht se sa këto medikamente e dëmtojnë shëndetin e përdorueses. Mjekët thonë se kjo është e dëmshme, prandaj edhe ndalesa e përdorimit të medikamenteve të ndryshme për shtyrjen e ciklit është po aq sa rrezikohet shëndeti.

3. Agjërimi është obligim për atë që nuk është udhëtar. Ndërsa udhëtarit është i liruar nga obligueshmëria e agjëritimit. Allahu, xh.sh., thotë: “...*Kush është i sëmurë prej jush, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë (të agjërojë) më vonë aq ditë...!*”, - mirëpo agjërimi i udhëtarit është më i dashur për Allahun, prandaj edhe e përmbyll ajetin duke thënë: “...*Mirëpo, po që se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.*”. (El Bekare: 184).

**Vëmendje:** Agjërimi i një dite fillon nga imsaku, dhe përfundon me perëndimin e diellit. Nëse gjatë një pjese të kësaj kohe njeriu nuk është udhëtar, nuk i lejohet ta prish agjërimin. Thënë ndryshe,

<sup>11</sup> Sahih Muslim, nr. 335, 1/265.

nëse dikush ka dalë nga rrethi i banimit të tij para imsaku, dhe synon të udhëtojë në largësi sa të konsiderohet udhëtar, duke pasur për qëllim që mos të kthehet në vendbanimin e tij deri pas akshamit, konsiderohet udhëtar, dhe i lejohet që mos të agjërojë.

Ndërsa, nëse gjatë një pjese të kësaj dite, qoftë nëse ka dalë nga rrethi i banimit pas imsakut apo ka dalë para imsaku, mirëpo synon të kthehet para akshami, nuk i lejohet ta prishë agjërimin. Kjo pasi dita e agjërimin është adhërim nga imsaku deri në aksham, dhe një pjesë të kësaj kohe i plotëson kushtet e atyre që duhet agjëruar, një pjesë të këtij adhërimi nuk është udhëtar, kështu që obligohet të agjërojë tërë ditën. Mirëpo, nëse vështirësia e rrugëtimit e ngarkon, aq sa nuk mundet t'i përballojë udhëtimit, e prish agjërimin në atë çast, për shkak të pamundësisë së agjërimin, apo rrezikshmërisë së shëndetit, mirëpo jo për shkak se është udhëtar<sup>12</sup>.

### **Agjërimi obligohet me hyrjen e muajit Ramazan**

Agjërimi i muajit Ramazan bëhet obligim me hyrjen e muajit Ramazan. Ndërsa, obligimi i ditëve të Ramazanit fillon nga zbardhimi i dytë, ose, thënë ndryshe, nga fillimi i shkëndijave të zbardhimit real, dhe përfundon me perëndimin e diellit. Informimi - njoftimi për fillimin dhe përfundimin e Ramazanit dhe agjërimin e ditëve përkatëse realizohet përmes këtyre formave:

- a. **Shikimit të Hënës:** Nëse do të shihej Hëna në fund të muajit Shaban, konkretisht në ditën e 29-të, lajmërohet autoriteti përgjegjës, i cili pas vërtetimit të saktësisë së informacionit, do të vendosë ta shpallë apo jo ditën vijuese si Ramazan. Kështu që, agjërimi shpallet nga autoriteti kompetent-institucional, dhe jo nga shikimi apo jo i Hënës<sup>13</sup>.

<sup>12</sup> Prof. Dr. Ebu El Haxh, Sallah, *El Minhaxh El Vexhiz fi Fikh Et Taharah ve Es Salah ve Es Sijam ve El Itikaf*, (Jordan, Amman, Dar El Faruk, 2015), f. 192

<sup>13</sup> Err Rrazi, Husamudin, *Hullasatu Ed Delail ve Tenkih El Mesail fi Sherh El Kuduri*, (Jordan-Amman, Der El Feth, 2016) 1/573-574.

Prandaj, obligimin dhe të drejtën e shpalljes së fillimit të Ramazanit nuk e gëzon dhe as nuk i takon individit, edhe nëse atë e ka parë me sytë e vet. Atij mund t'i refuzohet dëshmia për arsye të ndryshme, dhe se agjërimi i bëhet obligim vetëm atij, përderisa është i bindur se e ka parë Hënën. Atij i ndalohet thirrja e njerëzve për ta agjëruar Ramazanin, gjë e cila do të rezultonte më çrregullime dhe huti në shoqëri. Kjo kompetencë në aspektin juridik fetar është e rezervuar për institucionin, autoritetin kompetent. Në vendin tonë autoriteti i vetëm kompetent për shpalljen e Ramazanit është Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës. Për këto procedura verifikuese, përmes së cilave do të përcaktohej fillimi i Ramazanit, na ka informuar Muhamedi, a.s., i cili thotë: *“Agjëroni atëherë kur ta shihni Hënën, dhe përfundojeni agjërimin atëherë kur ta shihni atë, ndërsa nëse ajo nuk duket, atëherë plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë!”*<sup>14</sup>. Nëse në ditën e 29-të shihet Hëna, të nesërmen duhet agjëruar. Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Mos agjëroni derisa ta shihni Hënën, dhe qëndroni agjërueshëm derisa ta shihni atë, nëse nuk duket nga turbullira e qiellit, përcaktojeni atë.”*<sup>15</sup>.

- b. Duke e plotësuar muajin Shaban tridhjetë ditë:** Nëse nuk duket Hëna në përfundim të ditës së 29-të, atëherë plotësohen 30 ditë të muajit Shaban, dhe Ramazani me automatizëm fillon pas ditës së tridhjetë të muajit Shaban. Muhamedi, a.s., në transmetim e lartcekur ka thënë: *“...plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë!”*.
- c. Përmes llogaritjes astronomike:** Astronomia është shkencë që i studion trupat qiellorë dhe proceset e tyre. Ajo në studimet e veta përdor metoda shkencore, e të cilat tashmë janë shumë të sakta dhe të avancuara. Në periudhë të gjatë, shkenca e Astronomisë nuk ishte e formuar aq sa t'i bindte dijetarët islamë për saktësinë e rezultateve të saj.

**Kujdes:** Shkenca e Astronomisë nuk duhet ngatërruar me **Astrologjinë**, apo me pseudo-shkencat që mundohen ta zbulojnë fatin e njerëzve

<sup>14</sup> *Sahih El Buari*, nr. 1810, 2/574,.

<sup>15</sup> *Sahih Muslim*, nr. 1080, 2/759.

përmes vrojtimit të lëvizjeve të trupave qiellorë. Astrologjia nuk ka baza apo rregulla shkencore, prandaj më shumë i ngjan metodës së falltarëve, gjë e cila është e ndaluar.

Sot Astronomia është shkencë me rregulla, ligje, dhe metoda të cilat studiohen në institucione arsimore, universitete etj. Tanimë rezultatet e llogaritjes së lëvizjeve të trupave qiellorë e planetëve janë jashtëzakonisht precize dhe shumë të sakta. Precizitet aq i lartë, ku pas dhjetëra vitesh mund të tregojë ditën, orën, po edhe minutën e eklipsit, dhe saktësisht se cilën pjesë të Tokës e përfshin ajo etj. Llogaritja astronomike është shumë më e saktë sesa përpjekja e shikimit të Hënës me sy.

**Imam Es Subkiju**, i cili ka vdekur në vitin 756 hixhrij, konkretisht 689 vjet më parë (ishte prej dijetarëve të fundit që i ngjasonte imamëve të katër shekujve të parë në dituri). Ai thoshte se saktësia e llogaritjes astronomike është e prerë, ndërsa dëshmia e dëshmitarëve është e diskutueshme. Diçka që është e diskutueshme nuk mund të ketë prioritet para të padiskutueshmes, e assesi të ketë përparësi... prandaj, nëse dikush thotë se e kam parë Hënën, dhe llogaritja astronomike e dëshmon të kundërtën, apo anasjelltas, mbështetemi dhe vendosim sipas llogaritjes së astronomisë<sup>16</sup>. Nëse Imam Es Subkiju e kishte thënë këtë para shtatë shekujve, çka do të thoshte sot, po ta shihte këtë zhvillim të jashtëzakonshëm të Astronomisë, e cila dëshmon me prova për rezultatet e saja. Saktësinë e metodës shkencore të Astronomisë e dëshmojnë studiuesit e saj, myslimanë dhe jomyslimanë. Hoxha ynë, Shuajb El Arrnauti, në njërën nga ligjëratat e tij, na thotë se e kishte parë një shqiptar nga Siria, i cili e kishte përgatitur një kalendar për rreth 400 vjetët e ardhshme, preciziteti i të cilit studim i kishte lënë përshtypje të jashtëzakonshme. Mirëpo, me keqardhje, vazhdon ai, fatkeqësisht ai kalendar dhe studimi i tij ishin shkatërruar nga faktori njeri, pasi bindja e tyre ishin në kundërshtim me punën e tij<sup>17</sup>. Hoxha ynë, Ahmed El Xhemal, tregon se një marinar mysliman i devotshëm i kishte thënë se preciziteti i kohëve është me sekonda, gjë të cilën e njohim shumë mirë, pasi natyra e punës sonë ndërlihet me precizitetin koh-

<sup>16</sup> Es Subkij, Tekijudin, *Fetava Es Subkij*, (Egjipt, Dar El Mearif) vëll. I, f. 209.

<sup>17</sup> Jordan, Amman, lagjia: Medinetu Err Rrijadije, në shtëpinë e tij, viti 2015.

or<sup>18</sup>. Llogaritjen astronomike për përcaktimin e kohëve e pranojnë shumica e dijetarëve bashkëkohorë. Hadithet e lartcekura nuk e ndalojnë përdorimin e metodave të tjera, nëse profesionalistët e fushës së tyre dëshmojnë për saktësinë e tyre.

Nëse dijetarët islamë janë unifikuar për një normë juridike, mbyllet mundësia e diskutimit të saj. Mendimet që e atakojnë atë nuk konsiderohen fare, dhe pranimi i tyre është i pamundshëm. Mirëpo, nëse konsensusi i këtyre dijetarëve ndërlihet me ndonjë shkak specifik, atëherë, me ndryshimin e shkakut ndryshon edhe norma juridike e saj. Shkaku i mospranimit të llogaritjes astronomike ka qenë pamjaftueshmëria e saktësisë së saj. Prandaj, nëse sot saktësia e arritjeve astronomike është e pakontestueshme, duhet që edhe përfitimi nga ajo të jetë i padiskutueshëm. Llogaritja shkencore astronomike më nuk është e dyshimtë. Ajo është më e saktë sesa shikimi i Hënës me sy. Njeriu mund të gabojë, të hutohet apo të mashtrohet nga lëvizjet që i sheh apo nuk i sheh në horizont, ndërsa gabimet apo hutimet e tilla shkencore janë thuajse të pamundshme.

**Shqetësim:** Nëse llogaritja astronomike është aq e saktë, atëherë pse ndodh që studiuesit e Astronomisë të thonë se ka filluar muaj i ri hënor, ndërsa shikimi i Hënës është i pamundur?

Këtë përgjigje e shpjegon Prof. Dr. Sheref El Kudah, në punimin e tij shkencor, ku thotë se Hëna nuk mund të shihet me sy para 15 orëve, dhe mund të zgjatë pamundësia e shikimit të saj deri pas 30 orëve. Sigurisht se përmes teleskopit mund të shihet më shpejt, mirëpo jo para 12 orëve pas lindjes. Shkaku i mosdukjes së Hënës gjatë këtij intervali kohor është sepse Toka gjendet në mes të Diellit dhe Hënës, dhe si rezultat i këtij pozicioni rrezet e Diellit nuk arrijnë në Hënë, dhe ato rreze nuk do të mund të reflektojnë në Tokë, prandaj nuk do të duket Hëna. Kjo do të vazhdojë derisa Hëna të devijon aq sa rrezet e Diellit ta arrijnë Hënë, e të cilat pastaj do të reflektojnë në Tokë, dhe do të mund të shihet Hëna<sup>19</sup>. E njëjta

<sup>18</sup> El Hamevij, Ahmed El Xhemal, *El Ihbar Bivakt El Imsak Biliftar* (Jordan-Amman, Dar Linesher ve Et Tveziu. 2014) f. 53-54.

<sup>19</sup> El Kudah, Prof. Dr. Sheref, *Mexheletu Dirasat*, (El Xhama El Urdunijeh, 1999). nr. 2, 26/17,18.

gjë ndodh edhe kur muaji është në procesin e përfundimit të tij, kur disa orë para përfundimit nuk ka mundësi të shihet Hëna.

Pretendimet se Muhamedi, a.s., e ka ndaluar llogaritjen astronomike janë të pasakta dhe keqkuptim. Pejgamberi, a.s., thotë: *“Ne jemi popull analfabet, nuk dimë të shkruajmë dhe as të llogarisim; muaji është njëzet e nëntë ditë apo tridhjetë ditë.”*<sup>20</sup>. Hadithi duhet të kuptohet kështu:

- Ai e pasqyron gjendjen arsimore të arabëve për atë kohë. Këtë e thotë Zoti, xh.sh.: *“Allahu është Ai që ua solli analfabetëve një të dërguar nga gjiri i tyre...”* (El Xhumua: 2).
- Kur pasqyrohet gjendja, assesi nuk kuptohet se duhet të vazhdohet ashtu. Muhamedi, a.s., në mundësinë e parë kishte investuar në dituri, dhe atë përmes lirimit të robërve të luftës, duke ua kushtëzuar me mësimin e shkrimit për dhjetë (10) veta prej myslimanëve<sup>21</sup>.
- Objektivi i këtij hadithi është se, përderisa jemi shoqëri analfabetësh, të përcaktohen kohët e adhurimeve me të shikimit të Hënës, apo të plotësimit të muajve 30 ditë.
- Hadithi nuk e ndalon mësimin. Ai nuk e ndalon as llogaritjen astronomike. Zoti, xh.sh., në Kuran thotë: *“Allahu e ka bërë Diellin burim drite, kurse Hënën e ka bërë të shkëlqejë, që ju ta dini numrin e viteve dhe njehsimin e kohës...”* (Junus: 5).
- Kështu që, llogaritja kohore është e kërkuar. A nuk është trashëgimia e tëra e ndërtuar në llogarinë e numrave?! Si të jetë llogaritja e ndaluar. Veçse, kërkohet që ajo të jetë e saktë.
- Fjala رؤية - رأى në gjuhën e Kuranit e ka kuptimin *shikim, njohje*, e cila arrihet përmes zemrës, mendjes dhe syrit. Zoti, xh.sh., thotë në Kuran:

أَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ

*“A nuk e ke parë çfarë bëri Zoti yt me poseduesit e elefantëve?!”* (El Fil: 1).

<sup>20</sup> Sahih El Buhari, nr. 1814, 2/575. Dhe Sahih Muslim nr. 1080, 2/761.

<sup>21</sup> Hanbel, Ahmed, *Musned*, recensoi: hoxha Shuajb Arnauti (Bejrut, Mesesetu Er Rrisaleh 2001) nr. 2216, 4/92. Hadithi i saktë.

Folja تر nga رأى - رؤية në gjuhën e Kuranit d.m.th.: a nuk e ke parë, dëgjuar?! Në kuptim real, Zoti, xh.sh., po thotë: “A nuk e ke dëgjuar informacionin përmes së cilit e ke kuptuar aq qartë, sikurse ta kishe parë me sy, se si ka vepruar Zoti me poseduesit e elefantëve<sup>22</sup>.”. Realisht Muhamedi, a.s. nuk e kishte parë ngjarjen e elefantëve, por saktësia e shpalljes ishte aq e lartë, sikurse ta shihte me sy. Llogaritja astronomike është shumë e saktë, dhe trajtohet sikurse shikimi i Hënë me sy. Në njërin nga transmetimet e hadithit të theksuara më lart, thuhet: “*Nëse Hëna nuk duket nga turbullirat e qiellit, përcaktoheni atë!*”. Përcaktimi përfshin edhe llogaritjen. Përderisa do të kuptohet se kur fillon Ramazani nuk është e rëndësishme rruga që përdoret. Përveçse, ajo duhet të jetë shkencore dhe e saktë, në mënyrë që mos të gabohet. Muhamedi, a.s., në disa raste ka vepruar sipas fjalëve të sahabëve, sikurse, për shembull, në luftën e Bedrit, të Hendekut etj. Muhamedi, a.s., ka thënë: “*Ju jeni më të ditur se unë për çështje që nuk janë fetare.*”<sup>23</sup>.

### **Koha e fillimit të agjërimit të ditëve të muajit Ramazan**

Përcaktimi i kohës së imsakut, momentit kur duhet të stopohemi nga gjërat që e prishin agjërimit, është kompetencë e institucionit i cili vepron në bazë të argumenteve islame dhe nxjerr konkluzë unifikuese për myslimanët e vendit që përfaqëson. Lidhur me këtë çështje Muhamedi, a.s., ka thënë: “*Ezani i Bilalit vërtet është natën. Hani dhe pini derisa ta dëgjoni ezanin e Ibën Ummi Mektumit!*”<sup>24</sup>. Pejgamberi, a.s., nuk kishte kërkuar që çdokush të stopohet nga ushqimet sipas vlerësimit të tij. Ai urdhëronte që ata ta fillojnë agjërimit me ezanin e Ibën Ummi Mektumit, i cili ezan thirrej me kohën e imsakut. Ata vepruan sipas udhëzimit të Muhamedit, a.s., dhe nuk ishin të pavëmendshëm ndaj ajetit: “*...Hani e*

<sup>22</sup> En Nesefij, Abdullah bin Ahmed, *Medarik Et Tenzil ve Hakaik Et Tevil*, (Dar El Kalem Et Tajib 1998), 3/580.

<sup>23</sup> *Sahih Muslim*, nr. 2363, 4/336.

<sup>24</sup> *Sahih Muslim*, nr. 1092, 2/768,

*pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës)...!” (El Bekare: 187). Nga kjo kuptojmë se syfyri zgjat derisa të duket apo të dallohet bardhësia e ditës nga ajo e natës. Zoti, xh.sh., në Kuran nuk ka thënë derisa të shfaqet apo të qartësohet ajo, por ka thënë se, derisa të dallohet bardhësia e ditës nga ajo e natës. Një sahab i kishte thënë Muhamedit, a.s.: “Unë i vendosi nën jastëk dy penj, që ta dalloj dritën e mëngjesit nga errësira e natës.”. Kurse, Pejgamberi, a.s., ia kishte sqaruar se ajeti kuranor nuk e përmban atë kuptim, por ai e kishte për qëllim “*dallimi mes errësirës së natës nga zbardhimi i ditës*”<sup>25</sup>. Prandaj shkëndijat e para të zbardhimit të ditës janë kufiri i fundit i lejimit të ushqimit dhe njëkohësisht fillimi i agjërimit.*

Pretendimi që përcaktimi i kohës së imsakut është para kohës, dhe se është legjitime ngrënia dhe pirja edhe pas imsakut, është gabim dhe e rrezikim, keqkuptim i fesë, si dhe mosrespektim i kohëve të përcaktuara nga autoriteti institucional. Kjo shfaq turbullira dhe çrregullime shoqërore, e të cilat kanë arritur të depërtojnë edhe në mes familjeve, meqë disa anëtarë të familjes vazhdojnë të hanë e pinë, e disa të tjerëve ndoshta kanë mbetur pa syfyr, pa ushqim, pasi ka kaluar koha! Kjo formë e veprimit jo vetëm që e prish agjërimit e atyre që hanë pas imsaku, por edhe ndikon në prishjen e agjërimit edhe të të tjerëve, si dhe gjithashtu krijon përçarje në familje dhe shoqëri, e të cilat çrregullime aspak nuk na duhen. Është e çuditshme se si merret ky guximin që të veprohet ashtu. Dhe, sikurse nuk mjaftohen me këtë, ata ftojnë edhe të tjerë në këtë veprim, e i cili në rastin më të mirë është i dyshimit. Veprimi i tyre paraqet shprehjen apo të kuptuarit, se personi po e di atë që të tjerët nuk e dinë!<sup>26</sup> E, Enesi, r.a., tregon që mes syfyrit – imsakut - dhe faljes së namazit të sabahut me Pejgamberin, a.s., i lexonim nga 50-60 ajete të Kuranit<sup>27</sup>. Leximi i këtyre ajeteve me përkushtim dhe falja e sunetit merr rreth 30 minuta. Falja e Sabahut pas këtij intervali kohor nga imsaku është sipas Sunetit.

<sup>25</sup> *Sahih Muslim*, nr. 1090, 2/766.

<sup>26</sup> El Hamevij, *El Ihbar Bivakt El Imsak Biliftar*, f. 67.

<sup>27</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 550, 1/210.



**Përfundimi i agjërimit të ditëve të Ramazanit, iftari:** Në citatin që tregohet koha e syfyrit, potencohet edhe koha e iftarit, konkretisht deri në cilën kohë duhet të vazhdojë agjërimi. Zoti, xh.sh., thotë: “...*pastaj, plotësojeni agjërimitin derisa të bie errësira...!*” (*El Bekare: 187*). Agjërimi plotësohet kur perëndon dielli. Nuk mjafton humbja e shikueshmërisë së Diellit, përderisa ende nuk ka perënduar. Pejgamberi, a.s., na tregon se kur bie errësira, njëkohësisht plotësohet edhe agjërimi. Ai thotë: “*Nëse nata ka filluar nga lindja, dhe përfundon dita nga perëndimi, duke perënduar dielli, agjëruesi le të bëjë iftar!*”<sup>28</sup> Që të perëndojë dielli, duhet:

- Fillimi i natës nga lindja. Këtë e thotë ajeti, kur thotë: “...derisa të bie errësira...”.
- Përfundimi i diellit nga perëndimi. Në një hadith tjetër thotë: “*Mosdukja e Diellit*” të cilin e sqaron transmetimi tjetër, kur thotë: “*Perëndimi i diellit*”, kur perëndon dielli, sigurisht që nuk duket më. E nëse Dielli nuk duket, nuk do të thotë se ka perënduar.
- Perëndim i diellit, jo fshehje e tij pas kodrave apo maleve, por të perëndojë në horizont.<sup>29</sup>

Porosi të Muhamedit, a.s.: “...*Ai që ruhet nga të dyshimtat, e ka ruajtur pastërtinë e fesë dhe të nderit të vet, kurse ai që i vepron të dyshimtat, veçse ka rënë në haram...*”<sup>30</sup>. “*Lëri gjërat e dyshimta duke kaluar tek ato që nuk janë të dyshimta!*”<sup>31</sup>. Ju, si duhet të veproni?! Ta pasoni institucionin, t’i siguronit adhurimet, apo të përfundoni në teoritë e pretendimeve individuale, e që zakonisht barten nëpër shoqëri dhe janë pa studim dhe referencë. Këtë e refuzojnë shumica e dijetarëve.

Përfundimi i Ramazanit, kalimi në muajin Sheval, konkretisht shpallja e Bajramit, bëhet në formë të përafërt me atë të shpalljes së Ramazanit. Veçse, në asnjë rrethanë nuk lejohet agjërimi i kësaj dite, ashtu sikurse ndalohet prishja e agjërimit para shpalljes së Bajramit. Kështu arrihet uniteti i shoqërisë, gjë të cilën e do shumë edhe i Madhi Zot, xh.sh.

<sup>28</sup> *Suahih El Buhari*, nr. 1853, 2/591.

<sup>29</sup> El Hamevij, *El Ihbar Bivakt El Imsak Biliftar*, f. 42-43.

<sup>30</sup> *Sahih Muslim*, nr. 1599, 3/219.

<sup>31</sup> *Sahih El Buahri*, nr. 1946, 2/724.

**Nijeti:** Agjëruesi duhet që me zemër ta ketë në dije se dëshiron të agjërojë. Kushtëzohet që nijeti i tij të jetë i prerë dhe jo i hamendur. Përgatitja e alarmit për t'u zgjuar në syfyr, zgjimi në syfyr, stopimi nga ushqimet në kohën e imsakut etj., konsiderohen në pozitën e nijetit, elemente këto me të cilat është i pajisur çdo agjërues. Shqiptimi i nijetit me gojë, është i preferuar. Veçanërisht preferohet nijeti me gojë (shqiptimi) me pëlqimin e katër medhhebeve për atë që mund t'i shfaqen dyshime apo që e ndien veten më të sigurt nëse e shpreh njëjtin për agjërimin e tij, kështu që, me shqiptimin e nijetit edhe e largon dyshimin.

**Koha e nijetit:** Koha e nijetit për agjërim në Ramazan fillon nga akshami i ditës paraprake të agjërimin, dhe përfundon përafërsisht dyzet e pesë (45) minuta para hyrjes së kohës së drekës të ditës që agjëron<sup>32</sup>. Sigurisht nëse deri në këtë kohë nuk ke vepruar diçka që e prish agjërimin.

**Si bëhet nijeti:** Mjafton që në Ramazan të vendosësh me zemër për secilën ditë që të agjërosh. Allahu, xh.sh., e ka caktuar që koha e muajit Ramazan të jetë agjërim farz. Prandaj, kjo kohë është e zënë me agjërimin e Ramazanit<sup>33</sup>. Gjithsesi se kërkohet nijeti për agjërim, mirëpo preferohet të kesh bindje që agjërimi yt është për Ramazan.

Nijeti duhet të veprohet për çdo ditë. Çdo ditë agjërimi është adhurim i veçantë, i pavarur, prandaj ka nevojë për nijet të veçantë. Nëse agjëron sot, në iftar përfundon agjërimi, që të fillojë agjërimi i ditës vijuese, kështu që kërkohet nijet tjetër. Nëse prishet agjërimi një ditë, nuk është pengesë për agjërimin e ditëve vijuese, por edhe prishja e agjërimin të asaj dite nuk e prish agjërimin e ditëve të tjera<sup>34</sup>.

<sup>32</sup> El Merginani, Alij bin Ebi Beker bin Abduxhelil, *El Hidajeh fi Sherh Bidejeti El Mubtedij*, recensoi: Talal Jusuf (Bejrut, Dar Ihja El Kutub El Arabije) 1/116.

<sup>33</sup> El Kesani, Alauddin, Ebu Bker Ibën Mesud Ibën Ahmed, *Bedaia Es Sanaia fi Tertib Esh Sheraia*, (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmije, 1986), 2/84.

<sup>34</sup> El Musilij, Abdullah bin Mahmud, *El Ihtijar Et Talil El Muhtar*, recensoi: hoxhë Shuajb Arrnauti, (Bejrut, Muesesetu Err Risale El Alemijeh, 2009) 1/398.

## Sunetet e agjërimit

Sunetet apo veprat e preferuara në muajin e bekuar Ramazan janë të shumta. Kjo pasi është muaj i përpjekjeve për ta arritur kënaqësinë e Zotit, xh.sh. Sigurisht se janë të shumta edhe format e përpjekjeve për ta arritur një bagazh sa më të madh të shpërblimeve, e njëkohësisht edhe të fshirjes së mëkateve. Rënditja e rëndësisë së tyre dallon prej personit në tjetrin, varësisht se sa ndikojnë ato vepra në jetën e individit. Ne do t'i potencojmë disa nga veprat e preferuara:

1. Sugjerohet që para hyrjes në Ramazan të bëjmë atmosferë Ramazani, në mënyrë që kur të hyjmë në Ramazan, ta ndiejmë dhe ta përjetojmë sa më mirë. Që nga koha e Pejgamberit, a.s., besimtarët luteshin që ta arrinin dhe ta agjëronin muajin Ramazan.
2. Syfyri; preferohet të zgjohemi në syfyr. Pejgamberi, a.s. ka thënë: *“Hani syfyr, sepse begatia është në syfyr!”*<sup>35</sup>.
3. Pastrimi i dhëmbëve pas ushqimit në syfyr, para imsakut. Këtu përcaktohet koha e pastrimit, pasi preferohet distanca nga çdo gjë mund ta rrezikojë atë.
4. Bërja iftar me ujë apo hurme menjëherë pas perëndimit të diellit. Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Umeti im do të ketë mirësi përderisa nuk e vonon iftarin.”*<sup>36</sup>.
5. Kujdesi nga çdo gjë që mundet ta rrezikojë agjërimin, edhe pse nuk e prish atë, sikurse që është shpëlarja e gojës deri te laringu gjatë abdesit. Edhe kur jemi agjërueshëm preferohet vetëm shpëlarja e gojës, pa përcjelljen e ujit deri te laringu.
6. Në Ramazan preferohet që njeriu të garojë në vepra të mira, si:
  - Në leximin e Kuranit; të lexojë sa më shumë Kuran, sepse shpërblimi i leximit të tij në këtë muaj është i jashtëzakonshëm. Xhibrili, a.s., për çdo Ramazan e lexonte Kuranin me Muhamedin, a.s., e në Ramazanin e fundit të Muhamedit, a.s., e lexuan Kuranin dy herë<sup>37</sup>.

<sup>35</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 1923, 3/29.

<sup>36</sup> *Sahih El Muslim*, nr. 1098, 2/771.

<sup>37</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 3623, 4/203.

- Bujaria, në Ramazan, si asnjëherë më parë, sepse besimtari duhet ta shtrijë dorën e ndihmës ndaj të tjerëve. Ibën Abbasi, r.a., thotë: “*I Dërguari i Allahut, a.s., ishte njeriu më bujar, ndërsa kulmi i bujarisë së tij ishte në Ramazan*<sup>38</sup> ...”.
  - Ftesa apo shtrimi i iftarit ndaj të tjerëve, veçanërisht për të afërmit, pasi këtu bashkohen mirësitë. Ruajtja e lidhjeve familjare, ushqimi i agjërueseve etj. Pejgamberi, a.s., ka thënë: “*Melekët luten për atë që i ushqen agjëruesit derisa ta përfundojnë ushqimin...*”<sup>39</sup>. Gjithashtu Pejgamberi, a.s., thotë: “*Ai që i jep iftar një agjëruesi, e merr shpërblimin e agjëruesit, pa i pakësuar atij asgjë nga shpërblimi.*”<sup>40</sup>.
7. Preferohet falja e njëzet (20) rekateve teravi. Të fillohet me imamin falja e jacisë, dhe të përfundojë me imam, respektivisht me faljen e vitrit së bashku. Sahabët, r.a., në kohën e Omerit, r.a., i falnin njëzet (20) rekate tervai...<sup>41</sup>
  8. Qëndrimi në xhami gjatë dhjetë (10) ditëve dhe netëve të fundit të Ramazanit. Kjo me nijet adhurimi. Ibën Omeri, r.a., thotë: “Pejgamberi, a.s., qëndronte në xhami në dhjetëshin e fundit të Ramazanit.”<sup>42</sup>.
  9. Shtimi i intensitetit të lutjeve. Njëra prej mirësive të Ramazanit është se në të pranohen lutjet. Muhamedi, a.s., ka thënë: “Tre personave nuk u refuzohet lutja: agjëruesit derisa të bëjë iftar, udhëheqësit të drejtë, si dhe atij që i bëhet padrejtësi.”<sup>43</sup>.
  10. Objektivë apo qëllim i Ramazanit është që të ndikojë te besimtari për

<sup>38</sup> *Sahih Muslim*, nr. 2038, 4/1803.

<sup>39</sup> Et Tirmidhij, Muhamed bin Isa bin Sevrak, *Es Sunen*, recesoi: Dr. Beshar Avad Maruf (Bejrut, Dar El Garb El Islamij, 1998), nr. 745, 2/145. Imam Et Tirmidhiu ka thënë: Hadithi është Hasen Es Sahih.

<sup>40</sup> Burimi paraprak, nr. 807, 2/163. Imam Et Tirmidhiu ka thënë: Hadithi është Hasen Sahih.

<sup>41</sup> Ibën Xhad, Alij, *Musned*, recensoi: Amir Ahmed Hajdar (Bejrut, Muesesetu Nadir, 1990) nr. 2825, 1/413. Thotë hoxha Shuajb Arrnauti në recensimin e librit të “*El Ihtijarit*” hadithi është i saktë, ata që thonë ndryshe kanë gabuar 1/237.

<sup>42</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 2025, 3/47.

<sup>43</sup> *Musned i Ahmed bin Hanbelit* nr. 9742, 15/463.

ndryshim pozitiv. Agjërimi e përmbush shpirtin, e qetëson trupin, pasi e nivelon apo i minimizon kërkesat apo ambiciet fizike. Pejgamberi, a.s., ka thënë: “*Kush nuk e lë gënjeshtren, fjalët dhe punët e këqija, Allahu nuk ka nevojë që ai ta mbajë barkun bosh.*”<sup>44</sup>. Qëllimi i agjërimit është që njeriun ta bëjë të devotshëm. Apo, që njeriun ta bëjë adhurues të mirë të Zotit dhe njëri të dobishëm për familjen dhe shoqërinë. Agjërimi kontribuon për këto qëllime, nëse nuk arrihen këto objektiva, nuk është plotësuar qëllimi. Ne kemi nevojë për shpërblime dhe avancim të virtyteve të mira. Zoti, xhs.h., nuk ka nevojë për agjërimin tonë. Në llidhje me këtë edhe është thënë: “Kur nefsi është i uritur, të gjitha gjymtyrët ngopen, dhe kur nefsi ngopet, të gjitha gjymtyrët janë të uritura.”<sup>45</sup>.

### Gjërat që nuk preferohen gjatë agjërimit

Me termin “gjërat që nuk preferohen apo mekruhet” e agjërimit synojmë ato vepra që, nëse i veprojmë, nuk e prishim agjërimin, por preferohet që të distancohemi nga ato. Niveli i papëlqyeshmërisë së një vepre zakonisht ndërlidhet me nivelin e rrezikshmërisë së prishjes së agjërimit. Ndër gjërat e papreferuara gjatë agjërimit mund t’i potencojmë:

- Pastrimi i dhëmbëve me brushë dhe pastë dhëmbësh, për shkak të frikës se do shkojë diçka nga pasta në fyt, dhe nëse kjo ndodh, atëherë prishet agjërimi. Ndërsa pastrimi pa pastë dhëmbësh, gjithashtu nuk preferohet por është më i lehtë sesa përdorimi i pastës. Nëse është e urryer që kur të merret abdes mos të arrijë uji deri në laring (fyt), gjë që jashtë Ramazanit preferohet, atëherë përdorimi i brushës për pastrim do jetë më i papreferuar, pa asnjë diskutim<sup>46</sup>. Nga kjo përjashtohet përdorimi i misvakut<sup>47</sup>, pasi Pejgamberi, a.s., e ka preferuar përdorimin e tij gjithëherë para se të merret abdes, pava-

<sup>44</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 1903, 3/26.

<sup>45</sup> Musallari, Rushit, Fikhu Praktik, f. 448.

<sup>46</sup> Prof. Dr. Ebu El Haxh, Sallah, *El Minhaxh El Vexhiz fi Fikh Et Taharah ve Es Salah ve Es Sijam ve El Itikaf*, f. 183.

<sup>47</sup> Shkop që përdoret për pastrimin e dhëmbëve.

rësisht a ishte Ramazan, apo jo<sup>48</sup>. Kjo vlen vetëm për misvakun, sepse misvaku është përjashtim tekstual, dhe ne nuk kemi të drejtë të bëjmë analogji apo krahasim në përjashtime. Analogjia bëhet në rregullat e zakonshme.

- Çdo gjë që të dobëson gjatë agjërimit dhe nuk është e domosdoshme, nuk është e preferuar. Për shembull: dhurimi i gjakut, hixhamja etj. Enes bin Maliku, r.a., është pyetur: “A e keni konsideruar të papreferuar hixhamen për agjëruesin?”. Ai ka thënë: “Jo, përveçse për shkak të dobësimit të njeriut.”<sup>49</sup>
- Ushqimi në kohën kur dyshohet se a ka hyrë koha e imsakut, pasi nëse do ketë hyrë koha e imsakut agjërimi juaj do të jetë i prishur. Besimtari duhet ta bëjë atë që adhurimet t'i kryejë në formën më të plotë dhe më të mirë. Pejgamberi, a.s., ka thënë se “*me të vërtetë hallalli është i qartë, dhe harami është i qartë, dhe në mesin e tyre ka çështje të dyshimta... kush ka rënë në dyshime, ka rënë në haram*”<sup>50</sup>. Prandaj, rrezikimi i agjërimit është i ndaluar.
- Nuk preferohet shijimi i ushqimit për atë që e përgatit ushqimin, por nuk ndalohet, veçanërisht nëse burri nuk ka mirëkuptim. Ibën Abbasi, r.a., ka thënë se lejohet të shijohet gjella në enën që përgatitet.<sup>51</sup> Megjithatë, distancimi nga kjo praktikë është më i dashur.
- Të gjitha gjërat që jashtë Ramazanit janë të arsyeshme, por edhe të kërkuara mes bashkëshortëve, e të cilat mund të sjellin te kontakti intim, janë të papëlqyera. Sa më provokues të jetë raporti emocional i tyre, aq më të papreferuara janë ato vepra. Prandaj, të gjitha veprat në të cilat njeriu mund të përfundojë me intimitet, janë jo të preferuara<sup>52</sup>.

<sup>48</sup> *Sahih El Buhari*, 3/31. Në preambulën e kapitullit.

<sup>49</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 1940, 3/33.

<sup>50</sup> *Sahih Muslim*, nr. 1599, 3/1219.

<sup>51</sup> *Sahih El Buhari*, 3/30. Në preambulën e kapitullit.

<sup>52</sup> Esh Shejbani, Ebu Abdullah, Muhamed bin El Hasan bin Ferkad, *El Asef*, recensoi: Ebu El Vefa El Afgani, (Pakistan, Idaretu El Kuran ve El Ulum El Islamijeh), 2/235.

## Veprat që nuk janë të papëlqyera gjatë agjërimit

Ndër veprat që lejohet të veprohen, e të cilat nuk e prishin agjërimit dhe nuk janë të papëlqyera, pasi nuk e rrezikojnë prishjen e agjërimit, do t'i përmendim:

- Përdorimi i pikave të ndryshme në sy nuk e prish agjërimit, edhe nëse ndien shije në fyt. Sytë janë kanale të hapura. Llogariten pjesë e brendshme e trupit. Depërtimi i ndonjë gjëje përmes syve, juridikisht nuk konsiderohet prishës për agjërimit. Mirëpo kjo është përjashtim i rregullit përmes hadithit të Pejgamberit, a.s., i cili i kishte lyer sytë dhe kishte nxitur për lyerjen e tyre...<sup>53</sup>
- Nuhatja e aromave apo parfumeve. Përmes parfumit nuk depërton asnjë materie, vetëm se nuhatet erë e mirë, e cila gërshetohet me ajrin. Ndërsa, aromat në formë tymi, që burojnë nga druri, e prishin agjërimit<sup>54</sup>. Prandaj, tymi i duhanit, i parfumeve etj., e prishin agjërimit, nëse nuhaten me qëllim, sepse ato burojnë ose janë materie rrjedhëse të një objekti, thithja e të cilës e prish agjërimit.
- Përdorimi i oksigjenit përmes aparaturave nuk e prish agjërimit. Nëse në të vendosen medikamente shëruese, të cilat arrijnë në organet e konsiderueshme, prishet agjërimit, për shkak të materies që hyn në trup, dhe jo për shkak të oksigjenit<sup>55</sup>.
- Vjellja pa qëllim nuk e prish agjërimit. Gjithashtu edhe nëse vjellim me qëllim, por në sasi të vogël, nuk prishet agjërimit. Prandaj, vjellja e prish agjërimit, nëse bëhet me qëllim dhe me gojën plot. Resulullahi, a.s., ka thënë: *“Ai që vjell, nuk e ka detyrë të agjërojë më vonë, kurse ai që qëllimisht e provokon vjelljen, duhet ta agjërojë atë ditë më pas”*<sup>56</sup>. Prandaj, nëse vjell pa qëllim, pavarësisht sa

<sup>53</sup> *Et Tirmidhij fi Sunenihi*, nr. 1757, 3/286. Imam Et Tirmidhiu ka thënë, hadithi është i mirë-i pranuar.

<sup>54</sup> Prof. Dr. Ebu El Haxh, Sallah, *El Minhaxh El Vexhiz fi Fikh Et Taharah ve Es Salah ve Es Sijam ve El Itikaf*, f. 182.

<sup>55</sup> Burimi paraprak, f. 186.

<sup>56</sup> Ebu Davud, Sulejman bin El Eshath bin Is'hak bin Beshir, *Sunen Ebu Davud*, recensoi: Muhamed Kamil Kurrah, nën mentorimin e hoxhë Shuajb El Arnautit, (Bejrut,

vjell, nuk e prish agjërimin. Ndërsa, nëse këtë e bënë qëllimisht, në sasi të madhe sa e vjellura nuk mund të mbahet në gojë, prishet agjërimi, dhe duhet të kompensohet ajo ditë.

### **Parimet mbi të cilat vlerësohet saktësia e agjërimin**

Rregulla përmes së cilës përgjithësisht e rregullon gjërat që e prishin dhe nuk e prishin agjërimin është:

القاعدة: يفطر الصائم بدخول مفطر معتبر من منفذ معتبر إلى جوف معتبر بوصول معتبر مع ارتفاع الموانع المعتبرة.

*“Agjëruesi e prish agjërimin e tij me depërtimin e materieve që juridikisht janë prishëse, të cilat nëpërmes rrugëve të konsideruara arrijnë në organet e synuara, dhe mbeten në to, me kusht që të evitohen pengesat ligjore të konsiderueshme (të cilat mund ta ndryshojnë normën)!”*

Nga ky rregull kuptojmë se elementet apo rregullat e gjërave që e prishin agjërimin janë:

1. *Depërtimi i materieve që juridikisht janë prishëse*: Materiet që juridikisht nuk e prishin agjërimin janë apo konsiderohet çdo gjë që vendoset nga jashtë, që është aq e imët, sa t’i ngjajë susamit të bluar, dhe nuk e ndiejmë kalimin e saj në organizëm; këto materie nuk e prishin agjërimin<sup>57</sup>. Gjithashtu, mbetjet e ushqimit në gojë, të cilat janë më pak sesa kokrra e bizeles, juridikisht nuk janë materie që e prishin agjërimin, dhe kalimi i tyre në organizëm nuk e prish agjërimin. Kjo pasi këto sasi janë aq të imëta, sa që është e vështirë të ruhen nga to<sup>58</sup>. Zoti, xh.sh., nuk na ngarkon me atë që është ngarkesë e tepërt psikike dhe praktike.

Dar Errisaleh El Alemije, 2009), nr. 2380, 4/56. Sheh Shuajbi thotë: hadithi është i saktë.

<sup>57</sup> El Mevla Hasru, Muhamed bin Feramurzi, *Darar El Hukam Sherh Garar El Ahkam*, (Bejrut, Dar Ihja El Kutub El Arabije) 1/207.

<sup>58</sup> El Kesani, *Bedaia Es Sanaia fi Tertib Esh Sheraia*, 2/90.



Prandaj, çdo gjë që hyn nga jashtë, ndihet në organizëm, dhe çdo mbetje ushqimi në gojë që është sa bizelja apo më e madhe, e prish agjërimin, sikurse janë ushqimet, lëngjet, zalli, dheu etj. Materia që e prish agjërimin nuk përkufizohet me të qenit ushqyese.

2. Përmes **rrugëve të konsideruara**, kanaleve apo vrimave përmes të cilave depërtojnë materiet në organizëm, e që duhet të jenë juridikisht të pranuar. Që një vrimë apo kanal të jetë juridikisht i pranuar, sikurse goja, hunda, vrima anale etj., duhet që mjekësia t'i konsiderojë kanale depërtuese në organizëm. Pavarësisht se këto kanale a janë natyrale apo artificiale, p.sh., nëse trupi ka plagë apo kanal që, nëse diçka bie në të, arrin në organet e konsiderueshme, agjërimi prishet. Mirëpo, nëse ndonjë materie vendoset në trup, mirëpo nuk arrin në këto organe, nuk plotësohet shkaku i prishjes së agjërimit, respektivisht agjërimi nuk prishet. Ebu Bekri, r.a., thoshte se njëri prej shoqëruesve të Pejgamberit, a.s., ka thënë: “Të Dërguarin e Allahut, a.s., e kam parë në El Araxh -vend afër Mekës-, duke hedhur ujë në trupin e tij, ndërkohë që ishte agjërueshëm, dhe e bënte këtë për shkak të etjes dhe nxehtësisë së madhe.”<sup>59</sup>. Pra, përderisa ujë dhe gjërat e ndryshme nuk kalojnë përmes kanaleve të konsideruara dhe nuk kanë arritur në organet e përcaktuara, agjërimi nuk prishet<sup>60</sup>. Nga kjo rezulton se çdo injeksion, infuzione që nuk kalon përmes këtyre rrugëve, nuk e prishin agjërimin, pavarësisht natyrshmërisë së tyre, sepse shkaku i prishjes së agjërimit nuk se a është materia ushqyese, apo jo.
3. Arritja e materieve në organet e synuara, e të cilat juridikisht e prishin agjërimin; organet e synuara dhe që janë destinacion janë: fyti, lukthi dhe zorrët<sup>61</sup>. Nëse materiet juridikisht prishëse, përmes kanaleve apo vrimave të konsideruara juridikisht arrijnë në destinacionin e tyre, në organet e synuara, agjërimi prishet. Sikurse që

<sup>59</sup> Ebu Davudi në *Sunenin e tij*, nr. 2365, 4/46. Hadithi është i saktë.

<sup>60</sup> Es Serahsi, Muhamed bin Ahmed bin Ebi Suhejl, *El Meksuut*, (Bejrut, Dar El Mearif, 1993), 3/68.

<sup>61</sup> El Kesani, *Bedaia Es Sanaia fi Tertib Esh Sheraia*, 4/8-9.

mund të jenë materiet e ngurta dhe të lëngëta, depërtimi i medikamenteve që kalojnë përmes fytit, vrimës anale dhe që arrijnë në lukth apo zorrë, pra, agjërimi priset. **Dhe, e ritheksojmë se të qenët e materieve ushqyese apo jo nuk është kriter përcaktues i prishjes së agjërimin.** Të qenët e materieve ushqyese të zakonshme ndikon në llojin e kompensimit, se a duhet të jetë kompensimi vetëm kaza, ditë për ditë, apo duhet të jetë dy muaj hënorë, plus dita përkatëse. Ndërsa, nëse këto materie nuk arrijnë në këto organe, agjërimi nuk priset. Prandaj, pas sqarimit të medicinës, se injeksionet, infuzionet etj., në asnjë rrethanë nuk hyjnë dhe nuk kalojnë nëpër vrimat juridikisht të pranuar, dhe assesi nuk arrijnë në organet e synuara -lukth, zorrë dhe fyt - , agjërimi nuk duhet të konsiderohet i prishur. Këtë e kanë thënë dijetarët qysh nga para njëqind vjetësh (100), sikurse ish-myftiu i Egjiptit, hoxha Muhamed bin Buhajt El Mutiëi, i cili thotë se, edhe nëse hipotetikiqisht diçka nga këto materie kalon në këto organe, përderisa nuk kalon përmes vrimave të konsiderueshme, agjërimi nuk priset. Sikur të ishte shkak i prishjes së agjërimin materia ushqyese, atëherë gëlltitja e zallit, gurit, gjeheve etj., nuk do ta prishte agjërimin.

Normat juridike ndërtohen mbi shkaqe (العلل), jo në objektiva (الأهداف). Ata që thonë se infuzionet ushqyese e prishin agjërimin, duke u argumentuar se përmes infuzionit ushqyës njeriu mund të keqpërdor dhe me lehtësi të agjërojë, do ta gjejë këtë përgjigje te ata që nuk e pranojnë këtë.

Fillimisht, vështirësia nuk është objektive, qëllim apo shkak i obligueshmërisë së agjërimin. Nëse besimtari agjëron përmes kësaj dinakërie, ai do të ketë mëkat te Zoti, dhe nuk i kërkohet ta bëjë kaza apo ta kompensojë agjërimin. Një vepër konsiderohet e përfunduar nëse përmbushen kushtet e saj. Prandaj, këtu kushtet e agjërimin janë plotësuar, dhe agjërimi nuk ka nevojë të përsëritet. Kategoria e shpërblimit të agjërueseve dallon në bazë të nijetit, vështirësisë, kënaqësisë që ndihet në kryerjen e adhurimeve etj.

Trupi i njeriut, nëse zhytet në ujë, thith sasi të konsiderueshme të tij, ndoshta edhe më shumë sesa një infuzion, dhe ai ujë e freskon dhe e for-

con trupin; megjithatë agjërimin nuk e prish, sepse uji nuk ka hyrë përmes rrugëve të pranuar juridikisht, dhe as nuk ka arritur në organet e përcaktuara. Pejgamberi, a.s., nuk e kishte pëlqyer që besimtarët të agjëronin më shumë se një ditë pa e ndërprerë, dhe nuk e ka pëlqyer që të agjërohen dy ditë ngjitur me një syfyr. Ai kishte thënë: “*Mos e lidhni agjërimin!*” (dy ditë pa e ndërprerë fare). I thanë: “O i Dërguar, ti i agjëron ditët pa i ndërprerë!”. Tha: “*Unë nuk jam sikurse ju. Unë qëndroj te Zoti im, më ushqen dhe më furnizon me pije*<sup>62</sup>.”.

Dijetarët islamë ndajnë mendime të ndryshme ndaj hadithit. Ata kanë thënë:

- Zoti, xh.sh., e ushqente me ushqime speciale, (sikur të ishte kështu, nuk do të quhej agjërim i pandërprerë, pasi është ushqyer) apo fiziku i tij ishte i asaj natyre, sa lehtësisht i përballonte urisë. (Mirëpo, ai në disa raste kishte dalë për të ecur nga uria)<sup>63</sup>.
- Zoti, xh.sh., krijonte ushqim në organizmin e tij, apo i dhuronte forcë të veçantë që të kishte mundësi të agjëronte dy ditë pa ndërprerë fare.

Dijetari i shquar, ish-myftiu, Prof. Dr. Abdulmelik Es Sadi, thotë se kjo tregon se forcimi i organizmit nuk e prish agjërimin, pavarësisht formës; kjo përderisa nuk kalon përmes kanaleve dhe nuk arrin në organet e konsiderueshme.

Nëse dikush merr infuzion ushqyes me qëllim, qortohet apo dënohet për atë vepër, mirëpo nuk e përsërit adhurimin. Ai që e fal namazin në tokën e uzurpuar, namazi i pranohet, mirëpo dënohet për veprën e palejuar. Përderisa njeriu është duke agjëruar, nuk mund të prishet agjërimi me pretendime, pa qenë e sigurt prishja e tij<sup>64</sup>. Njeriu, kur ka nevojë për infuzion, zakonisht nuk e ka obligim agjërimin. Megjithatë, kemi raste kur dikush infuzionin e ka terapi të vazhdueshme, dhe gëzon vullnet, dëshirë dhe mundësi që të agjërojë, prandaj këtë mundësi nuk duhet ta pamundësojmë, përderisa rregullat fetare e mundësojnë atë.

<sup>62</sup> Hanbel, Ahmed, *Musned*, nr. 13461, 21/126. Hadithi është i saktë.

<sup>63</sup> *Sahih Muslim*, nr. 2038, 3/1609.

<sup>64</sup> El Musilij, *El Ihtijar Et Talil El Muhtar*, 1/411.

Nëse dikush mendon se duhet të themi që infuzioni ushqyes e prish agjërimin, për shkak të mundësisë së keqpërdorimit, kur dikush pa arsye mund të marrë infuzion në mes të ditës, në mënyrë që ta lehtësojë agjërimin e tij, dije se normat juridike nuk ndërtohen në përjashtime; ato ndërtohen në ato që janë të zakonshme! Marrja e infuzionit me vetëdëshirë, me qëllim që t'ia lehtësojë vetes agjërimin, mund të jetë e rrallë. Realisht mjekët nuk japin infuzion pa arsye, gjë e cila e minimizon mundësinë e keqpërdorimit. Mirëpo, nëse kjo ndodh, atëherë nijeti ndikon në shpërbliimin apo jo të veprës, dhe jo në vlefshmërinë apo jo të veprave të kësaj natyre.

Këtë që e thamë për infuzionin e ka thënë para një shekulli edhe ish-myftiu i Egjiptit, Muhamed Buhajt El Mutiëi<sup>65</sup>, alameja e hoxha i shquar shqiptar, Vehbi Sulejman Gavogji<sup>66</sup>, dekani i Fakultetit të Medhëhebit Hanefi në Jordani, Prof. Dr. Sallah Muhamed Ebu El Haxh<sup>67</sup>. Këtë qëndrim e mbrojnë edhe stafit akademik në Fakultetin e Medhëhebit Hanefi në Jordan.

Ashtu siç e përmendëm, këtë qëndrim e mbron edhe dijetari i mirënjohur, ish-myftiu i Irakut, Prof. Dr. Abulmeliku Es Sadi, Zoti e ruajttë, i cili në këtë fushë përgjigjej sipas medhhebit shafij, pasi e pyetën në mexhlisin e tij, në ditë e xhuma, pas Jacisë, në derset e zakonshme të hapura të tij - në verën e vitit 2022, kur thotë dhe argumenton se infuzioni nuk e prish agjërimin.

Gjithashtu, Prof. Dr. Velid Shavishi, dekan i medhhebit maliki, po në të njëjtin vit, kur shkova në zyrën e tij dhe e pyeta, e ai tha se shumë prej malikinjve thonë se infuzioni ushqyes e prish agjërimin, e këtë e thonë ata që nuk e njohin siç duhet medhhebin dhe usulet - formën argumentuese - të medhhebit maliki. Infuzioni, pavarësisht se a është ushqyes apo jo,

---

<sup>65</sup> *Ed Din El Halis ev Irshad El Halk Ila Din El Hak*, të autorit: Es Subkij, Mahmud Muhamed Hatab, që e recensoi dhe përfshiu tekstin e ish Myftiut: Emin Mahmud Hatab, (Medineh Muneverah, Mektebeh El Mahmudije Es Subkijeh, 1977), 8/457.

<sup>66</sup> *El Kafi fi El Fikhi El Hanefij*, (Bejrut, Mesesetu Errisaleh) 2/646.

<sup>67</sup> *El Minhaxh El Vexhiz fi Fikh Et Taharah ve Es Salah ve Es Sijam ve El Itikaf*, (Jordan, Amman, Dar El Faruk, 2015) f. 184.

nuk duhet ta prishë agjërimin. Këtë e mbështet edhe hoxha i nderuar, Rushit Musallari<sup>68</sup>.

Rregullat juridike e mbështesin fuqishëm këtë mendim, veçanërisht nëse shikohet në prizmin e burimeve medhhebore.

Prej urtësisë dhe angazhimit të hoxhës duhet të jetë që t'i nxitë njerëzit për adhurime dhe t'i përmirësojë ata në bazë të rregullave të tyre. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran: “...*e kush është i sëmurë prej jush, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë!*”. (*El Bekare: 184*).

Përderisa revista “Edukata Islame” është revistë shkencore, e shoh të udhës që të paraqitet ky mendim, e i cili është shumë mirë i argumentuar, dhe kështu të përfitohet në raste të nevojshme.

**1. Materiet të mbesin në to, në ato organe.** Gjërat që e prishin agjërimin duhet të arrijnë dhe të mbesin në destinacionin e tyre, në fyt, lukth dhe zorrë. Prandaj, nëse diçka arrin në këto organe, dhe largohet prapë, nuk e prish agjërimin. Dijetarët kanë thënë se, nëse një kokërr rushi, pjesë mishi etj., lidhet me pe, dhe lëshohet në lukth, dhe më pas tërhiqet, agjërimi nuk priset<sup>69</sup>.

Kështu që, nëse vendosen gypa, kamera etj., në organizëm, dhe tërhiqen prapë, agjërimi nuk priset. Mirëpo, nëse këto lyhen me ndonjë materie e cila ndihet në organizëm, dhe mbetet sasi që ndihet, do të thotë se ka hyrë diçka nga jashtë që ligjërisht konsiderohet prishëse, dhe përmes kanaleve të konsiderueshme ka arritur dhe ka mbetur në organe të përcaktuara, agjërimi priset. Agjërimi priset për shkak të materies, jo për shkak të mjeteve që janë vendosur dhe tërhiqen<sup>70</sup>. Sigurisht se nuk bëhet mëkat nëse e prish agjërimin në raste të tilla, veçanërisht nëse nuk ka mundësi të trajtohen këto çështje pas iftarit, apo rrezikohet diçka për shkak të vonimit të trajtimit, ose institucioni i mjekësisë nuk punon në ato orare etj.

<sup>68</sup> Musallari, Rushit, *Fikhu Praktik*, f. 462.

<sup>69</sup> El Kesani, *Bedaia Es Sanaia fi Tertib Esh Sheraia*, 2/93.

<sup>70</sup> Prof. Dr. Ebu El Haxh, Sallah, *El Minhaxh El Vexhiz fi Fikh Et Taharah ve Es Salah ve Es Sijam ve El Itikaf*, f. 185.

**2. Me kusht që të evitohen pengesat ligjore të konsiderueshme**, nëse paraqiten pengesa legjitime, e të cilat feja i konsideron të falura apo që nuk ndikojnë për prishjen e agjërimit edhe pse forma është e prishjes së agjërimit. Të këtilla janë, për shembull: kur hani apo pini nga harresa, e që nuk prishet agjërimi. Në lidhje me këtë Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Kush han apo pi nga harresa, duke qenë agjërueshëm, mos ta ndërpresë agjërimitin e tij, pasi Allahu e ka gostitur me ushqim dhe pije!”*<sup>71</sup>. Gjithashtu, nëse ekziston diçka nga ajo që njeriu nuk mund të ruhet përveçse në gjendje të jashtëzakonshme, sikurse, për shembull, pluhuri, tymi që përfshin ajrin e të ngjashme, edhe nëse ndihen në fyt, nuk prishet agjërimi, pasi nuk ka mundësi të ruhem nga ato, dhe Zoti, xh.sh., nuk obligon përtej mundësisë.

Ndërsa, veprimet që nuk konsiderohen pengesa të arsyeshme juridikisht, e që nëse veprohen prishet agjërimi, janë: imponimi, gabimi, sikurse, për shembull, kur je i vetëdijshëm që je agjërueshëm, mirëpo duke i pastruar dhëmbët e gëlltit ujin, apo duke dashur ta shpërlash gojën dhe e nxjerr ujin jashtë, ashtu që e gëlltit ujin, kjo po që e prish agjërimitin<sup>72</sup> etj.

### **Disa kategori të tjera që lirohet nga agjërimi**

- Nëna shtatzënë dhe gjdhënset, pavarësisht a e rrezikojnë veten apo frytin e tyre.
- Uria dhe etja e tepërt që e rrezikojnë shëndetin.
- Të shtyrit në moshë, edhe nëse nuk kanë probleme shëndetësore, por dobësia fizike nga mosha nuk i përballon agjërimit. Ata, nëse kanë mundësi financiare, e paguajnë një vlerë materiale të përcaktuar nga institucioni, dhe përmes saj e arrijnë shpërblimin e Ramazanit. Nëse nuk kanë mundësi ta paguajnë atë vlerë, Zot i shpërblen për nijetin e tyre.

<sup>71</sup> *Sahih El Buhari*, nr. 6669, 8/136.

<sup>72</sup> Hoxhë Zadeh, Abdurrahman bin Muhamed bin Sulejman, *Mexhmau El Enhur fi Sherh Multka El Ebhur*, (Bejrut, Dar Ihja Et Turath El Arabij), 1/241.

**Kompensimi i agjërimit:** Të gjithë ata që kanë qenë të obliguar me agjërim dhe nuk kanë agjëruar për arsye të justifikueshme fetarisht, obligohen t'i kompensojnë ditët përkatëse. Njeriu lirohet nga obligimi nëse e vepron atë me të cilën është obliguar, ose nëse Zoti, xh.sh., e liron. Allahu, xh.sh., nuk na ka liruar, përkundrazi, e ka obliguar kompensimin, prandaj, përderisa nuk ke agjëruar, duhet të agjërohen ditët përkatëse. Allahu, xh.sh., thotë: *“...Kush prej jush është i sëmurë, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë (le të agjërojë) më vonë aq ditë...!”*. (El Bekare: 184).

Kompensimin e kanë borxh edhe ata që nuk kanë agjëruar pa arsye, ndërse obligohen që kur t'i kryejnë të gjitha ditët që nuk i kanë agjëruar, të agjërojnë edhe dy muaj rresht, për gabimin që e kanë bërë. Kompensimi i agjërimit mund të bëhet përmes formave të ndryshme, duke agjëruar në ditë dhe kohë të caktuara, të përshtatshme për personin në fjalë.

Dr. Muhamed STUBLLA

## **VALUE AND LEGAL NORMS OF FASTING IN RAMADAN**

### **Abstract**

The importance of a topic is evaluated based on its ranking in the respective field. Fasting is one of the fundamental practices in Islam. Understanding and observing fasting correctly leads to the understanding of Islam itself. Worship is connected to specific times. Fasting is essential during the month of Ramadan when it becomes obligatory. Based on the importance of this month and specific days, as well as the importance of unifying the Islamic society, we have explained in detail how Ramadan and the days of fasting begin and how fasting and Ramadan end. Ramadan is indeed the month of blessings, and it is obligatory only for certain categories. However, all believers should strive to engage in commendable deeds through various forms. The accuracy of fasting is conditioned by fulfilling the conditions of fasting and avoiding what breaks it. Therefore, it is of particular importance to establish clear and detailed principles or rules to understand how fasting is observed and when fasting may be broken. The level of fasting is elevated as we distance ourselves from doubtful acts and perform preferred deeds. The month of Ramadan is a month of mercy. Out of the mercy of the Most Merciful, some categories are exempted from fasting. Those exempted are not deprived of the reward of fasting; they are allowed to fast whenever they have the opportunity, and they will receive the reward, in the name of God, as they would in Ramadan. However, that is not all. Those who are unable to



make up for it will attain the desired reward of Ramadan by paying a symbolic amount, relying on their intention and desire to fast. As for those who have not fasted, even without reason, the door of repentance, returning to God, and compensating for what they have lost is open to them before God.

**Keywords:** *fasting, Ramadan, month, Prophet, peace be upon him.*

Dr. Sedat ISLAMI

## **KONCEPTI, VLERA DHE RËNDËSIA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT SIPAS BREZAVE TË HERSHËM TË DIJETARËVE MYSLIMANË**

### **Abstrakt**

Duke qenë se agjërimi i Ramazanit në tekstet kuranore dhe pejgamberike është përshkruar si një adhurim me reflektim edukativ, atëherë ne, në këtë punim, ia kemi vënë vetes për detyrë që ta zbardhim qëndrimin e brezave të hershëm të myslimanëve përkitazi me këtë adhurim. Respektivisht, të hedhim dritë mbi konceptin e tyre për agjërimin, mbi praktikat e tyre në agjërim dhe adhurimet e Ramazanit, mbi etikën përkitazi me agjërimin etj. Punimi e ka rëndësinë e vet pasi vjen si plotësim i trajtesave të bëra për agjërimin e Ramazanit, po edhe si një motivues për të agjëruar ashtu siç kërkohet. Metodologjia e ndjekur në punim është përshkruese. Punimi është i ndarë tematikisht në disa pjesë, të cilat përfshijnë parapërgatitjen për agjërimin, konceptin për agjërimin, praktika të ndryshme adhuruese dhe mënyrën e përcjelljes së Ramazanit. Të gjeturat e punimit dëshmojnë përkushtimin e madh të brezave të hershëm për agjërimin e Ramazanit dhe adhurimet përkatëse, sikurse në vete përmbajnë fuqi të madhe motivuese dhe edukative për brezat tanë. Rekomandim kryesor i punimit mbetet që adhurimeve në përgjithësi, e agjërimit të Ramazanit në veçanti, t'i kush-tohet rëndësi më e madhe, në mënyrë që të arrijnë ta luajnë rolin e tyre shumëdimensional në shoqëri.

***Fjalët kyçe:** agjërimi, Ramazani, namazi, brezat e hershëm, dijetarët.*

## HYRJE

Agjërimi i muajit Ramazan është obligim për secilin besimtar që i plotëson kushtet përkatëse. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ  
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ﴾ ١٨٣

*“O besimtarë! Ju ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u qe urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.” (Bekare: 183)<sup>1</sup>*

Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshminë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Allahut; faljen e namazit, dhënien e zekatit; ha-xhin, dhe; agjërimit e Ramazanit.”<sup>2</sup>

Siç mund të shohim nga këto dy tekste, agjërimi nuk është thjesht obligim, por është edhe shtyllë e fesë.<sup>3</sup> Kjo nga aspekti normativ. Nga aspekti i mirësive dhe i shpërblimit, agjërimi i Ramazanit paraqet mundësi të rralla:

- ky është muaji i faljes së mëkateve, siç ka thënë Pejgamberi, a.s.: “Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe llogaritje në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e mëparshme.”<sup>4</sup>
- kjo është vepra për të cilën Allahu i Madhëruar shpërblen ndryshe nga veprat e tjera. Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Allahu ka thënë: “Të gjitha veprat e njeriut i përkasin atij, përveç agjërimit, i cili është për Mua, dhe Unë shpërblej për të...”<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Përkthimi i kuptimeve të ajeteve kuranore është marrë nga: *Kurani i madhërishëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006.

<sup>2</sup> Hadithin e shënojnë Buhariu në *Sahih*, nr. 8, dhe Muslimi në *Sahih*, nr. 16.

<sup>3</sup> Shih: Ahmed bin Rexheb El Hanbelij, *Fet’hu-l-Bari sherhu Sahihi El Buhari*, ver. grup studiuesish, (Medine: Mektebetu El Gureba El etherije, 1996), 1/24!

<sup>4</sup> Hadithin e shënojnë Buhariu në *Sahih*, nr. 2014, dhe Muslimi në *Sahih*, nr. 760.

<sup>5</sup> Buhariu në *Sahih*, nr. 1904; Muslimi në *Sahih*, nr. 1151. Teksti është i Muslimit.

- ky është muaji i Natës së Kadrit, natë kjo që ka vlerë më të madhe se një mijë muaj. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ﴾ ﴿١﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ﴿٢﴾ لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ ﴿٣﴾ تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِم مِّن كُلِّ أَمْرٍ ﴿٤﴾ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ ﴿٥﴾

*“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. 2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit? 3. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj. 4. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. 5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”*  
(Kadër: 1-5)

Kjo ka bërë që përkushtimi i besimtarëve për këtë muaj të jetë ndryshe nga muajt e tjerë. Pikërisht këtë përkushtim, në kuptim të bindjeve dhe praktikave të brezave të hershëm të myslimanëve, mëton ta sjellë ky punim, dhe këtë duke hulumtuar për përgjigje për pyetjet hulumtuese në vazhdim:

1. Si e pritnin brezat e hershëm Ramazanin?
2. Cili ishte koncepti i tyre për agjërimin e vërtetë?
3. Si e shihnin rolin edukativ të agjërimin në jetën dhe praktikat e tyre?

Kjo nënkupton se qëllimi primar i përshkrimeve është aspekti edukativ, dhe më pak ai i normave. Punimi ka rëndësinë plotësuese sa i përket trajtesave që janë bërë për agjërimin e Ramazanit pasi në këtë formë, përmbledhëse e klasifikuese, me aq sa kam njohuri, nuk është bërë më parë në gjuhën shqipe.

Metodologjia e ndjekur në punim është përshkruese. Këtu kemi përshkruar thëniet, duke i dokumentuar nga burime përkatëse, ndërsa, për t’i ikur zgjerimit të madh të punimit, kemi mjaftuar vetëm me tekstin e përkthyer. Po kështu, punimi nuk ka synim shterues dhe gjithëpërmbledhës të materialit prandaj kemi përmendur thënie për ilustrim brenda një kapitulli a nënkapitulli të caktuar ndërsa kemi lënë tjerat. Punimi është i ndarë

tematikisht në katër kapituj kryesorë, të paraprirë me këtë hyrje dhe të pasuar me një përfundim ku kemi përmbledhur disa rezultate e mësimë me rëndësi.

## KAPITULLI I: PRITJA E RAMAZANIT

### 1.1. Përgatitja psikike për muajin Ramazan

Agjërimi nuk është adhurim i lehtë, sepse duhet të abstenosh nga gjërat që mbajnë gjallë fuqinë fizike, e nëse merren parasysh të mirat e tij, e veçmas në botën tjetër, atëherë kjo e forcon besimtarin që ta sfidojë lodhjen dhe mundimin fizik. Sahabiu i nderuar, Ebu Dherri, r.a., thoshte: “O njerëz, po ju këshilloj dhe po tregohem i mëshirshëm me ju: faluni natën për errësirën e varrit, agjëroni ditët me vapë për vapën e ditës së ringjalljes, jepni lëmoshë nga frika e një ditë të vështirë për çështjet e mëdha (Dita e Llogarisë)!”<sup>6</sup>.

Pra, ky thesar i jashtëzakonshëm i mirësive për të cilat dallon agjërimi bënte që të parët ta shihnin si mundësi të rrallë të fitimeve të mëdha, të faljes së madhe të mëkateve. Omeri, r.a., thoshte: “Mirë se vjen, o pastruesi ynë (nga mëkatet)!”<sup>7</sup> Në fakt, shprehja e këtij gëzimi ishte traditë që hoxhallarët e brezave të parë e kishin përvetësuar. Ibën Ebi Dunja ka thënë: “Hoxhallarët dikur paskëshin thënë, me rastin e ardhjes së Ramazanit: “Erdhi pastruesi (nga mëkatet).”<sup>8</sup>.

Pra, nëse Ramazani shihet kësisoj, si mundësi, jo si barrë, atëherë agjërimi i tij dhe përfitimi nga mundësitë e shumta të tij është i lehtë.

<sup>6</sup> Ali bin El Hasen Ibën Asakir, *Tarihu Dimeshk*, red. shkenc. Umer bin Garameh el Amri, (Bejrut: Dar el fikr, 1995), 66/214. Kjo i atribuohet edhe sahabiut tjetër, Ebu Derdasë, r.a. Shih: Ahmed bin Rexheb El Hanbelij, *Letaifu El emarif fima li-mevasimi El amin El vedhaif*, red. shken. Tarik bin Ivedullah, (Bejrut: El mekteb El islamij, 2007), f. 299!

<sup>7</sup> Nasir bin Muhamed Ebu Lejth es-Semerhandi, *Tenbihu El gafiline bi-ehadithi sejjidi El enbijai ve El murseline*, red. shkenc. Jusuf Ali Bedjevi, (Damask-Bejrut: Dar Ibën Kethir, ed. 3, 2000), f. 321.

<sup>8</sup> Ibën Ebi Dunja, *Fedailu Ramadan*, (Rijad: Dar es selef, 1995), nr. 25, f. 53.

## 1.2. Lutja për ta arritur Ramazanin

Ramazani nuk shihej si çfarëdo mundësie, por si mundësi e rrallë prandaj përgatitja për të fillonte qysh herët. Muala bin Fadli duke rrëfyer për të parët thotë: “Gjashtë muaj më parë e lusnin Allahun e Madhëruar që t’ua mundësonte arritjen e Ramazanit, sikur që e lusnin gjashtë muaj të tjerë më pas që t’ua pranonte.”<sup>9</sup> Madje kishin një lutje të veçantë, atë që e përcjell Jahja bin Ebi Kethiri: “O Allah, më dorëzo te Ramazani, dorëzoje Ramazanin tek unë dhe merre prej meje (si vepër të mirë) të pranuar!”. Abdulaziz bin Ebi Revvad e përcjell një lutje tjetër: “O Allah, Ramazani po afrohet dhe po vjen, prandaj ma dorëzo Ramazanin, më dorëzo mua tek ai dhe miratoje prej meje si të pranuar! O Allah, ma mundëso që të agjërojë dhe falem me durim dhe llogaritje në shpërblimin Tënd! Më begato me vendosmëri, përpjekje, forcë dhe energji, dhe më mbroj nga mërzitja, ligështia, përtacia dhe kotja. Më beko për Natën e Kadrit, dhe bëje atë më të mirë për mua se njëmijë muaj!”<sup>10</sup>.

## 1.3. Përgatitja fizike për muajin Ramazan

Agjërimi, që nënkupton angazhim fizik, qoftë në abstenimin nga ushqimi dhe pija qoftë në kryerjen e adhurimeve të tjera, teravive, për shembull, kërkon një parapërgatitje edhe fizike, prandaj ne gjejmë te brezat e parë që t’i kenë kushtuar rëndësi edhe këtij aspekti. Ibën Rexhebi ka thënë: “Agjërimi në muajin Shaban është si ushtrim (parapërgatitor) për agjërimin e Ramazanit, (më saktë) që (besimtari) mos t’ia fillojë agjërimin të Ramazanit me lodhje dhe mundim.”<sup>11</sup>. Ebu Bekir Verraku angazhimin e suksesshëm në Ramazan e shihte si produkt të përgatitjes në muajt paraprak, e më saktë në muajt Rexheb dhe Shaban. Në mënyrë figurative këtë e shprehte kësisoj: “Shembulli i muajit Rexheb është sikur shembulli i erës, muaji Shaban i ngjan reve ndërsa shembulli i Ramazanit është si-

<sup>9</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaifu El emarif*, vep. cit., f. 264.

<sup>10</sup> Shih këto dy lutje në: Sulejman bin Ahmed et Taberani, *Ed dua*, (Bejrut: Dar el kutub el ilmije, 1413), f. 284.

<sup>11</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 242.

kur shembulli i shiut.”<sup>12</sup> Në një rast tjetër ka thënë: “Muaji Rexheb është muaj i mbjelljes, muaji Shaban i ujitjes ndërsa muaji Ramazan i korrjes.”<sup>13</sup> Serri Sekatiu konsideronte se në muajin Rexheb sukcesi jep shenjat e para ndërsa në Ramazan arrihet plotësisht. Në mënyrë figurative shprehej kështu: “...muaji Rexheb është muaji i gjethimit, muaji Shaban muaji i degëzimit, muaji Ramazan muaji i vjeljes...”<sup>14</sup>.

Pjesë e kësaj parapërgatitje fizike ka qenë edhe angazhimi me leximin e Kuranit. Sahabiu i nderuar, Enesi, r.a., rrëfen se: “Myslimanët (e parë) me rastin e ardhjes së muajit Shaban i qaseshin leximit të Kuranit dhe dhënies së zekatit, në mënyrë që ta ndihmonin besimtarin e varfër dhe meskin për agjërimin e Ramazanit.”<sup>15</sup>.

#### 1.4. Ikja nga mëkatet

Mëkatet janë pengesë e hekurt para adhurimeve. Prandaj, që një besimtar të ketë mundësi të përfitojë nga të mirat e Ramazanit, paraprakisht duhet t’i braktisë mëkatet. Kjo është porosia që na e kanë lënë të parët. Ibën Rexhebi thoshte: “Kini kujdes nga mëkatet sepse ato ju privojnë nga falja në stinët e mëshirës.”<sup>16</sup>

Ikjen nga mëkatet të parët e shihnin edhe duke ikur nga gjërat që të çojnë në mëkate, e me theks të veçantë shoqërinë e keqe. Ebu Derda, r.a., thoshte: “Vëllai më i mirë është ai që të thotë: Eja të agjërojmë para se të vdesim, ndërsa më i keqi është ai që të thotë: “Eja të hamë para se të vdesim!”<sup>17</sup>.

<sup>12</sup> Muhamed Rexheb Samerrai, *Ramadan fi El hadareti El arabijeti El islamijeh*, (Damask: Dar El evail, 2002), f. 15.

<sup>13</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 118.

<sup>14</sup> Po aty, f. 219.

<sup>15</sup> Ahmed bin Ali bin Haxher El Askalani, *Fet’hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, (Bejrut: Dar El ma’rife, 1379 h.), 13/311.

<sup>16</sup> Ibën Rexhebi, *Letaif El mearif*, ve. cit., f. 476.

<sup>17</sup> Ahmed bin Abdullah El Asbahani, *Hiljetu el evlija*, (Bejrut: Dar el kutub el ilmije, 1409 h.), 1/218.

### 1.5. Angazhimi kolektiv për pritjen e Ramazanit

Ramazani dallon për frymën kolektive. Ky është muaji i vetëm në të cilin adhurimet fakultative, siç janë teravitë, falen me xhemat në xhami. Po kështu është muaji i vizitave të ndërsjella. E, mbi të gjitha, është muaji i shpërblimeve të mëdha. Prandaj edhe ka qenë praktikë e gjeneratave të para që zekatin ta japin para fillimit të Ramazanit, në mënyrë që edhe besimtarët nga shtresat e varfra t'i përkushtohen adhurimit. Thënia e Enesit, r.a., që e shënuam më lart e dëshmon këtë: “Myslmanët (e parë) me rastin e ardhjes së muajit Shaban i qaseshin leximit të Kuranit dhe dhënies së zekatit, në mënyrë që ta ndihmonin besimtarin e varfër dhe meskin për agjërimin e Ramazanit.”<sup>18</sup>

### 1.6. Ikja nga veprimet e ndaluara

Ndonëse porositet agjërimi në muajin Shaban, për t'u forcuar për agjërimin e muajit Ramazan, megjithëkëtë duhet pasur parasysh rregullat fetare, në mënyrë që mos të na shtyjë dashuria për adhurim për të bërë edhe gjëra të ndaluara. Më saktësisht, duhet ikur nga agjërimi i asaj që quhet si dita e dyshimtë, e që është dita e fundit, e tridhjetë, e muajit Shaban. Sahabiu i nderuar, Ammar bin Jasiri, r.a., ka thënë: “Kush e agjëron ditën e dyshimtë, ai veçse e ka kundërshtuar babanë e Kasimit, Muhamedin, paqja e Zotit qoftë mbi të!”<sup>19</sup>. Kjo porosi, në fakt, është edhe porosi pejgamberike, e që në hadith të saktë Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Mos le t'i paraprijë askush agjërimin të Ramazanit me agjërimin e një ose dy ditëve të mëparshme (ditëve të fundit të muajit Shaban), përveç nëse e ka pasur traditë agjërimin<sup>20</sup>, atëherë le ta agjërojë atë ditë!”<sup>21</sup>.

<sup>18</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet'hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep.cit., 13/311.

<sup>19</sup> Ebu Davudi, nr. 2334; Tirmidhiu, nr. 686. Albani e ka saktësuar këtë hadith.

<sup>20</sup> Nëse ka agjëruar të hënat dhe të enjtet dhe ajo ditë ka rastisur të jetë e hënë ose e enjte.

<sup>21</sup> Buhariu, nr. 1914.



## 1.7. Përgëzimi me rastin e ardhjes së Ramazanit

Ibën Rexhebi ka thënë: “Si mos të përgëzohet besimtari për hapjen e dyerve të Xhenetit?! Si mos të përgëzohet mëkatari për mbylljen e dyerve të Zjarrit?! Si mos të përgëzohet i mençuri për kohën në të cilën pran-gosen djajtë?! Cila kohë mund t’i ngjajë kësaj kohe?!”<sup>22</sup>.

## KAPITULLI II: AGJËRIMI: KONCEPTI, OBJEKTIVAT, VLERA, DHE ETIKA

### 2.1. Emërtimi i Ramazanit dhe i agjërimit

Ramazani është muaji i nëntë me radhë në listën e muajve hënorë. Quhet me këtë emër sipas efektit shkatërrues të mëkateve që ka. Imam Sheukani ka thënë se është quajtur me këtë emër për shkak të djegies së mëkateve (në arabisht *ramida* - رمض , e nënkupton djegien).<sup>23</sup> Pra, veprat e mira që bëhen në këtë muaj i djegin mëkatet, prandaj edhe Ramazani quhet me këtë emër.

Ndërsa, sa i përket agjërimit, quhet durim (ar. sabër), sepse, siç shpjegon Sujuti, në agjërimit manifestohet durimi ndaj ushqimit, pijes dhe dëfrimit seksual, ose pengimi/privimi i nefsit nga këto.<sup>24</sup> Durimin, si pjesë qenësore e agjërimit, e ka shpjeguar edhe Ibën Rexhebi, i cili ka thënë: “Agjërimi është pjesë e durimit, i cili ndahet në tri lloje, dhe që të tri llojet bashkohen në agjërimit. Në agjërimit ka durim për adhurim, durim ndaj epsheve dhe durim ndaj urisë, etjes dhe dobësisë së turpit.”<sup>25</sup>.

<sup>22</sup> Ibën Rexhebi, *Letaif El mearif*, ve. cit., f. 264.

<sup>23</sup> Muhamed bin Ali esh-Sheukani, *Fet'h El Kadir*, (Damask - Bejrut: Dar Ibën Kethir - Dar El Kelim Et Tajjib, 1414 h.), 1/209.

<sup>24</sup> Xhelaludin Sujuti, *Hashijetu es-Sindi ala Suneni en-Nesai*, (Haleb: Mekteb El matbuat El islamiye, ed. 2, 1986), 4/218.

<sup>25</sup> Ibën Rexhebi, *Letaif El mearif*, ve. cit., f. 269.

## 2.2. Koncepti për agjërimin e vërtetë

Agjërimi i vërtetë nuk nënkupton vetëm abstenimin nga ushqimi dhe pijet. Ky është mësim që u përcoll prej pejgamberit tonë, Muhamedit, a.s. Në një nga këshillat e tij, ai, a.s., ka thënë: “Kush nuk i braktis gënjeshtren dhe paturpësinë, si dhe të vepruarit sipas tyre, (atij nuk i pranohet agjërimi, sepse), Allahu nuk ka nevojë që ai ta braktisë ushqimin dhe pijen e vet.”<sup>26</sup> Me këtë kuptim gjejmë edhe këshilla të të parët tanë. Omeri, r.a., thoshte: “Agjërimi nuk nënkupton abstenimin vetëm nga ushqimi dhe pija, por edhe nga gënjeshttra, e kota, marrëzitë dhe betimi.”<sup>27</sup>

Një përmbledhje të bukur rreth thelbit të agjërimin e ka bërë edhe dijetari me nam, Ibën Xheuzi, i cili ka thënë: “Agjërimi është tre llojesh: agjërimi i shpirtit, që manifestohet duke e shkurtuar shpresën (lidhjen me dynjanë), agjërimi i mendjes, që manifestohet duke e kundërshtuar epshin (të keqen), dhe agjërimi i trupit, që manifestohet duke abstenuar nga ushqimi, pija dhe kënaqësitë seksuale...”<sup>28</sup>.

Pra, mund të shohim se të të parët tanë agjërimi nuk nënkupton vetëm largimin nga ushqimi dhe pija, por edhe nga mëkatet.

## 2.3. Objektivat e agjërimin

Agjërimi, fizikisht, manifestohet me braktisje të ushqimit dhe pijes, ose me uri. Mirëpo, përse është caktuar të jetë kështu dhe jo ndryshe? Cila është urtësia e urisë në këtë aspekt? Ebu Bekër Merveziu rrëfen: “E kam dëgjuar Bishrin duke thënë se uria e pastron zemrën, e mbyt epshin dhe trashëgon diturinë e hollësishtme.”<sup>29</sup>.

<sup>26</sup> Buhariu, nr. 1903.

<sup>27</sup> Ebu Bekir Ibën Ebi Shejbe, *El kitab El musannef fi El ehadith ve El athar*, red. shkenc. Kemal Jusuf El Hut, (Rijad: Mektebetu err-rushd, 1409 h.), nr. 8882, 2/272.

<sup>28</sup> Abdurrahman bin Ali bin Muhamed El Xheuzi, *Bustan El vaidhine ve rijad es-samiine*, red. shkenc. Ejmen Buhajri, (Bejrut: Muessesetu El kutub eth-thekafije, ed. 2, 1998), f. 230.

<sup>29</sup> Muhamed bin Ahmed Edh Dhehebij, *Sijer a'lam en-nubela*, red. shkenc. grup redaktorësh nën mbikëqyrjen e Shuajb Arnautit, (Bejrut: Muessesetu err-rrisale, ed. 3, 1985), 10/471.

Kjo mbase i hap rrugë qëllimit kryesor të agjërimit, devotshmërisë. Agjërimi, siç është përkufizuar edhe në Kuran<sup>30</sup>, synon që besimtarin ta bëjë të devotshëm. Kjo, në fakt, lidhet edhe me konceptin për agjërimin, pasi jo çdo agjërime e luan këtë rol. Ky është vetëm agjërimi i vërtetë, ai që e përmbledh aspektin fizik e moral, e që e luan këtë rol. Nga këtu Imam Gazaliu agjërimin e kategorizon në tre nivele: agjërime të thjeshtë, të mirë dhe të përsosur. Dhe thotë: “Dije se agjërimi i ka tri shkallë: agjërime i barkut, që është agjërime i njerëzve të rëndomtë; agjërime i gjymtyrëve (syve, gjuhës, duarve), që është agjërime i të dalluarve, dhe, agjërime i zemrës, që është agjërime i elitës –njerëzve më të dalluar!”<sup>31</sup>

Me këtë synohet që besimtari të pavarësohet nga çdo gjë dhe çdo-kush, dhe të lidhet vetëm me Zotin e vet. Ky është niveli i lartë i besimit, e të cilin nuk mund ta arrijë secili besimtar. Ndryshe, nëse nuk largohesh nga mëkatet, është dëshmi se nuk ke agjëruar siç duhet. Prandaj Omeri, r.a., ka thënë: “Mos shikoni në namazin dhe agjërimin e askujt pa mos shikuar më parë në sinqeritetin e tij kur flet, në ruajtjen e amanetit kur t’i lihet dhe devotshmërinë kur nefsi e nxit për mëkat.”<sup>32</sup> Pra, jo vetë adhurimin, por reflektimin e tij e ka bërë si kriter të vlerësimit të besimtarëve.

Objektivë apo synim tjetër i agjërimit është dhe mbrojtja nga mëkatet dhe jo vetëm. Sahabiu i nderuar, Abdullah bin Mesudi, r.a., ka thënë: “Agjërime është mburojë e pamposhtur.”<sup>33</sup>

Objektivë tjetër e agjërimit është dhe përkujdesja shoqërore. Një nga shpjegimet pse uria manifestohet në agjërime është edhe për këtë arsye. Dikush prej të parëve që pyetur: “Përse është obliguar agjërime?”, - ndër-  
rsa e kishte dhënë këtë përgjigje: “Që i pasuri ta shijojë hidhëtinë e urisë, dhe kështu mos ta harrojë të varfrin.”<sup>34</sup>

<sup>30</sup> Shih: Bekare: 183!

<sup>31</sup> Ebu Hamid Muhamed bin Muhamed El Gazali, *Ihjaw ulumi ed-din*, (Bejrut: Dar El ma'rifeh, p.v.b.), 1/234.

<sup>32</sup> Ebu Nuajm El Asbahani, *Muntehab min hadithi Junus bin Ubejd*, red. shkenc. Abdullah Galí es-Sehli, (Bejrut: Dar El muktebas, 2014), f. 264.

<sup>33</sup> Ebu Davud es-Sixhistani, *Ez-zuhd*, red. shkenc. grup redaktorësh, (Halvan (Egjipt): Dar El Mishkah li en-neshri ve Et Teuzië, 1993), f. 153.

<sup>34</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 300.

## 2.4. Motivet e agjërimit

Ajo që e shtyn një besimtar të agjërojë përmbledhet në të mirat që i përfiton si agjërues, si dhe në të mirat nga të cilat privohet si mosagjërues. Gjithsesi edhe rrezikut që i ekspozohet nëse e braktis qëllimshëm agjërimin, ose, me pak fjalë, ndërmjet shpresës dhe frikës, inkurajimit dhe dekurajimit.

### 2.4.1. Inkurajimi

Ibën Kajimi, derisa fliste për agjërimin, i përmendte disa gjëra vërtet motivuese për të agjëruar: “Agjërimi është frenim i të devotshmëve, mburojë e luftëtarëve, ushtrim (trajnim, edukim) i të mirëve dhe të afuarve (tek Allahu me vepra të mira), ndërsa për Allahun është vepër e dalluar nga të tjerat.”<sup>35</sup> Pra, ky efekti edukativ i agjërimit dhe kjo pozita e tij si vepër e veçuar për Zotin, e me të cilën aludohet në hadithin, rezulton te porosia: “Të gjitha veprat e njeriut i përkasin atij, përveç agjërimit, i cili është për Mua, dhe Unë shpërblej për të...”<sup>36</sup>, e që e nxisin dhe e motivojnë një besimtar për të agjëruar.

Ajo që e nxit një besimtar të agjërojë është edhe e mira që fiton në botën tjetër. Shekik Belhi paskësh thënë: “Kërkuam për dritën e varrit, e gjetëm në namazin e natës. Kërkuam përgjigjet për Munkerin dhe Nekirin, i gjetëm në leximin e Kuranit. Kërkuam për kalimin e Siratit, e gjetëm në agjërim dhe lëmoshë.”<sup>37</sup>

Për këtë shkak dijetarët kanë përmendur se një ndër gjërat që një i vdekur, po t’i jepej mundësia të kthehej prapë në këtë botë, do ta bënte, pra, është agjërimi. Ibën Xheuziu ka thënë: “Për Allahun, po t’i thuhej

<sup>35</sup> Ibën Kajim El Xheuzije, *Zad El mead*, (Bejrut - Kuvajt: Muessesetu err-rrisale - Mektebetu El Menar El islamije, ed. 27, 1994), 2/27.

<sup>36</sup> Buhariu në *Sahih*, nr. 1904; Muslimi në *Sahih*, nr. 1151. Teksti është i Muslimit.

<sup>37</sup> Xhelaludin Sujuti, *Bushra El keib bi-likai El Habib*, red. shkenc. Abdulhamid Muhammed Dervish, (Damask: Dar Ja’rub li ed-dirasat ve en-neshër ve Et Teuzië, 2004), f. 39.

banorëve të varrezave: shprehni një dëshirë, do të shprehnin dëshirë që ta agjëronin (qoftë edhe vetëm) një ditë të Ramazanit.”<sup>38</sup>

### 2.4.2. Dekurajimi

Lëshimi i mundësisë së Ramazanit për faljen e mëkateve është vërtet humbje e madhe. Ta kesh para vetes tërë ato mundësi dhe në fund të dalësh pa t’u falur mëkatet, kjo vërtet se është humbje. Për këtë shkak, Kadtadeja ka thënë: “Kujt nuk i falen mëkatet në Ramazan, mos të pret se do t’i falen në muajt e tjerë.”<sup>39</sup>

Kjo jo vetëm nga aspekti i lëshimit të kësaj mundësie të madhe të shpërblimit dhe të faljes së mëkateve, por edhe nga aspekti normativ. Imam Dhehebiu, në librin *El Kebair* (Mëkatet e mëdha), përmend se te myslimanët braktisja e qëllimshme dhe e pajustificueshme e agjërit është mëkat i madh, e madje edhe më i madh sesa prostitucioni dhe konsumimi i rakisë.<sup>40</sup>

### 2.5. Vlera dhe mirësitë e Ramazanit dhe agjërit

Arsyeya pse duhet njohur me vlerat e Ramazanit dhe agjërit qëndron në efektin e tyre motivues. Në fakt, kjo parimisht qëndron në çdo gjë. Një *arif* (besimtar i ditur dhe devotshëm) paskësh thënë: “Ai që nuk e di shpërblimin për veprat e mira, do ta ketë të vështirë t’i bëjë ato.”<sup>41</sup> Pra, nëse nuk di për vlerat, e ke vështirë të agjërosh. Prandaj, edhe si plotësim të pjesës paraprake për motivet e agjërit, do të përmendim diç nga ajo se si brezat e hershëm e kanë parë vlerën e Ramazanit dhe agjërit.

<sup>38</sup> Abdurrahman bin Ali bin Muhamed El Xheuzij, *Et Tebsiretu*, (Bejrut: Dar El kutub El ilmije, 1986), 2/78.

<sup>39</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 37\.

<sup>40</sup> Muhamed bin Ahmed Edh Dhehebij, *El kebair*, red. shkenc. Meshhur bin Hasen Al Selman, (Emirate: Mektebetu El Furkan, ed. 2, 2003), f. 161.

<sup>41</sup> Abdurrahman bin Ahmed bin Rexheb El Hanbelij, *Ihtijaru El evla fi sherhi hadithi ihtisami El melei El a'la*, red. shkenc. Xhasim Fehejd Deuseri, (Kuvajt: Mektebetu Dari El Aksa, 1985), f. 52.

Ramazani është një muaj i dalluar. Abdullah bin Mesudi, r.a., ka thënë: “Dita e xhumasë është zotëria i ditëve të javës, ndërsa Ramazani është zotëria i muajve të vitit.”<sup>42</sup>. Këtë vlerë të Ramazanit në mesin e muajve të tjerë e ka përshkruar edhe Ibën Xheuziu, i cili ka thënë: “Shembulli i dymbëdhjetë muajve është sikurse shembulli i bijve të Jakubit (a.s.), dhe sikurse Jusufi, a.s., që ishte fëmija më i dashur për të (Jakubin, a.s.), po kështu Ramazani është muaji më i dashur për Allahun. Dhe, po ashtu siç ua fali mëkatet bijve të Jakubit, a.s., me lutjen e njërit prej tyre, Jusufit, a.s., po kështu Zoti i fali mëkatet e njëmbëdhjetë muajve me bereqetin e Ramazanit.”<sup>43</sup>. Se Ramazani ka vlerë të madhe flasin edhe gjërat për të cilat është veçuar. Zbritja e Kuranit në Ramazan dhe agjërimi janë dy argumente që flasin për vlerën e madhe të këtij muaji. Fahrudin Rraziu, duke folur për muajin Ramazan, ka thënë: “Allahu i Lartësuar e veçoi Ramazanin me argumentin më të fuqishëm të zotësisë së Tij (rububijetit), e që është shpallja e Kuranit në këtë muaj, kështu, nuk përjashtohet mundësia ta ketë veçuar atë po kështu edhe me një lloj madhështor të adhurimit, pra agjërimin.”<sup>44</sup>.

Ajo që e dallon Ramazanin dhe e bën joshës e tërheqës për besimtarët është se i tëri është i mirë. Në secilën ditë të tij ai paraqet mundësi, e të cilat me kalimin e ditëve vetëm sa shtohen e nuk pakësohen. Prandaj, Ibën Rexhebi, kur flet për këtë veçori të Ramazanit, thotë: “Muaji (i Ramazanit), i tëri është mëshirë, falje dhe amnisti nga zjarri i xhehemit.”<sup>45</sup>.

Ndërsa sa i përket agjërimit, vlera e tij është e pakrahasueshme. Fakti që është vepër që i atribuohet Allahut të madhëruar, siç qëndron në hadithin kudsij “Të gjitha veprat e njeriut i përkasin atij përveç agjërimit i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të...”<sup>46</sup>, i ka bërë dijetarët të

<sup>42</sup> Ebu Bekir Ibën Ebi Shejbe, *El kitab El musannef fi El ehadith ve El athar*, vep. cit., nr. 5509, 1/477.

<sup>43</sup> Ibën El Xheuzi, *Bustan El vaidhine ve rijad es-samiîne*, vep. cit., f. 230.

<sup>44</sup> Muhamed bin Umer Fahrudin err-rrazi, *Mefatih El gajb*, (Bejrut: Dar Ihja Et Turath El arabij, ed.3, 1420 h.), 5/251.

<sup>45</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 372.

<sup>46</sup> Buhariu në *Sahih*, nr. 1904; Muslimi në *Sahih*, nr. 1151. Teksti është i Muslimit.

nxjerrin përfundime interesante për vlerën e agjërimit. Sufjan bin Ujejne, dijetar nga brezat e parë, ka thënë: “Në ditën e Kiametit Allahu, xh.sh., do ta llogarisë robin të cilit, për shkak të padrejtësive që ka bërë, do t’ia marrë veprat (e mira dhe do t’ia japë të dëmtuarit) derisa mos t’i mbetet asnjë vepër përveç agjërimit. Atëherë Allahu, xh.sh., do ta marrë përsipër kompensimin për padrejtësitë e tij, ndërsa atë (mëkatarin do ta falë dhe) do ta futë në Xhenet, për hatër të agjërimit.”<sup>47</sup> Këtë detaj, pra të të qenit të agjërimit vepër që i atribuohet Allahut, edhe Ibën Abdul Berri e shpjegon si vlerë të shtuar të agjërimit. Ai ka thënë: “Shprehja në hadith: “Agjërimi më përket Mua...”, e që është dëshmi për vlerën e agjërimit ndaj adhurimeve tjera.”<sup>48</sup>

Ibën Rexhebi, duke folur për vlerën e agjërimit, ka thënë: “Për ata që Allahu ua ka mundësuar ta arrijnë dhe agjërojnë Ramazanin, agjërimi është mirësi e madhe. Këtë, në mos tjetër, e dëshmon hadithi i tre vetave, dy prej të cilëve vdiqën dëshmorë, ndërsa i treti vdiq në shtrat. Dikush e pa në ëndërr teksta hynte në Xhenet para dy të parëve që vdiqën si dëshmorë. Pejgamberi Muhamed, paqja qoftë mbi të, duke ua shpjeguar sekretin e hyrjes së tij në Xhenet para dy të parëve, tha: “Po a nuk ka falur pas tyre kaq e kaq namaze, dhe a nuk e ka arritur edhe një Ramazan dhe e ka agjëruar? Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, ndërmjet tyre është si distanca ndërmjet qiellit dhe Tokës!”<sup>49</sup>

Agjërimi, që nënkupton abstenim dhe privim të vullnetshëm nga disa gjëra të lejuara, në botën tjetër të sjellë kompensime. Ibën Rexheb Hanbeliu ka thënë: “Kush agjëron në dynja (duke abstenuar) nga epshi, do ta arrijë atë (do t’i kompensohet) nesër në Xhenet. Kush agjëron duke brak-

<sup>47</sup> Ahmed bin El Husejn Ebu Bekir El Bejhaki, *Es-sunen El kubra*, red. shkenc. Muhamed Abdulkadir Ata, (Bejrut: Dar El kutub El ilmije, ed. 3, 2003), nr. 8335, 4/454, dhe nr. 8510, 4/502.

<sup>48</sup> Xhelaludin Sujuti, *Hashijetu es-Sindi ala Suneni en-Nesai*, vep. cit., 4/160.

<sup>49</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaifu-l-mearif*, vep. cit., f. 265. Hadithin e shënonjnë Imam Ahmedi në Musned (1403) dhe Ibën Maxheh në Sunen (3185) ndërsa Ahmed Shakiri e ka saktësuar.

tisur çdo gjë, përveç Allahut, bajrami i tij do të jetë ditën kur do ta takojë Allahun xh.sh.”<sup>50</sup>.

Agjërimi përtej vlerës në kuptim të shpërblimit ka edhe vlerë formuese të personalitetit adhurues të besimtarit. Thabit Bunani ka thënë: “Njeriu nuk do të quhet rob adhurues, pavarësisht tipareve që ka, përderisa nuk e ka edhe namazin dhe agjërimin, sepse ato janë nga mishi dhe gjaku i tij.”<sup>51</sup>.

Kjo bënte që te myslimanët e brezave të parë agjërimin jo që nuk e shihnin barrë, por mirësi që do të donin ta shtonin si vepër në bagazhin e tyre sa më shumë që kishin mundësi. Katade rrëfen: “Kur Amir bin Kajsit i erdhi vdekja, qau. “Përse qanë?”, - e pyetën. Tha: “Nuk po qaj pse po e kam frikë vdekjen, apo pse më ka ngelur merak diçka nga dynjaja, por po qajë për etjen (agjërimin) e ditëve të verës me vapën dhe namazin e natës.”<sup>52</sup>.

## 2.6. Etika e agjërimit

Nga ajo që mësuam te koncepti, pamë se agjërimi nuk manifestohet dosido. Ai ka edhe etikën përkatëse e cila, po mungoi, rrezikon pranimin e agjërimit në tërësi. Ibrahim Nahi u konsideronte se: “Gënjeshtra e prish agjërimin.”<sup>53</sup>.

Për këtë shkak të parët kanë kërkuar që të ruhemi jo vetëm nga ushqimi por edhe nga ndalesat. Ebu Dherri, r.a., thoshte: “Kur të agjërosh, ruaji gjymtyrët (nga harami).”<sup>54</sup> Xhabir bin Abdullahu, r.a., ka thënë: “Nëse agjëron atëherë le të agjërojë me ty veshi, syri dhe gjuha jote nga gënjeshtra dhe mëkatet. Mos e shqetëso shërbëtorin, bëhu i urtë dhe i qetë

<sup>50</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaifu-l-mearif*, vep. cit., f. 285.

<sup>51</sup> Ahmed bin Abdullah El Asbahani, *Hiljetu el evlija*, vep. cit., 2/318.

<sup>52</sup> Edh Dhehebij, *Sijer a'lam en-nubela*, vep. cit., 4/19.

<sup>53</sup> Ahmed bin Abdullah El Asbahani, *Hiljetu el evlija*, vep. cit., 4/227. Gënjeshtra nuk e prish agjërimin, e zbeh shumë dhe zhvesh nga shpërblimi por nuk e zhvlerëson si vepër.

<sup>54</sup> Ibën Ebi Shejbe, *El kitab El musannef fi El ehadith ve El athar*, vep. cit., nr. 8878, 2/271.



gjatë agjërimit, dhe assesi, ditën kur agjëron dhe ditën kur han mos i bë të njëjta!”<sup>55</sup>. Ebu Hurejre rrëfen se ai dhe shokët e tij kur agjëronin, qëndronin në xhami, e thoshin: “Po e pastrojmë agjërimin tonë.”<sup>56</sup>. Ndryshe, mëkatet i shihnin si prishëse të agjërimit. Imam Euzaiu thotë ta ketë dëgjuar Jahja bin Ebi Kethirin duke thënë: “Njeriu agjëron (abstenon) nga ajo që është hallall dhe e mirë ndërsa e prish agjërimin me mish të qelbur, mishin e vëllait të vet.”<sup>57</sup>. Shprehja “mishi i vëllait” nënkupton përgojimin. Hafsa bint Sirin citon Ebu El Alije të ketë thënë: “Agjëruesi vazhdon të jetë në adhurim përderisa nuk përgojon, edhe nëse është i shtrirë për të fjetur.” Hafsa bint Sirin thoshte: “Agjërimi është mburojë përderisa nuk e shpon. Shpimi i mburojës së agjërimi bëhet me përgojim.”<sup>58</sup>.

Pra, etika e agjërimit nënkupton ruajtjen nga mëkatet, veçmas ato që kanë të bëjnë me gjuhën dhe të cilat kanë potencial të zbehjes, e në mos edhe të zhbërjes së agjërimit. Për këtë shkak, Muxhahid bin Xhebër ka thënë: “Dy tipare po pate të shpëton agjërimi (nga humbja e shpërblimit): ikja nga përgojimi dhe gënjeshtria.”<sup>59</sup>. Dhunnuni agjëruesin më të dalluar e konsideronte atë që ruhej më së shumti nga mëkatet, thoshte: “Agjëruesi më i dalluar është ai që e ruan gjuhën e tij më së shumti.”<sup>60</sup>

Do ta doja ta përmbyll këtë pjesë me fjalët e bukura dhe konstatimin e drejtë e brilant që ka bërë Ibën Rexhebi, i cili ka thënë: “Nëse namazi nuk e largon njeriun nga punët e pandershme dhe të këqija, e largon prej Zotit. Nëse agjërimi nuk e mbron njeriun nga fjalët e kota dhe të vepruarit sipas tyre, e bën të urreyer dhe refuzuar.”<sup>61</sup>.

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> Ahmed bin Abdullah El Asbahani, *Hiljetu el evlija*, vep. cit., 1/382.

<sup>57</sup> Po aty, 3/69.

<sup>58</sup> Abdurrezzak es-San'ani, *El musannef*, red. shkenc. Habiburrahman A'dhami, (Indi: El mexhlis El ilmij, ed. 2, 1403 h.), nr. 7895, 4/307.

<sup>59</sup> Shih: Ibën Ebi Shejbe, *El kitab El musannef fi El ehadith ve El athar*, vep. cit., nr. 8887, 2/272!

<sup>60</sup> Muhamed Abdurreuf Zejn El Abidin El Munavi, *Fejd El Kadir sherhu El Xhami es-Sagir*, (Egjpt: El mektebetu et tixharije El kubra, 1356 h.), 2/197.

<sup>61</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaifu-l-mearif*, vep. cit., f. 310.

Pra, po e zhveshe agjërimin nga objektivat dhe etika, lëre që mbetesh pa shpërblim, por edhe dëmtohesh, bëhesh i urryer dhe i padëshiruar.

## 2.7. Syfyri

Të parët tanë kanë folur edhe për syfyrimin. Siç dihet, syfyri është më shumë se thjesht një ushqim parapërgatitës për agjërimin përkatëse. Është dhe mirësi me të cilën jemi veçuar, si ymet<sup>62</sup>, dhe po kështu kohë e volitshme e lutjeve dhe adhurimit. Ibën Haxheri kur flet për syfyrimin thotë se bereqeti i tij mund të arrihet me shtatë gjëra: ndjekjen e traditës pejgamberike, kundërshtimin e Ithtarëve të Librit, forcimin për adhurim, largimin e moralit dhe sjelljeve të këqija që vijnë si pasojë e urisë, shkas për lëmoshë ndaj atij që lyp ose që ha ushqim me të, shkas për dhikrin dhe lutjen në kohën kur mendohet të pranohet lutja, dhe arritja e kohës së nijetit të agjërimit (i cili duhet të bëhet natën).<sup>63</sup>

## KAPITULLI III: ADHURIMET NË RAMAZAN, NATA E KADRIT DHE SADAKAJA E FIRIT

### 3.1. Nxitimi me vepra të mira

Mundësitë e Ramazanit janë të rralla, prandaj besimtari thirret t'i shfrytëzojë. Katade Ramazanin e shihte mundësi të papërsëritshme prandaj thoshte: "Kujt nuk i falen mëkatet në Ramazan, nuk do t'i falen as në muajt e tjerë."<sup>64</sup>

Arsye tjetër pse duhet shfrytëzuar Ramazanin është edhe klima e veçantë për adhurim, për shkak se të këqijat ndodhin më pak. Imam Kurtubiu ka thënë: "Në Ramazan e keqja ndodh më pak, dhe kjo është një çështje e perceptueshme."<sup>65</sup>

<sup>62</sup> Shih hadithin: "Ajo që e dallon agjërimin tonë nga agjërimi i Ithtarëve të Librit është ngrënia e syfyrit..." Muslimi, nr. 1096!

<sup>63</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet'hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 4/140.

<sup>64</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 371.

<sup>65</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet'hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 4/114.

Ibën Haxheri, duke folur përkitazi me meselenë e prangosjes së djajve në Ramazan, ka thënë: “Aludim në atë se besimtari nuk ka justifikim. Sikur i thuhet besimtarit se djajtë të janë larguar, prandaj mos e justifikoj braktisjes e adhurimeve dhe as bërjen e mëkateve me ata dhe ndikimin e tyre!”<sup>66</sup>. Sigurisht se kjo klimë jo vetëm që duhet të na nxitë, por duhet ta provokojë edhe konkurrencën mes nesh për punë të hairit. Hasan Basriu thoshte: “Allahu e ka bërë Ramazanin fushë garë për robërit e Tij, në të cilën garojnë me adhurime për të kënaqësia e Tij. Disa nxituan, dhe fituan, e të tjerë mbetën mbrapa, dhe humbën.”<sup>67</sup>. Shtoja kësaj edhe faktin se Ramazani, siç përmendëm edhe më parë në thënien e Ibën Rexhebit, i tërë është i mirë, i tëri është mëshirë, falje e amnisti! Agjëruesi edhe gjatë ditës, edhe gjatë natës, është në adhurim. Duaja i pranohet sikur kur është agjërueshëm, sikur kur bën iftarin. Gjatë ditës agjëron (i largohet ushqimit dhe pijes) dhe bën durim, gjatë natës ha dhe falënderon.<sup>68</sup>

Prandaj edhe bënte thirrje: “Ibën Rexheb Hanbeliu ka thënë: “...Shfrytëzoni këto ditë, e që nuk kompensohen dhe që nuk mund të vlerësohen me asnjë çmim! Nxitoni me amel (vepër) para se të goditeni me exhel (vdekje), para se t’i bini pishman pse nuk keni bërë asgjë..!”<sup>69</sup>; “O mëkatarë të mëdhenj, mos e lëshoni plaçkën (fitimin) në këto ditë të bekuara, sepse ato nuk kompensohen dhe as që mund të maten për nga vlera!”<sup>70</sup>.

### 3.2. Agjërimi

Agjërimi është adhurimi kryesor për të cilin karakterizohet Ramazani. Ne më parë e cituam Fahrudin Rrazin, i cili thotë se Ramazani është vlerësuar për faktin se në të ka zbritur Kurani dhe është obliguar agjërimi. Prandaj, falja në Ramazan është e kushtëzuar me agjërimin: “Falja dhe

<sup>66</sup> Po aty, 4/114-115.

<sup>67</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 369.

<sup>68</sup> Po aty, f. 280.

<sup>69</sup> Po aty, f. 477.

<sup>70</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 374.

amnistia, që të dyja, vijnë si rezultat/shpërblim i agjërimit dhe faljes në Ramazan.”<sup>71</sup>

### 3.3. Duaja

Për rëndësinë e duasë në Ramazan ka folur edhe Ibën Kethiri, i cili ka thënë: “E preferuar është që duaja të bëhet shpesh e në çdo kohë, mirëpo në Ramazan edhe më shpesh, e në dhjetëshin e fundit edhe më shpesh, dhe pastaj në ditët/netët teke (të këtij dhjetëshit të fundit) edhe më shpesh.”<sup>72</sup>

Ibën Rexheb Hanbeliu ka thënë: “...(Agjëruesit) Duaja i pranohet sikur kur është agjërueshëm, sikur kur bën iftarin...”<sup>73</sup>. Prandaj, të parët tanë e shfrytëzonin duanë si mundësi të rrallë. Abdullah bin Omeri, r.a., thoshte: “Secili besimtar ka një lutje të pranuar në kohën e iftarit, e cila o i plotësohet këtu, në këtë bot, o i ruhet dhe i deponohet në Ahiret.” Abdullah bin Omeri, r.a., lutej: “Zoti im, Ti që fal shumë, më fal!”<sup>74</sup>. Lutjen për t’u falur mëkatet dhe për të shpëtuar e kanë përmendur edhe të tjerë. Ibën Rexhebi thoshte: “Një ndër dhuratat më të mëdha të Ramazani është që robi ta kapë (të bekohet me) kohën e pranimit të duasë në të cilën lutet për Xhenet dhe shpëtim nga Zjarri...”<sup>75</sup>. Imam Neveviu konsideronte se krahas kësaj besimtari lutet edhe për çështje materiale, e edhe për të tjerët thoshte: “Për agjëruesin preferohet të lutet për çështje të rëndësishme të botës tjetër dhe të kësaj bote, të lutet për dashamirët dhe për të gjithë myslimanët. Lutja preferohet të bëhet gjatë tërë ditës, sepse besimtari gjatë tërë kësaj kohe quhet agjërues.”<sup>76</sup>

<sup>71</sup> Po aty, f. 374.

<sup>72</sup> Ismail bin Umer Ibën Kethir, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, red. shkenc. Muhamed Husejn Shemsuddin, (Bejrut: Dar El kutub El ilmije, 1419 h.), 8/433.

<sup>73</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 280.

<sup>74</sup> Po aty, f. 371.

<sup>75</sup> Po aty, f. 379.

<sup>76</sup> Jahja bin Sheref En Nevevi, *El mexhmu sherhu El muhedheb*, (Dar El fikr), 6/375.

### 3.4. Dhikri

Një nga adhurimet më me vlerë të veçantë ë Ramazan është dhe dhikri. Ibën Kajimi ka thënë: “Agjëruesit më të mirë janë ata që e përmendin më së shumti Allahun e Madhëruar gjatë agjërimit të tyre.”<sup>77</sup>. Kjo mbase edhe për shkak të kohës. Ramazani është kohë e dalluar dhe me vlerë të shtuar, prandaj edhe adhurimet në të kanë vlerë dhe shpërblim të shumëfishuar. Zuhriu thoshte se: “Një tesbih në Ramazan ka vlerën e njëmijë tesbihëve jashtë tij.”<sup>78</sup>.

### 3.5. Leximi i Kuranit

Leximi i Kuranit në Ramazan ka vlerë të madhe. Zbritja e Kuranit në Ramazan është veçori që ngrit vlerën e këtij muaji, sikur që është adhurim, shpërblimi për të cilin është i madh. Prandaj të parët tanë i kushtonin rëndësi të madhe leximit të Kuranit në Ramazan. Leximin e Kuranit e shihnin mbase si përkushtimin kryesor në Ramazan, siç cituam më parë Zuhriun. Humejdi rrëfen se Imamët Ebu Hanife dhe Shafiu e kishin zakon gjatë Ramazanit të lexonin çdo ditë nga dy hatme.<sup>79</sup> Ibën Abdul Hakimi rrëfen për Imam Malikun, se kur vinte Ramazani, ai nuk merrej me asgjë tjetër përveç leximit të Kuranit, madje as ligjëratat e Hadithit nuk i mbante.<sup>80</sup>

### 3.6. Namazi i teravive

Teravitë janë veçori e Ramazanit. Ato janë namazi vullnetar i vetëm që falet me imam dhe xhemat në xhami përgjatë gjithë muajit. Falja e tyre, siç e cituam më lart Ibën Rexhebin, për shpërblim e ka faljen dhe amnistinë, prandaj edhe jemi nxitur në tekste fetare, hadithe më saktësisht,

<sup>77</sup> Ibën Kajim El Xheuzije, *El vabil es-sajjib min El kelimi Et Tajjib*, red. shkenc. Sejid Ibrahim, (Kajro: Dar El hadith, ed. 3. 1999), f. 75.

<sup>78</sup> Ibën Ebi Shejbe, *El kitab El musannef fi El ehadith ve El athar*, vep. cit., nr. 29840, 6/106.

<sup>79</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 365.

<sup>80</sup> Po aty.

që t'i falim teravitë dhe ato t'i falim me imamin, derisa ta mbarojmë. Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Kush falet në Ramazan, me besim dhe llogari (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e mëhershme!”<sup>81</sup>; “Ai që vërtet falet me imamin gjersa ta mbarojë, falja do t'i llogaritet sikur ta ketë bërë tërë natën.”<sup>82</sup>.

Ibën Rexhebi konsideronte se shpërblimi i paskajshëm në Ramazan arrihet nëpërmjet faljes së përkushtuar, thoshte: “Në Ramazan, besimtarit i bashkohen dy lloje të xhihadit të nefsit: xhihadi gjatë ditës me agjërim, dhe xhihadi gjatë natës me namaz. Kështu që, kush i bashkon këto dy lloje të xhihadit dhe i kryen me durim e sipas rregullave përkatëse, arrin shpërblimin e paskajshëm.”<sup>83</sup>.

Ndërsa flasim për teravitë, do të donim ta përcjellim një këshillë të çmueshme të dijetarit hanefi, Kasanit, i cili i porositi imamët që mos ta zgjatnin shumë namazin e teravive dhe që mos t'i largojnë njerëzit, sepse “shumimi i xhematit është më i mirë sesa zgjatja e leximit”, prandaj thotë që leximi të jetë në përputhje me gjendjen e xhematit, të lexohet aq sa ata nuk irritohen nga zgjatja dhe nuk largohen...<sup>84</sup>.

### 3.7. Umreja në Ramazan

Një nga adhurimet me vlerë në Ramazan është dhe umreja. Ajo në vlerë krahasohet me shpërblimin e haxhit<sup>85</sup>, prandaj të parët i kushtonin rëndësi umres në Ramazan. Umreja e ka arritur këtë vlerë, siç thotë Ibën El Arabiu, për shkak se Ramazani është bashkuar me të, pra, umre si adhurim më vete, dhe Ramazani si kohë e dalluar për adhurime, më vete,

<sup>81</sup> Buhariu, nr. 37; Muslimi, nr. 759.

<sup>82</sup> Ibën Maxheh transmeton, nr. 1327 ndërsa Albani e ka saktësuar.

<sup>83</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 306.

<sup>84</sup> Mes'ud bin Ahmed Kasani, *Bedaiu es-sanai fi tertibi esh-shera'i*, (Bejrut: Dar El kutub El ilmije, ed. 2, 1986), 1/289.

<sup>85</sup> Pejgamberi a.s., ka thënë: “Një Umre në Ramazan vlen sa një Haxh.” Transmetim unanim. Kurse në një version: “...sa një haxh me mua.”

prandaj janë bërë dy adhurime bashkë, dhe umreja e ka arritur këtë vlerë.<sup>86</sup>

### 3.8. Iftaret dhe sadakaja

Ramazani është muaj i shumëfishimit të shpërblimeve për veprat e mira. Së këndejmi, Ramazanin e shihnin edhe si muaj të dhënies së ushqimit - iftareve. Ibën Xheuzi thoshte: “Kush i jep iftar një agjëruesi, e ka shpërblimin sikurse të agjëruesit. Përpiqu ta agjërësh Ramazanin 60 ditë!”<sup>87</sup>. Pra, jepi iftar ndonjë miku e skamnorë çdo ditë!

Abdullah bin Umeri nuk bënte iftar vetëm se me skamnorët. Nëse ndodhte që familja, pa dijen e tij, t’i largonin skamnorët, atëherë kur ai merrte vesh, nuk darkonte me ta. Nëse ishte duke ngrënë ndërsa dikush kërkonte ushqim, çohet dhe ia jepte hisen e vet.<sup>88</sup> Junus bin Jezidi rrëfen se Ibën Shihabi gjatë Ramazanit nuk bënte tjetër vetëm se lexim të Kuranit dhe dhënie ushqim.<sup>89</sup> Imam Dhehebiu, duke folur për Hammad bin Ebi Sulejmanin, thotë se ka qenë një pasanik i madh, i cili gjatë Ramazanit u jepte ushqim 500 agjëruesve, ndërsa pas Bajramit secilit prej tyre ia jepte nga njëqind dërhëmë.<sup>90</sup>

Arsyeja pse duhet ta shfaqim këtë bujari qëndron në shembullin e Pejgamberit tonë, Muhamedi, a.s. Imam Shafiu ka thënë: “Më pëlqen ta shohë besimtarin në Ramazan më zemërgjerë sesa më parë, dhe këtë në shenjë pasimi ndaj të Dërguarit të Allahut në njërën anë, dhe, në anën tjetër, për shkak të nevojës më të theksuar të njerëzve, meqë janë më shumë të dhënë pas agjërimit dhe namazit, sesa pas punës dhe fitimit.”<sup>91</sup>

<sup>86</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet’hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 3/604-605.

<sup>87</sup> Abdurrahman bin Ali bin Muhamed El Xheuzi, *Et Teksireh*, (Bejrut: Dar El kutub El ilmije, 1986), 2/86.

<sup>88</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 30 \.

<sup>89</sup> Jusuf bin Abdullah, *Et Temhid lima fi El Muvettai min El meani ve El esanid*, red. shkenc. Mustafa bin Ahmed El Alevij, (Marok: Ministria e Vakëfeve, 1387 h.), 6/110-111.

<sup>90</sup> Edh Dhehebij, *Sijeru A’lami-n-Nubela*, vep. cit., 5/238.

<sup>91</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 30 \.

### 3.9. Dhjetë ditët/netet e fundit, itikafi dhe Nata e Kadrit

#### 3.9.1. Dhjetë ditët në përgjithësi

Ramazani është i tëri i mirë, vetëm se disa pjesë janë më të mira sesa pjesët e tjera. Të këtilla janë dhjetë ditët e fundit të tij, të rezervuara për dhuratat më të mëdha të Ramazanit. Për këtë shkak ato trajtoheshin në mënyrë të veçantë nga ana e të parëve. Ebu Uthman Nehdi rrëfen: “Brezat e parë i dallon tre dhjetëshe: dhjetë ditët e para të muajit Dhul Hixhe, dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, dhe dhjetë ditë e para të muajit Muharrem.”<sup>92</sup>. Prandaj, Ibën Kethiri porositi që në këto dhjetë ditë të shtohet adhurimi, e veçmas lutja: “E preferuar është që dua ja të bëhet shpesh e në çdo kohë, mirëpo në Ramazan edhe më shpesh, e në dhjetëshin e fundit edhe më shpesh, e pastaj në kohën e ditëve teke (të këtij dhjetëshit të fundit) edhe më shpesh.”<sup>93</sup>.

#### 3.9.2. Itikafi

Itikafi nënkupton të qëndruarit në xhami në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Rëndësia e kësaj vepre qëndron në përmbushjen e nevojës dhe të halleve që ka personi, sepse itikafi nënkupton përkushtim dhjetëditor vetëm për adhurim. Prandaj edhe Ata bin Ebi Rebah thoshte: “Shembulli i atij që bën itikafin është sikurse shembulli i njeriut që e ka ndonjë nevojë të ndonjë njeri me pushtet, dhe të porta e të cilit ulet dhe qëndron duke thënë se nuk do të çohet deri kur t’i përmbushet nevoja. Ai që bën itikaf, ai qëndron në Shtëpinë e Zotit, dhe thotë: “Nuk do të çohem derisa të më falen mëkatet. Itikafi është ndër veprat më të çmuara, nëse bëhen sinqerisht.”<sup>94</sup>. Të parët tanë qëndronin në itikaf për ta ruajtur agjërimin.

<sup>92</sup> Ibën El Xheuzi, *Et Tefsireh*, vep. cit., 2/124.

<sup>93</sup> Ibën Kethir, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 8/433.

<sup>94</sup> Muhamed bin Ahmed Serhasi, *El mebsut*, (Bejrut: Dar El ma'rife, 1993), 3/115.



Ebu Hurejre rrëfen se ai dhe shokët e tij, kur agjëronin, qëndronin në xhami dhe thoshin: “Po e pastrojmë agjërimin tonë.”<sup>95</sup>.

### 3.9.3. Nata e Kadrit

Ebu Bekir Verraku ka thënë: “Nata e Kadrit (Nata e Vlerës) është quajtur kështu ngase në të është shpallur një Libër me vlerë, i është shpallur një peygamberi me vlerë dhe një umeti me vlerë.”<sup>96</sup>. Ibën Kethiri ka thënë: “Adhurimi në Natën e Kadrit është më me vlerë sesa adhurimi në një mijë muaj në të cilët nuk është Nata e Kadrit.”<sup>97</sup>.

Për këtë arsye të parët kanë bërë thirrje për shfrytëzim të këtyre dhjetë ditëve. Ibën Rexheb Hanbeliu thoshte: “...Shfrytëzoni këto ditë, e që nuk kompensohen dhe që nuk mund të vlerësohen me asnjë çmim! Nxitoni me amel (vepër) para se të goditeni me exhel (vdekje), para se t’i bini pishman pse nuk keni bërë asgjë...!”<sup>98</sup>; “O mëkatarë të mëdhenj, mos e lëshoni plaçkën (fitimin) në këto ditë të bekuara, sepse ato nuk kompensohen dhe as që mund të maten për nga vlera!”<sup>99</sup>; “O ti që e ke çuar jetën dëm, kompensoje në Natën e Kadrit tërë atë që e ke humbur, sepse ajo llogaritet sa tërë jeta!”<sup>100</sup>.

Prandaj të parët edhe e kanë konsideruar si një mirësi që nuk do të duhej të lëshohej, madje edhe sikur të ishte në një nga netët e vitit, e lëre më që dihet saktësisht se është në njërin nga dhjetë netët e fundit të Ramazanit. Ibën Bettali ka thënë: “...Sikur Allahu t’ua bënte me dije robërve se në netët e vitit ka një natë të ngjashme me Natën e Kadrit, do të ishte

<sup>95</sup> Abdurrahman bin Ali bin Muhamed El Xheuzi, *Et Teksireh*, vep. cit., 2/76. Shih edhe: Ahmed bin Abdullah El Asbahani, *Hiljetu el evlija*, vep. cit., 1/382.

<sup>96</sup> Sejid bin Husejn El Affani, *Ruhban El lejl*, (Kajro: Mektebetu Ibën Tejmije, ed. 2, 1993), 2/214.

<sup>97</sup> Ibën Kethir, *Tefsiru El Kur’ani El adhim*, vep. cit., 8/424.

<sup>98</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 477.

<sup>99</sup> Po aty, f. 374.

<sup>100</sup> Po aty, f. 340.

obligim për ta që, në kërkim të kësaj nate, t'i ngjallnin me adhurim të gjitha netët e vitit...<sup>101</sup>.

### 3.10. Sadakaja e Fitrit

Sadakaj e Fitrit është sadaka e obliguar për t'u dhënë në fund të Ramazanit. Rëndësia e kësaj sadakaje është e veçantë. Ibën Abbasi, r.a., transmeton: “Pejgamberi, a.s., e obligoi zekatin e fitrit si pastrim për agjëruesin (nga gabimet eventuale në agjërime) dhe si ushqim për meskinët. Kush e jep para namazit, është zekat i pranuar, ndërsa kush e jep pas namazit, ajo mbetet lëmoshë e rëndomtë.”<sup>102</sup>.

Vekië bin Xherrah, në mënyrë figurative, e përshkruante këtë efekt të Sadakasë së Fitrit dhe thoshte: “Sadakaja e Fitrit në raport me Ramazanin është sikurse dy sexhdet e harresës në raport me namazin; i plotëson mangësitë në agjërime sikurse sexhdeja që i plotëson mangësitë në namaz.”<sup>103</sup>.

## KAPITULLI IV: PËRMBYLLJA E RAMAZANIT DHE FESTA E BAJRAMIT TË FITRIT

### 4.1. Ndarja nga Ramazani

Ashtu sikurse ardhja e këtij muaji sjell gëzim, po ashtu edhe ndarja me të na mërzi. Këtë mërzi e shkakton ndarja nga mundësitë e shpërblimit dhe frika e pamundësisë për ta arritur sërish Ramazanin. Ibën Rexhebi thoshte: “E si mos t'i rrjedhin lotët besimtarit për ndarjen nga Ramazani, kur ai nuk e di nëse do të jetojë aq sa ta arrijë prapë Ramazanin?!”<sup>104</sup>.

<sup>101</sup> Ibën Bettal Ali bin Halef, *Sherhu Sahihi El Buhari*, red. shkenc. Ebu Temim Jasir bin Ibrahim, (Rijad: Mektebetu err-Rrushd, ed. 2, 2003), 4/159.

<sup>102</sup> Ebu Davudi, nr. 1609; Ibën Maxheh, nr. 1827.

<sup>103</sup> Neveviu, *El Mexhmu sherhu El muhedheb*, vep. cit., 6/140.

<sup>104</sup> Ibën Rexhebi El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 381.

Prandaj, ndarja është moment që shkakton keqardhje, veçmas për ata që nuk e kanë shfrytëzuar sa duhet. Aliu, r.a., siç transmetohet, në natën e fundit të Ramazanit thërriste me zë: “Sikur ta dija se kush është i pranuar (kujt i janë pranuar veprat), e ta përgëzoj, dhe kush është i privuar, e ta ngushëlloj!”<sup>105</sup>. Ibën Mesudi, në natën e fundit të Ramazanit dilte dhe thërriste me zë: “Kush është ai që sonte është pranuar tek Allahu, që ta përgëzojmë, dhe kush është ai që sonte është refuzuar, që ta ngushëllojmë...”<sup>106</sup>.

## 4.2. Bajrami i Fitrit

Bajrami paraqet njërin nga dy gëzimet e besimtarit për agjërimin<sup>107</sup>. Ky gëzim është i veçantë, sepse bëhet për suksesin në adhurim. Dihet se ka qenë praktikë e sahabëve, shokëve të pejgamberit Muhamed, a.s., që në ditën e Bajramit ta urojnë njëri-tjetrin duke thënë: “Allahu e pranofte prej nesh dhe prej jush!”<sup>108</sup>.

Jo vetëm urimi por edhe dallimi me zbukurim, madje për të gjithë, “edhe për ata që shkojnë për ta falur Bajramin, edhe për ata që qëndrojnë në shtëpi, edhe për gratë, edhe për fëmijët.”<sup>109</sup>.

Megjithëkëtë, festimi nuk nënkupton shturjen. Umer bin Abdul Azi-zi në hytben e Bajramit të Fitrit iu drejtua masës me këto fjalë: “O ju njerëz, agjëruat për Allahun tridhjetë ditë, u falët tridhjetë ditë, ndërsa sot keni dalë që të kërkoni prej Allahut t’jua pranojë agjërimin.”<sup>110</sup>. Ibën Rexhebi ka thënë: “Nuk është festa për atë që ka veshur rrobë të re, por për

<sup>105</sup> Po aty, f. 369.

<sup>106</sup> Po aty.

<sup>107</sup> Argument hadithit: “Agjëruesi ka dy gëzime: kur të bëjë iftar, gëzohet, e po kështu gëzohet kur ta takojë Allahun e Madhëruar dhe ta shpërblejë Ai për agjërimin...” Buhariu, nr. 7492; Muslimi, nr. 1151.

<sup>108</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet’hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 2/446.

<sup>109</sup> Ahmed bin Rexheb El Hanbelij, *Fet’h El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, red. shkenc. Sabri bin Abdulhalik esh-Shafij, (Kajro: Mekteb tahkiki dari El haremejn, 1996), 8/420.

<sup>110</sup> Ibën Rexheb El Hanbelij, *Letaif El mearif*, vep. cit., f. 369.

ata që kanë bërë hapa përpara në adhurim. Festa nuk është për atë që rrobat dhe mjetin udhëtues (veturën) e ka zbuluar, por për atë që mëkatet i janë falur. Në natën e Bajramit amnistia dhe falja shpërndahen te ro-bërit, kështu që, kush arrin diçka nga ajo, ka festë e gëzim, përndryshe është i refuzuar dhe plot dëshpërim.”<sup>111</sup>.

### 4.3. Çfarë pas Ramazanit?!

Prandaj kërkohet vendosmëria për të mos iu kthyer kurrë mëkateve, përndryshe kthimi në mëkate është tregues për refuzim të agjërimit. Kab bin Maliku ka thënë: “Kush e agjëron Ramazanin dhe vendos që mos t’i bëjë mëkat Allahut pas Ramazanit, ai do të hyjë në Xhenet pa u pyetur dhe pa u marrë në llogari. Ndërsa kush e agjëron Ramazanin, kurse në shpirt e fsheh vendosmërinë për t’iu kthyer mëkateve pas Ramazanit, agjërimi do t’i refuzohet.”<sup>112</sup>. Bishr Hafiu e pyetën për disa njerëz që në Ramazan e adhuronin Allahun dhe përpiqeshin për vepra të mira ndërsa kur mbaronte Ramazani i ktheheshin avazit të vjetër. “Njerëz të këqij janë ata që Allahun e njohin vetëm në Ramazan.”, - u përgjigj ai.<sup>113</sup>

Prandaj, ne i gjejmë të parët që pikërisht në ditë të Bajramit porosisnin për ruajtje nga mëkatet. Njëri prej shokëve të Sufjan Theuriut rrëfen të ketë thënë: “Gjëja e parë që do ta fillojmë ditën e Bajramit me të është ta ulim shikimin.”<sup>114</sup>. Kjo për faktin se Ramazani i ngjan një shkollë dhe trajnimi që, po ia dole ta kryesh me sukses, ke vit të mbarë: “Kujt i shkon për dore Ramazani (ka sukses në të) dhe shpëton (pa u dëmtuar nga mëkatet), i shpëton tërë viti.”<sup>115</sup> Pra, fryma e Ramazanit dhe mësimet e tij vazhdojnë ta udhëzojnë besimtarin përgjatë gjithë kohës.

<sup>111</sup> Po aty, f. 484.

<sup>112</sup> Po aty, f. 378.

<sup>113</sup> Po aty, f. 390.

<sup>114</sup> Ibën El Xheuzi, *Et Tëbsireh*, vep. cit., 2/106.

<sup>115</sup> Ibën Kajim El Xheuzije, *Zad El mead*, vep. cit., 1/386.

Do të doja që përmbylljen ta bëj me këshillën e bukur të Ibën Xheuziut, i cili ka thënë: “O ti që Ramazanin e përmbushe në mënyrën më të mirë, mos ndrysho pas tij as në muajin Sheval.”<sup>116</sup>

Pra, mësimet e Ramazanit le të vazhdojnë të udhëheqin me jetën tënde sa të jesh gjallë!

## PËRFUNDIM

Nga ky përshkrim përmbledhës i agjërimit dhe i adhurimeve të tjera në muajin Ramazan mund të konstatojmë se të parët tanë e kanë kuptuar drejt agjërimin, si nga aspekti i objektivave dhe qëllimeve të tij, si nga ai i etikës dhe normave përkatëse. Ata, rrjedhimisht, kanë ofruar shembullin e duhur të një agjëruesi që bashkon ndërmjet aspektit material, shpirtëror dhe etik në agjërimit, pra, nuk abstenon vetëm nga ushqimi dhe pija, por dhe nga çdo gjë tjetër që mund ta dëmtojë reputacionin e tij prej besimtari të devotshëm dhe të ndershëm. Punimi konfirmon angazhimin shtesë të të parëve tanë në Ramazan, si në aspektin e adhurimit, po ashtu edhe në atë solidar. Punimi, duke marrë shkas këtë koncept të kompletuar për agjërimit që ofron kjo përmbledhje, duke iu referuar mendimeve dhe thënieve të brezave të parë, rekomandon shfrytëzimin e trashëgimisë sonë të pasur shkencore e kulturore, si dhe orientimin t’i referohemi fillimisht asaj për çështjet fetare, sepse do ta gjejmë më të mirën dhe më të saktën.

<sup>116</sup> Ibën El Xheuzi, *Et Tefsireh*, vep. cit., 2/114.

Dr. Sedat ISLAMI

## **THE CONCEPT, VALUE, AND IMPORTANCE OF FASTING IN RAMADAN ACCORDING TO EARLY GENERATIONS OF MUSLIM SCHOLARS**

### **Abstract**

Since fasting in Ramadan, in the Qur'anic and prophetic texts, is described as a form of worship with educational character, in this paper, we have undertaken the task of elucidating the views of previous generations of Muslims regarding it. Specifically, shedding light on their concept of fasting, their practices in fasting and Ramadan worship, the ethics related to fasting, etc. This paper complements existing ones and also serves as a means to motivate people to fast in Ramadan. The methodology followed in this paper is descriptive. The paper is thematically divided into several parts, including preparation for fasting, the concept of fasting, various practices of worship and the manner of observing Ramadan. The findings of the paper demonstrate the great dedication of the previous generations to fasting in Ramadan and contain great power, both motivational and educational, for current generations. The main recommendation of the paper is that worship, in general, and fasting in Ramadan, in particular, should be given greater importance so that they can play their multidimensional role in society.

**Keywords:** *fasting, Ramadan, prayer, early generations, scholars.*



Mr. Driton ARIFI

## **SËMUNDJA - ARSYE JUSTIFIKUESE PËR PRISHJEN E AGJËRIMIT**

### **Abstrakt**

Agjërimi është një adhurim fiziko-trupor, që për nga natyra mëton në privimin e organizmit nga të ngrënit dhe pirja, që nga mëngjesi i hershëm e deri në perëndim të diellit. Duke qenë i tillë, të njëjtën gjë s'arrin dot ta përballojë i sëmuri, ngase organizmi i tij nuk i kryen funksionet në formën e vet të paraparë. Duke qenë kështu, Ligjvënësi i Gjithëdijshtëm në Kuranin fisnik, në formë tekstuale, e shkarkoi të sëmurin nga kjo detyrë, dhe e hoqi prej supeve të tij, së paku deri në rrethana më të mirëqena, obligimin e agjërit. E nëse nuk shpresohet prej tij shërimi, Ai gjeti për të kompensues material për ta shëruar aspiratën e tij të lënduar për agjërim, duke e ligjësuar *fidjen*.

Nga hulumtimet solide të shkollarëve islamë dhe interpretimet që ua bënë citateve kuranore e atyre pejgamberike, vihet në dritë fakti se nëse personi vuan nga ndonjë sëmundje që agjërimi e përkeqëson sëmundjen, e prolongon shërimin e saj apo i shkakton dhimbje të papërballueshme, ai nuk obligohet, madje në rrethana të rrezikimit të jetës së tij të njëjtit i ndalohet edhe të agjërojë. Allahu nuk e ngarkon askënd përmbi kapacitetet dhe mundësitë që i ka akëcili, dhe ky është principi mbi të cilin ndërtohen të gjitha detyrat dhe obligimet islame, pa përjashtim.

**Fjalët kyçe:** *agjërim, medikamente, fidje, justifikim, ruh'sah, azimeh...*



## Hyrje

Agjërimi është adhurim madhështor me të cilin Allahu i Plotfuqishëm i ngarkoi besimtarët myslimanë për ta hapur mundësinë e artë para tyre, që ata të arrijnë gradën e devocionit dhe afrimit të çiltër tek Ai. Mirëpo, me gjithë aspiratën që të gjithë besimtarët myslimanë të përfitojnë nga një ofertë e çmuar hyjnore, disa prej tyre, për shkaqe të ndryshme objektive, atë e kanë të pamundur. Të sëmuret janë në krye të listës së atyre që agjërimin s'e përballojnë dot, ngaqë shëndeti i tyre ua imponon një disiplinë dhe regjim rigid ushqimor gjatë ditës dhe natës, eventualisht edhe terapia mjekuese që interferon brenda segmentit kohor të agjërimit.

Principi themelor i Islamit është se ai është ngritur mbi bazën e lehtësimit, e jo vështirësimit, ndërkaq ngarkimi eventual i të sëmureve me agjërim do ta cenonte këtë parim të pakontestueshëm hyjnor. Prandaj, jo rastësisht, të sëmuret janë përfitues nga fryma tolerante e Islamit dhe nga pakoja lehtësuese e dispozitave të tij.

Diskutimi për sëmundjen si arsye justifikuese e prishjes së agjërimit, si në të kaluarën nga dijetarët klasikë, por edhe në epokën e fundit mbetet mjaft kureshtar. Ai diskutim kap segmente e pika interesante. Për shkak të gjerësisë së nocionit dhe vështirësisë së vënies së limiteve të prera për të, dijetarët myslimanë bënë përpjekje që të heqin dilemat dhe të zbardhin një herë e mirë se cila është ajo sëmundja për shkak të së cilës besimtari shkarkohet nga detyra hyjnore e agjërimit. Te sëmundja ka dhe implikime të tjera, që dosido, shtjellimi i rasteve të tilla duhet të bëhet bashkangjitur me të. Prandaj, kjo trajtesë modeste, si dhe shumë të tjera të kësaj natyre, tentojnë të hedhin dritë në diskutimin shkencor rreth kësaj kategorie të njerëzve dhe çështjeve tjera që mund të interferohen në të.

## Mirëqenia fizike e mendore është kusht i obligimit me agjërimit

Islami, duke qenë një fe e natyrshme të njeriut, në asnjë situatë nuk ka sjellë norma e rregullativa ngarkuese për besimtarët, deri në atë shkallë sa të jenë përtej mundësive dhe kapacitetit të tyre fizik e mendor. Ai detyrën e ngarkesën e ka të ndërtuar mbi parimin e mundësisë njerëzore. Agjërimiti, sikurse edhe adhurimet e detyrat e tjera fetare, natyrisht që i përkasin këtij segmenti të tolerancës, dhe nuk bëjnë përjashtim fare prej tij. Allahu i Lartmadhërisëm këtë princip e bëri të qartë katërçipërisht, kur tha: *“Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta. Atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi, dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi...”*. *El Bekare, 286*. Juristi dhe komentuesi i mirënjohur hanefi, Ebu Bekër El Xhessas, në kontekst të interpretimit të këtij ajeti, thoshte se në këtë ajet e gjejmë tekstualisht parimin se Allahu nuk e ngarkon askënd me diçka që ai nuk mund ta kryejë, sepse po ta ngarkonte njeriu me atë që nuk do të kishte mundësi ta kryente, do të nënkuptonte se njeriu po ngarkohet me atë që është jashtë mundësisë e kapacitetit të tij...; kjo, përndryshe, do t'i binte sikur po të ngarkohej i hendikepuari me ecje, i verbëri me shikim, e të ngjashme.<sup>1</sup> Sigurisht se Allahu nuk e ngarkon krijesën e Vet të privilegjuar me diçka që përbën tejkalim të kapaciteteve të tij, qofshin ato fizike apo mendore. Kjo është ngritur në nivel postulati në të drejtën islame.

Po ashtu në një citat tjetër rikonfirmohet i njëjti parim: *“Prandaj druajuni Allahut aq sa të keni mundësi, dhe (Atij) nënshtroni...!”*. *Et Tega-bun, 16*. Droja ndaj Allahut, në trajtesën tonë, pra të kryerjes së obligimit të agjërimit, është e ndërlidhur kryekëput me mundësinë, pa plotësimin e së cilës nuk imagjinohet kryerja e veprës.

Në këtë sens, edhe Muhamedi (paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të) vinte pikat mbi shkronja për të kristalizuar të njëjtin parim juridik islam, nëpërmes hadithit të transmetuar prej Aishes, r.a., që thoshte: *“Rrokni për dorë ato punë, që mund t'i kryeni...!”*. (Buhariu, 43, Muslimi, 785). Pra, cilado vepër që nuk mund të kryhet nga ne, me të nuk ngarkohemi në asnjë situatë nga Ligjvënësi i Urtë.

<sup>1</sup> Ebu Bekr El Xhessas, Ahkam El Kuran, (Bejrut: Dar El Fikr, 2014), 1/733.

Agjërimi duke qenë një adhurim për kryerjen e të cilit na duhet; në njerën anë aftësia mendore, sa për të kuptuar thelbin dhe rëndësinë hyjnore të tij, mirëpo dhe në anën tjetër, na duhet edhe mundësia fizike e shëndeti pa të cilat realizimi i tij bëhet i pamundur ose në situatën më të mirë, ai bëhet vështirë i realizueshëm.

### **Sëmundja si arsye që justifikon prishjen e agjërit**

Meqë agjërimi, për nga natyra e tij është një lloj abstenimi që privon trupin e njeriut nga ushqimi dhe pija prej mëngjesit të hershëm e deri në perëndim të diellit, domosdoshmërisht se si të tillë, këtë adhurim s'ia dalin ta kryejnë dot disa kategori të njerëzve që shëndetin fizik nuk e kanë në gjendje të normalizuar. Të sëmurët, për shkak të sëmundjes e përkeqësimit të shëndetit të tyre, Ligjvënësi i shkarkoi nga ky adhurim, menjëherë në ajetin vijues, pas atij të obligimit të agjërit.

Zoti i Madhërishtëm në Kuranin fisnik tha: **“O besimtarë! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu si u ka qenë obligim edhe për ata që ishin para juve, ndoshta kështu arrini devotshmërinë. (Agjërimi) zgjat disa ditë. E nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (ai mundet që mos të agjërojë), por duhet t'i kompensojë aq ditë sa i ka prishur – në ditë tjera me agjërim. Dhe ata (njerëz) që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të japë fidje-shpagim aq sa mund të ngopet një i varfër me ushqim gjatë ditës (për një ditë agjërimi – një ditë ushqimi)...”**. *El Bekare, 183-184.*

Në këtë varg ajetesh gjejmë një rënditje racionale të përvijuar mjeshhtërisht nga i Gjithëdijshti Fuqiptotë. Në ajetin e parë lëshohet urdhri i prerë që kërkon normën parimore për kryerjen e këtij adhurimi, duke “ngushëlluar” besimtarët e ymetit të Muhamedit, a.s., se me të njëjtin ishin ngarkuar edhe pasuesit e profetëve para tij.

Ndërsa ajeti në vijim, siç theksonte komentuesi bashkëkohor, Tahir bin Ashur: “...vihet re sjellja e normës lehtësuese- *ruh'sah*, pas ngarkesës detyruese parimore-*azimeh*, sikur për të përshpejtuar qetësimin e zemrave të atyre që e dëgjojnë këtë urdhër, në mënyrë që mos të mendojnë se me

këtë adhurim, ngarkohen të gjithë ata, në formë absolute e në çdo rrethanë.”<sup>2</sup>

Në formë decidive e pa doreza, në këtë ajet, dhe e ripërsëritur tutje edhe në ajetin vijues, atë të 185-tin, sëmundja rangohet arsyeja e parë, që justifikon për besimtarin prishjen e agjërimit të Ramazanit.

Kjo normë, që disi është dispozitë juridike e lehtësuar nga kërkesa parimore për kategorinë e të sëmurëve, në fakt ndërthet në vete rregullin e mirënjohur të jurisprudencës islame “*Vështirësitë tërheqin pas vetes lehtësimet*”. Thënë shtruar, sa herë që vërejmë në zbatimin e ndonjë norme apo detyre islame, vështirësi të papërballueshme e rëndesë që pamundëson vazhdimin e veprimit me të, duhet të hulumtojmë brenda kornizave të sheriatit islam, sepse aty doemos ekzistojnë edhe rrugët e linjat lehtësuese për të njëjtën vepër.

I sëmuri duke mos agjëruar, në fakt aplikon edhe një rregull të shëndoshë juridiko islame që thotë: “**...anashkalohen interesat-dobitë e një vepre, nëse nga e njëjta kemi dëme të konfirmuara e që janë më të mëdha**”. Pra me gjithë dëshirën e një besimtari të devotshëm që të përfitojë nga bekimet e mirësitë e Ramazanit dhe agjërimit, ai duhet ta lë agjërimin sepse i njëjti për të sjellë edhe dëme të konsiderueshme shëndetësore.

### **Definimi i sëmundjes që justifikon prishjen e agjërimit**

Kurani fisnik, rëndom kur rrëfen norma e dispozita, të tillat i sjell në formë tejet të përgjithësuar, pa u lëshuar në detaje e as në definime eksplicite. Detajet e specifikimet mbesin rëndom mision i Muhamedit, s.a.v.s., ose eventualisht i dijetarëve *muxhtehidë* pas tij, të cilët vejnë në spikamë dhe sqarojnë mjeshtërisht atë që Kurani e la të përgjithësuar.

Mirëpo, këtu duhet kujtuar se për aq kohë sa Kurani nuk specifikon natyrën, shkallën e as llojin e sëmundjes, për shkak të të cilës agjëruarit do t’i lejohej prishja e agjërimit, atëherë përcaktimi i saj lë mundësinë për debat e divergjencë juridike shkencore në mes shkollarëve islamë.

<sup>2</sup> Muhammed Tahir bin Ashur, Et Tahrir ve Et Tenvir (Tunis:Daru Sahnun, 1997), 2\162.

Me shprehjen **sëmundje** parimisht nënkuptojmë: “...gjendjen jo të shëndoshë e jo stabile të organeve apo pjesëve të trupit të njeriut sa që pamundësohet kryerja e funksionit në formën e duhur e normale të tyre.”<sup>3</sup>

Shikuar në thelb, ekziston pajtimi te të gjithë se çka ne duhet të konsiderojmë sëmundje për trupin e njeriut e çka jo. Megjithatë, te shkollarët e doktrinave të ndryshme juridike, madje edhe te vetë interpretuesit e këtyre ajeteve kuranore, gjejmë qasje goxha të skajshme interpretuese rreth asaj se cila nga ato sëmundje justifikon prishjen e agjërimit.

Një mendim që theksohet në literaturën islame, i transmetuar nga Hassen El Basriu, Imam Atau, Muhamed bin Sirini, madje ky i atribuohet edhe Imam Buhariut, e sigurisht se këtu hyjnë edhe literalistët-*dhahirnjtë*, pra që të gjithë këta thonë se cilido organ ose gjymtyrë po që se i sëmuret njeriut, duke ndier ai dhimbje në të, ose duke i shkaktuar mosfunksionimin normal të tij, ajo llogaritet arsye e mjaftueshme për lejimin e prishjes së agjërimit. Këtë qëndrim, ata e përqafojnë duke marrë si pretekst dome thënien gjuhësore të nocionit “sëmundje” në kontekstin më të thjesht e më parimor të saj. Dhe meqë Allahu në këto ajete, nuk ka detajizuar se cilën sëmundje e ka synuar, atëherë mbetet në domethënien gjithëpërfshirëse të saj.<sup>4</sup>

Ky mendim, nuk theksohet, as këtu, e as në literaturën bazike islame, për shkak të fuqisë a vlerës së tij në kuptim të kredibilitetit e argumentimit, apo pse duhet të kthehet koka kah ai, për të analizuar më thellë. Ai përmendet para lexuesve thjesht sa për të kristalizuar saktësinë e mendimit tjetër në vijim, që përfaqëson shumicën absolute të dijetarëve e shkollarëve të të gjitha doktrinave juridike pa asnjë dallim.

Në këtë kontekst, duhet theksuar faktin se agjërimi te disa sëmundje ka efekt të mahnitshëm pozitiv e lehtësues. Prandaj, si ka mundësi që t’i lejohet atij prishja e agjërimit, kur agjërimi atij jo që nuk ia vështirëson

<sup>3</sup> Fah’r Err Rrazilii, Et Tefsir El Kebir (Bejrut: Dar Ihja Et Turath El Islamij, 2001), 2\243.

<sup>4</sup> Muhammed El Kurtubij, El Xhami’ Li Ahkam El Kuran (Bejrut: Dar El Kitab Elarabij, 2003), 2\272.

Por shih edhe: Sejjid Sabik, Fikh Es Sunneh (Damask: Daru Ibën Kethir, 2002), 1\508.

gjendjen shëndetësore, por përkundrazi vetëm ia lehtëson e ia përshpejton shërimin e tejkalimin e problemit të tij shëndetësor.

Shto kësaj edhe faktin se disa sëmundje janë të tilla që agjërimi nuk ka kurrfarë efekti në to. Këtu mund të rangohet dhimbja e dhëmbit, veshit, syrit, sëmundjet e lëkurës, pastaj plaga e kufizuar në dorë apo këmbë që nuk kërkon konsumim oral të ndonjë bari për të qetësuar dhimbjen apo për të parandaluar infeksionin e të ngjashme. Prandaj prishja e agjërimin në rrethana të tilla konsiderohet e pajustificueshme juridikisht dhe absurde logjikisht.

**Mendimi i dytë** që përfaqësohet nga shumica dërmuese e dijetarëve islamë, e i cili na thotë se nuk është çdo sëmundje arsye që justifikon prishjen e agjërimin. Sipas këtij mendimi, sëmundja e cila është përmendur në këtë ajet është për qëllim ajo e cila nëse agjërojmë e eskalon ose përkeqëson atë sëmundje, ose vonohet shërimi i saj, eventualisht dëmtohet ndonjë organ apo gjymtyrë e trupit të njeriut. E nëse dikush vuan nga ndonjë sëmundje që agjërimi të tillit ia rrezikon jetën, në këtë situatë jo që është e lejuar të prishet agjërimi, por edhe bëhet i detyruar juridikisht.

Mirëpo, konfirmimin e efektit të sëmundjes në agjërim, i sëmuri mund ta bëjë ose me ndonjë përvojë të veten nga e kaluara, duke e provuar se agjërimi i ka shkaktuar përkeqësime shëndetësore ose nga ndonjë indikacion aktual që e vëren vetë, apo nëpërmjet informimit të ndonjë mjeku mysliman, i cili parimisht duket dhe gjykojmë për të se është i besueshëm e korrekt në vlerësimet e konstatimet e tij.<sup>5</sup>

Natyrisht, sot kjo e fundit duket që të jetë rrugë më kredibile dhe sigurisht se myslimanët për të ardhur deri te një vendim për të mos agjëruar, do të duhej të konsultoheshin paraprakisht me ndonjë mjek profesionalisht të mirëpërgatitur, e i cili është i besueshëm që rekomandimin për prishje nuk e jep pa konstatuar arsye të fuqishme për këtë gjë.

Duke u pyetur Imam Ebu Hanifeja, r.a., se për cilën sëmundje lejohet prishja e agjërimin, transmetohet të ketë thënë: “Nëse ndonjëri që është agjërueshëm ka frikë se nëse ha ose pi, i shtohet dhimbja e tij e syrit ose i

<sup>5</sup> Zejnuddin bin Nuxhejm El Hanefij, El Bahru Err Rraik Sherh Kenz Ed Dekaik (Bejrut: Daru El Kitub El Ilmijje, 1997), 2\492.

përkeqësohet sëmundja e temperaturës apo e etheve, ai mund ta prish agjërimin”, Ndërsa në një prononcim tjetër përafres ai kishte thënë: “Nëse personi është i sëmurë aq sa i lejohet atij falja e namazit ulur, ai konsiderohet i sëmurë dhe mund ta prishë agjërimin”.<sup>6</sup>

Megjithatë, Imam Ebu Hanifeja duket se në këto deklarime shkencore, më shumë kishte për qëllim të përmendte rastet në të cilat tolerohet prishja e agjërimit, se sa të ofronte ndonjë definicion juridik shkencor për sëmundjen justifikuese të prishjes së agjërimit.

Ky qëndrim i këtyre dijetarëve që përfaqësohet prej shumicës të të gjitha shkollave juridike islame (me dallime të papërfillshme në detajet e tij) është mjaft parimor, dhe sigurisht më i shëndosh edhe në aspektin racional dhe atë juridik islam. Mendimi i tillë, nuk ndalet në aspekti literal të tekstit, por hulumton thellë në intencat e tij për të sjellë definicione e standarde të cilat do të përputheshin me frymën e përgjithshme të normave juridike islame.

Si pikë referencë për këtë qëndrim merret përfundimi i ajetit të dytë që thekson sëmundjen si arsye që justifikon prishjen e agjërimit. Allahu në fund të këtij ajeti tha: “... *E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju...*”. *El Bekare, 185.*

Përderisa agjërimi ndonjë të sëmuri i shkakton; vështirësi, komplikime apo telashe të ndryshme shëndetësore, atëherë është absurde të mendohet se ato, Allahu i synon për agjëruetin. Thënë më mirë, siç theksohet në këtë citat, Ai e dëshiron të kundërtën e tyre, e do lehtësimin e tolerimit. E, lehtësim për të tillët është prishja, jo agjërimi.

Përtej kësaj, të sëmurët për trajtimin dhe shërimin e sëmundjes së tyre kanë nevojë për përdorim të barërave e terapive të ndryshme, të cilat natyrisht se kanë limit kohor të caktuar për të arritur efektin e vet, ndërkaq agjërimi pamundëson një gjë të tillë, prandaj edhe bie obligueshmëria e tij ndaj të sëmurëve.

<sup>6</sup> Ebi Mes'ud El Kasanij, *Bedai Es Sanai' Fi Tertib Esh Sherai'* (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmijje, 1987), 2/94.

Megjithatë këtu është me peshë të theksohet se shumica e juristëve theksojnë që nëse dikush thjesht ka frikën se nëse agjëron do t'i përkeqësohet shëndeti i tij, mirëpo këtë frikë nuk e ka fituar nga përvoja e kaluar më ndonjë sëmundje të tillë, e as nga informimi i mjekut të besueshëm, atëherë ajo frikë për mundësinë e sëmundjes nuk është arsye që justifikon prishjen e agjërimit.<sup>7</sup>

### **Kategoritë e tjera që marrin tretmanin e të sëmurëve**

Nga trajtimi më lartë u kuptua fakti se Allahu shkarkoi tekstualisht në Kuran të sëmurët, nga obligueshmëria e agjërimit për shkak të pamundësisë së tyre shëndetësore për agjërim. Mirëpo, te kjo kategori dhe për të njëjtën arsye, pra atë shëndetësore, hyjnë edhe gruaja shtatzënë, gjidhënëseja që ushqen fëmijën e saj me gjirin e saj, dhe personi shtyrë në moshë.

### **Gruaja shtatzënë dhe gjidhënëseja**

Gruaja shtatzënë nëse ka frikë për shëndetin e saj apo për embrionin që bartë në mitrën e saj lejohet që ta prish agjërimin. Po kështu është edhe te gjidhënëseja nëse ka frikë për shëndetin e vet apo për shëndetin e fëmijës të cilin është duke e ushqyer me gjirin e saj.

Imam Serah'siu, prej juristëve të mirënjohur hanefinj thoshte: “Nëse gruaja shtatzënë ose gjidhënëseja kanë frikë për veten (shëndetin) e tyre ose për fëmijën e tyre, ato të dyja lejohet ta prishin agjërimin sepse Muhamedi, s.a.v.s., ka thënë: *“Allahu vërtet e ka shkarkuar udhëtarin, nga gjysma e (rekateve) të namazit dhe e ka shkarkuar nga agjërimi, gruan shtatzënë dhe atë që është gjidhënëse”*.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Imam Ebu Bekr Muhammed Es Serahsij, El Mabsut (Aman-Jordani, Bejt El Efkar Ed Devlije, 2009), 1\345

Ndërsa hadithin e evidenton Tirmidhiu, në “Es Sunen” me numër 715.

Muhammed bin Isa Et Tirmidhij, El Xhami' El Kebir (Bejrut, Dar El Garb El Islami, 1998), 2\86.



Opinionii juridik islam për të justifikuar prishjen e agjërimit për gruan shtatzënë dhe gjdhënësen është i pranuar unanimisht nga të gjithë dijetarët e të gjitha shkollave juridike islame.

### Plaku i shtyrë në moshë

Nëse dikush ka rritur në moshë të shtyrë pra në pleqëri të thyer, qoftë burrë apo grua, lirohen nga agjërimi i Ramazanit në tërësi. Zoti i Madhërishëm në pjesën vijuese të ajetit që përjashtoi të sëmurin dhe udhëtarin nga obligueshmëria e agjërimit tha: “... *E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër...*”. *El Bekare, 184*. Ibën Abbasi, r.a., duke komentuar këtë pjesë të ajetit theksonte se: “Kjo nuk është normë e abroguar (anuluar) juridikisht, por ka të bëjë me plakun e shtyrë në moshë dhe plakën e shtyrë në moshë të cilët nuk kanë mundësi që të agjërojnë, prandaj ata për çdo ditë e kanë prishur bëjnë kompensimin material me anë të fidjes-shujtë ditore për të varfrit”<sup>9</sup>.

Allahu i Lartmadhërishëm ka hequr dilemat, për rastet e tilla për mosngarkesë me detyra që s’mund të përballohet nga kategori të caktuara kur ka thënë: “... (*Allahu*) *nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi...*”. *El Haxh, 78*.

### Kompensimi i ditëve të prishura nga kategoritë e larttheksuara

Nëse i sëmuri që e ka prishur agjërimit, vuan nga ndonjë sëmundje kaluese e jo kronike, por edhe gratë që kanë kaluar periudhën e shtatzënisë së tyre apo të gjdhënies, që të gjithë këta obligohen që të agjërojnë pas Ramazanit aq ditë sa i kanë prishur gjatë Ramazanit.

Thënë qartazi, për aq kohë sa kategoritë e tilla mund të kompensojnë agjërimit e prishur me arsye, me agjërimit të ditëve tjera, ata ngarkohen me agjërimit, e nuk lejohet që të shpaguajnë a të kompensojnë ato ditë të paagjëruara me *fidje*-shpagim material. Këtë mendim e mbështesin hane-

<sup>9</sup> Vehbi Sulejman Gavocqi, Erkan El Islam (Bejrut: Dar El Beshair El Islamijje, 2002), 2\645.

fitët, pastaj Ata bin Ebi Rebah, Hasen El Basriu, Nah'au, Seid bin Xhubejri, Imam Zuhriu, Rebia bin Abdurrahman, Evzaiu, Imam Suffjen Eth Theuriu, Ebu Ubejde, Ebu Thevri dhe është njëri prej dy mendimeve të Imam Shafiut.<sup>10</sup>

Kompensimin e ditëve mund ta bëjnë në cilëndo kohë e cilëndo stinë. Madje as nuk detyrohen që të bëjnë kompensimin e ditëve radhazi, edhe nëse ato ditë të paagjëruara kanë qenë të prishura radhazi.

### **Shpagimi me *fidje* për të shtyrin në moshë dhe atë që vuan nga sëmundjet e rënda kronike**

Kur Zoti i Madhërishtëm zbriti: “... *E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër...*”. *El Bekare, 184*, Ibën Abbasi e Seid bin Xhubejri e shumë komentues të tjerë të Kuranit thoshin se ajeti bën fjalë për plakun e shtyrë në moshë dhe atë të sëmurin që nuk shpresohet shërimi i tij sepse vuan nga ndonjë sëmundje kronike.

Pra, i moshuari i cili nuk shpreson në ditë më të mira në jetën e tij, dhe i cili ndien ngarkesë të rëndë nga agjërimi i Ramazanit është i liruar nga ai me tekst të ajetit të lartshënuar.

Po kështu qëndron çështja edhe me të sëmurin që vuan nga ndonjë sëmundje kronike e që nuk e përballon dot agjërimin, as ky nuk ngarkohet me agjërim.

E meqenëse asnjëri prej këtyre dy kategorive të fundit nuk shpresojnë në ditë më të mira e as përmirësim të gjendjes së tyre shëndetësore, për të kompensuar atë që u ka humbur nga mos agjërimi, Allahu e bëri detyrë për ta shpagimin material me *fidje*.

*Fidjeja* nënkupton pagesën e një ushqimi ditor për një të varfër nga mesatarja e ushqimit të atij vendi ku jetojnë personat e liruar nga agjërimi. Pastaj mbetet krejt teknike çështja se a do të ushqejë 30 të varfër për 30 ditë të prishura apo do t'i jap për të gjitha ditët e prishura pra 30 shujta

<sup>10</sup> Shih: Grup Autorësh, *El Meusuatu El Fikhijje El Kuvejtijje* (Kuvajt: Viyaret El Evkaf El Kuvejtijje, 1427 lunar), 32. 70!

ditore një të varfëri të vetëm. Krejt kjo mbetet në zgjedhjen e personit që e paguan atë *fidje*.

Në kuptim të kompetencës fetare, por edhe të lehtësimit për besimtarët, këto përcaktime të vlerës së *fidjes*, po edhe të shpërndarjes së saj te kategoritë e denja te ne, për këtë detyrë mbetet Bashkësia Islame e Kosovës, si institucion përfaqësues dhe mbikëqyrës i jetës fetare në vendin tonë.

Mirëpo, duhet theksuar se nuk mjafton vetëm një shujtë brenda ditës të paguhet, sepse me një shujtë nuk mjaftohet asnjë njeri sot, por detyrë është të mbulohen dy shujta me aq sa mjaftohet secili njeri në rrethana normale. E nëse as pagesën e shujtës nuk e ka në mundësi, atëherë lirohet nga çdo obligim sepse : **“Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta...”**. *El Bekare, 286*.<sup>11</sup>

E nëse ai që ka bërë shpagimin e agjërimit për shkak të sëmundjes të cilën e ka menduar se është kronike, por pastaj është shëruar, hanefinjte këmbëngulin se i tilli obligohet që të agjërojë ditët e prishura sepse tani është i mundshëm kompensimi i agjërimit me agjërim dhe kjo është më parimore, sepse parimisht ajeti këtë edhe e thotë: **“... e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë...”**, *El Bekare, 184*.<sup>12</sup>

### Rezultatet dhe konkluzat

Pas hulumtimit të më sipër rreth sëmundjes si arsye justifikuese e prishjes së agjërimit mund të sjellim për fund edhe këto konkluzat:

- Allahu i Plotëfuqishëm është i Mëshirshëm me robërit e Tij dhe në detyrat me të cilat Ai na ngarkoi nuk kërkoi nga ne të pamundurën.
- Agjërimi edhe nëse disi duket një obligim rëndues, megjithatë me të nuk ngarkohen vetëm se njerëzit që mund ta përballojnë atë, e

<sup>11</sup> Shih: Vehbi Sulejman Gavocqi, Erkan El Islam (Bejrut: Dar El Beshair El Islamijje, 2002), 2\645!

<sup>12</sup> Po aty, f. 656.

- shkarkohen prej tij të sëmurët dhe ata që kanë probleme me shëndetin e tyre, por jo vetëm.
- Sëmundja është përmendur tekstualisht, bashkë me udhëtimin në ajet kuranor si arsye që justifikon prishjen e agjërimit.
  - Ka edhe arsye të tjera që justifikojnë prishjen e agjërimit, por trajtesa jonë kishte në fokus vetëm sëmundjen dhe implikimet e saj.
  - Jo çdo sëmundje sipas mendimit më të saktë të dijetarëve është arsye që justifikon prishjen e agjërimit, por ajo duhet të jetë e tillë që agjërimi personit të tillë do t'ia përkeqësonte gjendjen, do t'ia shtonnte dhimbjen ose do t'ia vononte shërimin.
  - Edhe gruaja shtatzënë, gjidhënëse dhe plaku i shtyrë në moshë, që të gjithë këta marrin tretmanin e të sëmurit në sensin e lirimit nga obligimi i agjërimit.
  - Ata ose ato që kanë prishur agjërimin për shkak të sëmundjes, shtatzënisë, gjidhënies detyrohen vetëm me kompensim të atyre ditëve të prishura pas Ramazanit, në cilëndo kohë e stinë.
  - Plaku i shtyrë në moshë dhe i sëmuri kronik që nuk shpresohet shërimi i tyre, mjaftohen me pagesë të masës së shpagesës-*fidje*, që konsiston në ushqimin ditor prej dy shujtave për një të varfër, për secilën ditë të paagjëruar. Pra tridhjetë ditë të ushqehet nga një i varfër, ose t'i jepet një të varfëri për tridhjetë ditë nga ai që nuk ka agjëruar asnjë ditë të Ramazanit.
  - Në çdo konstatim të sëmundjeve duhet pasur parasysh se opinioni i mjekut profesionalist e i besueshëm ka vlerë kruciale për t'iu toleruar dikujt prishja ose jo e agjërimit.

---

**Literatura e përdorur:**

- Kurani Fisnik
- Ebi Mes'ud El Kasanij, Bedai Es Sanai' Fi Tertib Esh Sherai' (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmijje, 1987).
- Ebu Bekr El Xhessas, Ahkam El Kuran, (Bejrut: Dar El Fikr, 2014).
- Fah'r Err Rrazii, Et Tefsir El Kebir (Bejrut: Dar Ihja Et Turath El Islamij, 2001).
- Imam Ebu Bekr Muhammed Es Serahsij, El Mebsut (Aman-Jordani, Bejt El Efkar Ed Devlijje, 2009).
- Muhammed bin Isa Et Tirmidhij, El Xhami' El Kebir (Bejrut, Dar El Garb El Islamij, 1998).
- Muhammed El Kurtubij, El Xhami' Li Ahkam El Kuran (Bejrut: Dar El Kitab El Arabij, 2003).
- Muhammed Tahir bin Ashur, Et Tahrir ve Et Tenvir (Tunis: Daru Sahnun, 1997).
- Sejjid Sabik, Fikh Es Sunneh (Damask: Daru Ibën Kethir, 2002).
- Grup Autorësh, El Meusuatu El Fikhijje El Kuvejtijje (Kuvajt: Viyaret El Evkaf El Kuvejtijje, 1427 lunar).
- Vehbi Sulejman Gavoqi, Erkan El Islam (Bejrut: Dar El Beshair El Islamijje, 2002).
- Zejnuddin bin Nuxhejm El Hanefij, El Bahru Err Rraik Sherh Kenz Ed Dekaik (Bejrut: *Daru El Kitub El Ilmijje*, 1997).

Mr. Driton ARIFI

## **DISEASE – A JUSTIFIABLE REASON FOR BREAKING FAST**

### **Abstract**

Fasting is a physical act of worship, which by nature aims at depriving the body of food and drink from early morning until sunset. Due to this, a sick person cannot fast, as his body does not perform its functions in the intended form. Therefore, the Omniscient Legislator in the Noble Qur'an relieved the sick person from this duty, and removed from his shoulders, at least until more favorable circumstances, the obligation of fasting. If a person was not expected to get better, a material compensation to heal his wounded aspiration for fasting was found by legalizing the *fidya*.

According to Islamic scholars and their interpretations of Qur'anic and prophetic quotes, if a person suffers from a disease that may worsen due to fasting, prolong its healing, or cause great pain, then they are not obliged to fast. Furthermore, in circumstances when fasting can endanger their lives, the latter are prohibited from fasting. Allah does not burden more than one can bear and this is the principle upon which Islamic tasks and obligations are built, without exception.

**Keywords:** *fasting, medication, fidya, justification, ruh'sah, azimeh...*



Dr. Ejup HAZIRI

## TRAJTESË FIKHORE RRETH SADAKASË SË FITRIT

### **Abstrakt:**

Sadakaja e Fitrit është një obligim që përkon me muajin e bekuar Ramazan, e që në fakt është Ramazani ai që e vë në pah këtë obligim. Ai është një obligim i çmuar, me vlerë të madhe dhe rëndësi të posaçme.

Si obligim e ka kohën e vet se kur duhet dhënë apo se kush është më meritori për mbledhjen dhe tubimin e saj. Përveç kësaj, është e qartë, sipas teksteve kuranore, edhe se kujt duhet dedikuar, ngase janë të përcaktuara kategoritë përfituese, dhe nuk na lejohet të dalim jashtë tyre.

Zekati në përgjithësi dhe Sadakaja e Fitrit në veçanti, në kohën e shpalljes kishin tjetër tretman, për dallim nga koha aktuale, kur individë, organizata e shoqata të ndryshme, e ndonjëherë edhe të panjohura, apelojnë te besimtarët që fondet e Zekatit dhe të Sadakasë së Fitrit t'i adresojnë tek ata, për dallim nga koha e shpalljes, kur këto burime mblidheshin dhe tuboheshin në arkën e shtetit (Bejtul Mal), dhe ishte i Dërguari i Allahut, a.s., ai që i përcaktonte përfituesit realë të Zekatit dhe të Sadakasë së Fitrit. Ai gjithashtu kishte përcaktuar edhe individët që e bënë tubimin dhe grumbullimin e këtyre fondeve të rëndësishme.

Përveç kësaj, ai nuk u jepte, qoftë nga Zekati apo edhe nga Sadakaja e Fitrit, secilit që kërkonte të ishte përfitues, mirëpo e ndante sipas ndarjes që kishte përcaktuar Allahu i Madhërishtëm, ngase edhe te ndarja ka ndalesa; jo çdokush që paraqitet edhe duhet të



përfitojë! Për këto gjëra, dhe sigurisht edhe për gjëra të tjera, do të flitet brenda këtij punimi.

**Fjalët çelës:** *Sadakaja e Fitrit, zekati, lëmosha, fondacionet, grupet përfituese.*

## ÇKA ËSHTË SADAKAJA E FITRIT?

Sadakaja e Fitrit është një obligim që ndërlidhet me personat, e jo me pasurinë, për dallim nga Zekati, që obligimi i tij është i kushtëzuar me pasuritë e ndryshme. Sadakanë e Fitrit e kushtëzon muaji Ramazan, i cili nuk ka të bëjë me kuotën e pasurisë (nisabin), e as me plotësimin e disa kushteve, kushte që domosdo kërkojnë te Zekati.

Ndonëse i përket kategorisë së Zekatit, Sadakaja e Fitrit është më e veçantë dhe e lidhur ngushtë me muajin Ramazan, sepse nuk jepet para Ramazanit, e as pas tij, për dallim nga Zekati apo sadakatë e përgjithshme, që nuk kanë muaj specifik për t'u realizuar.

### Norma e Sadakasë së Fitrit

Sadakaja e Fitrit është bërë obligim në vitin e dytë hixhrij, në po të njëjtin vit në të cilin është bërë obligim edhe agjërimi i Ramazanit. Kjo është bërë obligim si pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota dhe të këqija, po edhe si ushqim për të varfrit.

Sadakaja e Fitrit është obligim (vaxhib), dhe duhet të jepet gjatë Ramazanit, gjegjësisht para faljes së namazit të Bajramit. I Dërguari i Allahut tha:

عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ قَالَ فَرَضَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ زَكَاةَ الْفِطْرِ طُهْرَةً لِلصَّائِمِ مِنَ اللُّغْوِ وَالرَّفَثِ وَطُعْمَةً لِلْمَسَاكِينِ مَنْ أَدَّاهَا قَبْلَ الصَّلَاةِ فَهِيَ زَكَاةٌ مَقْبُولَةٌ وَمَنْ أَدَّاهَا بَعْدَ الصَّلَاةِ فَهِيَ صَدَقَةٌ مِنَ الصَّدَقَاتِ.

*“Ibën Abbasi thotë: “Pejgamberi e obligoi Sadakanë e Fitrit si pastrim për agjëruesit nga fjalët e këqija dhe mëkatet, dhe si ushqim për të varfrit. Kush e jep Sadakanë e Fitrit para namazit të*

*Bajramit, ajo është sadaka e pranuar, ndërsa kush e jep pas namazit të Bajramit, ajo mbetet sadaka e rëndomtë.”<sup>1</sup>*

### **Koha kur jepet Sadakaja e Fitrit dhe kush duhet dhënë?**

Sadakaja e Fitrit është pastrim për agjëruesin nga shkarjet dhe gabimet e vogla, si dhe ushqim për të varfrin. Kush e jep Sadakanë e Fitrit para namazit të Bajramit, është zekat i pranuar tek Allahu, e ai që e jep atë pas namazit të Bajramit, ajo konsiderohet lëmoshë nga lëmoshat e zakonshme.

Dhënia e Sadakasë së Fitrit është obligim për secilin anëtar, të mosshuar apo të ri, madje dhe për fëmijët. Sadakanë e Fitrit është i obliguar ta japë çdo mysliman i lirë, mashkull apo femër, i madh apo i vogël, i shëndoshë mendërisht apo jo i shëndoshë, nëse pasuria e tij është mbi nevojat elementare të jetës së përditshme.

### **Qëllimet e Sadakasë së Fitrit**

Qëllimet e Sadakasë së Fitrit më së miri shpjegohen përmes hadithit të Ibën Abbasit, në të cilin thuhet: “*Pejgamberi, a.s., e obligoi Sadakanë e Fitrit si pastrim për agjëruesit nga fjalët e këqija dhe mëkatet, dhe si ushqim për të varfrit...*”<sup>2</sup>. Kjo nënkupton se qëllimi nga Sadakaja e Fitrit është dhënia e secilit që ka mundësi, në mënyrë që kjo ndihmë sado simbolike që është, të jetë pastrim për agjëruesin nga fjalët e këqija, thashethemet, gabimet e mundshme gjatë ditëve të agjërimit, prej të cilave njeriu ndonjëherë edhe mund të bjerë në to e të bëjë ndonjë shkelje. Prandaj, dhënia e Sadakasë së Fitrit e pastron agjëruesin nga fjalët e pahijshme dhe veprat e këqija. Këtë e konfirmon edhe Kurani, ku thuhet:

﴿ ۱۰۳ ﴾... خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا

*“Merr nga pasuria e tyre (e atyre që e pranuan gabimin) lëmoshë që t’i pastros me të dhe t’ua shtosh (të mirat)...” (Et Tevbe: 103)*

<sup>1</sup> Ebu Davudi në Sunen, nr. 1609; Ibën Maxheh në Sunen, nr. 1827.

<sup>2</sup> Ebu Davudi në Sunen, nr. 1609; Ibën Maxheh në Sunen, nr. 1827.

E pamundur është që njeriu mos të flasë për dikë keq dhe mos ta përgojojë dikë, apo mos të lëshohet tepër në të folur, dhe si rrjedhojë e kësaj edhe mos të gabojë. Prandaj, në këtë kontekst vjen Sadakaja e Fitrit, për ta pastruar njeriun nga ato veprime, për ta plotësuar atë që e ka filluar dhe për ta shpërblyer agjëruesin.

Përveç kësaj, prej qëllimeve të Sadakasë së Fitrit është edhe ndihma ndaj njëri-tjetrit, e me theks të veçantë ndihma ndaj nevojtarëve dhe shtresës së varfër, të cilët kanë nevojë të ndihmohen e të përkrahën prej të tjerëve. Islami na mëson që t'u ndalim në ndihmë atyre që kanë nevojë, që sadopak t'ua lehtësojmë gjendjen e tyre të rëndë.

Myslimani kur ndihmon, qoftë nga Zekati apo nga Sadakaja e Fitrit, apo edhe nga lëmoshat e përgjithshme, e falënderon Krijuesin e vet për këtë begatitë e mëdha që ia ka dhënë. Gjithashtu e falënderon Allahun edhe për plotësimin e agjërimit, sepse po mos të ishte ndihma e Allahut, sigurisht se njeriu s'do të mundej ta plotësonte një gjë të tillë!

### Përfituesit nga Sadakaja e Fitrit

Zekati apo Sadakaja e Fitrit u takon këtyre tetë kategorive, e të cilat i ka përmendur Allahu i Lartëmadhëruar në Librin e Tij:

إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ  
وَالْغَارِمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ وَابْنِ السَّبِيلِ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٦٠﴾

*“Allahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’u takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfituar zemrat (të dobtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve) në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Allahu e di gjendjen e robërve, punon sipas Urtësisë së Vet.” (Et Tevbe: 60).*

Nga ajeti kuranor dalin tetë kategori që kanë të drejtë të përftojnë nga Sadakaja e Fitrit apo Zekati.<sup>3</sup> Këto kategori nuk mund të anulohen, dhe as që mund t'i shuajë dikush. Ato mund të paraqiten në çdo vend dhe kohë. Për përparësinë e një kategorie mbi tjetrën duhet të kujdeset pushteti islam kompetent. Në shtetet islame këtë e bën qeveria, kurse atje ku nuk ka qeveri, është kompetente përfaqësia e veprimtarisë fetare islame, e cila edhe është përgjegjëse për jetën fetare islame në mjedisin përkatës, sepse ajo është bartëse e drejtpërdrejtë e prerogativave të halifes.<sup>4</sup>

Gjithsesi, nuk lejohet që Sadakaja e Fitrit të distribuohet jashtë këtyre tetë kategorive që përfshin ajeti kuranor, dhe këtë e dëshmon edhe hadithi në vijim: Ebu Davudi transmeton prej Zijad bin El Harith Esadaj, i cili thotë: *“Pranë të Dërguarit të Allahut shkova dhe ia dhashë besën (besatimin)..., ndërkohë erdhi një njeri dhe i tha të Dërguarit të Allahut: “Më jep mua sadaka!”*. I Dërguari i Allahut iu përgjigj: *“Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur me vendimin e të Dërguarit të Tij e as të dikujt tjetër në çështjen e ndarjes së sadakasë, derisa Ai e bëri Vetë, prandaj Ai ka gjykuar me ndarjen e sadakasë në tetë grupe, e nëse ti je në njërin prej këtyre grupeve, do të ta japim ty të drejtën tënde që e meriton.”*<sup>5</sup>.

### Kujt nuk i jepet Sadakaja e Fitrit?

Sa u përket kategorive që nuk mund të jenë nën umbrellën përfituese të Sadakasë së Fitrit, mund të themi se për disa prej tyre dijetarët janë dakorduar, e për disa tjera nuk janë të një mendimi. Nga kategoritë që nuk u jepet Zekati e as Sadakaja e Fitrit, janë: jobesimtarët, ateistët, armiqtë luftës ndaj Islamit, të pasurit, të fuqishmit me potencial pune, të afërmit, sikurse djali për babanë, apo anasjelltas, pastaj bashkëshorti për bashkëshorten, dhe anasjelltas, për fisin Benu Hashim apo për pasardhësit e Pejgamberit, a.s. etj.

<sup>3</sup> Kategoritë përfituese që i përmend ajeti, me të synohet si Zekati ashtu edhe Sadakaja e Fitrit, prandaj edhe nëse e përmendim termin zekat, me të nënkuptohet edhe Sadakaja e Fitrit.

<sup>4</sup> Grup autorësh, *Zeqati dhe Sadekatul Fitri*, Prishtinë, 1994, f. 33.

<sup>5</sup> Ebu Davudi në Sunen.

## Politeistët, ateistët dhe luftuesit e Islamit

Dijetarët myslimanë janë thujtë të një mendimi se politeistëve, ateistëve dhe atyre që e luftojnë islamin, nuk u jepet asgjë nga Sadakaja e Fitrit, e as nga Zekati. Konsensusi i tyre gjën mbështetje te fjalët e Allahut të Lartësuar, ku thuhet: *“Allahu ua ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën nga shtëpitë tuaja dhe që e ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes.”* (El Mumteheh, 9).

Sigurisht se një individ të tillë nuk i jepet asgjë nga Sadakaja e Fitrit, sepse ai e lufton Islamin dhe myslimanët, prandaj edhe dhënia atij do të nënkuptonte përkrahje ndaj tij karshi dëmit të Islamit dhe myslimanëve. Për këto kategori të përmendura këtu dijetarët janë të një mendimi, dhe nuk përcillet që ndokush të ketë kundërshtuar. Përjashtim bën nëse është për përfitimin e zemrave të tyre, siç mund të jenë njerëz me besim luhatur, të ri në të Islam, jobesimtarë, për parandalimin e të keqes, udhëheqës që përmes tyre mund të ndikohen të tjerët, njerëz me influencë dhe ndikim, njerëz që jetojnë në zonat kufitare me myslimanët, duke i stimuluar ata që ta mbrojnë kufirin prej jobesimtarëve dhe mos t’u shkaktojnë të këqija myslimanëve.<sup>6</sup>

Pra, ky ishte përjashtimi, përndryshe jomyslimanëve nuk u jepet asgjë nga Zekati apo Sadakaja e Fitrit, ngase ato merren prej të pasurve myslimanë, dhe dedikohen për të varfrit myslimanë. E, në këtë kontekst nuk merret te jomyslimanët, ashtu siç nuk mund të dhurohet për ta, me përjashtim të asaj që e cituam më sipër.

I Dërguari i Allahut, kur e kishte dërguar Muadhin në Jemen, e kishte porositur që banorëve jemenas t’ua bënte me dije se të pasurit e tyre duhet nxjerrë zekat për të varfrit e tyre. Juristët myslimanë, duke e komentuar rastin e Muadhit, kanë potencuar se të pasurit përfshijn myslimanët, ashtu siç të varfrit e tyre që i përfshijn vetëm myslimanët.

Ndërsa për sadaka-ndihma vullnetare, atëherë dijetarët myslimanë kanë potencuar se lejohet dhënia edhe për jobesimtarë. Në këtë kontekst

<sup>6</sup> Sabik, Sejid, *Fikhu’s Suneh*, vëll. I, f. 447-448.

Imam Shafi'u thotë: *“Nuk ka asgjë të keqe që jobesimtarit t'i jepet nga sadakatë vullnetare, por jo ato obligative (sikurse Zekati e Sadakaja e Fitrit), ngase Allahu i ka lavdëruar ata që japin dhe u ndihmojnë të tjerëve<sup>7</sup>: “Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër.” (El Insan: 8).*

Ndonëse, për këtë çështje, gjegjësisht dhënien e Zekatit apo të Sadakasë së Fitrit për jomuslimanë, Ibën Mundhiri ka treguar se për këtë ka konsensus (ixhma); disa dijetarë, duke i pasur parasysh shumë elemente, kanë potencuar se Ithtarët e Librave mund të futen sidomos te dy grupet e para përfituese të Zekatit: të varfrit dhe të ngratët. Prej Ibën Ebi Shejbes transmetohet në Musanefin e tij, se Omeri për fjalët: *“Allahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t'u takojë vetëm: të varfërve (nevojtarëve)...” (Tevbe, 60)*, thoshte se i përfshin edhe të varfrit prej Ithtarëve të Librit. Ikreme e bënte dallimin mes fukarenjve-të varfërve dhe mesakin-të ngratëve, duke konstatuar se të varfrit janë prej muslimanëve, kurse të ngratët prej Ithtarëve të Librit.<sup>8</sup> Ebu Jusufi i kishte dhënë nga zekati i arkës shtetërore një plaku çifut, duke u bazuar pikërisht në ajetin e 60-të të kapitnës Tevbe, e më pas kishte thënë: *“E ky është prej të ngratëve-mesakinëve të Ithtarëve të Librit.”<sup>9</sup>*

Sidoqoftë, shumica e juristëve janë të mendimit se nuk lejohet dedikimi i Zekatit për jomuslimanë, duke u bazuar në hadithin e Muadhrit, ku i Dërguari i Allahut, a.s., e porositi atë: *“...lajmëroi ata se Allahu ua ka bërë detyrim zekatin për të pasurit, i cili u kthehet skamnorëve të tyre...”* (Buhariu, nr. 1458). Në këtë kontekst Ibën Kudame thotë: *“Nuk di që në mesin e dijetarëve të ketë mospajtim rreth zekatit të pasurisë që nuk i jepet jobesimtarit.”* (Mugni, vëll. II, f. 487). Neveviu, në veprën e tij kapitale “Sherh Muslim”, thotë: *“Zekati nuk jepet për jobesimtarin.”<sup>10</sup>*

<sup>7</sup> Shafi'u, *El Umm*, Darul Ma'rifeh, 1410-1990, vëll. II, f. 66.

<sup>8</sup> Taberiu, *Xhamiul Bejan fi Te'vilil Kur'an*, me recenzurë të Ahmed Shakirit. Muessesetur Rrisaletu, bot. I, 1420h-2000m, vëll XIV, f. 308.

<sup>9</sup> Ebu Jusuf, *El Haraxh*, bot.II, Tab'atu-s Selefijetu, f. 55.

<sup>10</sup> Sherh Muslim, vëll. I, f. 197.

Ndërsa, një pjesë tjetër e juristëve, sikurse Zuhriu, Ibën Sirini dhe Zuhri, duke u bazuar në ajetin e 60-të të kaptinës Tevbe, pastaj në këtë ajet: **“Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, e nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju, dhe Ai ua largon (me punë të mira) të këqijat. Allahu është i informuar hollësisht për veprat tuaja.”** (El Bekare: 271), dhe në disa *athare*, mendojnë se lejohet edhe dedikimi për jomyslimanë, respektivisht për Ithtarët e Librit, me kusht që të jenë nevojtare dhe që mos të dëmtohen myslimanët.

Nga e tëra kjo mund të konstatohet se për politeistin, ateistin dhe ata që e luftojnë islamit dhe myslimanët nuk jepet asgjë, as nga Zekati, si dhe as nga Sadakaja e Fitrit, ndërsa për jomyslimanët e Ithtarëve të Librit ka divergjenca në mesin e juristëve myslimanë. Në këtë kontekst Jusuf Kardavi, pasi i përmend argumentet e të dy palëve dhe e bën një balancim mes argumenteve të tyre, thotë: “Baza apo esenca (në këtë çështje) është ajo se Zekati në rend të parë duhet t’u jepet të varfërve myslimanë, ngase Zekati është obligim i domosdoshëm për të pasurit e myslimanëve, mirëpo nuk ka ndonjë ndalesë që një pjesë nga Zekati t’i jepet edhe *dhimmiut*, nëse me dhënien e tij nuk dëmtohen myslimanët e varfër, duke u bazuar në ajetin e përmendur më sipër, e që është në formë të përgjithshme edhe në veprimin e Omerit dhe në mendimet e disa juristëve, e kjo është maja më e lartë e tolerancës që para Islamit askush nuk është ngritur.”<sup>11</sup>.

Sigurisht se mendimi i parë gjen mbështetje më të madhe te juristët myslimanë, dhe shihet si mendim i preferuar dhe i përzgjedhur, e mendimin e dytë e përfaqësojnë shumë pak juristë dhe, ndonëse nganjëherë, sipas disa transmetimeve, është bërë dedikimi i Zekatit edhe për jomyslimanët, respektivisht *ehludhimh*, praktika retrospektive gjatë historisë islame ka dëshmuar se ndarja e Zekatit është e drejtë ekskluzive që merret te myslimanët e pasur dhe shpërndahet te myslimanët e varfër. Mirëpo, ndoshta edhe dedikimi i Zekatit për jomyslimanët ka ardhur si pasojë e mungesës së pranimit nga ana e myslimanëve, për shkak të panevojshmërisë së tyre për një gjë të tillë, ashtu siç transmetohet edhe nga koha

<sup>11</sup> Kardavi, Jusuf, *Fikhu 'z Zekah*, vëll. II, f. 707-708.

e Omer bin Abdulazizit, kur gjatë sundimit të tij nuk kishte njerëz që e pranonin Zekatin, jo nga fakti se e shihnin veten të turpëruar për ta pranuar një gjë të tillë, por në realitet nuk kishin nevojë për të. Në këtë kontekst Jahja bin Seid thotë: *“Omer bin Abdulazizi më dërgoi për shpërndarjen e Zekatit dhe sadakasë në rajonet e Afrikës. Unë e tubova pasurinë dhe kërkova të varfër që t’ua jepja atë, mirëpo nuk gjetëm asnjë të varfër. Nuk gjenim ndokënd ta merrte, ngase Omer bin Abdulazizi i kishte pasuruar njerëzit. Atëherë unë me tërë atë pasuri bleva robër, dhe i lirova që të gjithë ata.”*

### **Jomyslimani në territorin islam (dhimmiu)**

Juristët myslimanë e kanë trajtuar edhe çështjen e *ehludhimeh*<sup>12</sup>-jomyslimanëve që jetojnë në territorin islam, se a duhet t’u jepet atyre nga Zekati, apo jo, për shkak se ata kanë një tretman tjetër, jo vetëm për shkak të vendit ku jetojnë, por edhe për shkak se kanë pranuar të jetojnë në sistemin e vlerave të Islamit. Për këtë çështje juristët myslimanë e kanë këtë mendim: Nuk ka asgjë të keqe që myslimani t’ia dedikojë sadakata të vullnetare *dhimmiut*-jomyslimanit që jeton në territorin islam, ngase kjo do të ishte kujdes njerëzor dhe, pa marrë parasysh mosbesimin e tyre, nuk ndalohet që atyre t’u bëhet mirë, përderisa ata nuk e luftojnë Islamit<sup>13</sup>, ashtu siç ka porositur Allahu: *“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan nga shtëpitë tuaja. Allahu i do ata që e mbajnë drejtësinë.”* (*El Mumteherineh*: 8).

Ky ajet, ka zbritur pas një ngushtimi shpirtëror të myslimanëve ndaj pjesës së tyre familjare që ishin jobesimtarë, eAllahu i Lartësuar ua lejon atyre që t’u bëjnë mirë atyre që nuk i luftuan dhe as që i dëbuan nga shtëpitë e tyre. Esmā, e bija e Ebu Bekrit, tregon se nëna e saj kishte ardhur dhe kishte kërkuar ndihmë prej saj, prandaj ajo kërkoi sqarimtake i Dër-

<sup>12</sup> Ehludhimeh janë jomyslimanët (përkatësisht ithtarët e librit), të cilët jetojnë brenda territorit islam dhe e kanë pranuar sundimin e udhëheqësit të myslimanëve. Këta janë nën përkujdesjen e shtetit islam.

<sup>13</sup> Kardavi, *Fikhu’z Zekah*, vëll. II, f. 703.



guari i Allahut, se çfarë të vepronte. I Dërguari i Allahut e porositi Esman që të mbajë lidhje me nënën e saj, ndonëse ajo ishte ende jobesimtare. (Buhariu, nr. 2946).

Imam Zuferi, prej hanefinjve, është i mendimit se lejohet dhënia e Zekatit për *dhimmiun* që jeton brenda territorit islam dhe që është nën mbrojtjen e shtetit islam, me kusht që mos të jetë prej atyre që e luftojnë Islamin. Ndërsa, sa i përket Sadakasë së Fitrit, Ebu Hanife dhe nxënësi i tij Muhamedi janë të mendimit se lejohet dedikimi i Sadakasë së Fitrit edhe për *dhimmiun*, duke u bazuar në argumentet e ndryshme që kanë ardhur në formë të përgjithshme, sikurse, për shembull: **“Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, e nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju, dhe Ai ua largon (me punë të mira) të këqijat. Allahu është i informuar hollësisht për veprat tuaja.”** (El Bekare: 271). Ebu Hanife dhe Muhamedi e arsyetojnë mendimin e tyre me faktin se Allahu i Madhërishëm nuk ka bërë ndonjë dallim mes një të varfri dhe një tjetri, por teksti kuranor i cituar sipër ka ardhur në mënyrë të përgjithshme. Mirëpo, Ebu Hanife e ka kushtëzuar që nëse Sadakaja e Fitrit i dedikohet *dhimmiut*, duhet që mos të jetë ai person armik i Islamit dhe person që e lufton Islamin, përndryshe nuk duhet t’i jepet atij asgjë nga Sadakaja e Fitrit. Megjithatë, sikurse Ebu Hanife, ashtu edhe Muhamedi dhe disa juristë tjerë që e kanë lejuar Sadakanë e Fitrit për *dhimmiun*, janë të mendimit se më e vlefshme është dedikimi i Sadakasë së Fitrit për myslimanët nevojtarë, sesa për *dhimmiun*.<sup>14</sup> Myslimani gjithnjë vjen në rend të parë, prandaj edhe lejimi që këta juristë kanë paraparë nuk nënkupton që të anashkalohet myslimani e sadakaja t’i dedikohet *dhimmiut*. Përkundrazi, së pari duhet të ndihmohet myslimani, e pastaj të ndihmohen edhe të tjerët që jetojnë brenda territorit islam. Edhe këta të fundit janë pjesë e shtetit islam, dhe Islami ka paraparë që ata mos të anashkalohen, por të trajtohen mirë dhe me drejtësi.

Kur themi se atyre nuk u takon asgjë nga Zekati, por nga sadakaja vullnetare, ndonëse ata jetojnë brenda territorit islam dhe e kanë pranuar

<sup>14</sup> Për këtë çështje shih më tepër veprën kapitale hanefite: *Bedaius-Sanaui fi tertibish-Sherai*, Alaudin Kasani, Sheriketul Matbuat El Ilmijetu, 1327, vëll. II, f. 49.

gjykimin e Islamit, kjo nuk nënkupton që ata të lihen pa ndihmë, assesi, ngase shteti e ka obligim që përmes alternativave të tjera nga thesari i shtetit t'u dalë në ndihmë atyre dhe t'ua plotësojë kërkesat e tyre. Omer bin Abdulazizi, si udhëheqës i tërë myslimanëve, i kishte shkruar guvernatorit të Basrës, duke e porositur: *“Shikoje gjendjen e ehludhimeh-jo-muslimanëve që jetojnë në territorin islam, atyre që e kanë arritur moshën e shtyrë, që e kanë humbur fuqinë dhe që nuk kanë të ardhura, dhe cakto për ta një pagesë rrjedhëse nga pasuria e shtetit islam...!”*<sup>15</sup>.

### Të pasurit

E, përderisa të varfrit dhe të ngratët janë pjesëmarrës thuajse të paevitueshëm në pasurinë e Sadakasë së Fitrit (dhe Zekatit), për shkak të nevojave të tyre jetike, të pasurit përjashtohen nga kjo, ngase ata në realitet nuk kanë nevojë për një gjë të tillë dhe nuk mund të futen në asnjë mënyrë nën kategorinë përfituese të Zekatit dhe Sadakasë së Fitrit. Kjo mund të dëshmohet edhe me tekste të prera, siç është hadithi i Muadhrit, ku i Dërguari i Allahut, a.s., e kishte porositur atë me fjalët: *“...lajmëroi ata se Allahu ua ka bërë detyrim Zekatin për të pasurit, i cili u kthehet skamnorëve të tyre...”* (Buhariu, nr. 1458). Në një hadith tjetër thuhet: *“Nuk lejohet sadakaja për të pasurin.”*<sup>16</sup>.

Po të jepej Zekati apo Sadakaja e Fitrit për të pasurit, atëherë do të humbte edhe urtësia e tyre, sepse përmes tyre arrihet një lloj baraspeshe mes shtresave të ndryshme në furnizime. Kështu, të varfrit dhe skamnorët nuk mbesin në gjendjen e tyre të mjerueshme, por statusi i tyre ndryshon, e kjo i kontribuon luftimit të varfërisë dhe eliminimit të saj.

Zekati dhe Sadakaja e Fitrit është një ndihmë modeste ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, e që u ndihmon dhe u kontribuon atyre për kushte më të mira jetësore, dhe kjo do të kontribuonte në ruajtjen edhe të shoqërisë nga sëmundja e varfërisë, sikurse edhe në ruajtjen e shtetit nga degradimi e dobësia.

<sup>15</sup> Ebu Ubejd, *El Emval*, f. 46. Cituar sipas Kardavi, *Fikhu'z Zekah*, vëll. II, f. 708.

<sup>16</sup> Transmetojnë të gjithë me përjashtim të Ibën Maxhes dhe Nesaiut.

Për aq sa të pasurit e japin atë, atëherë kjo do të nënkuptonte se ata kujdesen për të varfrit e shoqërisë së tyre. Në të kundërtën, barrierat mes shtresave të njerëzve do të thelloheshin dhe nuk do të eliminoheshin.

Juristët e shkollës juridike hanefite janë të mendimit se ata që e tubojnë-e mbledhin zekatin dhe Sadakanë e Fitrit, edhe po që se janë të pasur, atyre u takon hisja, gjegjësisht shpërblimi, për shkak se në lidhje me ta ka ardhur teksti që e konfirmon pjesën e zekatit ndaj tyre. Gjithashtu ata mbledhjen e Zekatit dhe të Sadakasë së Fitrit e kanë si punë që kompensohen për të, gjegjësisht marrin pagë për mbledhjen e Zekatit. Po ashtu, sipas hanefinjve, mund të jepet Zekati edhe për përfitimin e zemrave, pa marrë parasysh se a janë të pasur, apo jo. E, kategoria e tillë, gjegjësisht për përfitimin e zemrave, mund të jenë nga radhët e myslimanëve, por edhe nga radhët e jomyslimanëve. Mirëpo, pas përhapjes së Islamit dhe forcimit të tij, atëherë një gjë e tillë është e panevojshme, dhe bie nga funksionimi.<sup>17</sup>

Ndonëse hadithi i Ata bin Jesarit që në fillim flet për ndalesën e sadakave, gjegjësisht Zekatit për të pasurit, në vazhdim flet për pesë përjashtime; për mbledhësin e tij, për njeriun e blerë, për borxhliun, luftëtarin në rrugën e Allahut dhe për sadakanë e dhënë të varfrit, që ai më pas ia dedikon atë një të pasuri. Ky hadith dhe disa hadithe të tjera që tekstualisht i përmendin vetëm dy apo tri grupe përjashtuese prej të pasurve, nuk janë kuptuar njëjtë prej të gjithë juristëve. Shafiinjët dhe një pjesë e madhe e juristëve e ndajnë mendimin se i Dërguari i Allahut në thëniet e tij i sqaroi, dhe sadakatë dhe Zekati nuk u dedikohen të pasurve, por më vonë bëri përjashtime nga thënia e tij për grupet e përmendura. Kurse, hanefinjët janë të mendimit se përjashtimi i bërë nuk nënkupton domosdo se ata janë të pasur, sikurse, për shembull, përmendja e luftëtarit në rrugën e Allahut, mirëpo me të nënkuptohet se ai dikur (më herët) ka qenë i pasur, në pronësi të shtëpisë, me familje, rroba të mjaftueshme dhe pasuri që i tejkalon dyqind dërrhem, mirëpo papritmas vendos të udhëtojë për luftën në rrugën e Allahut, dhe ai ka nevojë për mjetet e udhëtimit, armët, mje-

<sup>17</sup> Ibën Humam, Kemaludin Muhamed ibën Abdulvahid, *Fet'hul Kadir Sherhu'l Hida-jeh*, Matbeatu Mustafa Muhamed, Kajro-Egjipt, pa vit botimi, vëll II, f. 21.

tin e luftës, apo për ndonjë shërbëtor për përkujdesje. Të gjitha këto atij nuk i duhen në rast të qëndrimit në shtëpinë e tij, por i nevojiten në rast të udhëtimit për në luftë në rrugën e Allahut. Prandaj, atij i jepet sipas nevojës që e obligon udhëtimi dhe nevojat e luftës.<sup>18</sup> Hanefijnjtë bazohen edhe në dy hadithet e përmendur në fillim të kësaj teme, ku potencohet se Zekati merret prej të pasurve, dhe jepet për të varfrit, si dhe se nuk lejohet dedikimi i tij për njerëzit e pasur.

Këtu po flasim për sadakatë obligative, ngase sadakatë vullnetare s'ka dyshim se lejohen edhe për të pasurit, sepse nuk ka ndonjë ndalesë për to. Vetë fakti se ato janë vullnetare, lejohet dedikimi i tyre ndaj kujtdo, mirëpo më racionale dhe më parësore është dedikimi i tyre ndaj atyre që kanë nevojë për të, e jo të bëhen ato në vende ku janë të panevojshme, mirëpo, siç potencova edhe më sipër, nuk ka ndalesë edhe po që se bëhen për të pasurit, e të cilët realisht nuk kanë nevojë për një gjë të tillë.

### **Të fuqishmit për potencial pune**

Të fuqishmit me mundësi pune janë kategoria tjetër që nuk e meritojnë marrjen e Zekatit e as të Sadakasë së Fitrit, për shkak të potencialit të tyre për punë dhe mundësisë për fitim. Islami i inkurajon njerëzit që të punojnë dhe të angazhohen dhe që mos ta presin fitimin e tjetrit e as mos t'ua shtrijnë dorën të tjerëve për të pritur për mëshirën e tyre. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut, a.s., ka thënë: *“Nuk do të hajë ushqim më të mirë askush sesa ai që e fiton me dorën e vet. Pejgamberi i Zotit, Davudi, a.s., ka ngrënë vetëm nga ajo që e ka fituar me dorën e vet.”* (Buhariu, nr. 2072). Njeriu nuk duhet të bëhet jetë parazit, e të presë gjithnjë prej të tjerëve, por duhet të zbatojë metoda të ndryshme të përfitimit. Më i vlefshëm është fitimi që e bën njeriu vetë, sesa kur kërkon lëmoshën te të tjerët. Prej Ebu Hurejres transmetohet se si i Dërguari i Allahut kishte thënë: *“Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, më mirë është që ndonjëri prej jush ta marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru, sesa të*

<sup>18</sup> Zejlei, *Tebjinul Hakaik Sherh Kenzud Dekaik ve Hashijetu Shelebij*, bot. I, El Matbeatul Kubra El Emirijetu, Bulak-Kajro, 1313h, vëll. I, f. 302.

vijë e të kërkojë (lëmoshë) prej ndokujt, pavarësisht nëse i jep apo jo!” (Buhariu, nr 1377 dhe Maliku, nr. 1588). Në këtë kontekst është e rëndësishme të përmendet një ngjarje nga periudha e ndritshme e Omerit, të birit të Hatabit, ku gjersa kalonte pranë një rruge, e pa një të ri që e kishte shtrirë dorën dhe po kërkonte lëmoshë te njerëzit. I habitur nga gjesti i tij dhe i zemëruar tej mase, e mori kamxhikun dhe filloi ta godasë atë, e më pas i tha: “O djalosh, mos na e shëmto fenë!”. Mesazhi i Omerit nënkupton se të rinjtë me mundësi dhe potencial pune duhet të angazhohen e të punojnë, e jo të bredhin rrugëve duke kërkuar lëmoshë prej të tjerëve. Në këtë kontekst, disa prej malikinjve janë të mendimit se personi që ka mundësi të punojë, e që është i varfër, nuk i lejohet që dikush t’ia dedikojë Zekatin atij, për shkak se ai ka mundësi për punë, mirëpo është neglizhenti dhe nuk punon, ndonëse ka potencial dhe mundësi për të gjetur punë.<sup>19</sup> Ky mendim nuk mund të thuhet se është ekstrem. Madje tekstet fetare dhe rregullat e fesë qëndrojnë në të njëjtën vijë, për shkak se Islami, ashtu siç kam potencuar edhe më sipër, është fe që nxit dhe inkurajon punë dhe lufton fitimi duke i shtrirë duart në pritje të mëshirës së të tjerëve. Islami qartë porositi për angazhim dhe punë. Përmes gjuhës së të Dërguarit të Allahut u tha: “**Nuk lejohet sadakaja obligative (Zekati dhe Sadakaja e Fitrit) për të pasurin dhe për të fuqishmin me trup të shëndoshë (atë që ka mundësi të punojë).**”<sup>20</sup> Pra, personi që është i ri dhe ka potencial për punë, atij nuk i jepet Zekati e as Sadakaja e Fitrit, për arsye se ai ka mundësi të punojë e të angazhohet, sepse Islami e përkrah punën dhe angazhimin personal.

Në haxhin lamtumirës, dy persona shkuan tek i Dërguari i Allahut përderisa ai po e ndante sadakanë për njerëzit nevojtarë. Ata dy kërkuan pasuri prej tij, e i Dërguari i Allahut hodhi shikimin ndaj tyre, dhe kur i pa se ishin të rinj dhe të fuqishëm, atëherë u tha: “*Nëse dëshironi, mund t’u jap, mirëpo në sadaka (obligative) nuk ka hise i pasuri dhe as i fuqishmi që ka mundësi të fitojë.*” (Ebu Davudi, nr.1633).

<sup>19</sup> Dusuki, *Hashijetu’d Dusuki ale’sh Sherhi’l Kebir*, vëll. I, f. 1494.

<sup>20</sup> Transmetohet në të gjitha koleksionet.

I Dërguari i Allahut u dha mundësi atyre të zgjedhin, nëse dëshironin të merrnin zekat, apo mos të merrnin, e kjo nga fakti se ai nuk e dinte gjendjen e tyre, por fjalën e tha duke e parë pamjen e tyre të jashtme, që ishin të rinj dhe se kishin mundësi të punonin. Ndoshta pamja e jashtme tregon se ata janë të aftë për punë dhe me potencial, e në realitet mund të jenë të paaftë për fitim apo mund të fitojnë duke punuar, por që fitimi i tyre mos të jetë i mjaftueshëm për ta. Nga ky hadith dijetarët myslimanë kanë nxjerrë mësim dhe ka kanë konstatuar se udhëheqësit myslimanë, përkatësisht shpërndarësit e zekatit, duhet t'i këshillojnë ata që pranojnë ta marrin zekatin, në mënyrë që ta njohin gjendjen e tyre, ashtu që destinimi i Zekatit mos të bëhet për njerëz të pasur e me potencial pune, mirëpo të bëhet për ata që janë të varfër dhe që realisht kanë nevojë për një ndihmë të tillë. Në këtë mënyrë ata bëhen shembuj në pasimin e metodologjisë së të Dërguarit të Allahut.

Për të fuqishmin është bërë haram zekati ndaj tij, sepse prej tij kërkohet të punojë për vetveten, e jo të rrijë ulur e të presë lëmshë. Nëse nuk gjen punë, atëherë ai konsiderohet i justifikuar, dhe atij duhet t'i ndihmohet gjersa ta gjejë ndonjë punë.<sup>21</sup>

Në situata të ndryshme, kur papunësia është e lartë dhe njerëzit nuk mund të gjejnë punë, përveç rasteve të rralla, edhe të rinjve që kanë potencial për punë duhet t'u ndihmohet dhe ta tejkalojnë krizën e tyre, mirëpo që pas situatave të tilla ata duhet t'i përvishen punës dhe mos të presin gjithnjë prej të tjerëve. Po ashtu, edhe nëse punon, mirëpo paga që e merr nuk i mjafton për vete dhe për familjen e tij, atëherë, sipas juristëve myslimanë, nuk ka të keqe nëse merr nga Zekati për plotësimin e nevojave. Kjo për faktin se kërkesat janë më të mëdha sesa të ardhurat e tij, prandaj ai merr nga Zekati sipas nevojës që ka.

Përfundimisht, për atë me mundësi pune që i ndalohet zekati, është ai që duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Të gjejë punë nga e cila pret fitim.
2. Që ajo punë të jetë në suaza të lejimit legjitim, e jo të jetë ligjërisht e ndaluar.

<sup>21</sup> Kardavi, *Fikhu'z Zekah*, vëll. II, f. 700.

3. Që të ketë mundësi të punojë.<sup>22</sup>

4. Që të fitojë sipas nevojave të tij që kërkohen.<sup>23</sup>

Interesant është të përmendet edhe një gjë, kur jemi te personi që ka mundësi të punojë dhe që është i shëndoshë, e që ka të bëjë me atë që tërë kohën e tij ia ka dedikuar adhurimit, duke iu shmangur punës dhe angazhimit për fitim, ndonëse ka mundësi të gjej punë dhe të fitojë. Sigurisht se adhurimi kërkohet prej secilit besimtar, mirëpo njëkohësisht kërkohet edhe puna dhe fitimi, ngase edhe kjo konsiderohet adhurim. Ashtu siç është urdhëruar me adhurim, është urdhëruar edhe për punë dhe fitim, prandaj personit që i është dedikuar vetëm adhurimit, duke i lënë të gjitha gjërat e tjera, nuk i jepet asgjë nga Zekati, për shkak se ai nuk e ka kuptuar qëllimin e adhurimit, dhe nuk e ka kuptuar drejt misionin e tij në këtë jetë. Dihet botërisht se në Islam nuk ka murgëri, dhe se fitimi për jetesë konsiderohet adhurim, kurdo që kryhet, brenda kornizave islame dhe kur qëllimi është i pastër.

### **Afërsia familjare**

Afërsia familjare në kontekstin e dhënies dhe të pranimit të zekatit apo të Sadakasë së Fitrit është diskutuar shumë mes juristëve dhe është debatuar gjatë, dhe disa e ngushtojnë rrethin e afërsisë familjare, përderisa disa të tjerë i japin konotacion më të zgjeruar.

### **Fëmijët për prindër, dhe anasjelltas**

Çështja e prindërve dhe e fëmijëve në raport me dhënien dhe pranimin e zekatit, apo edhe të Sadakasë së Fitrit, mes tyre është një çështje që thuhet se dijetarët myslimanë nuk kanë divergjenca, me përjashtim të një numri të vogël të tyre, që edhe në këtë kontekst kanë bërë disa përjashtime.

Në parim nuk lejohet që fëmijët t'u japin zekat apo t'ua japin Sadakanë e Fitrit prindërve të tyre, gjyshit, gjyshes dhe më lart (nëse ekziston),

<sup>22</sup> Ngase nëse është i vjetër, fëmijë apo i sëmurë, i pamundësohet të punojë dhe të fitojë.

<sup>23</sup> Kardavi, *Fikhu'z Zekah*, vëll. II, f. 559.

sikurse që nuk u lejohet prindërve ta japin Sadakanë e Fitrit për fëmijët e tyre, vajza apo djem, e as nipit e mbesës. Imam Maliku në këtë kontekst thotë se gjyshërit dhe djemtë e djemve bëjnë përjashtime, dhe atyre u lejohet dhënia e zekatit dhe e Sadakasë së Fitrit, ndërsa Ibën Tejmija është i mendimit se i lejohet të birit dhënia e zekatit për prindër, nëse ai s'ka mundësi t'i mirëmbajë ata dhe të kujdeset për nevojat e tyre, gjersa për prindërit nuk ka ndonjë person që kujdeset.<sup>24</sup> Kjo vjen si pasojë kur ata janë të varfër, dhe ai që e ka për obligim t'i mirëmbajë ata e ka të pamundur një gjë të tillë. Prandaj, në pamundësi të mirëmbajtjes dhe kujdesit ndaj tyre, i lejohet, sipas tij, edhe Zekati. Ndonëse, Ibën Tejmije mendimin e tij ia adreson njërit nga dy mendimet e Imam Ahmedit në lidhje me këtë çështje.<sup>25</sup>

Kur themi se nuk lejohet dhënia e Zekatit dhe as e Sadakasë së Fitrit për prindër dhe fëmijë, kjo bazohet në faktin se prindërit duhet të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'i mirëmbajnë ata, sikurse edhe fëmijët që e kanë obligim t'i mirëmbajnë prindërit e tyre. Një beduin erdhi tek i Dërguari i Allahut, dhe i tha: “Unë kam pasuri dhe një fëmijë, e babai im dëshiron ta marrë mallin-pasurinë time.”. Atëherë i Dërguari i Allahut i tha: “*Ti dhe pasuria jote janë të babait tënd.*”<sup>26</sup>

Juristët, kur e trajtojnë këtë pikë, gjithnjë në dritën e argumenteve kuranore dhe pejgamberike, argumentohen edhe me faktin se shtëpitë e bijve llogariten të prindërve, duke u mbështetur në ajetin kuranor, ku thuhet: “***Për të verbrin nuk është gjynah, as për të çalin, as për të sëmurin dhe as për ju që të hani në shtëpinë tuaj...***” (*El Isra, 61*<sup>27</sup>), gjë që, sipas disa komentatuesve i referohet shtëpive të bijve të tyre, për faktin se vazhdimësia e ajetit ka të bëjë me shtëpitë e baballarëve.

Parimisht, dhënia e Zekatit si dhe e Sadakasë së Fitrit, edhe po të lejohet për prindër dhe fëmijë, nuk do të ishte zgjidhje adekuate për ta, sepse

<sup>24</sup> Sabik, Sejid, *Fikhu's Suneh*, vëll. I, f. 459.

<sup>25</sup> Ibën Tejmije, *Ihtijarat ibën Tejmije*, f. 61.

<sup>26</sup> Bejhakui, *Sunen el kubra*.

<sup>27</sup> Kur'ani i Madhërishtëm. Përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan Nahi. Bot. IV-të, boton AIITC, Tiranë, 2006.



nuk do të ofronte ndonjë alternativë për mënjanimin e varfërisë së tyre, kur dihet se dhënia e tyre është një herë në vit, prandaj, si do ta mënjanonin ata varfërinë e atyre që e marrin me një shumë simbolike një herë gjatë një viti?! Mirëpo, i Madhërishmi kërkoi që prindërit të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'i mirëmbajnë ata, sikurse që kërkoi edhe prej fëmijëve që mos t'i harrojnë mirësitë e prindërve të tyre dhe të jenë në shërbimin e tyre, sipas nevojave të tyre, e jo të bëhen mosmirënjohës dhe mos të kujdesen për ta.

Ibën Mundhiri, në lidhje me Zekatin për prindër, thotë: *“Dijetarët janë të një mendimi (ixhma) se zekati nuk lejohet të jepet për prindër, ndaj të cilëve kërkohet furnizimi (e jo Zekati), ngase dhënia e Zekatit të tij për ta largon furnizimin prej tij, e në këtë kontekst dhënia e zekatit për ta llogaritet sikurse dhënia e Zekatit ndaj vetes, e kjo nuk lejohet...”*<sup>28</sup> Nga ky mendim kuptohet se fetvaja e Imam Malikut dhe Ibën Tejmijes nuk merret parasysh, apo ndoshta transmetimet e tyre në këtë kontekst nuk pranohen; përderisa çështja tregohet me konsensus të dijetarëve, mendimet e tyre konsiderohen jashtë kontekstit, dhe nuk shihen si mendime të favorshme. Vlen të theksohet se shiinjte nuk e shohin ndonjë ndalesë që Zekati të jepet edhe për prindër.<sup>29</sup>

Përderisa Zekati e as Sadakaja e Fitrit nuk lejohet për prindër prej fëmijëve të tyre, nuk lejohet as anasjelltas, ngase edhe këta të fundit janë pjesë përbërëse e tyre, dhe se juristët e kanë konsideruar dhënien e zekatit për bijtë prej baballarëve sikurse njeriu për vetveten, gjë e cila nuk lejohet. Ndonëse disa juristë kanë debatuar në lidhje me këtë, për shkak të një hadithi që në shikim të parë konfirmon të kundërtën, e ai është hadithi i Maën bin Jezidit, ku thuhet: *“Ja dhamë besën të Dërguarit të Allahut, unë, babai dhe gjyshi im..., dhe përderisa babai im kishte lënë një shumë dinarësh për sadaka te një person në xhami, unë shkova aty dhe mora një pjesë nga ajo. Mirëpo ai më tha: “Për Zotin, unë nuk kam lënë për ty!”*. Atëherë shkova dhe u ankova tek i Dërguari i Allahut, i cili tha: *“Ty të*

<sup>28</sup> Ibën Kudame, *El Mugni*, vëll. II, f. 647.

<sup>29</sup> Sherfudin Husejn ibën Ahmed ibën Husejn es-Sijagi, es-San’ani, *Rrevdu-n Nedir*, vëll. II, f. 421.

*takon ajo që ke pasur për qëllim, o Jezid, ndërsa ty, o Maën, të takon ajo që e ke marrë.*<sup>30</sup>. Juristët që janë marrë me trajtimin e haditheve, këtë hadith e kanë konsideruar se nuk e trajton çështjen e Zekatit apo të Sadakasë obligative, por që e trajton tematikën e sadakasë vullnetare, prandaj si i tillë nuk bën pjesë në tematikën për të cilën jemi duke diskutuar këtu.

Me fjalë të përgjithshme, nuk lejohet Zekati për prindër dhe prindërit e prindërve, sikurse që nuk lejohet as për fëmijët dhe fëmijët e fëmijëve, e për të cilën edhe Ibën Mundhiri thotë se ka konsensus për këtë. Ndonëse mund të ketë ndonjë përjashtim nga kjo, ashtu siç kanë folur disa prej juristëve, sikurse Imam Maliku, Ahmedi, Ibën Tejmije, Neveviu etj., si rregull i përgjithshëm dhe parimor është se nuk lejohet dhënia e Zekatit mes prindërve dhe fëmijëve. Mirëpo, ka të atillë që mendimin e Ibën Mundhirit, se me konsensus një veprim i tillë është jo i lejuar, e konsiderojnë si veprim iluzioni, krejtësisht të papranueshëm dhe që nuk e pasqyron realitetin, dhe që hadithin e mëhershëm e konsiderojnë si hadith që e trajton tematikën e sadakasë obligative, gjegjësisht Zekatit. Megjithatë, të këtij mendimi janë shumë pak, dhe mendimi i përzgjedhur shihet mendimi tjetër, të cilin mendim e përkrahin pjesa më e madhe e juristëve myslimanë. Madje, ka shumë prej juristëve që mendimin e dytë fare s'e përmendin, dhe në shumë libra të jurisprudencës ekziston vetëm mendimi i parë. Sidoqoftë, një zgjerim i tillë këtu vjen si rrjedhojë e njohjes së mendimeve dhe formës së argumenteve të tyre, ndonëse për shkak të natyrës së trajtimit të kësaj çështje na pamundësohet përmendja e të gjitha argumenteve dhe kundërpërgjigjet e ndërsjella në formën e argumentimit dhe në vetë argumentin.

### **Bashkëshorti për bashkëshorten, dhe anasjelltas**

Parimisht, burri e ka për obligim të kujdeset për gruan e vet. Ai është përgjegjës në mirëmbajtjen dhe furnizimin e saj. Ai njëherësh edhe konsiderohet kujdestar për të dhe atij i takon t'ia sigurojë dhe t'ia plotësojë kushtet ekonomike. Në këtë aspekt gruaja nuk e ka obligim të punojë dhe

<sup>30</sup> Buhariu, nr. 1333. transmetojnë edhe Ahmedi, Bejhekiu, Darimiu dhe Taberaniu.

të fitojë për mirëmbajtjen e familjes, ngase ky obligim i takon burrit, dhe është nën përgjegjësinë e tij, mirëpo nëse ajo punon, atëherë nuk ka gjë të keqe dhe mund t'i ndihmojë bashkëshortit të saj në sigurimin e kushteve materiale.

Islami dy bashkëshortët i trajton si një tërësi e pandashme, ashtu siç i trajton fëmijët me prindër, që edhe nëse tentojnë të largohen apo të ndahen mes vete, ata mbesin prapë si një tërësi e veçantë. Në lidhje me këtë i Madhërishmi në Kuranin Famëlartë thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja...”** (Err Rrum, 21).

Prandaj, në këtë kontekst dispozita e Zekatit dhe e Sadakasë së Fitrit për bashkëshorten, apo e bashkëshortes për bashkëshortin e saj, është sikurse dispozita e Zekatit të prindërve për fëmijët e tyre, dhe anasjelltas. Pra, në parim nuk lejohet dhënia e Sadakasë së Fitrit sikurse as Zekati për gruan, sikurse që nuk lejohet dhënia e as për bashkëshortin nga ana e gruas. Ndonëse, Ibën Mundhiri për këtë çështje thotë se është me konsensus të dijetarëve, pra, se nuk lejohet dhënia e Zekatit për bashkëshorten e personit, ka edhe mendime që e lejojnë një gjë të tillë, pa marrë parasysh se ato mendime përfaqësojnë një grup të vogël juristësh, megjithatë, e shoh të arsyeshme që të potencohet një gjë e tillë, sa për njohuri.<sup>31</sup>

Në anën tjetër, nëse bashkëshorti është i varfër dhe bashkëshortja dëshiron që Zekatin apo Sadakanë e Fitrit t'ia japë bashkëshortit të saj, atëherë juristët janë të ndarë në dysh, e kjo vjen si rrjedhojë e argumenteve të ndryshme ku ata bazohen.

Një pjesë e juristëve, ku në mesin e tyre është edhe Ebu Hanife dhe Imam Maliku, në njërin nga transmetimet e tij, si dhe shumë juristë të tjerë mendojnë se gruaja nuk ka të drejtë të japë zekat për burrin e saj, dhe as anasjelltas. Ebu Hanife, për mendimin e tij mbështetet në ajetin kuranor: **“Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji i juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”** (Err Rrum, 21). Sipas tij, burri e gruaja konsiderohen si pjesë e pandashme dhe

<sup>31</sup> Nevevi, *El Mexhmu*, vëll. VI, f. 229.

sikur të jenë një tërësi e pandashme, e dhënia zekat për njëri-tjetrin konsiderohet sikurse t'i jepet vetes.

Ndërsa, pjesa tjetër e juristëve, e që në mesin e tyre janë edhe dy nxënësit e Ebu Hanifes, Ebu Jusufi e Imam Muhamedi, Thevriu, Shafiu, Maliku, në njërin nga transmetimet edhe Ahmedit<sup>32</sup>, mbështeten në hadithin në vijim: “Prej Zejnebes, bashkëshortes së Abdullah bin Mesudit, transmetohet të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut tha: *“O ju turmë e grave, jepni sadaka-zekat, edhe nëse është nga stolitë tuaja!”*. Tha ajo: *“Unë u ktheva në shtëpi, dhe i thashë Abdullah bin Mesudit: “Ti je njëri i varfër, e i Dërguari i Allahut na urdhëroi të japim sadaka-zekat, prandaj shko pyete atë se a më lejohet të ta jap ty një gjë të tillë, në të kundërtën do të jap (sadaka) për dikë tjetër!”*. (Në versionin e Buhariut qëndron kjo shtesë: “Zejnebjja kujdesej për Abdullah bin Mesudin dhe disa jetimë nën përkujdesjen e saj, prandaj i tha Abdullahut: *“Pyete të Dërguarin e Allahut se a lejohet të të furnizoj ty dhe jetimët nën përkujdesjen time me sadaka!”*.) Abdullahu ia ktheu: *“Shko pyete ti!”*. Ajo thotë: “Unë shkova, dhe ja që pranë portës së të Dërguarit të Allahut një grua prej ensarëve, që kishte ardhur për të njëjtën çështje sikurse unë. Dhe doli Bilali, dhe ne i thamë atij: *“Shko tek i Dërguari i Allahut, dhe informoje se dy gra qëndrojnë pranë portës sate, me qëllim që të të pyesin ty se a lejohet sadakaja prej tyre për burrat e tyre dhe për jetimët që i kanë nën përkujdesje, mirëpo mos i trego se kush jemi ne!”*. Zejnebjja tha: *“Bilali hyri dhe e informoi të Dërguarin e Allahut, e ai e pyeti atë: “Kush janë ato dyja?”*. Bilali ia ktheu: *“Një grua prej ensarëve, dhe Zejnebjja.”*. Ai tha: *“Cila prej Zejnebeve?”*. *“Gruaja e Abdullahut”*, - ia ktheu Bilali. Atëherë i Dërguari i Allahut tha: *“Për ato dyja ka dy shpërblime; një për shkak të afërsisë, dhe tjetrin për shkak të sadakasë-zekatit.”*. (Hadithin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, e teksti është marrë te Muslimi, përveç shtojcës).

Problematika qëndron në faktin se me fjalën sadaka të përdorur në hadith a kuptohet Zekati, Sadakaja e Fitrit-sadakaja obligative, ashtu siç shpeshherë nënkuptohet në Kuran një gjë e tillë, apo nënkuptohet sadakaja vullnetare. Ata që mendojnë se me të kuptohet sadakaja obligative, e

<sup>32</sup> Shevkani, *Nejlul Evtar*, vëll. IV, f. 189.

lejojnë që gruaja ka të drejtë ta japë zekatin për burrin e saj, ndërsa ata që mendojnë se përmes nocionit sadaka në hadithin e mësipërm nënkuptohet sadakaja vullnetare, mendojnë se gruaja s'ka të drejtë ta japë zekatin për burrin e saj.

Ajo që thamë sipër, se Ebu Hanifja është bazuar krejtësisht në diçka tjetër, nuk nënkupton se ai nuk e ka njohur këtë hadith. Përkundrazi, hadithin në fjalë ai e konsideron si një obligim vullnetar, e assesi obligativ, prandaj edhe Imam Tahaviu, në komentin që i bën mendimit të Ebu Hanifes, pasi shqyrton të gjitha mendimet, si dhe potencon se hadithi në fjalë flet për një veprim vullnetar, e jo obligativ, siç kanë potencuar disa juristë.

### Sadakaja e Fitrit për të afërmit e tjerë

Kur jemi te të afërmit e tjerë, ka mbetur një çështje me rëndësi për t'u trajtuar, e që ka të bëjë me Sadakanë e Fitrit për të afërmit, me përjashtim të prindërve dhe fëmijëve, e që mund të jenë vëllezërit, motrat, hallat, tezet e të ngjashme me këtë. Në këtë çështje polemikat janë më të theksuara dhe mospajtimet mes juristëve janë më të mëdha sesa ato që ishin paraprake.

Për të mos u stërzgjatur shumë, do t'i përmendim edhe dy mendimet kryesore<sup>33</sup> në lidhje me Zekatin dhe Sadakanë e Fitrit për vëllezërit mes vete, apo për motrat dhe anasjelltas, për hallat e kështu me radhë. Mendimi i parë, që përfaqësohet ekskluzivisht prej hanefinjve (Ebu Hanifes dhe nxënësve të tij), prej Imami Jahjasë, Ahmed bin Hanbelit, sipas një transmetimi, prej Imam Malikut<sup>34</sup> dhe një grupi të madh juristësh, mendojnë se lejohet Zekati dhe Sadakaja e Fitrit për këto grupe njerëzish, me përjashtim të Zekatit apo Sadakasë së Fitrit për prindër dhe fëmijë, të cilën e

<sup>33</sup> Kur themi dy mendimet kryesore, i kemi për qëllim mendimet që janë të njohura, ngase ka edhe mendime të tjera në këtë çështje, sikurse mendimi i Abdullah bin Davudit, e që sipas tij dhënia e zekatit për të afërmit e tjerë është veprim i urryer, që nuk preferohet, mirëpo që, megjithatë nuk është i ndaluar. Shih *El Emval*, f. 582!

<sup>34</sup> Ibën Enesi (transmetim i Sahnun ibën Seid Et Tenuhi), *El Mudevinetul Kubra*, bot. I, El matbeatul hajrijetu, 1324h, vëll. I, f. 256.

kemi trajtuar sipër. Mendimi i tyre gjen mbështetje edhe te disa sahabë, sikurse Ibën Abbasi dhe të tjerë, të cilët kishin mendimin se lejohet t'u jepet zekat apo Sadakaj e Fitrit edhe te të afërmit, nëse ata janë nevojtarë dhe të varfër. Këta bazohen edhe në ngjarjen e gruas së Abdullah bin Mesudit, e cila, sipas një transmetimi, e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut për t'i dhënë sadaka bashkëshortit dhe fëmijëve jetimë të vëllait të saj.

Ndërsa mendimi i dytë, që përfaqësohet prej Shafiut dhe Ahmedit, në njërin nga mendimet, ka të bëjë me atë se nuk lejohet dhënia për të afërmit në fjalë, ngase, sipas tyre, nëse e jep Zekatin apo Sadakanë e Fitrit për ta, atëherë është sikurse po bie poshtë përkujdesja dhe furnizimi i tyre, e që është obligative.

Sidoqoftë, këto ishin dy mendimet kryesore në lidhje me këtë tematikë, dhe secili mendim i ka argumentet e veta, ndërsa ajo që ia vlen të theksohet është preferenca e shumë dijetarëve për mendimin e parë. Në lidhje me këtë, Jusuf Kardavi shprehet: *“Mendimin, të cilin e përzgjedhim, është ai mendim të cilin e përkrahin shumica e dijetarëve që nga koha e sahabëve, tabiinëve dhe të tjerëve, të cilët e kanë lejuar dhënien e zekatit për të afërmit, me përjashtim të fëmijës dhe prindit..”*<sup>35</sup>

### Mesazh për fund

Aktet e veçanta, thirrjet dhe fetvatë e dala prej përgjegjësit kryesor për mbarëvajtjen e myslimanëve te ne kanë qenë, janë, dhe sigurisht se edhe do të jenë nga institucioni fetar, që në këtë rast është Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës. Kjo Bashkësi monitoron, vëzhgon dhe kujdeset për komunitetin e saj, dhe si e tillë vazhdimisht ka bërë thirrje që fondi i Zekatit dhe i Sadakasë së Fitrit të jepet për Bashkësinë Islame, me qëllim që të ndihmohen medresetë, me të gjitha paralelet, si dhe Fakulteti i Studimeve Islame, për shkak se nuk ka ndonjë ndihmë apo ndonjë fond të përcaktuar nga shteti. Sigurisht se një veprim i tillë është plotësisht i ligjshëm dhe me bazë shariatike-juridike të bazuar në ajetin e grupeve të Zekatit, e më saktë te fjala “fi sebîlil-lah-në rrugë të Allahut”, ku futen

<sup>35</sup> Kardavi, *Fikhu'z Zekah*, vëll. II, f. 725.

edhe institucionet fetare, ngase sot, si asnjëherë më parë, është nevojë imperative për ngritje kulturore, arsimore dhe edukative të myslimanëve, e këtë pa dyshim se institucioni fetar në vend përpiqet ta arrijë me ngritjen e myslimanëve, si në aspektin kulturor, ashtu edhe në atë arsimor dhe edukativ. Kjo nuk nënkupton që grupet e tjera apo fondacionet të shuhen apo të anashkalohen. Përkundrazi, ato mbeten, dhe se askush nuk e ka të drejtën e shuarjes së llojeve ekzistuese. Mirëpo, institucioni fetar i përcakton grupet prioritare, gjithnjë sipas kushteve dhe rrethanave ekzistuese; në rast se përcakton një grup si prioritet ndaj një grupi tjetër, kjo nuk nënkupton shkelje, por si një veprim parësor në bazë të rrethanave kohore. Omeri, r.a., në kohën e tij e ka ndaluar që grupi “për përfitimin e zemrave” të jenë pjesëmarrës nga fondi i Zekatit, për shkak se në kohën e tij një gjë e tillë ishte e paarsyeshme dhe e panevojshme, ngase myslimanët ishin ata që sundonin, dhe nuk ishin të sunduar e të përndjekur. Pra, nuk ishte situata sikur në kohën e të Dërguarit, a.s., kur myslimanët kishin nevojë që t’i joshnin të tjerët në përqaftimin e Islamit, përmes mjeteve të ndryshme, e njëra prej tyre edhe ajo përmes ndarjes së Zekatit apo të Sadakasë së Fitrit, në mënyrë që t’ua përfitonin zemrat atyre që nuk ishin tamam të thelluar në Islam apo ende nuk kishin hyrë, dhe të shpresohesh për një kthim të tyre në Islam. Thjesht, mund të ndodhë që në një kohë të caktuar mos të gjenden disa nga kategoritë, por kjo assesi nuk e anulon tekstin, ngase mund të gjenden në një kohë tjetër apo në një vend tjetër. Kërkesa nga Kryesia e BIRK-ut, që Zekati dhe Sadakaja e Fitrit të jepet për të, në mënyrë që të mbahen qendrat e dijes islame, siç janë medresetë dhe Fakulteti, është kërkesë shumë e nevojshme dhe plotësisht e drejtë (për çka edhe elita e dijetarëve bashkëkohorë e pranojnë), dhe që nuk duhet anashkaluar, për shkak se roli i këtyre qendrave të dijes ka qenë jashtëzakonisht i madh, dhe mund të themi se ka qenë një xhihad i llojit të vet, e që i ka thyer barrierat e kohës, i ka tejkaluar sfidat e guximshme dhe ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes fetare, kulturore dhe edukative, sikurse që ka ndikuar edhe në ruajtjen e unitetit të myslimanëve dhe në ruajtjen e imazhit të Islamit.

Në rrethanat tona ekzistuese, Bashkësia Islame merr përsipër organizimin e mbledhjes dhe të ndarjes së Sadakasë së Fitrit, që është institucio-

ni fetar që kujdeset për myslimanët, dhe në bazë të prioriteteve të saja e bën edhe ndarjen, gjithnjë duke i dhënë përparësi çështjes së ngritjes arsimore dhe edukative të myslimanëve, për të cilën elita e dijetarëve bashkëkohorë mendojnë se në grupin “fi sebililah” futet edhe çështja e arsimit dhe ngritja e kujdesi ndaj institucioneve fetare. Për dallim nga vendet fetare, ku ekzistojnë ndihma dhe fonde të ndryshme nga shteti, në vendin tonë, thuajse nga shteti nuk ekziston asnjë ndihmë materiale për komunitetin mysliman, e që në një formë mbetet komuniteti më i marginalizuar. Prandaj, për mbijetesën e këtij komuniteti sigurisht se nevojitet ndihma e kësaj shoqërie, qoftë përmes Zekatit, Sadakasë së Fitrit, apo edhe formave të tjera të ndihmës ndaj institucionit të Bashkësisë Islame.

#### **Literatura e konsultuar:**

- Alaudin Kasani, *Bedaius-Sanaiu fi tertibish-Sherai*, Sheriketul Matbuat El Ilmijetu, 1327
- Ebu Jusuf, *El Haraxh*, bot.II, Tab’atu-s Selefijetu, pa vit botimi.
- Et-Tenuhi, *El Mudevinetul Kubra*, bot. I-rë, El matbeatul hajrijetu, 1324h.
- Grup autorësh, *Zeqati dhe Sadekatul-fitri*, Prishtinë, 1994.
- Ibën Humam, Kemaludin Muhamed bin Abdulvahid, *Fet’hul Kadir Sherhu’l Hidajeh*, Matbeatu Mustafa Muhamed, Kajro-Egjipt, pa vit botimi.
- Muhamed bin Ahmed El Fetuhi, Munteha El Iradat, v.I, f.496.
- Sabik, Sejid, *Fikhu’s Suneh*, bot. II-të, Daru’l Fet’h, Kajro-Egjipt.
- Shafiu, *El Umm*, Darul Ma’rifeh, 1410-1990.
- Taberiu, *Xhamiul Bejan fi Te’vilil Kuran*, me recenzurë të Ahmed Shakirit. Muesseseturr Rrisaletu, bot. I, 1420h-2000m.



Dr. Ejup HAZIRI

## TREATISE ON THE ZAKAT AL-FITR

### Abstract

Zakat al-Fitr is an obligation that coincides with the blessed month of Ramadan and is brought to our attention by it. It is a precious obligation of great value and special importance.

There is a specific time as to when it should be given and who is most deserving to collect and distribute it. Furthermore, according to Qur'anic texts, the beneficiaries are specified. Zakat, in general, and Zakat al-Fitr, in particular, at the time of the revelation, had a different treatment compared to the present day. Nowadays, individuals, organizations and sometimes even unknown entities appeal to believers to address their Zakat and Zakat al-Fitr funds to them, unlike the time of revelation when these resources were collected and distributed through the state treasury (Beit al-Mal), and it was the Messenger of Allah, peace be upon him, who determined the real beneficiaries of Zakat and Zakat al-Fitr. He also designated individuals responsible for collecting and distributing these important funds.

Furthermore, he did not give to everyone who sought to be a beneficiary, either from Zakat or Zakat al-Fitr, but distributed it as decreed by the Almighty, as there are restrictions even in distribution; not everyone who applies should benefit! These matters and other ones will be discussed in this paper.

**Keywords:** *Zakat al-Fitr, Zakat, charity, foundations, beneficiary groups.*

## **IV. KULTURË / TRASHËGIMI / ART**



Dr. Parim KOSOVA

## **XHAMITË E PRIZRENIT GJATË SHEKUJVE (I)**

### **Abstrakt**

Pas rënies së Prizrenit përfundimisht nën sundimin Osman më 1459 filluan të ndërtohen edhe objektet e para si vende adhurimi – mesxhidet dhe xhamitë. Prizreni në periudhën osmane, ishte një nga qytetet më të mëdha, më të rëndësishme dhe më të zhvilluara të Ballkanit, pas Edrenesë dhe Selanikut.

Si një qendër e rëndësishme ekonomike, shoqërore, ushtarake, politike, arsimore, fetare, administrative, Prizreni ishte edhe një nga qytete më më së shumti xhami dhe monumente islame, të cilat u ndërtuan përgjatë kësaj periudhe. Disa nga këto xhami monumentale kanë arritur deri në ditët tona, por disa të tjera, për shkak të rrethanave shoqërore-politike dhe luftërave të shpeshta e ndërtimeve të sistemeve, janë rrënuar dhe kanë shkuar në pakthim dhe për to dimë vetëm në saje të dokumenteve të kohës.

Punimi ynë synon të paraqes një pasqyrë të xhamive aktuale dhe atyre të shkatërruara të qytetit të Prizrenit, për kohën e ndërtimit të tyre, ndërtuesit e tyre, vakëflënësit, rindërtimet dhe të dhëna të tjera që lidhen me këto xhami.

***Fjalët çelës:** Kosova, Prizreni, mesxhidet, xhamitë, monumentet*

## 1. Prizreni gjatë periudhës osmane (1459-1912)

Prizreni nën sundimin osman ra disa herë. Rënia definitive ndodhi në vitin 1459.<sup>1</sup> Burimet e ndryshme, dëshmojnë që Prizreni në periudhën osmane, ishte një nga qytetet më të mëdha, më të rëndësishme dhe më të zhvilluara të Ballkanit, pas Edrenesë dhe Selanikut.<sup>2</sup> Prizreni ishte qendër e rëndësishme ekonomike, shoqërore, ushtarake, politike, arsimore, fetare, administrative, e më pas ishte qendër e Sanxhakat dhe më vonë edhe i Vilajetit, dhe sërish qendër e Sanxhakat, deri në vitin 1912.<sup>3</sup>

Sanxhaku i Prizrenit, si njësi administrative ka përfshirë një territor mjaft të gjerë. Në fillim të shekullit XVI, kishte afro 200.000 banorë. Ky numër ishte i madh për atë kohë, ndërsa numri i dendësisë së banorëve në Evropë ka qenë shumë më i vogël.<sup>4</sup> Sipas relacionit të Pjetër Mazrekut, të vitit 1623-24, Prizreni kishte 12.800 banorë.<sup>5</sup> Të dhënat që jep Coronelli në vitin 1688, dhe në vitin 1689, në Prizren kishte 6.000 shtëpi.<sup>6</sup> Prizreni ishte qytet i madh dhe i zhvilluar në çdo pikëpamje.

Ajo që e dëmtoi dhe e ndali zhvillimin e Prizrenit ishte lufta habsburge-osmane (1683-1690), kohë kur ushtria habsburgase në nëntor të vitit 1689 e shkrumboi edhe qytetin e Prizrenit dhe fshatrat e regjionit.<sup>7</sup> Gjurmimet

<sup>1</sup> Skender Rizaj, Prizreni deri te Tanzimati (1839), Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike XIII – 1983, Prishtinë, 1984, f. 60.

<sup>2</sup> Prizreni në dokumente osmane, përgatitën Ayten Ardel & Edib Agagjyshi, Alsar, Tiranë, 2021, 27.

<sup>3</sup> Dr. Skënder Rizaj, Vilajeti i Kosovës më 1878, Vjetar- godisnjak, II – III, Prishtinë – Pristina, 1970, 212-213.

<sup>4</sup> Skender Rizaj, Prizreni deri te Tanzimati (1839), Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike XIII – 1983, Prishtinë, 1984, f. 61-62.

<sup>5</sup> Dr. Muhamet Tërnavë, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 204.

<sup>6</sup> Dr. Muharem Cërabregu, Kosova në hartat e vjetra, Kontribut gjeografisë historike të Kosovës, Prishtinë, 1977, f. 92

<sup>7</sup> Хасан Калеси и Исмаил Ерен, Призренац Махмуд-Паша Ротул, његове задужбине и Вакуфнама, Старине Косова VI – VII Antikitete të Kosovës, Приштина – Prishtinë, 1972-1973, f. 24, 42; Prof. Asoc. Dr. Nehat Krasniqi, Karakteri i Luftërave habsburge-osmane dhe roli i shqiptarëve në to, Kumtime historike I, Materialet e trye-

mët e këtij shkatërrimi ishin vërejtur edhe në shekujt e mëvonshëm. Në dekadën e katërt të shekullit XIX Prizreni bëhet përsëri së bashku me Shkupin qyteti më i rëndësishëm në gjithë Shqipërinë verilindore.



*Prizreni (1913)*

Të dhëna me interes mbi historinë e përhapjes së fesë islame në trojet ilire-shqiptare na jep Ekrem Vlora, Skender Rizaj, Nexhat Ibrahim, N. Krasniqi etj. Sipas studiuesit N. Krasniqi, feja islame kishte filluar të përhapet fshehtazi ndër shqiptarët përmes misionarëve islamë, që para depërtimit osman në Shqipëri.<sup>8</sup> Këto gjurmë në Prizren dhe regjion i hasim

---

zave shkencore të mbajtura më 19 tetor 2015 dhe më 20 shtator 2017, Prishtinë, 2020, f. 59.

<sup>8</sup> Nehat Krasniqi, Dy dokumente gjenealogjike të rëndësishme, Dituria Islame, nr. 59. Prishtinë, 1994, f. 13; Nexhat Ibrahim, Islami në Ballkan para shekullit XV, Prizren, 2000, 55; Shefik Osmani, Sindroma antishqiptare e serbëve në përmbledhje “Gjenocidi serb në Kosovë” të botuar nga AIITC, 1999, Tiranë, f. 27; Dr. Sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osma-

te Sari Salltëk Babai, në Malin e Pashtrikut, atë të Gjallicës, në fshatrat Plavë, Zhur, Zgatar, faltoren islame në fshatin Mlikë, të ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIII.<sup>9</sup> Krahas tyre, edhe në vetë qytet i hasim der-vishët shtegtarë-bredhës, siç është rasti i Kalander Babës etj., e që me rënien e Prizrenit nën sundimin osman feja islame filloi të depërtojë edhe në masë.



ne, Prishtinë, 2011, f. 77. Këtu Krasniqi, citon Vlorën nga shkrimi: “Jeta myslimane shqiptare”, nr. 4, Detroit SHBA, 1959, f. 7.

<sup>9</sup> Xhamia e fshatit Mlikë në Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme të Ministrisë Kulturës Rinisë dhe Sportit të Kosovës (01.10.2014-10.10.2015) figuron në faqen f. 2. Në Listën e fundit të trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës, Xhamia e fshatit Mlikë figuron që është i shek. XIII, hyn në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Unik në Databazë 001250. Një shkrim për këtë Xhami kemi dhe nga Azbi Halili, Xhamia e Mlikut-ndër më të vjetrat në Kosovë, “Bujku” e hënë, 13 nëntor 1995, f. 11; Parim Kosova, Gora dhe veshja tradicionale e saj gjatë shekullit XX - Gora and its traditional costumes during the XX century, Prishtinë, 2007, f. 16; Nexhat Ibrahim, Islami në Ballkan para shekullit XV, Prizren, 2000, 55; Dr. Parim Kosova, kumtesë Tarikatet dhe teqetë e qytetit të Prizrenit, e lexuar në konferencën shkencore: “Trashëgimia Mistike në Kosovë” e organizuar nga Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 9 nëntor 2023, f. 1.

Në Prizren, më 1530/31 ishin 4 mëhallë myslimane dhe 9 të krishtera.<sup>10</sup> Po në këtë vit popullsia myslimane përbënte 40% të popullsisë. Në Prizren, në vitin 1570 kjo populli kishte arritur në 63%.<sup>11</sup> Në gjysmën e parë të shekullit XVII shqiptarët e fesë islame jo vetëm që mbizotëronin në qytetin e Prizrenit, por kjo gjendje ishte edhe nëpër fshatrat e tij. Qyteti i kishte 12 mijë banorë të përkatësisë fetare islame dhe 800 të përkatësisë të krishtere.<sup>12</sup>

### **1.1. Dëshmitë për mesxhidet-xhamitë në Prizren, dhe vështrim mbi publikimet**

Që në dhjetëvjeçarët e parë të sundimit osman në trojet shqiptare, si edhe kudo në Orientin Islam, sipas sistemit të vakëfeve, u themeluan institucione të shumta, dhe ato me karakter fetar, sikurse ishin mesxhidet dhe xhamitë.<sup>13</sup> Si kudo, edhe në Prizren, për vakëfet kujdeseshin drejtuesit e tyre (mytevelinjët).

Për një pjesë të mecenëve të xhamive të Prizrenit ka argumente të sigurta që ishin vendas, pra shqiptarë, kurse për disa të tjerë nuk kemi shënime të sakta.

Mendojmë se dokumentet autentike kanë qenë të shumta që do ta vërtetonin saktësisht edhe sponsorin, vitin e ndërtimit të xhamive dhe vakëf-namet për mbajtjen e tyre, mirëpo shumë nga këto dokumente janë tretur me djegien e Prizrenit dhe shkatërrimin e faltoreve islame në nëntor të vitit 1689 nga ana e ushtrisë habsburgase, si dhe nga ana e pushtetit serb e jugosllavë gjatë viteve 1912-1999.

<sup>10</sup> Skender Rizaj, Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Prishtinë, 1982, f. 465.

<sup>11</sup> Prizreni në dokumente osmane, përgatitën Ayten Ardel & Edib Agagjyshi, Alsar, Tiranë, 2021, f. 27.

<sup>12</sup> Skënder Rizaj, Islamizimi i popullit Shqiptar, Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarë, Prizren, 2001, f. 139; Dr. Muhamet Tërnavë, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 204.

<sup>13</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane, Prishtinë, 2011, f. 78.



Dëshmia më e vjetër deri më sot që është gjetur e publikuar dhe që e vërteton fillimin e ndërtimeve arkitektonike islame në Prizren është Vakufnameja e vitit 1513 e Suzi Çelebiut-Prizrenasit, i cili ishte myderriz, poet, historian, udhëpërshkrues dhe legator.<sup>14</sup> Dëshmi të tjera me rëndësi që e pasqyrojnë ekzistimin edhe të mesxhideve e xhamive në qytetin e Prizrenit janë: Vakufnameja e legatorit të madh Mehmed Kukli-beut, e legalizuar më 1538-1539.<sup>15</sup> Pastaj Vakufnameja e Gazi Mehmed Pashës, e legalizuar në muajin shkurt të vitit 1580.<sup>16</sup> Këto vakufname dhe defterët e hollësishëm (defterët mufassal) të sanxhakut të Prizrenit, të vitit 1571, si dhe ajo e vitit 1590/91, dëshmojnë se asokohe Prizreni filloi të zhvillohej shumë dhe të marrë karakter të një qyteti të mirëfilltë osman.<sup>17</sup>

Në Prizren, përveç Namazxhahut - Musallës dhe Xhuma Xhamisë, në gjysmën e dytë të shekullit XV ishin ndërtuar dhe mesxhidi i Ajas Beut, mesxhidi i Sinan Katibit dhe Iljaz Kukës.<sup>18</sup> Bazuar në dokumentet arki-

<sup>14</sup> Skender Rizaj, Gjurmime Albanologjike seria e shkencave historike, nr. XIII-1983, f. 62; Nexhat Ibrahim, Suzi Prizrenasi, Prizren, 1410/1990, f. 20-21; Vakufnameja e Suzi Prizrenasit, është pronë e Xhamisë së tij në Prizren, është në mbrojtjen e Shtetit me vendim të Entit Krahinor për mbrojtjen e përmendoreve kulturore, nr. 637 të 15 gusht 1955. Për vlerat shkencore të veprave të Suziut orientalisti Franc Babingeri në një letër që i dërgon prej Berlinit më 13.07.1929 orientalistit Olesnickij pos rëndësisë së veprave kërkon: "...sa më shpejtë të përpunohet në formë të një doktrature". Një kopje të letrës posedojmë në Bibliotekën personale.

<sup>15</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo. 1960, f. 163-166.

<sup>16</sup> Dr. Ekrem Hakkı Ayverdi, Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri-Yugoslavya, cilt 3, kitap 3, Istanbul, 1981, f. 185-186. E shqipëroi për nevoja të mia, Fejzullah Shatri, profesor i orientalistikës, Prizren, më 21.10.2003.

<sup>17</sup> Skender Rizaj, Prizreni deri te Tanzimati (1839), Gjurmime Albanologjike seria e shkencave historike, nr. XIII-1983, f. 62; Татјана Катич, Османизовање средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 134; Parim Kosova, Ndërtimet e arkitekturës Islame dhe medresetë e Prizrenit, në Simpoziumin e Dytë ndërkombëtar: "Qytetërimi Islam në Ballkan", Tiranë, Shqipëri 4-7 dhjetor 2003, Stamboll, 2007, f. 240.

<sup>18</sup> Татјана Катич, Османизовање средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 111-112, 121.

vore të decenies së katërt të shekullit XVI, Prizreni i kishte 8 xhami, të cilat i kishin edhe mejtepet e tyre.<sup>19</sup>

Në raportin e vitit 1838, të ish-nëpunësit të konsullatës austriake në Shkodër, J. Müllerit, thuhet se Prizreni i ka 42 xhami.<sup>20</sup> Shënime me vlerë në vitin 1874 dhe për mesxhidet dhe xhamitë në Prizren janë edhe ato të Tahir Efendiut, Myftiut të Vilajetit të Prizrenit, që i jep në kronikën e tij “Menakib” (Jetëshkrim).<sup>21</sup> Sipas Sallnames së vitit 1291/1874, Prizreni, përveç tjerash, i kishte 23 xhami dhe 2 mesxhide.<sup>22</sup> Në Sallnamen e vitit 1896 (1314) në Prizren ishin 25 xhami dhe një mesxhidi sherif.<sup>23</sup> Në Sallnamen e Vilajetit të Kosovës, të vitit 1318/1900/01, ishin 25 xhami dhe një mesxhid.<sup>24</sup> Këtu kuptojmë që në arealin kohor 1874-1900/01 në Prizren ishte ndërtuar vetëm edhe një xhami, sipas të dhënave të sallnameve që i marrim si të sakta, ngase janë burime zyrtare të administratës të Vilajetit të Kosovës.

Gjithnjë duhet pasur parasysh se gjatë viteve 1912-1999 të okupimit të gjatë serb, bullgarë e jugosllavë, qeveritë e tyre qëllimisht edhe i kanë shkatërruar e dëmtuar disa nga xhamitë e Prizrenit, po edhe me marifet janë kujdesur edhe për humbjen dhe fshehjen e dokumenteve përkatëse, madje duke i eliminuar edhe mbishkrimet nga vetë muret ballore mbi dyer e hyrjes të disa xhamive, apo edhe duke zhdukur dëshmi të tjera.

Gjatë hartimit të punimit kemi vërejtur se shumica e autorëve sllavë, në publikimet e tyre, për t’i vënë në lajthitje lexuesit, studiuesit dhe opi-

<sup>19</sup> Hasan Kaleši, Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda, Gjurmime Albanologjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 93.

<sup>20</sup> Bedrush Shehu, Një raport i J Müllerit për Kosovën në vitin 1838, Kosova – Kosovo, 5, Prishtinë-Pristina, 1976, f. 73.

<sup>21</sup> Dr. Esat Haskuka Historijsko-Geografska Analiza Urbanih Funkcija Prizrena, Gjakovica, 1985, f. 162; Dr. Sc. Nehat Krasniqi, Kronika “Menakëb” e Tahir Efendiut, burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës Turko-Osmane, Edukata Islame, Nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 80.

<sup>22</sup> Hasan Kaleši, Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda, Gjurmime Albanologjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 98.

<sup>23</sup> Kosova Vilayeti Salnamesi 1896 (Hicri 1314), Usküb - Istanbul, 2000, f. 263.

<sup>24</sup> Kosova Vilayeti Salnamesi 1318, Istanbul, f. 761.

nionin ndërkombëtar, i kanë shtrembëruar argumentet e shumta, edhe pse ato i kanë pasur nëpër duar. Për këto shtrembërime dallohen rektori i Bogosllavisë në Prizren, Petar Kostiq, konsulli i Rusisë në Prizren, I. S. Jastrebov etj., të cilët, përveç tjerash, theksojnë se në vendet e kishave të dikurshme ortodokse sllave janë ngritur shumë nga xhamitë e Prizrenit. E, në bazë të fakteve, madje edhe të burimeve osmane, vërtetohet se vetëm kisha e Shën Premtës është shndërruar në xhami, madje konstruksioni i kishës nuk është prekur fare, vetëm piktura murale është suvatuar, dhe mbi kambanarë është ngritur më vonë një minare e vogël. Rasti i dytë është në vendin e ish-kishës së dikurshme të Shën Anës, donator për ngritjen e xhamisë së vet ishte Mustafa pasha. Këto dy raste i dëshmon edhe Pjetër Mazreku, e raste të tjera nuk kemi hasur gjatë trajtimit të një musalla-namazxhahu dhe 41 mesxhideve-xhamive që janë ndërtuar gjatë periudhës osmane.

Njohësi i trashëgimisë së Prizrenit, serbi S. Nikoliq, e mohon se xhamia e Gazi Mehmet pashës, është ngritur në vendin ku më parë kinse ka qenë Pallati i Dushanit.<sup>25</sup> Të gjithë autorët serbë akuzojnë pa bazë edhe Sofi Sinan pashën për marrjen e gurëve nga kisha e Shën ArkangjELIT (në afërsi të Prizrenit) për ngritjen e xhamisë së tij. Këtë shpifje e kishin hedhur poshtë edhe ekspertët italianë, qysh në vitin 1941.<sup>26</sup>

Shumica e autorëve që veten e mbajnë si turq, në vend të termit osman, e përdorin kryesisht termin turk etj. Te disa prej autorëve jo sllavë janë përvjelë dhe ca lëshime, edhe përkundër faktit se ata, për qëllime të mira, e kanë trajtuar problematikën në fjalë.

Duke i përdorur këto botime në mënyrë analitike, për hartimin e punimit kemi shfrytëzuar edhe një liste të nxjerrë nga regjistri i “*Tapu Defter Kayıtlarina - Prizren Camileri*” në Stamboll, ku figurojnë 39 xhami në

<sup>25</sup> Др. Серафим С. Николић, Призрен од средњег века до савременог доба урбанистичко-архитектонски развој, Призрен, 1998, ф. 143.

<sup>26</sup> Muhamed Shukriu, punim i pabotuar, Xhamia e Sofi Sinan Pashës – Labirint i aktivitetit dhe kërcënimet permanente për asgjësim, Prizren, dt. 24.08.1992, f. 1-3.

Prizren.<sup>27</sup> Duke e analizuar këtë dokument, kemi parë se aty ka edhe përsëritje të emrave të xhamive. Gjithashtu e kemi shfrytëzuar edhe regjistrin e Vakëfeve të xhamive të Prizrenit, të marrë nga Arkivi i Kryeministrisë së R. Turqisë. Po ashtu i kemi analizuar edhe veprat e autorëve që janë marrë me këtë çështje, pastaj ditarët tanë gjatë inventarizimit të trashëgimisë së Prizrenit në vitet 2002-2003, si anëtar i ekipit profesional të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Prizren, dhe e kemi shfrytëzuar edhe një pjesë nga dokumentacioni i këtij Instituti, Databazën e trashëgimisë kulturore të MKRS të Kosovës, intervista me imamë të xhamive dhe me pleq të respektuar të lagjeve, po edhe me pasardhës të familjeve që kanë dhënë gjenerata imamësh, disa prej tyre tani që janë të ndjerë etj., dhe si përfundim, në bazë të këtyre të dhënave, kemi gjetur se në Prizren, gjatë periudhës osmane shumica e faltoreve fillimisht ishin ngritur si mesxhide, e pastaj janë shndërruar në xhami. Prandaj, për historikun, donatorin dhe datën e ngritjes së mesxhideve-xhamive jemi përpjekur ta marrim atë më të saktën, duke i krahasuar të dhënat.

## **2. Historiku i mesxhideve-xhamive të ndërtuara dhe të rindërtuara në Prizren 1455-1912**

Osmanët në gjithë territorin e shtetit të tyre kanë mbajtur shënime edhe për faltoret që ndërtoheshin. Mirëpo, pjesa më e madhe e arkivave osmane është shkatërruar gjatë luftës osmano-austriake të viteve 1683-1690.<sup>28</sup> Ushtria austriake, përveç djegies e shkatërrimit të Prizrenit, së bashku me gjithë faltoret islame në vitin 1689, kishte djegur edhe shumë dokumente të xhamive etj., prandaj burimet për vitet 1455-1689 janë të pakta. Ne mendojmë se për plotësimin e këtij punimi në të ardhmen duhet bërë hulumtime të mirëfilltë në arkivat e Republikës së Turqisë.

<sup>27</sup> Në vitin 1994 Av. A. Suroy, e solli nga Stambolli një Listë nga “*Tapu Defter Kayitlarina- Prizren Camileri*”, një kopje e kemi në bibliotekën tonë personale.

<sup>28</sup> Петар Костћ, Призренски мутесарифи и валије у XVIII i XIX веку, Гласник Скопског научног друштва V, Скопје, 1929, 157. Kostiq, prej pakë të vërtetave e shumë sajimeve në veprat e tij çuditërisht e jep këtë të vërtet.

### 2.1. “Musalla-Namaz-xhahu” Kërëk Xhamia

Mendohet se me marrjen e Prizrenit osmanët kanë ndërtuar faltoren provizore (musalla).<sup>29</sup> Në Vakufnamenë e Mehmet Kukli beut shënon se ai i kishte donatuar personit të caktuar, që për çdo ditë t’i jepeshin nga dy akçe për meremetimin e mureve të oborrit të namazxhahut.<sup>30</sup> Studiuesi N. Krasniqi e mbron mendimin se donatimi i ndërtimit të musallasë është bërë nga ana e Mehmet Kukli beut, i cili njëjtë, mirëpo me përmasa më të vogla, e ka ngritur dhe një musalla tjetër në fshatin Buzez të Opojës.<sup>31</sup> Atëherë, mund të mendojmë se fillimisht në këtë pjesë të fushës së qytetit, jo larg katedrales së Shën Premtes, osmanët e ndërtuan në shpejtësi një bazament provizor, e që ka shërbye për musalla-namazxhah, dhe të cilin më vonë Kukli beu e rregulloi duke ia ndërtuar edhe pjesët e tjera, me gurë shtufe-sige dhe duke e rrethuar me avlli. Dihet se namazxhahumusalla, si edhe në vendet e tjera, edhe në Prizren ka shërbyer si faltore islame në fushë të hapur, pra për faljen e namazit edhe nga një numër më i madh i besimtarëve.

Sipas memories së prizrenasve, një pjesë e ushtrisë osmane aty janë falur për xhuma dhe për Bajram (deri në gjysmën e dytë të shek. XIX). Falja e namazit të zakonshëm prej individëve dhe falja e xhumasë në masë është kryer sidomos nga ana e bahçevanëve dhe bujqve, të cilët për shkak të vrullit të punëve (në sezonin e pranverës e deri në fillim të vjeshtës), për të mos e humbur kohën e tyre të çmuar për të shkuar në shtëpi e për t’i ndërruar rrobat, a merrnin abdes dhe faleshin aty, ngase dyshe-meja e objektit nuk ka pasur shtrojë; falje individuale ka pasur edhe në vitet e para të pushtetit komunist,<sup>32</sup> po edhe për faktin se ky vend i faljes ishte më afër fushave ku punonin ata.

<sup>29</sup> Hasan Kaleşi, Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda, Gjurmime Albano-logjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 92.

<sup>30</sup> Hasan Kaleşi i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 165.

<sup>31</sup> Dr. Nehat Krasniqi, intervistë e dhënë më 28.01.2024 në Prishtinë.

<sup>32</sup> Deklaratë e Hafëz Jakup Muqeziut (ka mbaruar shkollimin më 1937 në Medresenë e Gazi Mehmet pashës) i lindur më 1919, dhënë më 22.10.2003 në Prizren; Vahit (Des-



Në popull njihet edhe si Kërëk Xhami (Xhamia e thyer), për faktin se edhe në fund të sundimit osman ishte pak e dëmtuar; kjo shihet edhe nga ana e fotografisë së bërë me rastin e okupimit të Prizrenit në nëntor të vitit 1912, nga ana e ushtrisë serbe, ku dy nga katër ushtarë janë fotografuar të krekosur me armë në këmbë, në gjendje gatitu, në Namazxhah, dhe dy të tjerë mbi varrezat e Namazxhahut. Aty vërehet se objekti ka bazamentin mbi tokë, minaren e improvizuar, minberin dhe mihrabin paksa të dëmtuar, e mahfili nuk vërehet.<sup>33</sup>

---

tan) Kabashi, i lindur më 1926 në Prizren, deklaratë e dhënë më 18 maj 2007 në Prizren.

<sup>33</sup> Është fotoja më e vjetër e kësaj faltoreje, aty shkruan: “Прва џамија, звана КРПК (изломлена) џамија, која је подигнута при заузећу ПРИЗРЕНА 1454 год. “Xhamia e

Që nga viti 1935, përreth namazxhahut filloi lëvrimi i tokave dhe eliminimi i varrezave, kështu që pranë objektit, në vitin 1956, u ndërtua magazina e ndërmarrjes “Zhitopromet”, kurse gjatë viteve 1966-69 u ndërtuan shtëpitë, ndërsa ambulanca e tanishme, në mes Namazxhahut dhe tyrbes, u ndërtua në vitin 1982.

Në vitin 1969, nga ana e Entit MPK-Prizren janë zhvilluar gërmimet arkeologjike.<sup>34</sup> Pastaj edhe në vitin 1989. Të dhënat gjenden në Raporti i Kërëk Xhamisë, Dt. 26.09.1987. nr. 19177, në ngastrën kadastrale 1136.<sup>35</sup>

Në vitin 1987, një ndërmarrje e Beogradit kërkoi që ta ndërtonte një objekt të madh në hapësirën e Namazxhahut, depos dhe përreth saj, mirëpo falë disa punonjësve jo serbë të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të Komunës së Prizrenit, Namazxhahu vihet nën mbrojtje të shtetit, me Vendim Nr. 329 datë 20.09.1987. Objekti gjendet në ngastrën kadastrale 1136/2.<sup>36</sup>

Në mënyrë të organizuar në masë, për herë të parë, pas katër dekadash, është falur namazi i Bajramit në vitin 1990.<sup>37</sup>

Në bazë të kërkesave të qytetarëve, të datës 25.06.2001, si dhe Kërkesës së Bashkësisë Islame për rikonstruimin, konservimin dhe ripërtëritjen e Namazxhahut, më 10 tetor të vitit 2001, në bashkëpunim të Institutit të Monumenteve të Prizrenit me Dijanetin e Republikës së Turqisë, filluan

parë, e quajtur Kërëk (e thyer) xhami, e cila është ngritur me marrjen e Prizrenit në vitin 1454.

<sup>34</sup> Muhamed Shukriu, Prizreni i Lashtë-Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, Prizren 2001, f. 340.

<sup>35</sup> Prof. Dr. Hakki Acün & Y. Doç. Dr. Mehmet Ibrahimgöl, Kosova-Pizren, Fatih sulltan Mehmet Mamazgahi (Kirik Cami) Kazi ve restorasyon çalışmaları ile Şehit Başçavuş Hşseyin Kutlu Parki – gërmimet dhe restaurimet e Namazxhahut (Xhamia e Thyer) Kosova-Prizren, Fatih Sultan Mehmet dhe Parku i dëshmorit (Başçavuş) Huseyin Kutlu. Ankara 2002. f. 9.

<sup>36</sup> Fotokopje të vendimit e kemi në bibliotekën personale.

<sup>37</sup> Deklaratë e Hafëz Jakup Muqezit (ka mbaruar shkollimin më 1937 në Medresenë e Gazi Mehmet pashës) i lindur më 1919, dhënë më 22.10.2003 në Prizren; Deklaratë e Asaf Avduti, i lindur në vitin 1949, i cili ka qenë me punë në objektin e “Zhitoprometit”, deklaratë e dhënë më 18.02.2024, madje ishte improvizuar dhe korrenti për ndriçim të objektit.

gërmimet arkeologjike dhe dolën gjurmët e shkallëve të minberit, parmakët e minberit, shkallët e hyrjes për në Namazxhah si dhe mahfili i myezinit (shih raportin e gërmimeve arkeologjike të dt. 29 dhe 30 tetor 2001!). Pastaj filloi faza e restaurimit, konservimit, dhe u shtua një pjesë konike në maje të minares të Namazxhahut; punimet u kryen gjatë muajit maj të vitit 2002, me investim të Republikës së Turqisë.<sup>38</sup> Po ashtu, më 5 prill 2002 pati edhe një përrurim. Dhe, me Pëlqimin e IMM Prizren, Nr. 167 dt. 12.11.2007, u lejua të kryhet meremetimi parcial në monumentin e Namazxhahut, nga ana e Drejtorisë të Ambientit të Komunës të Ankarasë të R. Turqisë.

Në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës xhamia në fjalë figuron e ndërtuar në vitin 1455.<sup>39</sup> Më 23.06.2023 nr. 124/2023 hyn në Listën e Aseteve me status të mbrojtjes së përhershme. Më 26.06.2023 nr. 3290/2023, hyn në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme kategoria trashëgimia arkitekturore mesjetë statusi 69/2016 nr. Unik në Databazë 000345.<sup>40</sup>

## 2.2. “Xhuma Xhamia”

Me pushtimin e Prizrenit nga ana e ushtrisë osmane në vitin 1455, kisha e Shën Premtes u shndërrua në xhami.<sup>41</sup> Këtë fakt e pranon edhe Tahir efendiu dhe shndërrimin në xhami paska bërë sulltan Mehmet Fatihu

<sup>38</sup> Prof. Dr. Hakki Acün & Y. Doç. Dr. Mehmet Ibrahimgöl, Kosova-Pizren, Fatih sulltan Mehmet Mamazgahi (Kirik Cami) Kazi ve restorasyon çalışmaları ile Şehit Başçavus Hüseyin Kutlu Parki – gërmimet dhe restaurimet e Namazxhahut (Xhamia e Thyer) Kosova-Prizren, Fatih Sultan Mehmet dhe Parku i dëshmorit (Başçavus) Hüseyin Kutlu. Ankara 2002. f. 8, 9, 10. Ceremonia e fillimit të punimeve u zhvillua më 12.10.2001.

<sup>39</sup> Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të Ministrisë Kulturës Rinisë dhe Sportit të Kosovës (01.10.2014 – 10.10.2015), f. 2.

<sup>40</sup> Databaza e MKRS të republikës së Kosovës.

<sup>41</sup> Prizreni në dokumente osmane, përgatitën Ayten Ardel & Edib Agagjyshi, Alsar, Tiranë, 2021, 27.



dhe ai qenka falur me xhematin, atë e ka quajtur dhe Xhuma Xhami.<sup>42</sup> Njihet edhe si Xhamia Atik-Xhamia e Vjetër.

Duhet të cekim se konstruksioni i kishës nuk është prekur fare vetëm piktura murale-freskat janë mbuluar me suva ngase besimi islam nuk lejon portrete të njerëzve. Në bazë të regjistrit të Vakëfeve të vitit 932-1525/26 kuptojmë që ky objekt ende nuk e kishte minaren por ishte mesxhid.<sup>43</sup>

Mbi kambanarë më vonë është ngritur një minare dhe paraqitet si xhami në vitin 944-1537/38. Hatib në këtë xhami ishte Mevlana haxhi Shabani.<sup>44</sup> Edhe në regjistrimin e përgjithshëm të Sanxhakut të Prizrenit, të përmbledhur rreth vitit 1550, del si Xhamia e Sulltan Mehmet-hanit.<sup>45</sup> Duke u bazuar në mbishkrimin që gjendet në murin e objektit, M. Shukriu mendon se ngritja e minares mbi kambanarë u bë në vitin 1756.<sup>46</sup> Tahir efendiu thekson se ajo është shkatërruar (kupto dëmtuar) dhe e kanë rinovuar banorët tanë,<sup>47</sup> pasi minarja e vjetër ishte dëmtuar mbi kumbonare ndërtohet një minare e re me sheref në vitin 1858/59.<sup>48</sup> Tahir efendiu ishte autor i epigrafit të këtij renovimi të vitit 1858 të Xhuma Xhamisë.<sup>49</sup>

<sup>42</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane, Prishtinë, 2011, f. 101; Hasan Kaleši, Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda, Gjurmime Albanologjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 92.

<sup>43</sup> Osmanli Arsiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arki-vore osmane, Istanbul 2007, f. 413.

<sup>44</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 167.

<sup>45</sup> Татјана Катич, Опширни попис Призренског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 51.

<sup>46</sup> Muhamed Shukriu, Prizreni i Lashtë-Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, Prizren 2001, f. 346.

<sup>47</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane, Prishtinë, 2011, f. 101.

<sup>48</sup> Në vitin 1994 Av. A. Suroy, e solli nga Stambolli një Listë nga “*Tapu Defter Kayitlarina- Prizren Camileri*”, një fotokopje të këtij dokumenti e kemi në bibliotekën tonë personale.

<sup>49</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane, Prishtinë, 2011, f. 81.

Sipas regjistrit të Vakëfnimeve të vitit 932-1525/26 figuron vakëfi i Mesxhidit të Sulltan Mehmet Hanit,<sup>50</sup> vakëfnimi i Xhuma Xhamisë figuron edhe në regjistrin e Vakëfnimeve të datës 28 qershor 1283-1866/67.<sup>51</sup>

Në vitin 1912, gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Prizreni u pushtua nga ushtria serbe.<sup>52</sup> Pas disa ditësh, pra në nëntor 1912, te pjesa e poshtme e minares në kambanar, serbët kishin vendosur një kambanë me një mbi-shkrim.<sup>53</sup> Pushteti i Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene në vitin 1918, në Xhuma Xhaminë e Prizrenit, ndaloi zhvillimin e ceremonive fetare islame. Banorët e kësaj lagjeje në afërsi blejnë një shtëpi dhe e adaptojnë si Mesxhid. Në vitin 1923 okupatori e rrënoi minaren e Xhuma Xhamisë dhe atë e rikthyen në kishë.

Për imamët e kësaj xhamie pas vdekjes së hoxhë Lytfullahut, në vend të tij në xhaminë e Fatih Sulltan Mehmetit, më 19 maj të vitit 1804 ishte caktuar i vëllai Sejfullahu.<sup>54</sup> Imami i fundit i xhamisë kishte qenë Fejzullah Fluku.

Sipas studiueses E. Shukriu, monumenti ka shtatë faza të ndërtimeve dhe të rindërtimeve. Dhe faza e VI përfshin kohën e shndërrimit të kishës në xhami. Faza e VII, është ajo kur xhamia shndërrohet përsëri në kishë.<sup>55</sup>

Objekti gjendet në ngastrën kadastrale 2387, listën poseduese 2974, dhe me vendimin 352 të vitit 1948 merret në mbrojtje të shtetit.<sup>56</sup> Objekti, për shkak të vlerave që i ka, është regjistruar në Raportin teknik të

<sup>50</sup> Osmanli Arsiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413.

<sup>51</sup> T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 28/06/1283 – Hicri Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0190 Sıra No-1502.

<sup>52</sup> Prizreni në dokumente osmane, përgatitën Ayten Ardel & Edib Agagjyshi, Alsar, Tiranë, 2021, f. 31.

<sup>53</sup> Др. Серафим С. Николић, Призрен од средњег века до савременог доба урбанистичко-архитектонски развој, Призрен, 1998, f. 340.

<sup>54</sup> Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 258.

<sup>55</sup> Dr. Edi Shukriu, Kisha e Shën Premtes në Prizren, Buletin i Fakultetit Filozofik XXI / 1991, Prishtinë, 1993, f. 96-97, 99.

<sup>56</sup> Një fotokopje të këtij dokumenti e kemi në bibliotekën tonë personale.

UNESCO-s PP/1975-76-76/3.3.411.6.<sup>57</sup> Në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme ka hyrë më 26.06.2023 me nr. 3390/2023. Statusi 69/2016 (Zonë e Veçantë e Mbrojtur, Ligji Nr. 03/L-039) me numër unik në Databazë 1974.<sup>58</sup>

### 2.3. Xhamia “Mevlana Xhafer Efendi” (Jeni Mahallë)

Kjo xhami në popull dhe në shkrime njihet me disa emra si Mevlana Xhafer Efendi (ngjitur me xhaminë e ka tyrben), Xhamia Xhedid-Xhamia e Re, dhe në popull si xhamia e Jeni Mëhallës.

Gjendet në hapësirën ndërmjet namazxhahut dhe Xhuma Xhamisë. H. Kaleshi është i mendimit se kjo xhami është ngritur pas Xhuma Xhamisë (Atik-Xhamisë së vjetër prandaj quhet Xhamia e Re) dhe e konsideron si xhaminë e dytë të ngritur në Prizren. Në Vakufnamenë e Mehmet Kukli beut të vitit 944/1538, në mesin e dëshmitarëve figuron edhe hatibi i Xhamisë Xhedid (Xhamia e Re) që ishte Mevlana Mehmedi i biri i Mustafës.<sup>59</sup>

Sipas Tahir efendiut: *“Dervish Çelebiu e ngriti xhaminë...edhe këtë e meremetonin banorët tanë...pranë saj është varrosur Xhafer efendi, që ka rënë dëshmor në kohën e ngritjes së xhamisë”*.<sup>60</sup> Në gurin mbivarror të Xhafer efendiut shënon viti i vdekjes së tij 1585.

Në Defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571, del vakëfnimi i mesxhidit të Dervish Çelebiut.<sup>61</sup> Njëjtë ky vakëfnim del edhe në regjistrin e vakëfnimeve, të vitit 978-1570/71.<sup>62</sup> Në Regjistrin e Vakëfeve të vitit

<sup>57</sup> MM. V. Planque et J. Sonnier, preservation et mise en valeur du patrimoine monumental de Prizren, province de Kosovo, Document a diffusion restreinte Rapport Technique PP/1975-76/3.411.6, n. De serie FMR?CC/CH?76?162, UNESCO, Paris, 1976, A3. f.13.

<sup>58</sup> Databaza e MKRS të Republikës së Kosovës.

<sup>59</sup> Hasan Kaleshi i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 167.

<sup>60</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane, Prishtinë, 2011, f. 96.

<sup>61</sup> Татјана Катич, Опширни попис Призренског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 552.

<sup>62</sup> Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul, 2007, f. 413.

1253-1837/38 figuron si xhamia e Dervish Çelebisë, dhe kjo na jep të drejtë që të konstatojmë se para këtij viti mesxhidit i është ndërtuar minarja, dhe ajo është shndërruar në xhami.<sup>63</sup> Edhe kjo faltore, sikurse të tjerat, është dëmtuar ose rrënuar gjatë vitit 1689, nga ana e ushtrisë habsburgase.

Xhamia e kishte themele të murosura me guri të lidhura me llaç balte, muret ishin të ndërtuara prej qerpiçi të lidhur me llaç balte me hatulla horizontale. Xhamia ka pasur hajatin. Muret e jashtme, të brendshme dhe minarja e xhamisë kanë qenë me suva.

Xhamia e kishte edhe mektebin e vetë.<sup>64</sup> Dhe, në bazë të deklaratave të disa pleqve të lagjes, oborri i xhamisë ka qenë shumë më i madh, mirëpo dikush prej fqinjëve ka uzurpuar pjesë nga oborri e mejtepi i xhamisë.

Pasi xhamia ka qenë e ndërtuar me material jo të fortë, dhe nga rritja e numrit të xhematlinjve shumë herë ka pasur meremetime, madje dhe pa kritere, sikurse gjatë viteve 1988-1989, pastaj 1991-1996, edhe hyrja në xhamia nga pjesa e oborrit u mbyll, dhe është hapur e reja, nga rruga kryesore. Në investimet e viteve 2005-2006 pothuajse komplet u ndryshua struktura e hapësirave të xhamisë. Nga e vjetra ka mbetur vetëm minarja shumëkëndëshe dhe tyrbja.

Në Listën e trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS-së të Kosovës (06.10.2023-06.10.2024) Nr. 5123, 2023-02 dt. 06.10.2023 xhamia hyn në kategorinë arkitekturore dhe në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Vendimit 1442/57, nr. Unik në Databazë 000393.<sup>65</sup>

#### 2.4. Xhamia “Jakub Bej Evrenoz”

Pas Musallës (namazxhahut) dhe Xhuma Xhamisë, objekti i tretë islam që është ndërtuar në Prizren në gjysmën e dytë të shekullit XV është

<sup>63</sup> T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 08/09/1253 – Hicri Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0016 Sıra No-0101.

<sup>64</sup> Mr. Hamit Altıparmak'in tüm bilimsel çalışmaları, Kosova – Prizren'de osmanli eserleri, hazırlayan: Osman Baymak, Prizren, 2001, f. 297-299.

<sup>65</sup> Një fotokopje të këtij dokumenti e kemi në bibliotekën tonë personale.

mesxhidi i donatuar nga Jakub bej Evrenozi, i cili ishte rikabdar (zyrtar i odës së Sulltan Fatihut) dhe komandant i parë i kështjellës së Prizrenit, i cili ka disponuar të ardhura të vogla.<sup>66</sup> Njëra prej katër mëhallëve myslimane në Prizren deri në fund të shekullit XV ishte edhe mëhalla e Jakub beut, ndryshe njihej edhe si Mëhalla e Çarshisë, në krye të saj ishte Imami i mesxhidit të Jakub beut.<sup>67</sup> Edhe në Vakufnamenë e Kukli beut (1538), vërtetohet që këtë faltore para vitit 1526 e ngriti Jakub bej Evrenozi. Ajo ndryshe quhet edhe Xhamia e Jakub pashës - Jakup dedesë,<sup>68</sup> në popull njihet edhe si Xhamia e Arastës.

Sipas Tahir efendisë për t'u falur dyqanxhinjtë, Jakub beu fillimisht e ndërtoi mesxhidin i cili shpesh herë është restauruar, pastaj i ndërtohet minarja dhe shndërrohet në xhami, kështu fillon mbushja e hapësirës rreth saj me objekte të reja të banimit dhe ato ekonomike.<sup>69</sup> Në Defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1590/91, përmendet Mëhalla e Çarshisë, gjegjësisht e Jakub beut.<sup>70</sup>

Faltorja është ndërtuar në bërthamën e qytetit të Prizrenit dhe sipas fotografisë konstatohet se kishte përdhesen dhe katin dhe ishte me plani-

<sup>66</sup> Tatjana Katic, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 106-107; Tatjana Katic, *Опширни попис Призренског санџака из 1571. године*, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 551.

<sup>67</sup> Tatjana Katic, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 111-112, 121.

<sup>68</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 159.

<sup>69</sup> Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleši, Ismail Eren, *Prizren Kitabeleri, Vakıflar dergisi*, sayı VII, İstanbul, 1968, f. 82; Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 159; Prof. Dr. Esat Haskuka, *Ura, Çarshia, Xhamia dhe Lagjja Arasta*, Prizren, 1999, f. 22-23; Tatjana Katic, *Опширни попис Призренског санџака из 1571. године*, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 551.

<sup>70</sup> Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII Administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982, f. 251.

metri drejtkëndëshe, kulmi ishte me konstruksion druri dhe ishte me katër faqe (ujor).

Kati i epërm i xhamisë kishte shërbyer për falje të namazit, ku i zinte rreth 200 vetë, kthinat e katit përdhes shfrytëzoheshin nga ana e tregtarëve dhe zejtarëve si depo, njëjtë për zejtari për një kohë kishte shërbyer edhe oda e xhamisë në përdhese.<sup>71</sup>

Mesxhidi, ka funksionuar fillimisht përmes dhuratave të banorëve të thjeshtë. Për mbajtjen e mesxhidit Jakup Beu kishte vakëfnuar shtatë dyqane dhe mullirin me katër gurë. Në vitet e dyzeta të shekullit XVI, mesxhidi fitoi edhe dy dyqane, pastaj hoxhë Shabani kishte vakëfnuar edhe gjashtë dyqane, kurse zonja Kalqa kishte vakëfnuar dhe katër dyqane të tjera, dhe numri i dyqaneve në posedim të xhamisë ishin 19.<sup>72</sup>

Vakëfnimi i mesxhidit të Jakub beut është vërtetuar në vitin 926-1519/20 dhe 974-1566/67, dhe në vitin 1224-1809/10.<sup>73</sup> Në regjistrimin Osman të vitit 1530/31 figuron vakëfnimi i Jakub beut, komandantit të kalasë së Prizrenit.<sup>74</sup>

Vakëfnime të Ahmet bej Evrenozit (babait të Jakub beut) i gjejmë të vërtetuara në vitet: 1519/20, 974-1566/67, pastaj në regjistrimin e vitit 1530/31, në defterin e vitit 1571 përmendet vakëfnimi i të ndjerit Ahmet beg B. Evrenozit i cili ka vdekur në vitin 1506.<sup>75</sup> Në një dokument të dat-

<sup>71</sup> Prof. Dr. Esat Haskuka, Ura, Çarshia, Xhamia dhe Lagjja Arasta, Prizren, 1999, f. 22-23.

<sup>72</sup> Татјана Катич, Османизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 107-108; Татјана Катич, Опширни попис Призренског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 551.

<sup>73</sup> Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413; T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 23/11/1224 – Hicri Prizren, Defter No-171/0 Sayfa No-0088 Sıra No-0683.

<sup>74</sup> Dr. Olga Zirojević, Vučićrnski i Prizrenski Sandžak u svetlosti Turskog Popisa 1530/31 godine, Gjurmime Albanologjike 2, 1968, viti VII (I) Prishtinë, 1969, f. 113-114.

<sup>75</sup> Dr. Olga Zirojevic, Vucitrnski i Prizrenski Sandjak u svetlosti Turskog Popisa 1530/31 godine, Gjurmime Albanologjike 2, 1968, viti VII (I) Prishtinë, 1969, f. 113-114; Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413; Татјана Катич, Опширни попис Призр-

ës 14 maj 1565, dëshmohej që myteveli-administrator i vakëfeve të Evrenoz beut (gjyshit të Jakub beut) ishte Mustafa beu.<sup>76</sup> Mendohet se Jakub beu i ka trashëguar edhe vakëfet e babait dhe gjyshit të tij. Është interesante të ceket se prej kaq shumë vakëfnimeve për arsye të panjohura sipas regjistrimit të vitit 1571 faltores i kishin mbetur vetëm pesë dyqane dhe mulliri.<sup>77</sup>

Me kalimin e kohës objekti u restaurua disa herë. Për restaurim dy herë i kishte dhënë nga 1000 lira të arit sulltan Reshati (sundoi 1909-1915 P.K.).<sup>78</sup> Xhamia është dëmtuar gjatë viteve 1853 dhe 1913 për shkak të zjarrit.<sup>79</sup> Zjarri i fundit është shkaktuar qëllimisht nga ana e pushtesit serbë të cilët e dogjën pjesën më të madhe të Arasta Çarshisë dhe urën e saj me dyqane.

Nga prizrenasit edhe sot kujtohet me respekt imami i xhamisë hafiz Fetiu, i cili ka pasur 12 mekamet e zërit për thirrje të ezanit.<sup>80</sup>

Sipas Planit të përgjithshëm urbanistik të Prizrenit, xhamin e Jakub bej Evrenozit e rrethuan në vitin 1963 së cilës ia lanë vetëm minaren, duke ia hequr suvanë e jashtme, atë e restauruan dhe e konservuan.<sup>81</sup> Në vi-

нског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна изданја књига 58, Београд, 2010, ф. 551.

<sup>76</sup> Prizreni në dokumente osmane, përgatitën Ayten Ardel & Edib Agagjyshi, Alsar, Tiranë, 2021, 43.

<sup>77</sup> Tatjana Katic, Османлизованије средњовековног града: Урбани и демографски ре-звој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, ф. 107-108; Tatjana Katic, Опширни попис Призренског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна изданја књига 58, Београд, 2010, ф. 551.

<sup>78</sup> Prof. Dr. Esat Haskuka, Ura, Çarshia, Xhamia dhe Lagjja Arasta, Prizren, 1999, f. 22-23.

<sup>79</sup> Prof. Dr. Esat Haskuka, Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve, Prizren 2003, f. 217.

<sup>80</sup> Deklarim i Hoxha Muharrem Haxhi (ish Imam i xhamisë “Maksut Pasha”), i lindur më 1952 në Prizren, më 24.01.2024, ai së bashku me familjen janë kujdesur edhe për hafëzin.

<sup>81</sup> Muhamed Shukriu, Prizreni i Lashtë-Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, Prizren 2001, f. 329.

tin 2022 u larguan dy kioske që kanë qenë prej vitesh të vendosura pranë minares kurse në vitin 2023 u largua edhe pisha që kishte filluar të rrezikonte minaren.

Minarja gjendet në ngastrën kadastrale 2024 KK-Prizren, u vlerësua përmendore kulturore me aktvendimin nr. 1300/1970 të Entit për Mbrojtjen Përmendoreve Kulturore-Prizren.<sup>82</sup>

Në Listën e trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës (06.10.2023-06.10.20240) Nr. 5123, 2023-02 dt. 06.10.2023 Minarja e xhamisë së Arastës është i kategorisë “Arkitekturore” hyn në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Vendimit 1442/57, nr. Unik në Databazë 001395.<sup>83</sup>

## 2.5. Xhamia “Sejdi Beu” (Ajaz Beut)

Në Prizren njëra prej mëhallëve myslimane në fund të shekullit XV ishte edhe ajo e Ajaz Beut. I cili gjatë viteve 1470-1484 kishte ushtruar funksionin e sanxhakbeut në disa vise të Ballkanit, dhe besohet se kishte qenë edhe sanxhakbej i Prizrenit, ai kishte vakëfnuar në Prizren, për mesxhidin e tij, pesë dyqane, një mulli dhe një vresht.<sup>84</sup>

Sipas T. Katiç, në gjysmën e dytë të shekullit XV, Ajaz beu në mëhallën e tij e ndërtoi mesxhidin. Dhe sot aty gjendet xhamia e Sejdi beut, i ngritur në shekullin XVII, dhe studiuesja e lartcekur shkruan se: “*ka gjasë që Sejdi-beu përtëriu mesxhidin e Ajaz beut*”.<sup>85</sup>

Sipas Ayverdit, Sejdi beu prej fitimeve të tija filloi ndërtimin e mesxhidit në vitin 1650. Edhe studiuesi E. Haskuka, thotë se u ndërtua në

E. Haskuka është i mendimit që në vitin 1963 e rrënojnë xhaminë, Prof. Dr. Esat Haskuka, Ura, Çarshia, Xhamia dhe Lagjja Arasta, Prizren, 1999, f. 22-23.

<sup>82</sup> Arkivi i QRTK Prizren.

<sup>83</sup> Databaza e MKRS të Republikës së Kosovës.

<sup>84</sup> Tatjana Katiç, Опширни попис Призренског санџака из 1571. године, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 552, 556, 55.

<sup>85</sup> Tatjana Katiç, Османованје средњовековног града: Урбани и демографски резвој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 108- 109.



mesin e shekullit XVII.<sup>86</sup> Kjo xhami ka pasur dhe mejtepin. Në bazë të traditës të ruajtur thuhet se Sejdi beu, në një fushatë ushtarake ishte plagosur dhe kthehet në Prizren, ku ndërton në bërthamën urbane në çarshinë një shatërvan, mesxhidin dhe pranë saj një shtëpi të vogël ku edhe pas ca vitesh aty edhe ndërton jetë.<sup>87</sup> Si duket më ai nuk kishte marrë pjesë në fushata ushtarake, por i kushtohet edhe ngritjes së përshpirtshmërive të tija dhe ndërton edhe një mesxhid në lagjen Kurillë.

Xhamia ka planimetri katrore, themelet i ka prej guri të lidhura me llaç balte, murrët i ka të ndërtuara nga qerpiçi po njashtu të lidhura me llaç balte dhe muret janë të lidhura me hatulla horizontale. Kulmi ka konstrukcionin e drurit me maje dhe është me katër faqe (ujor), të cilat ishin të mbuluara fillimisht me rasa guri më vonë me qeramidhe (tjegulla) të luguar tradicionale, më vonë janë vendosur tjegulla mediterane. Dritaret janë pa harqe, e gjithë pjesa e mureve të jashtme dhe ato të brendshme kanë qenë të suvatuara. Dera e hyrjes në objektin e xhamisë është me hark rrethet e saja janë me gurë të latuar. Në hajatin e jashtëm të xhamisë është edhe një mihrab.<sup>88</sup>

Gjatë luftës osmano-habsburgase në nëntor të vitit 1689 edhe kjo xhami ka pësuar keq, dhe pas një kohe është rindërtuar. Në oborr në hyrje të xhamisë është i varrosur Hakim Baba që ka vdekur nga mortaja në vitin 1689/90. Sipas Imamit të xhamisë, ushtarët habsburgas edhe mbishkrimin e kanë eliminua, dhe pas largimit të kësaj ushtrie pas një kohe është krye rindërtimi i objektit.<sup>89</sup>

<sup>86</sup> Mr. Hamit Altiparmak'in tüm bilimsel çalışmaları, Kosova-Prizren'de osmanli eserleri, hazirlayan: Osman Baymak, Prizren, 2001, f. 267; Prof. Dr. Esat Haskuka, Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve, Prizren 2003, f. 220.

<sup>87</sup> Deklaratë e djalit të ish myezinit të xhamisë "Maksut Pasha" haxhi Aqif efendiut z. Abidin (Aqif) Skenderi, i lindur në vitin 1953, dhënë më 27.01.2024 në Prizren.

<sup>88</sup> Parim Kosova, hulumtimet e zhvilluara gjatë vitit 2002, 2015.

<sup>89</sup> Deklaratë e Imamit të xhamisë Sejdi Beu, z. Lutfi (Nexhat) Ballëk, (është imam në këtë xhami që nga viti 2005) i lindur në Prizren më 14.08.1971, dhënë më 20.02.2024.

Në regjistrin e Vakëfnameve të vitit 1290-1873/74, figuron Vakëfi i Sejdi Beut.<sup>90</sup> Kjo dhe disa xhami të tjera të Prizrenit që ishin të ndërtuara me qerpiç pra me material jo të fortë shpesh herë janë rinovuar. Nga ana e dy mbishkrimeve të gdhendura në mermer që gjinden njëra mbi derën e oborrit të xhamisë e tjetra mbi derën e hyrjes në xhami mësojmë se xhamia është rinovuar në vitin 1226/1811 nga ana e Abdurrahman agës.<sup>91</sup> Rinovimi i serishëm ishte bërë në vitin 1290-1873/74 nga ana e haxhi Halitit.<sup>92</sup>

Në vitin 1988 nga ana e esnafit të Prizrenit është bërë një meremetim, edhe gjatë vitit 1994 është krye një meremetim me ç'rast është suvatuar dhe minarja. Në vitin 2006 në pjesën e djathtë nga ana e mihrabit, është ndërtuar një aneks, i cili shërben xhamisë si mekteb për mësim-besim.<sup>93</sup> Kurse në vitin 2014-2015, nga ana e MKRS, nën mbikëqyrjen e QRTK-së, minarja u restaurua dhe iu hoq suvaja dhe u bë fugimi dhe riparimi i kulmit.<sup>94</sup>

Xhamia e Sejdi Beut, figuron në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme të Ministrisë Kultures Rinisë dhe Sportit të Kosovës (01.10.2014-10.10.2015) në faqe 2.<sup>95</sup>

<sup>90</sup> T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 08/09/1253 – Hiçri Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0016 Sıra No-0101.

<sup>91</sup> Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleşi, Ismai Eren, Prizren Kitabeleri, Vakıflar dergisi, sayı VII, İstanbul, 1968, f. 84.

<sup>92</sup> Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleşi, Ismai Eren, Prizren Kitabeleri, Vakıflar dergisi, sayı VII, İstanbul, 1968, f. 92; Prof. Dr. Esat Haskuka, Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve, Prizren 2003, f. 220.

<sup>93</sup> Deklaratë e Imamit të xhamisë Sejdi Beu, z. Lutfi (Nexhat) Ballëk, (është imam në këtë xhami që nga viti 2005) i lindur në Prizren më 14.08.1971, dhënë më 20.02.2024.

<sup>94</sup> Deklaratë e IDA (inxh. dipl. Ark) Jusuf Xhibo, punonjës në QRTK Prizren, dhënë më 27.01.2024.

<sup>95</sup> Disponojmë një fotokopje të këtij dokumentit.

## 2.6. Xhamia “Iljaz Kuka”

Në mëhallën e Ajaz beut në gjysmën e dytë të shekullit XV Iljaz Kuka ka ngritur mesxhidin e tij dhe ndër këtë mëhallë ishte krijuar mëhalla e tij, e cila edhe sot quhet me këtë emër.<sup>96</sup> Mëhalla në fjalë përmendet edhe në Vakëfnamenë e vitit 919/1513 të Suzi Prizrenasit, i cili në këtë mëhallë kishte financuar ndërtimin edhe të mesxhidit të tij (Suziut).<sup>97</sup>

Përveç T. Katiçit, e cila argumenton se mesxhidi është ndërtuar nga ana e Iljaz Kukës, edhe studiuesi N. Krasniqi është i mendimit që këtë xhami vetë Ilijaz Kuka e ka ngritur, dhe ai ishte gjyshi i Mehmet Hajrudin Kukli beut.<sup>98</sup> Studiuesi H. Kaleshi, duke e analizuar Vakëfnamenë e Mehmet Kukli beut dhe shkrimin e vitit 1317/1897-98, që ndodhet në murin e brendshëm të xhamisë, thekson se këtë mesxhid e ka ndërtuar Mehmet Kukli beu, në emër të Iljazit, gjyshit të tij, i cili kishte marrë pjesë në pushtimin e Prizrenit.<sup>99</sup>

Sipas Kaleshit, mesxhidi ndërtohet në vitin 1534-35, më vonë i bashkëngjitet edhe minarja<sup>100</sup>, kurse T. Katiç shkruan se Mehmet Kukli Begu

<sup>96</sup> Tatjana Katiç, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 108-109.

<sup>97</sup> Dr. Sc., *Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Prishtinë, 2011, f. 139; Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 146.

<sup>98</sup> Dr. sc. Nehat Krasniqi, *Kontribute Albanologjike, Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Prishtinë, 2011, f. 139; Tatjana Katiç, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 108-109.

<sup>99</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 146; Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleši, Ismail Eren, *Prizren Kitabeleri, Vakiflar dergisi*, sayı VII, Istanbul, 1968, f. 94.

<sup>100</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 147; Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleši, Ismail Eren, *Prizren Kitabeleri, Vakiflar dergisi*, sayı VII, Istanbul, 1968, f. 94.

vetëm e ka meremetuar mesxhidin e gjyshit të tij, Iljazit.<sup>101</sup> Në bazë të këtij burimi më të hershëm, i bie që mesxhidin në fjalë e kishte ndërtuar Iljaz Kuka. Në Defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1590/91, sërish përmendet Mëhalla Iljaz Kuka edhe me emrin tjetër Azkuçan.<sup>102</sup>

Xhamia Iljaz Kuka fillimisht ka pasur planimetri katrore me themele të murosura me guri të lidhura me llaç gëlqereje, muret i ka të ndërtuara me gurë lumor po ashtu të lidhur me llaçi gëlqereje, në disa pjesë të mureve është përdorur dhe tulla e pjekur. Muret kanë dhe hatulla horizontale dhe dritare. Më vonë me mbylljen e hajateve objekti merre planimetri drejtkëndëshe.

Xhamia sallën e lutjeve e ka të mbuluar nga brenda me kube, kurse nga jashtë kulmi i xhamisë së bashku me atë të hajatit tani është një tërësi me konstruksion druri është me katër faqe (ujor), të cilat ishin të mbuluara fillimisht me rasa të holla guri më vonë me qeramidhe (tjegulla) të luguar tradicionale e tani është e mbuluar me tjegulla fabrikale. Mihrabi i xhamisë ka pak dekorime të ngjyrosura, xhamia ka minber dhe mahvilin të mbështetur në hashabe.

Për meremetimin e minares nga ana e Mehmet bin Osman efendiut mësojmë nga shkrimi i vitit 1213/1798 që gjendet në anën e djathë të murit nga hyrja e xhamisë, por kurë është ndërtuar minarja nuk jepet informata.<sup>103</sup> Është e vetmja xhami në Prizren që minaren e ka të anuar ma se një shekull, ka lakim prej bazës deri te sherefja në drejtimin jugperëndimor dhe nga sherefja deri tek alemi i saj është anuar në drejtimin verilindor.<sup>104</sup>

<sup>101</sup> Татјана Катич, Османизовање средњовековног града: Урбани и демографски резвој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 118.

<sup>102</sup> Skender Rizaj, Prizreni deri te Tanzimati (1839), Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike XIII – 1983, Prishtinë, 1984, f. 62, 70.

<sup>103</sup> Hasan Kaleši i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 146.

<sup>104</sup> Parim Kosova, rezultatet nga hulumtimet në terren 2002, 2003 dhe 15 janar 2024.

Në regjistrin e Vakëfeve të vitit 1252 -1836/37 dhe të vitit 1281-1864/65 figurojnë vakëfnimet e xhamisë së Iljaz Kukës.<sup>105</sup>

Në pjesën jugperëndimore të xhamisë, ka qenë edhe objekti i Mektebit, të cilën pushteti komunist e shndërroi në zyre dhe sallë për konferenca për Këshillin Popullor të lagjes më vonë shërbeu për nevoja të bashkësisë Lokale. Nga ana e Bashkësisë Islame në vitin 1979 aty u ndërtua një lokal afarist.

Muret e oborrit të xhamisë janë me dritare me harqe me kanxhela dhe derën e hyrjes në oborr po ashtu e ka me pjesën e sipërme me hark.

Edhe kjo xhami ka përjetuar fatin e faltoreve të tjera islame gjatë vitit 1689, po sa ka qenë e dëmtuar nuk kemi shënime, si edhe nuk e dimë se kur është rindërtuar ose meremetuar pas kësaj fatkeqësie. Me kalimin e kohës xhamia ka përjetuar meremetime të shumtë. Përmes shkrimit të vitit 1317/1897-98 që ndodhet në brendësi të murit të xhamisë, ku shkruan se është kryer rinovimi i xhamisë nga ana e myteveiliut të vakëfeve Ahmet Beu (që ka qenë i farefisnisë të Iljaz Kukës) dhe me këtë xhamia ka pësuar ndryshime të mëdha njëherësh edhe dekorimet murale janë kryer me këtë rast.<sup>106</sup> Meremetimet janë bërë në xhami edhe gjatë viteve 1990, 1992, 2005.

Në Listën e trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës (06.10.2023-06.10.2024) Nr. 5123,2023-02 dt. 06.10.2023 xhamia është e kategorisë “Arkitekturore” dhe hyn në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Vendimit 1442/57, nr. Unik në Databazë 000350.<sup>107</sup>

<sup>105</sup> T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 12/10/1251 - Hicri, Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0100 Sıra No-0780; T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 03.03.1211 - Hicri, Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0218 Sıra No-1714.

<sup>106</sup> Hasan Kaleşi i Ismail Redžep, Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine, Prilozi za Orijentalnu filologiju, VIII-IX, 1958-9, Sarajevo, 1960, f. 146; Kemal Özergin, Dr. Hasan Kaleşi, Ismail Eren, Prizren Kitabeleri, Vakıflar dergisi, sayı VII, İstanbul, 1968, f. 94.

<sup>107</sup> Databaza e MKRS të Republikës së Kosovës.

## 2.7. Xhamia “Katib Sinani”

Në gjysmën e dytë të shekullit XV është ndërtuar mesxhidi i Sinan Katibit, në fund të atij shekulli përmendet edhe mëhalla me emrin e tij, në krye të mëhallës ishte imami i këtij mesxhidi.<sup>108</sup> Edhe Vakëfi i Mesxhidit të Sinan Katibit i regjistruar në vitin 926/1519-1520 është dëshmi që faltorja është ndërtuar para këtij viti.<sup>109</sup> Mëhalla me emrin Sinan Katibi paraqitet edhe në vitin 1530.<sup>110</sup> Në defterin e vitit 1000-1590/91, përmendet sërish kjo mëhallë dhe kishte 71 shtëpi.<sup>111</sup>

Njihet në popull edhe si Xhamia e Shkurt, ngase minarja e parë kishte qenë e ultë, njihet dhe si Xhamia Velishah, për arsye se aty ndodhej tyrbja e Veli Shah Babës që kishte ndërruar jetë në vitin 1570, tyrbja është eliminuar në vitin 1996.<sup>112</sup>

Në vakëfin e vitit 974-1566/1567, faltorja figuron ende mesxhid, kurse në regjistrin e vakëfnimeve të vitit 1205-1790/1791, ajo figuron si xhami.<sup>113</sup> Vakufi i mesxhidit të Sinan Shkruesit në regjistrimin e Defterit të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571 kishte vetëm një mulli.<sup>114</sup>

<sup>108</sup> Tatjana Katic, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 108-109.

<sup>109</sup> Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413.

<sup>110</sup> Tatjana Katic, *Osmанизованје средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека*, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 125.

<sup>111</sup> Skender Rizaj Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII Prishtinë, 1982, f. 251; Skender Rizaj, *Prizreni deri te Tanzimati* (1839), Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike XIII – 1983, Prishtinë, 1984, f. 62, 65.

<sup>112</sup> Në murin lindor të xhamisë ka qenë e vendosur pllaka e mermertë me shënimin se aty pushon Veli Shah Baba që kishte ndërruar jetë në vitin 1570, disponojmë foto të pllakës.

<sup>113</sup> Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413; T.C. Başbakanlık, Vakıflar Genel Müdürlüğü, Vakıf Listesi, 26/08/1205-Hicri Prizren Defter No-171/0 Sayfa No-0006 Sıra No-0022.

<sup>114</sup> Tatjana Katic, *Опширни попис Призренског санџака из 1571. године*, Историјски Институт, посебна издања књига 58, Београд, 2010, f. 553, 555.

Xhamia ka bazë katrore e tërë xhamia është e ndërtuar prej gurit të lumit, materiali lidhës ndërmjet gurëve është llaçi gëlqerorë, skajoret e objektit, të dritareve dhe derës hyrëse janë me gurë të latuar. Dera hyrëse në xhami dhe të gjitha dritaret janë me harqe dritaret e poshtme kanë dhe kanxhela hekuri. Muret e jashtme dhe ato të brendshme kanë qenë të suvatuara me llaç gëlqereje. Xhamia është me kupolë e ndërtuar me material të fortë e mbuluar me llamarinë plumbi. Minarja e xhamisë është 16 këndorë i ndërtuar me gurë të latuar dhe i suvatuar. Në hajatin e xhamisë në pjesën e majtë është edhe një mihrab.<sup>115</sup>

Kjo xhami, si dhe të tjerat në Prizren, është shkatërruar gjatë vitit 1689, nga ana e ushtrisë habsburge, pastaj është rindërtuar dhe ka pasur edhe meremetime të mëvonshme.

Studiuesi S. Mehmeti shkruan: *“Xhamia e Sinan Katibit në vitin 1893/4 ka njohur një renovim dhe meremetim të theksuar. Këtë e dëshmon edhe mbishkrimi/kronogram në gjuhën osmane që ruhet mbi derën e kësaj xhamie, e të cilin e ka shkruar poeti “Hifzi”-u, me shkrimin arab t’alik në të gdhendur në një pllakë mermeri”*. Dhe poeti “Hifzi” është hafiz Abdylaziz ef. Ahmet Kurtishi, i biri i Zejnelabidinit, i cili ishte myderriz në medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren dhe po ashtu edhe myfti i Prizrenit.<sup>116</sup>

Në vitin 1927 pjesa e madhe e oborrit të xhamisë së Qatip Sinanit ishte marrë me motivacion kinse të zgjerimit të rrugës, por në fakt zbatohet plani urbidicial i Korunoviçit, për këtë arsye minarja e bukur me she-refin e dekoruar ka mbetur në tretuar.

Nuk arritëm të sigurojmë të dhëna se gjatë meremetimit të vitit 1893/4 apo të viteve të fundit njëzeta të shekullit të kaluar është suvatuar eksterieri i jashtëm i xhamisë dhe i hajateve me fasadë neoklasike etj.

Gjatë viteve 1992, 1997, u bë renovimi i xhamisë, u krye suvatimi i minares si dhe i rrënuan muret e oborrit, duke u ndërtuar muri i ri me shtylla të betonta, të cilat u mbështollën me pllaka qeramike, e ndërmjet

<sup>115</sup> Hulumtimet e zhvilluara nga ana jonë gjatë viteve 1991-2024.

<sup>116</sup> Sadik Mehmeti, Mbishkrimi i xhamisë së Katib Sinanit në Prizren dhe autori i tij, Gjurmime albanologjike, Seria historike, nr. 50 (2020), Prishtinë, 2020, f. 81, 83-86.

shtyllave u vendosën kanxhela të hekurta, si dhe u bë rregullimi i çatisë së derës së oborrit.

Gjatë viteve 2015-2017 u bë dekorimi i mureve të brendshme të xhamisë, dekorimi i vjetër u eliminua. Në pjesën e poshtme të mureve të brendshme u vendosën pllaka qeramike.

Në pjesën juglindore të xhamisë ka qenë objekti i mejtepit me përdhese dhe kat. Në kate pos mësonjëtores ka qenë edhe dhoma e personelit. E cila gjatë viteve 1947-1986 ka shërbye si zyre e për nevoja të Këshillit Popullor, më vonë si zyre e Bashkësisë Lokale. Në vitin 1987 Këshilli i BI-së të Prizrenit e rrënoi objektin e vjetër dhe e ndërtoi një të re, ku në përdhese janë dy dyqane në kate dhe salla për aktivitete, e të cilën e shfrytëzon një shoqatë. Kurse në oborrin e saj të dikurshëm veri jugor janë ndërtuar dy dyqane.<sup>117</sup>

Në Listën e trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës (06.10.2023-06.10.20240) Nr. 5123, 2023-02 dt. 06.10.2023 Monumenti është i kategorisë “Arkitekturore” dhe hyn në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Vendimit 1442/57, nr. Unik në Databazë 000370.<sup>118</sup>

## 2.8. Xhamia “Ahmet Beu” Dukagjini

Ahmet bej Dukagjinzade ishte nipi i Lekë Dukagjinit dhe dhëndër i Sulltan Selimit I (1512-1520). Ky ka pasur poste të larta në Perandorinë Osmane, kurse nga dhjetori i vitit 1514, ederi në mars të vitit 1515 ishte Vezir i Madh. Në Prizren e ndërtoi mesxhidin në mëhallën e atëhershme të Xhuma Xhamisë, sot Mëhalla e Tabakhanes, e që në popull njihet si Xhamia e Ahmet beut dhe e Tabakhanes. Ahmet beu kishte ndërtuar jetë në vitin 1561.<sup>119</sup> Sipas këtyre burimeve, del se kjo xhami është ndërtuar pak vite para xhamisë së Suziut.

<sup>117</sup> Hulumtimet e bëra nga ana jonë gjatë viteve 1991-2024.

<sup>118</sup> Databaza e MKRS të Republikës së Kosovës.

<sup>119</sup> Skender Rizaj, Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Prishtinë, 1982, 286, 482; Тајјана Катич, Османизовање средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига



Pasi ishte i familjes zulmëmadhe të Dukagjinëve, jo rastësisht në raportin e vitit 1838 për Kosovën, ish-punonjësi i konsullatës austriake në Shkodër, J. Müller, shkruan se në Prizren “...në pikëpamje historike, më e rëndësishmja është xhamia e Ahmedit”.<sup>120</sup>

Në regjistrin e vakëfnimeve në Ankara figurojnë dhe tri vakëfnime të Ahmet bej Dukagjinit, ajo e vitit 926-1520, pastaj e vitit 974-1566/67,<sup>121</sup> si dhe vakëfnimi që figuron në defterin e Prizrenit të vitit 1571, i cili ishte dedikuar për mbështetjen e Xhuma Xhamisë. Mëhalla e Tabakhanes, sipas regjistrimit të vitit 1571, i kishte 66 shtëpi.<sup>122</sup>

Xhamia ka planimetri katrore, me themele të murosura me gur të lidhur me llaç balte, muret janë të ndërtuar nga qerpiçi, të lidhur me llaç balte dhe me hatulla horizontale. Xhamia e ka edhe hajatin. Kulmi i xhamisë është me maje, me konstrukcion druri, dhe është me katër faqe (ujor), e mbuluar me tjegulla. Edhe kulmi i hajatit është me konstrukcion druri, të mbështetura në hashabë druri. Brendia e xhamisë e ka mihrabin, mahvilin, minberin. Muret e jashtme dhe të brendshme të xhamisë janë me suva. Në muret e brendshme nuk janë hasur gjurmë të pikturës murale. Minarja është e shkurtër, ndërsa ka formë cilindrike shumëkëndësh, të murosur me gur të latuar dhe me suva.

Xhamia, sikurse edhe të tjerat, ka pësuar dëmtime nga lufta osmano-austriake e vitit 1689, dhe më vonë këto dëme janë sanuar, për shkak se

LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 114; Татјана Катич, Опширни Попис Призренског Саџака из 1571. Године, Београд 2010, f. 556; Deklaratë e stërnipit të Ahmet bej Dukagjinzades z. Omar el Adli Beg Dukagin-zade, nga Damasku i Sirisë i cili jeton tani në SHBA, dhënë më 24 qershor të vitit 2021 në Prizren, na prezantoi edhe disa dokumente për xhaminë në fjalë dhe për një xhami tjetër në Prizren.

<sup>120</sup> Bedrush Shehu, Një raport i J. Müllerit për Kosovën në vitin 1838, Kosova – Kosovo, 5, Prishtinë-Pristina, 1976, f. 73.

<sup>121</sup> Osmanli Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti-Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Istanbul 2007, f. 413.

<sup>122</sup> Татјана Катич, Опширни Попис Призренског Саџака из 1571. Године, Београд 2010, f. 556. Татјана Катич, Османизовање средњовековног града: Урбани и демографски развој Призрена од половине 15 до краја 16 бека, Историјски Часопис, књига LXVII (2018): историјски Институт САНУ септембар 2019, f. 125.

objekti nuk është ndërtuar me material të fortë, prandaj gjatë shekujve ka pasur meremetime të shpeshta; ato të fundit janë kryer në vitin 1990 dhe 1997. Për shkaqe të këtyre ndërhyrjeve dhe përfshirjes së hajatit brenda objektit nga e vjetra ka mbetur vetëm gabariti i lartësisë së objektit dhe minarja.

Në Listën e trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të Përkohshme të MKRS të Kosovës (06.10.2023-06.10.2024) Nr. 5123,2023-02 dt. 06.10.2023 është monument arkitekturor, dhe hyn në nënkategorinë Monument/Ansambël nr. Vendimit 1442/57, nr. Unik në Databazë 000373.<sup>123</sup>

---

<sup>123</sup> Databaza e MKRS të Republikës së Kosovës.

Dr. Parim KOSOVA

## PRIZREN MOSQUES THROUGHOUT CENTURIES (I)

### Abstract

After the final fall of Prizren under Ottoman rule in 1459, the construction of the first mosques and masjids began, which were to serve as places of worship of god. During the Ottoman period, Prizren was one of the largest, most important, and most developed towns in the Balkans, after Edirne and Thessaloniki.

Due to its importance, as an economic, social, military, political, educational, religious, and administrative center, Prizren was one the towns with the highest number of mosques and Islamic monuments built during this time. Some of these monumental mosques have survived to this day, but others, due to socio-political circumstances and frequent wars have been destroyed and are known to us only thanks to historical documents.

This paper aims to present an overview of the current mosques as well as those that have been destroyed in the town of Prizren, the date of their construction, who built them, who funded their construction, reconstruction work in the past, and other related data.

**Keywords:** *Kosovo, Prizren, masjids, mosques, monuments*

Tatjana KATIĆ

## **TË ARDHURAT E KADILLËKUT TË PRIZRENIT NGA TREGTIA E MËNDAFSHIT DHE MINIERËS SË KORISHËS (1525-1544)\***

### **Abstrakt:**

Punimi paraqet përkthimin zyrtar të dokumentit financiar të Perandorisë Osmane, i cili përmban një pjesë të të ardhurave shtetërore të mbledhura në territorin e sanxhakut të Prizrenit, gjatë periudhës kohore 1525-1544. Në shkrimin e burimit osman, si dhe në hyrje të shkrimit, jepen shënime për minierën e Korishës, afër Prizrenit, të cilat të dhëna gjer tani nuk kanë qenë të njohur në historiografi. Dokumenti përmban edhe shënime për dhënien me qira të peshores për matjen e mëndafshit.

*Fjalët kyçe: Perandoria Osmane, defterët financiar (maliye defterleri), minierat, argjend, Korishë, Prizren, mëndafsh.*

### **Hyrje**

Defterët financiar (Maliye), gjegjësisht (Maliyeden mudevver defterleri, shkurtresa MAD), të cilët ruhen në Arkivin e Kryeministrit të së qeverisë në Stamboll, janë burimet më të rëndësishme për historinë ekonomike të Perandorisë Osmane. Ata përbëjnë shënime të detajuara të të gjitha burimeve, në dispozicion të të ardhurave shtetërore, mënyrave të

---

\* Versioni shqip i punimit hulumtues të Dr. Tatjana Katiqit.

shfrytëzimit të tyre, dhënien me qira, shënimeve për qiramarrësit dhe detyrimet e tyre. Defterët janë të formatit dhe vëllimit të madh, nga disa qindra gjer në disa mijëra faqe.

Regjistrimi i qirasë i një pjese të të ardhurave shtetërore të sanxhakut të Prizrenit, i prezantuar në këtë punim, gjendet në MAD nr.656, faqe 309-314.<sup>1</sup> Kryesisht përfshin borxhet e mbetura ose këstet individuale të dhënies me qira të peshores për matjen e mëndafshit, dyllores prizrenase, asetet e humbura dhe jo të kërkuara, dhe që për ne janë me interes të veçantë, shënimet për minierën e Korishës. Në historiografinë vendase nuk është shkruar fare për minierën afër Prizrenit.<sup>2</sup> Që miniera me të vërtetë ka ekzistuar, është konfirmuar edhe në vite e '60-ta të shek. XX, kur janë botuar përkthimet e para osmane, raporti i ligjit të atëhershëm për minierën afër Prizrenit, nga viti 1488, në gjuhën frënge<sup>3</sup>, në gjuhën serbe<sup>4</sup>, dhe tridhjetë vjet më vonë edhe në gjuhën turke<sup>5</sup>.

Në bazë të rregulloreve të ligjit të përmendur, i cili ishte në fuqi që “nga kohët e lashta”, do të thotë para se të kishte rënë në duart e osmanëve, është e qartë se bëhet fjalë për minierën e argjendit, e lokacioni i saktë i saj nuk ishte i mundur të përcaktohet. Tani, në bazë të shënimeve nga dokumenti, transkriptit dhe përkthimit që e sjellim, është e qartë se ajo

<sup>1</sup> MAD 656, 388 faqe të formatit 44cm x 16cm, regjistron të ardhurat nga pjesa evropiane e Perandorisë

<sup>2</sup> Në kronikën e Shën Arkangjelit përmenden vendbanimet të braktisura të arit të shpërlarë në Prizren. Mbreti Vukashin ka farkuar në farkatoren prizrenase monedha nga argjendi. Në vitin 1370 farkataren e ka dhënë me qira tre dubrovnikasve. Supozohet se monedhat në Prizren i ka farkuar edhe Gjuragji I Balshiq, e me besueshmëri dihet për Vuk Brankoviçin. Gjetjet e parave të argjendta të Prizrenit me emrin e qytetit në alfabet cirilik dhe me figurën e Krishtit janë të përshkruara nga numizmatikët. Јиречек К., *Историја Срба*, II, Београд 1952, 173, 202-203; Иванишевић В., *Новчарство средњовековне Србије*, Београд, 2001, 67, 143, 284.

<sup>3</sup> Beldicaeanu N., *Les actes des premiers sultans conservés dans les manuscrits turcs de la Bibliotheque Nationale a Paris*, T. II: *Reglements miniers, 1390-1512*, Paris-Le Haye, 1964, f. 218-221

<sup>4</sup> Rizaj S., *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva*, Priština, 1968, f. 247-248.

<sup>5</sup> Akgunduz A., *Osmanlı Kanunnameleri ve Hukukî Tahlilleri*, 2. kitap II Bayezid devri kanunnameleri, Istanbul 1990, f. 472-475.

minierë gjendej në afërsi të fshatit Korishë. Nga i njëjti dokument shihet se gjer në vitin 1535 menaxhimi i minierës ishte në duart e të krishterëve, gjersa në periudhën e mëturjes, si menaxhues dhe qiramarrës paraqiten myslimanët. Shumat e shënuara të të hollave nuk ofrojnë mundësi të caktimit të lartësisë së qirasë, sepse kanë të bëjnë me borxhet e vjetra të qiramarrësve të caktuar dhe menaxherëve të haseve të minierave. Çështjen e qiradhënies e ndriçon një burim tjetër osman. Ky është regjistri i përmbledhur i Vilajetit të Rumelisë, nga viti 1530<sup>6</sup>, në të cilin është e regjistruar qiraja trevjeçare e minierës së Korishës, të haseve minierash, si dhe disa të ardhura të vogla në shumën 165.000 akça<sup>7</sup>. Burimi i njëjtë shënon edhe panairin e Korishës, pranë kishës Presveta Bogorodica<sup>8</sup>, i cili është dhënë për qira trevjeçare për 1000 akça<sup>9</sup>. Korisha ka pasur edhe tregun e drithërave, i cili po ashtu është dhënë me qira<sup>10</sup>.

Miniera e Korishës është regjistruar disa vite më herët, në regjistrin e përgjithshëm të sanxhakut të Prizrenit, nga viti 1518<sup>11</sup>. Ajo i përkëste, sikurse pasuritë e tjera natyrore në posedim të sulltanit, sikurse minierat e tjera osmane, pra sulltanit, dhe ka pasur hasin e vet (një numër të caktuar të fshatrave banorë, e të cilët kanë qenë të obliguar të kryejnë shërbime ndihmëse, më së shpeshti t'i furnizojnë objektet e minierave dhe shkrito-

<sup>6</sup> 167 Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-ili Defteri (937/1530), II, Dizin ve Tıpkıbasım, T.C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, Yayın nu: 69, Defter-i Hakani Dizisi: IX, Ankara 2004.

<sup>7</sup> Po aty, f. 371

<sup>8</sup> Црква Пресвете Богородице – Покрова Св. Богородице, на крајњем источном делу села. *Задужбине Косова*, Призрен-Београд 1987, 462.

<sup>9</sup> 167 Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-ili Defteri (937/1530), II, 371.

<sup>10</sup> Për ekzistimin e sheshit të drithërave dëshmon baxhi në drithëra (taksa për qarkullimin e mallit me shumicë), qiramarrësi i të cilët viteve tridhjeta të shekullit XVI ishte emin (besniku) Mustafa. Shiko përpara në dokument në kuadër të artikullit për minierën e Korishës.

<sup>11</sup> *Defterhane-i Amire Tahrir Defteri, no. 92 (TD 92)*.

reve me dru dhe qymyr)<sup>12</sup>. Hasit të minierës së Korishës i përkisnin: Korisha, Planjane, Stretinovci (Malësia e re) dhe Shën Petri (Kabashi)<sup>13</sup>.

Peshorja për matjen e mëndafshit ishte burimi më i madh i të ardhurave të shtetit osman në sanxhakun e Prizrenit. Sipas regjistrimit të përmendur nga viti 1530, qiraja trevjeçare ishte 355.000 akça<sup>14</sup>. Prizreni ishte qendra tregtare e mëndafshit në Ballkan dhe në vartësi të tij ishin edhe tregjet më të vogla, sikurse Peja dhe Tetova. Megjithëse të dy qytete ishin jashtë sanxhakut të Prizrenit, njëri i ka takuar sanxhakut të Dukagjinit, e tjetri sanxhakut të Pashës, e dëftesat për dhënien me qira të peshojave të atjeshme i ka lëshuar kadiu i Prizrenit, që ishte dëshmi e unitetit të hapësirës ekonomike, i cili i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm administrativë të Perandorisë Osmane. Interesant është edhe fakti se në gjyqin e sheriatit, si dorëzanë për dhënien me qira të peshores në Pejë ishte mitropoliti (ipe-shkvi) ortodoks i Prizrenit, ndërsa si dorëzanë në Tetovë ishte prifti ortodoks lokal.

Në dokumentin që e sjellim, qiramarrësi kryesor i shumicë së ardhurave të përmendura ishte Mustafai, i caktuari që direkt apo duke i dhënë me nënqira ka grumbulluar të ardhura nga tregtia e mëndafshit, e dyllores dhe bejtulmalit.

### **T r a n s k r i p t i:**

[309] **Der liva-i Prizrin**

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-ı rusum-i mizan-i harir der Prizrin**

Der zimmet-i Bali Sinan emin ‘an tahvil-i Mustafa emin multezim, ‘an kist-ı mizan-i harir der Prizrin, ‘an gurre-i Rebi‘u’l-evvel sene 932 (16. XII 1525)

‘An bakıye-i muhasebe-i hod 1.000

Der zimmet-i Mustafa emin multezim ‘an mahsul-ı mizan-i harir der Prizrin ‘an gurre-i Rebi‘u’l-evvel sene 938 (13. X 1531)

<sup>12</sup> Shih më gjerësisht С. Кагић, *Потрошни материјали у османском рударству и металургији*, Историјски часопис LVIII, f. 197-207.

<sup>13</sup> TD 92, 2.

<sup>14</sup> 167 Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-ili Defteri (937/1530), II, 371.

‘An bakiye-i muhasebe-i hod	<u>5.752</u>
‘An bakiye-i muhasebe-i hod	752
‘An irsaliye-i Hızane-i ‘Amire be-nakl-ı Husam ‘an cavuşan-ı Dergah-ı ‘Ali	5.000

Der zimmet-i Nikola Todor ‘an kıst-ı resm-i mizan-i harir-i Prizrin ‘an gurre-i Rebi‘u’l-evvel sene 941 (10. IX 1534)

Habs şud der zindan-i İstanbul fi 9 Muharrem sene 946 (27. V 1539)

‘An kıst-ı selase sinin mea rusum ve teslimat 103.270

Minha

Der zimmet-i Mustafa emin multezim ‘an bakiye-i muhasebe-i hod ki der zimem baş behod bud ve teslimat 10.000

Der zimmet-i ‘Ali emin ‘an ziyade-i mevacib-i hod 200

Be-havale der zimmet-i ‘amil el-mezbur 93.070

Der zimmet-i Mustafa emin multezim ‘an kıst-ı mizan-i harir der Prizrin ‘an gurre-i Rebi‘u’l-evvel sene 944 (8. VIII 1537) 149.618

‘An bakiye-i muhasebe-i hod ki der zimem baş behod ve teslimat 51.596

‘An kesr-i iltizam 98.022

Der zimmet-i Mevlana Mahmud b. Ahmed Eş-şehriye Gocucuzade kadi-i Prizrin ‘an mahsul-i mizan-i harir der Prizrin ‘an gurre-i Za (Zi’l-ka‘de) sene 950 ila gaye-i şehir-i mezbur (26.I – 24. II 1544) zabtkerde ve bera-yı isalkerde be Hızane-i ‘Amire kabzkerde ve teslimkerde ber muceb-i muhasebe-i hod. 4.798

[310]

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-i kokoz-i kaza-i Bihor ve gayruhu**

Der zimmet-i İcvetko veled-i Vuk ‘an kıst-ı kokoz-i kaza-i Bihor ve Prizrin

der nahiye-i Tırgovişte ‘an 26. Rebi‘u’l-evvel sene 926 (16. III 1520)

‘an kıst-ı selase sinin mea rusum ve teslimat 2.309



[311]

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-i resm-i mizan-i harir der kaza-i İpek ve gayruhu**

Der zimmet-i Mahmud b. Yusuf ulufe-i rab‘i-i yesar el-havale ‘an tahvil-i Peyo b. Todor ‘an kıst-ı resm-i mizan-i harir der kaza-i İpek ve Kalkandelen an 15. Zi’l-ka‘de sene 937 (30. VI 1531) ber muceb-i hucec-i Mevlana Bedreddin kadi-i Prizrin. 300

Kefil bi’l-mal Mihadin midrepolit ‘an mahale-i Prizrin

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-i mizan-i harir-i Kalkandelen**

Der zimmet-i papas Nikola Bratovan veled-i Mirko ‘an mahale-i Progor der nefsi-i Kalkandelen ‘an kıst-ı resm-i mizan-i harir-i kaza-i Kalkandelen ‘an 15. Zi’l-ka‘de sene 938 (19. VI 1532)

‘an kıst-ı selase sinin mea rusum ve teslimat 81

[312]

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-i şem‘-hane-i kaza-i Prizrin**

Der zimmet-i Suleyman b. ‘Abdullah ‘an mahale-i tabağlar der nefsi-i Prizrin

‘an kıst-ı şem‘-hane-i kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Şevval sene 933 (1. VII 1527) ‘an kıst-ı selase sinin mea rusum ve teslimat 370

Kefil bi’l-mal ve bi’n-nefs Mustafa b. Rızacı Hacı

Der zimmet-i Mustafa emin ‘an tahvil-i katib Mustafa ‘an kıst-ı şem‘-hane-i kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Şevval sene 936 (29. V 1530) ber muceb-i muhasebe-i hod ‘an irsaliye be-nakl-ı ‘Ali ‘an ebna-i sipahiyan havale el-vakı‘ fi 11 Ca (Cemaziye’l-evvel) sene 941 (18. XI 1534) 2.000

Der zimmet-i Mustafa emin ‘an tahvil-i katib ‘an kıst-ı şem‘-hane-i kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Şevval sene 939 (26.IV.1533) ber muceb-i muhasebe-i hod irsaliye ‘an yed-i Mustafa ‘an silahdaran, fi eva’ili-Receb sene 942

(26. XII 1535 – 4. I 1536) 1.000

[313]

**Der zimmet-i mezkurin ‘an mahsul-i beytu’l-mal ve gayruhu-i kaza-i Prizrin**

Der zimmet-i Mustafa emin ‘an tahvil-i Suleyman ‘an kıst-ı beytu’l-mal ve mal-ı ga’ib ve gayruhu-i kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Şevval sene 936 (29. V 1530) ber muceb-i muhasebe-i hod 500

Der zimmet-i Mustafa ‘an silahdaran havale-i tahvil-i Suleyman ‘an kıst-ı beytu’l-mal ve mal-ı ga’ib ve gayruhu der kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Za (Zi’lka‘ de) sene 939 (25. V 1533) ‘an irsaliye-i Hızane-i ‘Amire fi eva’il-i Receb sene 942 (26. XII 1535 - 4. I 1536), ber muceb-i muhasebe-i Mustafa emin 2.102

Der zimmet-i katib Murad ‘an tahvil-i Ahmed Hatvani ‘an kıst-ı beytu’l-mal ve yave ve kackun-i kaza-i Prizrin ‘an gurre-i Şevval sene 945 (20. II 1539) 300

[314]

**Der zimem-i mezkurin ‘an mahsul-i hassha-i ma‘den-i Korişa**

Der zimmet-i Bojan emin ‘an tahvil-i İstamad ‘an kıst-ı hassha-i ma‘den-i Korişa ve gayruhu der nezd-i Prizrin ‘an 28. Oynus el-vakı‘ fi 17 Ramazan sene 932 (27. VI 1526) ber muceb-i muhasebe-i hod. 4.350

Der zimmet-i mezkurin ‘an tahvil-i Belça b. İvan ve Peyo ‘an kıst-ı mahsulat-i hassha-i Korişa ‘an 28. Oynus el-vakı‘ fi 24 Zi’l-ka‘de sene 938 (28. VI 1532) 1.020

Der zimmet-i Mustafa emin multezim bac-i galle ki makbul şude 20

Der zimmet-i ‘Ali b. Yusuf ‘an ebna-yı sipahiyan havale ‘an kesr-i teslimat ber muceb-i hucec-i Mevlana kadi-i Prizrin 1.000

Der zimmet-i mezkurin ‘an tahvil-i Musa ‘an k1st-1 mahsulat ve rusum-i hassha-i Koriša an 28 Oynus el-vakı’ fi 27 Zi’l-hicce sene 941 (29.VI.1535)	<u>4.628</u>
Der zimmet-i Mustafa emin multezim ber muceb-i muhasebe-i hod ve teslim	178
Der zimmet-i Mehmed emin	3.990
Der zimmet-i ‘Ali emin	460

**Përkthim:**

[309] Në sanxhakun e Prizrenit

**Debitorët e shënuar në emër të të ardhurave nga tatimi në peshoren për matjen e mëndafshit në Prizren.**

Debitori, emini<sup>15</sup> Bali Sinani, i cili i përket tahvilit<sup>16</sup> të emin qiramarrësit Mustafa, për tatim në peshojën për matjen e mëndafshit në Prizren, nga dita e parë e muajit Rebiul Evel të vitit 932 hixhrij (16.XII 1525).

Borxhet e mbetura të kontabilitetit të tij	1.000
--	-------

Debitori i Mustafasë, emin qiramarrësi, në emër të të ardhurave nga peshorja për matjen e mëndafshit në Prizren, nga dita e parë e Rebiul Evelit të vitit 938 hixhrij (13.X.1531).

Në emër të borxheve të mbetura të tij në kontabilitetin e tij,	<u>5752</u>
--	-------------

Borxhet e mbetura të kontabilitetit të tij,	752
---	-----

Dërguar në arkën e perandorisë, nëpërmjet Hysamit, rreshterit të Portës së Lartë,	5000
---	------

<sup>15</sup> Emini, drejtori i të ardhurave shtetërore, ka mundur të paraqitet edhe në rolin e qiramarrësit të të njëjtit për të ardhurat shtetërore.

<sup>16</sup> Termi teknik që e përcakton kohën e qiramarrjes, gjegjësisht kohën e shfrytëzimit të qirasë, apo periudhën në të cilin qiramarrësi ka të drejtë t’i gëzojë të ardhurat nga qiraja.

Debitori i Nikolla Todorit, në emër të tatimit të peshores prizrenase për matjen e mëndafshit, nga dita e parë e Rebiul Evelit të vitit 941 hixhrij (10.IX.1534). Është burgosur dhe gjendet në burg në Stamboll (regjistruar) 9 Muharem të vitit 946 hixhrij (27.V.1539).

Qiraja trevjeçare me tatime dhe këste është 103.720

Nga kjo:

Debitori i eminit, qiramarrësit Mustafa, në emër të borxheve të mbetura të kontabilitetit të tij, të cilët i përkasin edhe borxhet e t'ia personale dhe këstet, 10.000

Debitori i eminit Ali, në emër të tepricës së kontabilitetit të tij, 200 transferuar në debitorin e grumbullimit të të ardhurave 93.070

Debitori i Mustafasë, eminit qiramarrësit, në emër të tatimeve në peshoren për matjen e mëndafshit në Prizren, nga dita e parë e muajit Rebiul Evel të vitit 944 hixhrij (8.VIII.1537), 149.618

Nga borxhet e mbetura të kontabilitetit të tij për të cilin është personalisht i ngarkuar me këste, 51.596

Nga ndarja për qira 98.022

Borxhet e kadiut të Prizrenit Mevlana Mahmudit, biri i Ahmed Shehrit, Goqigjizades<sup>17</sup>, të ardhurat nga peshorja për matjen e mëndafshit në Prizren, nga dita e parë e muajit Dhyllkade të vitit 950 hixhrij, gjer në fund të muajit të njëjtë (26.I-24.II 1544), është konfiskuar dhe mbajtur për të dërguar në arkën e Perandorisë. Dorëzuar në bazë të kontabilitetit të tij, 4798

[310]

**Debitorët e të shënuarave në emër të të ardhurave nga kokozat<sup>18</sup> e krimbit të mëndafshit në kadillëkun e Bihorit dhe të tjerë.**

Debitori i Cvetkut, birit të Vukut, në emër të tatimit nga kokozat e krimbit të mëndafshit të kadillëkut të Bihorit dhe Prizrenit, në komunën

<sup>17</sup> Zyrtar i cili kujdeset për transportin e tendës së sulltanit, gjatë kohës së depërtimeve ushtarake.

<sup>18</sup> Çaurat e krimbit të mëndafshit.

e Tërgovishtit, nga 26 i muajit të Rebiul Evelit të vitit 926 hixhrij (16.III. 1520). Qiraja trevjeçare me tatime dhe këste është 2309

[311]

**Debitorët e shënuar në emër të të ardhurave nga tatimi në peshoren për matjen e mëndafshit në kadillëkun e Pejës dhe të tjerë.**

Debitori i grumbulluesit të ardhurave shtetërore të Mahmudit, djalit të Jusufit, ulufegjisë<sup>19</sup> të krahut të majtë të batalionit të katërt, i cili i përket në tahvil të Pejë Todorit, për tatim nga qiraja e peshores për matjen e mëndafshit në kadillukët e Pejës dhe Tetovës, të datës 15 Dhylkade të vitit 937 hixhrij (30.VI. 1531), në bazë të huxhetit<sup>20</sup> të Mevlana Bedridinit, të kadiut prizrenas, 300

Garant me pasuri është mitropoliti (ipeshkvi) Mihadin nga mahalla e Prizrenit.

**Debitorët e shënuarave nga të ardhurat nga peshorja për matjen e mëndafshit në Tetovë.**

Debitori i priftit Nikolla Bratovanit, djalit të Mirkos, nga mëhalla e Progorit në vetë Tetovën, për tatim në qira nga peshorja për matjen e mëndafshit në kadillëkun e Tetovës, nga data 15 e muajit Dhylkade, e vitit 938 hixhrij (19.VI.1532). Qiraja trevjeçare me tatime dhe këste 81

[312]

**Debitorët e të shënuarave nga të ardhurat nga dyllorja e kadillëkut të Prizrenit**

Debitori i Sylejmanit, të birit të Abdullahut, nga mahalla e Tabakhanes në Prizren, nga qiraja e dyllores të kadillëkut të Prizrenit, nga dita e parë e muajit Sheval, të vitit 933 hixhrij (1.VII.1527).

Qiraja trevjeçare me tatime dhe këste është 370

<sup>19</sup> Pjesëtar i kalorësisë së sulltanit.

<sup>20</sup> Vërtetimi gjyqësor që jepet me kërkesën e palës.

Garant me pasurinë e vet personale është Mustafai, djali i haxhi Rizaxhiut.

Debitori i Mustafa eminit, i cili i përket tahvilit të qatibit Mustafa, në emër të qirasë së dyllores në kadillëkun e Prizrenit, nga dita e parë e muajit Sheval të vitit 936 hixhrij (29.V.1530). Sipas llogarisë së tij, dërguar nëpërmjet spahisë<sup>21</sup> Alisë, grumbullimi i të ardhurave shtetërore ka ndodhur më datë 11 të muajit të Xhumadel Ula, të vitit 941 hixhrij (18.XI.1534), 2.000

Debitori i Mustafa eminit, i cili i përket tahvil qatibëve, në emër të qirasë së dyllores së kadillëkut të Prizrenit, nga dita e parë e muajit të Shevalit të vitit 939 hixhrij (26.IV.1533). Sipas llogarisë së tij dërguar nëpërmjet silahdarit<sup>22</sup> Mustafa, në dekadën e parë të muajit Rexheb të vitit 942 hixhrij (26.XII 1535-4.I.1536), 1.000

[313]

**Debitorët e shënuarave nga të ardhurat e bejtullmallit<sup>23</sup> dhe tjerë në kadillëkun e Prizrenit.**

Debitori i Mustafa eminit, i cili i përket tahvilit Sylejman, në emër të qirasë së bejtullmallit, gjërave të humbura dhe të tjerë, në kadillëkun e Prizrenit, nga dita e parë e muajit Sheval të vitit 936 hixhrij (29.V.1530).

Në bazë të kontabilitetit të tij, 500

Debitori i silahdarit Mustafa, transferuar në tahvilin e Sylejmanit, në emër të qirasë së bejtullmallit, gjërave të humbura dhe tjerë, në

<sup>21</sup> Pjesëtar i kalorësisë vendore të sulltanit.

<sup>22</sup> Pjesëtar i kalorësisë qendrore të sulltanit.

<sup>23</sup> Arka e sulltanit, në të cilën janë derdhur të ardhurat nga trashëgimia jo e kërkuar, pasuria e të munguarve, personave të humbur apo prej të panjohurve, kompensimi për gjetjen e kafshëve të humbura, robërve të arratisur dhe të tjera.

kadillëkun e Prizrenit, nga dita e parë e muajit Dhylkade, të vitit 939 hixhrij (25.V.1533).

Dërguar në arkën e perandorisë, në dekadën e parë të muajit Rexheb të vitit 942 hixhrij (26.XII.1535-4.I.1536), sipas kontabilitetit të Mustafasë eminit 2102

Debitori i Murat qatibit, i cili i përket tahvilit të Ahmed Hatvanisë, për dhënien me qira të bejtulmalit, kafshëve të humbura dhe njerëzve të arratisur në kadillëkun e Prizrenit, nga dita e parë e muajit Sheval të vitit 945 hixhrij (20.II.1539). 300

[314]

**Debitorët e shënuarve në të ardhura nga haset e minierës së Korishës**

Debitori i Bozhan eminit, i cili i përket tahvilit të Stamatit, për qira të haseve të minierës së Korishës dhe të tjerë, në afërsi të Prizrenit, nga 28 qershor, i cili është 17 të muajit Ramazan të vitit 932 hixhrij (27.VI.1526).

Sipas llogarisë së tij, 4.350

Debitorët e përfshirëve, të cilët i përkasin tahvilit Belqe Ivanovit dhe Pejtit, nga qiraja e të ardhurave të haseve të Korishit, nga 28 qershori, që është nga data 24 të muajit Dhylkade të vitit 938 hixhrij (28.VI.1532) 1.020

Debitori i Mustafa eminit, të pranuar nga baxhi<sup>24</sup> në drithëra 20

Debitori i grumbulluesit të të ardhurave shtetërore, spahiut Ali, i biri i Jusufit të ndara për këste, sipas huxhetit të Mevlanas, kadiut të Prizrenit 1000

<sup>24</sup> Tatimi në qarkullim me shumicë. Arsyeja pse kjo taksë në drithëra është paguar në Korishë ishte se ato janë importuar nga vendet e tjera, pasi banorët lokalë kanë qenë të punësuar në minierë, dhe nuk kanë pasur kohë të merren edhe me bujqësi.

Debitorët e të shënuarve, të cilët i përkisnin tahvilit të Musës, nga qiraja e të ardhurave dhe tatimeve të haseve të Korishës, nga data 28 qershor, që është data 27 të muajit Dhyllixhe të vitit 941 hixhrij (29.VI. 1535)

	<u>4.628</u>
Debitori i Mustafa eminit, në bazë të llogarisë së tij të dorëzuar	178
Debitori i Mehmed eminit	3.990
Debitori i Ali eminit	460

Përktheu dhe përshtati:  
**Faik MIFTARI**



Tatjana KATIĆ

**THE PRIZREN KADILIK'S INCOMES  
FROM SILK TRADE, KORIŠA MINE AND OTHER  
(FOR THE YEARS 1525 - 1544)**


**(Summary)**

This article presents an accounting register made by Finance Department of the Ottoman Empire (*Maliyeden mudevver defteri*, no 656)

which contains data on incomes, expenditures and treasury payments,

concerning farming of some public revenues in the Prizren *sancak*. These are: silk weighing scale, Prizren chandlery, estates of persons dying without heirs, lost property, property of an unknown owner, and, what is the most important, the Koriša silver mine near Prizren. Data from this register, as well as from some other Ottoman registers of which the earliest information was from 1488, testified that the mine had its own *işci has*, consisted of the following villages in 1518: Koriša, Planjane, Stretinovce and Kabaš; in 1530. the total amount of 165.000 *akce* was paid for three-year lease of the mine, *işci has* and some less significant income sources; also, until 1535, the Koriša silver mine had been managed by Christians. In the following period Muslims were mine managers, contractors and renters.

**Keywords:** *Ottoman Empire, accounting registers (maliye defterleri), mining, silver, Koriša, Prizren, silk.*



*Başbakanlık Arşivi İstanbul,  
Maliye defteri – Maliyeden mudevver defteri [MAD] 656.*



Besnik JAHA

## KRITIKA SOCIALE NË LETËRSINË SHQIPE (INTRODUKTAT E FAN S. NOLIT)

### **Abstrakt**

Deri vonë në studimet letrare shqipe kanë munguar vepra të mirëfillta kritike letrare, pavarësisht se në shumicën e kulturave botërore me traditë në letërsi leximi kritik shihej si qasje kryesore ndaj tekstit. Pra, thjesht shumica e veprave kritike të para Luftës së Dytë Botërore nuk është se dëshmonin ndonjë kriter të kualitetit<sup>1</sup>. Arsyeja e mungesës së këtij kualiteti ishte fakti se edhe kritika letrare shqipe, njësoj sikurse letërsia deri vonë, u zhvillua nën ndikimin e kontesteve të ndryshme kulturore, sociale, politike e ideologjike nëpër të cilat kaloi shoqëria shqiptare. Prandaj, gati-gati, kritika letrare shqiptare deri në ditët tona nuk e ka të plotë autonominë e saj.

*Fjalët kyçe: kritika, letërsi shqipe, sociale, introdukë*

---

<sup>1</sup> Si shembull mund të marrim studimet për historinë e letërsisë shqipe. Që nga inicimet e para për të bërë një histori të letërsisë shqipe, si prej studiuesve të huaj apo shqiptarë (“*Manuale di Letteratura albanese*” (1896), e Alberto Straticos, “*Historija e letraturës shqipe*” (1925), e At Justin Rrotës, “*Populli, gjuha dhe letërsia shqipe*” (1931), e Renato Petrotës, “*Albanian literature, an Outline of Prose, Poetry and Drama*” (1955), e Stuart E. Mannit, “*Storia della Letteratura albanese*” (1959), e Giuseppe Schiroit - i Riu), apo edhe tek ato që pretendohen si histori të letërsisë shqipe (“*Shkrimtarët shqiptarë 1*” (1941), e Namik Ressulit, “*Shkrimtarët shqiptarë 2*” (1941), e Karl Gurakuqit, “*Historia e letërsisë shqiptare*” (1983), e botuar nën kujdesin e Dhimitër Shuteriqit, “*Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi 1,2,3*” (1984), e Rexhep Qosjes, “*History of Albanian literature*” (1995), e Robert Elsie), e vërejmë se pretendimet për të bërë histori të letërsisë përfundojnë në bërjen e manualeve, bibliografive, apo të poetikave letrare të periudhave.

## Teoria e kritikës letrare

Dihet se si komponentë themelorë për studimin e letërsisë janë tri fusha studimore: teoria e letërsisë; historia e letërsisë, dhe; kritika letrare, ndërsa raporti mes të parës dhe të dytës është shumë më i thellë sesa i dy të parave me të fundit, që në fakt ngjan si një mjet apo derivat i tyre. Vlerësimi i veprave letrare “*Poetikën*” e Aristotelit e bën jo vetëm veprën e parë strukturale të teorisë së letërsisë, por edhe veprën e parë të historisë së letërsisë, e respektivisht edhe të kritikës letrare.

Megjithatë, që nga antika e deri më sot kritika letrare është parë jo njësoj, si në qasje të interpretimit të tekstit letrar, ashtu edhe në aspekt të autonomisë si fushë studimore. Prandaj, në plan të autonomisë, në kohë të ndryshme janë parë edhe nevoja të ndryshme të qasjes ndaj kritikës letrare. Për shembull, në kohën tonë është vërejtur edhe nevoja që kjo fushë studimore të ndahet në dy disiplina, si në: *histori të kritikës*<sup>2</sup> dhe *teori të kritikës*<sup>3</sup>.

Po një seriozitet e rreptësi të ngjashme me atë të zbatuar në shkencat e tjera, dhe gjithashtu edhe gjithëpërfshirës e jo të cekët, Tzvetan Todorov e kërkon edhe në letërsi, respektivisht në fushën e kritikës letrare. Madje-madje, Todorov këtë e kërkon si kushtin themelor për prodhimin e një letërsie kualitative e me bazë kualitetin letrar. “*Studimet letrare duhet t’i praktikojmë me të njëjtin seriozitet e të njëjtën rreptësi siç veprohen në shkencat e tjera. “Nëse kritika ekziston, ajo duhet të jetë një shqyrtim i letërsisë në kuptim të një kornize konceptuale që rrjedh nga një pasqyrë gjithëpërfshirëse e fushës letrare”*”, thotë ndër të tjerash Todorov.

<sup>2</sup> Një vepër që trajton historinë e kritikës letrare nga Platoni e deri në kohën tonë është vepra “*A History of Literary Criticism*”, e M. A. R. Habib, e botuar në vitin 2005. Si vepër tjetër e historisë së kritikës letrare, mirëpo më e kufizuar në kohë, njihet edhe vepra “*A History of Modern Criticism 1790-1950*”, e René Wellek. Ndërsa, si punë ekipore në disa vëllime njihen veprat “*The Cambridge History of Literary Criticism*”, vëllimi i nëntë i të cilit komplet përfshin periudhën e shekullit të 20-të, dhe është botuar në vitin 2008, nën përkujdesjen e Christa Knellwolf dhe Christopher Norris.

<sup>3</sup> Një vepër e njohur që trajton teorinë e kritikës letrare është vepra “*Teorija kritike*”, e Mary Kriger, e botuar në Beograd, në vitin 1982.

<sup>4</sup> Tzvetan Todorov, Hyrje në letërsinë fantastike, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, f. 14.

Në kritikën letrare shqiptare mungojnë vepra të kësaj natyre. Pra, ne na mungojnë madje edhe vepra që trajtojnë kënaqshëm qoftë edhe bashkërisht këto dy disiplina. E vetmja vepër që merret me, të themi, studimin e teorisë dhe të historisë së kritikës letrare shqiptare njëkohësisht, është ajo e Ibrahim Rugovës, “*Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*”<sup>5</sup>.

Sidoqoftë, me pak hulumtim vërehet se deri vonë në studimet letrare shqipe kanë munguar vepra të mirëfillta kritike letrare, pavarësisht se në shumicën e kulturave botërore me traditë në letërsi leximi kritik shihej si qasja kryesore ndaj tekstit. Pra, thjesht shumica e veprave kritike të para Luftës së Dytë Botërore nuk është se dëshmonin ndonjë kriter të kualitetit<sup>6</sup>. Arsyeya e mungesës së këtij kualiteti ishte fakti se edhe kritika letrare shqipe, njësoj sikurse letërsia deri vonë, u zhvillua nën ndikimin e konteksteve të ndryshme kulturore, sociale, politike e ideologjike nëpër të cilat kaloi shoqëria shqiptare. Prandaj, gati-gati, kritika letrare shqiptare deri në ditët tona nuk e ka të plotë autonominë e saj.

<sup>5</sup> Kjo është vepra kryesore e një historie të kritikës letrare shqiptare. Vepra është botuar edhe në kompletin e veprave të Ibrahim Rugovës, në vitin 2005, nga Shtëpia Botuese “Faik Konica”, në Prishtinë. Janë të njohura edhe dy vepra të tjera që kanë plotësuar mungesën e studimeve në fushën e kritikës letrare dhe historisë së kritikës letrare shqiptare, e që janë botuar në të njëjtin vit: “*Kritika letrare*” e përpiluar prej Ibrahim Rugovës dhe Sabri Hamitit, mirëpo që kufizohet në kohë (nga De Rada e deri te Migjeni), e botuar nga Rilindja, në Prishtinë, dhe; “*Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944*”, e Nasho Jorgaqit, e botuar në Tiranë.

<sup>6</sup> Si shembull mund të marrim studimet për historinë e letërsisë shqipe. Që nga inicimet e para për të bërë një histori të letërsisë shqipe, si prej studiuesve të huaj apo shqiptarë (“*Manuale di Litteratura albanese*” (1896), e Alberto Straticos, “*Historija e letraturës shqype*” (1925), e At Justin Rrotës, “*Populli, gjuha dhe letërsia shqipe*” (1931), e Geatano Petrotës, “*Albanian literature, an Outline of Prose, Poetry and Drama*” (1955), e Stuart E. Mannit, “*Storia della Letteratura albanese*” (1959), e Giuseppe Schiroit - i Riu), apo edhe tek ato që pretendohen si histori të letërsisë shqipe (“*Shkrimtarët shqiptarë 1*” (1941), e Namik Ressulit, “*Shkrimtarët shqiptarë 2*” (1941), e Karl Gurakuqit, “*Historia e letërsisë shqiptare*” (1983), e botuar nën kujdesin e Dhimitër Shuteriqit, “*Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi 1, 2, 3*” (1984), e Rexhep Qosjes, “*History of Albanian literature*” (1995), e Robert Elsie), e vërejmë se pretendimet për të bërë histori të letërsisë përfundojnë në bërjen e manualeve, bibliografive, apo të poetikave letrare të periudhave.

## Një historik i shkurtër i kritikës letrare shqipe

Sa i përket vështrimit të historisë së kritikës letrare shqiptare, mund të themi lirisht se për të, në çdo periudhë, ka munguar një interesim serioz. Si nga institucionet, ashtu edhe nga individët. Prandaj gjejmë epoka letrare në të cilat hasim pika të patrajuara në aspekt të kritikës, apo edhe pjesërisht të hulumtuara e të trajtuara, duke dhënë kështu një hartë letrare (sipas konceptit të Jonathan Caller-it për hartën letrare) plot mungesa në historizimin e kritikës letrare shqipe. Pra, jo që deri vonë ka munguar vetëm interesimi për t'u marrë me kritikë, po edhe në ditët e sotme, me përjashtime të vogla, na mungon një përkushtim serioz për t'u marrë me historinë e kritikës letrare shqipe.

Në shumicën e rasteve, deri vonë, kritika letrare ishte vetëm informative. Gjithsesi, me mangësitë dhe formën e vet primitive të gjykimit mbi veprën letrare kritika letrare shqipe nis rrugëtimin e vet qysh në periudhën e letërsisë së vjetër shqipe, ndërsa shfaq veprën teorike në periudhën e Rilindjes, përkatësisht veprën *Parime të estetikës* të Jeronim de Radës.

Megjithatë, përveç disa mendimeve prej autorëve të ndryshëm të Rilindjes, kritika letrare shqipe nuk është se pati ndonjë të autor të përkushtuar në lëvrimin e saj në kulturën shqiptare. Po kështu vazhdoi deri në periudhën pasromantike/paramoderne, kur në shesh dolën autorët Faik Konica e Fan S. Noli.

Përderisa Faik Konica u përkushtua në zhvillimin e mendimit kritik në revistën e tij *Albanica*, Fan S. Noli e përdori një model tjetër të lëvrimin të kritikës në letërsinë shqipe, respektivisht duke zhvilluar një model të veçantë, atë sociologjik të kritikës letrare, thuajse fund e krye me anë të *Introduktave/Parathënieve* të tij në veprat që përkhente nga gjuhët e ndryshme në gjuhën shqipe. Dhe, janë pikërisht *introduktat* e tij materiali që do ta trajtojmë në vazhdim të këtij punimi.

Përveç këtyre, në hartën historike të kritikës letrare shqipe bëjnë pjesë edhe: Ernest Koliqi, Krist Maloki, Eqrem Çabej, Mitrush Kuteli, Arshi Pipa, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Rexhep Qosja, Mensur Raifi, Drago Siliqi, Martin Camaj, Dhimitër Shuteriqi, Ali Aliu, Vangjel Koça, apo nga gjenerata më e re: Agron Tufa, Ag Apolloni, Kujtim Rrahmani, Kuj-

tim Shala, Nysret Krasniqi, Gëzim Aliu, Zarije Kapllanaj, Orjela Stafasani etj.

### **Kritika letrare e *Introduktave* të Nolit**

Fan S. Noli lirisht mund të konsiderohet figura më polidimensionale e kulturës shqiptare. Ai ishte intelektuali më i madh shqiptar (poliglot, poet, dramaturg, ideolog, kritik, kompozitor, teolog), pra në Shqipëri dhe në diasporë, dhe shkrimtari më tipik i kësaj të fundit. Edhe sot e kësaj dite Noli është i vetmi doktor i dyfishtë shqiptar nga Universiteti i Harvardit (në Muzikë dhe në Histori), dhe autori më përfaqësues i diasporës shqiptare.

Ibrahim Rugova thotë për Nolin se, për *ndryshim nga kritikët e tjerë, ai pati fatin të jetë më shumë si kritik letrar*<sup>7</sup>. Dhe, këtë konstatim Rugova e mbështet vetëm në modelin kritik të *introduktave* që Noli e shkroi për secilën vepër që përktheu. Pra, në hartën e kritikës së tij përfshihen jo shumë autorë, mirëpo që të gjithë të veçantë: Shekspirin, Servantesin, Tolstoin, Ibsenin e Kajamin. Gjithsesi është interesant fakti se Noli kurrë nuk shkroi ndonjë *introduktë* për ndonjë libër shqip, ndërsa bën përjashtim rasti i Faik Konicës, për librin e të cilit botuar në anglisht shkruan një *introduktë*.

Ndërkaq, Nasho Jorgaqi shfaqjen e Nolit në kritikë e sheh si një *dukuri të rëndësishme në kritikën tonë letrare*<sup>8</sup>. Sipas Jorgaqit, për *dallim nga kritikët e tjerë, Noli u mor kryesisht me autorë dhe vepra të letërsisë botërore, por problemet që ngriti e shqyrtoi nuk ishin të huaja për letërsinë tonë kombëtare, përkundrazi kishin lidhje me çështje thelbësore dhe i hapnin asaj horizonte të reja*<sup>9</sup>.

Nga ajo që na ka arritur deri më sot prej Nolit nga fusha e kritikës mund të vërehet qartë se Shekspiri ishte i preferuari i tij. Kjo vërehet

<sup>7</sup> “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 116.

<sup>8</sup> Nasho Jorgaqi, *Profile dhe problem letrare (Studime, gjurmime, ese)*, Dudaj, Tiranë, 2008, f. 334.

<sup>9</sup> Po aty.



edhe nga disa shkrime të ngjashme me *introduktat* (“*Shekspiri dhe unë*”, “*Uiliam Shekspiri*”). Këtë e vëren edhe Ibrahim Rugova, kur thekson se *që me përthimin e Othelos, më 1916, Noli do të fillojë veprimtarinë e tij në formë introduktash, që e intensifikon brenda viteve '26-'32, dhe më vonë edhe një shkrim për Tolstoin (...), e mbas vendosjes përfundimtare të tij në Amerikë, ai do t'i kushtohet kryesisht studimit shkencor për Skënderbeun dhe Betovenin*<sup>10</sup>.

*Introdukta* e parë e Nolit është ajo që bën për veprën “Othelo” të Shekspirit. Këtë *introduktë* Noli e shkruan në vitin 1916, ndërsa veçohet nga të tjerat për faktin se përfshin të dhëna për autorin dhe veprën më shumë sesa secila *introduktë* tjetër gjegjëse.

Pas kësaj *introdukte* Noli nuk boton ndonjë *introduktë* tjetër për 10 vjet me radhë. Ndërsa, pas 10 vjet projeksioni e pune intensive në shumë drejtime, vjen viti më produktiv i Nolit, viti 1926, kur boton: *Hamleti* të Shekspirit, në Bruksel (ndërsa shkruhet në Berlin), pra edhe *introduktën* për të, të dytën me radhë; *Jul Qesari* të Shekspirit, në Bruksel (ndërsa shkruhet në Berlin), pra edhe *introduktën* për të; *Armiku i popullit* të Henrik Ibsen-it, në Bruksel (ndërsa shkruhet në Berlin), pra edhe *introduktën* për të; *Zonja Ingra e Ostrotit* po të Henrik Ibsen-it, në Bruksel (edhe kjo e shkruar në Berlin, njëherësh *introdukta* më e shkurtër e tij), dhe; *Makbethi* të Shekspirit, në Bruksel (edhe kjo e shkruar në Berlin).

Vërehet se vetëm gjatë vitit 1926 boton 5 vepra, ndërsa shkruan gjashtë *introdukta*, pasi një *introduktë* të shkruar në vjeshtën e vitit 1926, në Librasht, për *Rubairat* e Omer Hajamit e boton vitin tjetër, pra në vitin 1927, po në Bruksel.

Pas këtij angazhimi të jashtëzakonshëm Noli bën një tërheqje për një kohë nga kritika letrare, dhe na shfaqet vetëm pas pesë vjetësh, në vitin 1932, pasi arrin ta përktëjë vëllimin e parë të veprës *Don Kishoti i Mançes* të Servantesit. Pra, një *introduktë* tjetër prej Nolit na vjen vite më vonë, në vitin 1932, për veprën e Miguel de Servantes Saavedrës, *Don*

<sup>10</sup> *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 117.

*Kishoti i Mançes*. Këtë *introduktë* Noli e shkruan dhe e boton pasi në Amerikë, në Boston, ku edhe mbetet deri në fund të jetës së tij.

Sipas Ibrahim Rugovës, *thujtje të gjitha mendimet lidhur me kritikën e Nolit kanë të bëjnë me funksionin social e politik të tyre, që i referohehin kohës dhe situatës shoqërore të atëhershme*<sup>11</sup>. Rugova po ashtu veçon edhe një çështje interesante e të vënë re edhe nga kritika e kohës: *problemi i identifikimit të kritikës së tij me situatën e tij personale, si udhëheqës i një revolucioni dhe si një i dështuar në atë fushë*.<sup>12</sup>

Pas *introduktës* për *Don Kishoti*-n Noli më nuk shkruan *introdukta* deri në vitin 1957. Për 25 vjet me radhë ai nuk merret më me *introdukta* të veprave të autorëve të tjerë. Prandaj, si e fundit për të tjerët dhe e para për një autor shqiptar mbetet *introdukta* e shkruar për veprën e Faik Konicës *Shqipëria kopsht shkëmbor i Evropës Juglindore*, e botuar në Boston, vitin 1957. Pas kësaj *introdukte* Noli për vite me radhë merret vetëm me *Parathënie* të veprave të veta, për të cilat ndërkohë, pra edhe para vitit 1957, kishte botuar edhe ndonjë *Parathënie* krejt të shkurtër

Kështu, pas dy shkrimeve me karakter kritik, *Shekspiri dhe unë* dhe *Uliam Shekspiri*, Noli në Boston të Amerikës boton: *Parathënie* të shkurtra për veprat *Historia e Skënderbeut* (1949); *Hymnore ortodokse e lindjes* (1951); *Hymnore për kor të përzier* (1936); *Uratore e Kishës Ortodokse* (1941), dhe; *Kremtore e Kishës Ortodokse* (1947). Që të gjitha këto *Parathënie*, veç e veç, nuk janë më të gjata sesa një, apo më së shumti, dy faqe libri.

Në përgjithësi, kontributi i Fan Nolit në kritikën letrare shqipe është më se i veçantë, si me 9 *introduktat* për veprat e të tjerëve, ashtu edhe me 5 *parathëniet* për veprat e veta po edhe shkrimet e tjera me karakter kritik në përgjithësi.

Kritika e Fan Nolit karakterizohet kritikë sipas metodës sociologjike, dhe kjo është gjë e vërejtur në të gjitha *introduktat* e tij. Sipas Eqrem

<sup>11</sup> Po aty, 116.

<sup>12</sup> Për këtë shih: Mensur Raifi, Fan Noli dhe Migjeni, Prishtinë, 1979, f. 67.

Çabejt, *gjithë përkthimet e Nolit kanë një tendencë sociale, në drejtim të një përmirësimi të shoqërisë shqiptare*<sup>13</sup>.

Një element si ky e vëren edhe studiuesi i njohur Arshi Pipa, i cili në *Kritika* (Nr. 1, Tiranë, 1944) thotë se kritika letrare e Nolit është kritikë sociale. Ndërsa përpiluesi i librit poetik të Nolit (*Albumi-t*), Mitrush Kuteli, Nolin si kritik e sheh vonë diku në vitet 1943, dhe thotë se *introduktat* e Nolit janë vetëm modele të gjalla analizimi, gjykimi e interpretimi<sup>14</sup> (studimi *Poeti Fan S. Noli*, 1943).

Vlen të theksojmë se edhe Noli vetë ishte i vetëdijshëm për modelin e kritikës që bënte, dhe për synimin që kishte me shkrimin e *introduktave*. Madje nëpër *introdukta* jep shenja se qëllimisht e ka zgjedhur këtë model të kritikës. Për shembull, në një *introduktë* që bën (*introdukta* për tragjedinë *Hamleti* të Shekspirit), Noli, ndër të tjerash, para se ta përfundojë *introduktën*, thotë:

*Shpjegimet elementare, të dhëna këtu, nuk mund të shërbejnë shumë veç në qoftë se ia zgjojnë këndonjësit kurshetin t'a shikojnë e t'a gjykojnë vetë.*<sup>15</sup>

Gjithsesi se Noli në *introduktat* e tij nuk ndalej vetëm të zgjimi i kurreshtjes. Ai në disa sosh vërehet se shqyrton edhe një varg çështjesh e problemesh që atij i dukeshin me interes dhe që mund të lidheshin me veprën, autorin apo gjendjen e shqiptarëve në atë kohë. Kjo e fundit, pra gjendja e shqiptarëve në atë kohë, *me më shumë Sança Pança se Don Kishotë*, siç thotë Noli tek *introdukta* për veprën *Don Kishoti i Mançes*, po që na e jep një pamje edhe më të plotë të modelit të kritikës së trajtuar prej Nolit, i cili, edhe pse vetëm me *introdukta*-parathënie, prapë arriti të zërë një vend të spikatur në mendimin kritik shqiptar.

<sup>13</sup> Eqrem Çabej, “*Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*”, Tiranë, 1936.

<sup>14</sup> Citim i marrë nga botimi i veprës *Albumi*, të Fan Nolit, botuar në Prishtinë, 1968, f. 9-26, me parathënie të Mitrush Kutelit.

<sup>15</sup> Fan S. Noli, *Ligjërime introdukta, vëllimi 2 i veprave të Nolit, Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 80.*

---

**Literatura:**

1. Aristoteli, *“Poetika”*, Buzuku, Prishtinë, 2010.
2. Fan S. Noli, *“Vepra 6”*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
3. Fan S. Noli, *Ligjërime introdakta*, vëllimi 2 i veprave të Nolit, Rilindja, Prishtinë, 1968.
4. Àt Justin Rrotës *“Letratyra shqype”*, 1925.
5. Gaetano Petrotas, *“Populli, gjuha letërsia shqipe”*, 1931.
6. *“Histori e letërsisë shqiptare”*, Rilindja, Prishtinë, 1989.
7. *“Historia e letërsisë shqipe I-II”*, Enti i botimeve shkollore i republikës socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1968.
8. Rexhep Qosja, *“Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, II, III”*, Rilindja, Prishtinë, 1984-1985.
9. Namik Ressuli, *“Albanian Literature”*, Boston, Massachusetts, Vatra, 1987.
10. Ibrahim Rugova, *“Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”*, Faik Konica, Prishtinë, 2005.
11. Namik Ressuli, *“Shkrimtarët shqiptarë 1”*, PAKTI, 2007.
12. Karl Gurakuqi, *“Shkrimtarët shqiptarë 2”*, PAKTI, 2008.
13. Nasho Jorgaqi, *“Profile dhe probleme letrare”*, Dudaj, Tiranë, 2008.
14. Sabri Hamiti, *“Shkollat letrare shqipe”*, 2004.
15. Eqrem Çabej, *“Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe”*, Tiranë, 1936.
16. Tzvetan Todorov, *“Hyrje në letërsinë fantastike”*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.
17. Northop Fraj, *“Anatomia e kritikës”*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
18. Nasho Jorgaqi, *Profile dhe problem letrare (Studime, gjurmime, ese)*, Dudaj, Tiranë, 2008.

Besnik JAHA

## **SOCIAL CRITICISM IN ALBANIAN LITERATURE (INTRODUCTIONS BY FAN S. NOLI)**

### **Abstract**

Until recently, in Albanian literary studies, there were no comprehensive critical literary works, despite the fact that in most cultures with a tradition in literature, critical reading was seen as the primary approach to the text. Therefore, simply put, the majority of the critical works before WWII did not possess any quality. The reason for the lack of quality was the fact that Albanian literary criticism, like literature itself until late, developed under the influence of various cultural, social, political, and ideological contexts through which Albanian society passed. Therefore, it can almost be said that Albanian literary criticism until now does not enjoy full autonomy.

**Keywords:** *criticism, Albanian literature, social, introduction*

## **V. REFLEKSIONE**



Besnik MUSTAJ

## NË EMËR TË BIRIT OSE TË NXËNËSIT\*

Ende s'i kisha mbushur nëntë vjet kur regjimi i kohës, i quajturi push-tet i popullit, e shpalli zyrtarisht Shqipërinë vend ateist dhe ndaloj me ligj çdo formë të ushtrimit të fesë, qoftë kjo private apo publike. Besimi në Zot u përcaktua si “opium për popullin” dhe u shpall armik politik dhe kombëtar. Kishat dhe xhamitë u rrafshuan, librat fetarë u dogjën, klerikët, ata që shpëtuan nga burgu, u veshën me kominoshe e me çizme dhe u dërguan të punonin në ferma e në uzina për të fituar bukën e gojës njësoj si të gjithë vdekatarët e tjerë. Në mos, le të vdisnin urie! Po me ligj penal u ndalua edhe mëshira ndaj tyre. Posaçërisht ndaj tyre nuk lejohej as “solidariteti socialist”. Ata duhej të edukoheshin përmes punës së rëndë fizi-ke në gjirin e klasës punëtore, ku edhe të mësonin si jetonte populli në sajë të djersës së ballit. Në kodin penal u shtuan nenet, me dënime deri në dhjetë vjet burg për këdo, që guxonte të bënte kryq apo të binte në gjunjë për t'u falur qoftë edhe në vetmi brenda shtëpisë së tij.

Më kujtohet heshtja që sundonte në shtëpinë tonë në Tropojë tek sa gjyshi dëgjonte në radio lajmet. Gjithë populli, sipas radios, rinia sidomos, por edhe gratë, burrat, pleqtë ishin ngritur në këmbë me pishtarë në dorë të digjinin “errësirën robëruese, me të cilën feja e kishte mbushur tru-rin e njerëzve të paditur për shekuj e shekuj me radhë”. Kjo përmytje do të kryhej në kokën e njerëzve dhe do të shënonte “fundin e pakthyeshem të së kaluarës”. Unë ndërkohë isha i mbushur plot me një ndjesi të përzier turpi dhe sikleti të madh, por që nuk guxoja ta shprehja në sy të gjyshërve

---

\* Marr nga libri me ese “Bishti i Kometës” botoi Toena, Tiranë 2014.



dhe të nënës. Të nesërmen, në shkollë, mësuesja do i pyeste një nga një fëmijët nëse ishin bashkuar me prindërit gjatë shembjes së xhamisë, gjatë djegies së ramos së priftit apo gjatë rrafshimit të varrezave të qytetit, ku deri dje, të gjallët mendjemykur u kishin vënë te koka të vdekurve kryqe apo gjysmëhëna të gdhendura në gur apo të derdhura në allçi dhe u kishin ndezur qirinj.

Mua më vinte, qysh një ditë para, turp kur të nesërmen do të isha i detyruar të pohoja faqe gjithë klasës se gjyshi, gjyshja ashtu si edhe nëna ime nuk ishin bashkangjitur me gjithë popullin për të çua në vend fjalën ndriçuese të Partisë. Ata kishin qëndruar të mbyllur në shtëpi. Për babain nuk kisha çfarë të thosha. Ai dilte ditë për ditë nga shtëpia ndaj të gdhirë për të shkuar në punë e kthehej në mbrëmje vonë, pasi mua më kishte zënë zakonisht gjumi. Unë e dija se ç'po ndodhte gjithandej tashmë, ani pse nëna, me t'u kthyer nga shkolla, nuk më lejonte më të vija këmbën jashtë pragut të oborrit. E dija nga radio. Kaq do të më kishte mjaftuar për ta treguar gjerë e gjatë euforinë e përditshme të asaj përmbysjeje të pashembullt në historinë e Shqipërisë dhe për të sajuar, madje me ngjyra, ekzaltimin e të mive bashkë me mua brenda shkumëzimit të asaj euforie.

Por do të vinte çasti kur mësuesja do të më pyeste konkretisht se në cilën ngjarje kishin marrë pjesë të djeshmen vetë prindërit e mi. Cilit hoxhë ja kishin rruar mjekrën në mes të lagjes, nën yshtjet gazmore të turmës revolucionare? Aty do të skuqesha e do të më mbulonin djersët e turpfit. Djersë të ftohta. Isha i sigurtë se gjyshi, gjyshja dhe nëna ime kishin qëndruar gjithë kohën mbyllur në shtëpi, a thua se i fshiheshin një murtaje. Dhe jo vetëm kishin qëndruar mbyllur në shtëpi, por edhe njëri me tjetrin ishin marrë vesh më shumë me shenja se me fjalë, gjë që nuk më kishte ndihmuar mua as të kuptoja disi se çfarë mendonin ata. Shpresa e vetme për të më nxjerrë nga sikleti mbetej babai. Ai vazhdonte zakonin e daljes në agim e të kthimit afër mesnatës. Por, edhe kur qëllonte, në të rrallë, të kthehej pak më herët, dhe bëhej kështu pjesë e darkës familjare, ai nuk çelte kurrë biseda rreth ditës së tij të punës. As gjyshërit, ashtu si nëna ime, të paktën faqe ne, fëmijëve, nuk e pyesnin. Ky rregull, i pakuptueshëm për mua, zbatohet me rreptësi të plotë. Në një nga këto mbrëmje, unë nuk e përmbajta dot ankthin dhe, i mbushur me një guxim të papritur,

e pyeta babin se ku po e zhvillonte ai betejën e vet. Babai, i vetmi i shkolluar mirë në familjen tonë, madje i shkolluar në Tiranë, do të duhej ta mirëkuptonte hallin tim. Ende pa e mbaruar pyetjen, babai më përfshiu me një vështrim të çoroditur.

- Cilën betejë? – Ai kishte sakaq një zë të acaruar, por që unë nuk desha ta vija re. Duhej t'i tregoja se dija edhe unë të isha i vendosur dhe e dija për çfarë po flisja.

- Betejën kundër fesë, siç po bën mbarë populli ynë përparimtar.

- Nuk janë punë për ty këto, - ma preu shkurt. – Nuk janë punë fëmijësh. Dëgjove? Nuk janë punë për ty. – Unë mbeta pa gojë. Babai nuk ishte treguar kurrë kaq i paduruar me mua. Edhe kur nuk i pëlqenin ndërhyrjet e mia, ai prapë e gjente fjalën e duhur për të më sqaruar pa e humbur butësinë. Kësaj here ai u bë krejt tjetër.

Si nuk ishin punë për mua këto? E dinte ai në ç'darë na vinte ne mësuesja në shkollë apo jo? Këto dhe shumë pyetje të tjera të ngjashme më vërshuan mizëri në kokë, por që nuk bëhej më fjalë t'i shtroja. Babai më kishte tronditur shumë me ashpërsinë e vet të panjohur. Ai kishte një autoritet të tillë mbi mua, sa edhe me butësinë e vet të zakonshme, do të më kishte detyruar verbërisht të besoja se ajo që po ndodhte nuk ishte vërtet punë për mua e se mësuesja gabonte që na përziante ne, fëmijëve, në këtë histori të ngatërruar të mëdhenjsh. Ky babai tjetër që po zbulojta befas asaj mbrëmjeje, vërtet ma mbylli gojën, si të më fuste përdhunshëm midis dhëmbëve një shuk lecke, por edhe më zgjoi në shpirt një inat gurgullues kundër atyre që më kishin bërë kokën, inat që unë, sigurisht, do të duhej ta mbaja përbrenda si një llavë zjarri. U ndjeva i dobët, i braktisur. Nuk kisha më kujt t'i kërkoja ndihmë. Ku do i fshihja të nesërmen djersët e ftohta, kur të pohoja para gjithë klasës se prindërit e mi i kishin bërë bisht detyrës historike?

Edhe ashtu, duke zier nga inati, e dija, megjithatë, që nuk do kisha zemër të shisja prindërit para të tjerëve. Vetëm do të heshtja me sytë përdhe, me fytyrën që më përcëllonte nga turpi. Me të drejtë, mësuesja nuk do të ndjente pikë mëshire për mua. Edhe pa pohimin tim, ajo do e merrte me mend ç'po ndodhte dhe do të më drejtohej, duke më tundur gishtin, që ta shihnin të gjithë shokët, se prindërit e mi ishin dezertorë ndaj detyrës

së madhe të revolucionit. Kjo është shumë e rëndë, do e ngrinte ajo zërin edhe më shumë. E kupton ti sa e rëndë është kjo? Domethënë se më takonte mua në vazhdim të bëja detyrën time, që do të thoshte se duhej të shpjegoja përse ata i kishin bërë bisht detyrës revolucionare. Kjo do të ishte më e tmerrshme: Nuk pranohej të ishte i sinqertë. Unë mund ta kisha kapërcyer pyetjen e saj rreth prindërve të mi me një mbledhje të supeve. Mund edhe të belbëzoja nëpër dhëmbë, duke u betuar me zemër në dorë se nuk e dija ç‘i mbante prindërit e mi larg asaj stuhie revolucionare. Por jo, mësuesja doemos që nuk do të kënaqej me përgjigjen time. Ajo do të më urdhëronte kërcënueshëm të tregohesha i sinqertë. Bijtë e Partisë, do të më skërmitoj mësuesja, e hapin zemrën para shokëve. Familja e vërtetë e revolucionit janë shokët e tij të idealit. Apo jo? Do të kërkonte ajo mbështetjen e klasës. Unë do të dëgjoja një “po” bubullimë, sa edhe muret e shkollës të dridheshin duke lëshuar një pluhur të hollë gëlqereje, që do i mbushte sytë e mi si hi i nxehtë...

Sinqerisht në shpjegimin e sjelljes së prindërve të mi, sipas mësueses time, do të thoshte që unë të shpaloj para fëmijëve të tjerë gjithë përçmim se prindërit e mi ishin besimtarë të verbuar dhe nuk u bënte zemra të bashkoheshin me fjalët e Partisë. Me fjalë të tjera, ata vetëm me trup jetonin në të tashmen. Me shpirt ata ishin të zhytur në të kaluarën e mykur dhe kjo sepse e kishin trurin të mpirë nga opiumi fetar. Unë nuk isha në gjendje të pohoja me zemër në dorë se prindërit e mi ishin njëmend besimtarë të devotshëm. E dija se në shtëpinë tonë kremtoheshin të gjitha festat fetare, ca nga të cilët, siç kam mësuar më vonë, nuk kishin lidhje me islamin si, bie fjala, Shën Gjergji, Shën Kolli e ndonjë tjetër. Në betimet e pathyeshme të gjyshërve dhe të nënës time hynte edhe “Për emër të Zotit”. Në shtëpinë tonë nuk gatuhej kurrë mishi i dërrit. Por kaq nuk i mjaftonte mendjes time, sado që mendje fëmije, të shprehej me siguri se prindërit e mi ishin besimtarë të verbër. Në të vërtetë kisha edhe një pengesë të pakapërcyeshme për ta pranuar një cilësim të tillë. Sipas “fjalës së Partisë”, besimtarët e verbër ishin njerëz injorantë. Ndërkohë që babai im ishte ndër burrat më të shkolluar të krahinës tonë. Për gjyshin unë e dija se nuk kishte kryer ndonjë shkollë, por e shihja me sytë e mi se ai pjesën më të madhe të ditës e kalonte duke lexuar. Madje lexonte kryesisht librat

e kuq të Udhëheqësit. Gjyshja dhe nëna ishin larg botës së dijes, ama as ato nuk më dukeshin aspak injorante. Isha i vendosur të mos e poshtëroja familjen time sikur edhe në prush të ma fushin kokën. Po si do të bëja?

Mbetej vetëm një mundësi e dytë: të pranoja se të mëdhenjtë e familjes time ishin të lidhur me armikun e jashtëm. Na ishte thënë e përsëritur se feja, qoftë ajo e Krishtit e qoftë ajo e Muhamedit, ishin ngulitur me përdhunë ndër trojet shqiptare nga pushtuesit e huaj. Ky ishte një spekulim shumë i rafinuar nga ana e makinës propagandistike të regjimit. Vite më vonë, për interesat e mia letrare, i kam studiuar me vëmendje botimet e asaj periudhe. Në fjalimet e Enver Hoxhës e për rrjedhim në mijëra faqe shkruar nga të tjerët, nuk gjendet asgjë që do t'i përngjante sadopak një debati publik, qoftë ky edhe debat midis ateistëve dhe teologëve. Ateizmi shpallet me dekret si ideologji zyrtare e vetme dhe në emër të tij përdoren instrumente të dhunës policore për asgjësimin e kundërshtarëve, kristianë apo myslimanë qofshin. Enver Hoxha shmangu qëllimisht polemikat mbi përmbajtjen e dogmës së njëjës apo tjetrës fe. Si pinjoll i një mullai, ai me siguri e dinte mirë se nuk mund ta çrrënjoste besimin nga kokat e shqiptarëve duke përdorur logjikën, filozofinë apo moralin. Vendimin e vet, një vendim tërësisht politik dhe vetëm në shërbim të pushtetit të vet, ai bën sikur e përlligj me disa elementë historikë, të cilët nuk kishin asnjë lidhje me fjalën e Krishtit apo të Muhamedit. Ai u përqendrua në kontekstin historik kur kishin ardhur në trojet shqiptare këto dy fe. Perandoria romake në fillim e pastaj perandoria bizantine e ajo osmane, ku kishin bërë pjesë trojet e të parëve tanë në këto periudha të njëpasnjëshme të antikitetit e të mesjetës, jepnin fakte të mjaftueshme për t'u kujtuar misionarët të krishterë ashtu si dhe ata myslimanë thjesht si pushtues të stërgjyshërve tanë. Spekulumi i propagandës zyrtare qendrore të identifikimi i misionarëve të fesë si trashëgimtarë të ushtrive pushtuese për të arritur në përfundimin se këto fe ishin mish krejt i huaj në karakterin kombëtar të shqiptarit dhe si të tilla duheshin çrrënjësuar nëpërmjet një operacioni kirurgjikal radikal. Enver Hoxha shpallte si objektivin e vet madhor pas-trimin përfundimtar të identitetit të shqiptarit, duke synuar në të vërtetë një tabularasa të trurit të shqiptarit, që do të thoshte as më shumë e as më pak veç një përgatitje klinike e shqiptarit për të hyrë lirisht në kallëpin e

njeriut të ri, i cili nuk duhej të kishte sidomos kujtesë individuale. Kujtesa kolektive do të ishte e higjienizuar dhe shërbehej e gatshme nga sistemi. Po t'i referohemi edhe teorisë leniniste për revolucionin komunist, njeriu i ri nuk ka identitet kombëtar.

Kush do të mbronte në ato rrethana tmerrësisht dramatike dhe të ndërlikuara njeriun shqiptar nga shpëlarja e trurit?

Misionarët e fesë, si trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të ushtrive të dikurshme pushtuese, duhej detyrimisht të ishin për jetë të jetëve në shërbim të armiqve të jashtëm të Shqipërisë. Për ta vazhduar historinë time, mua më mbetet pra vetëm një mundësi e dytë: të pranoja se të mëdhenjtë e familjes time nuk merrnin pjesë në veprën çliruese të Partisë sepse bënë me vetëdije punën e armikut të jashtëm. Rrjedhimisht, ata nuk mund të quheshin ndryshe veçse tradhtarë të atdheut, sabotatorë të pushtetit popullor, të shitur te spiunazhi amerikan. Për veten time më mirë pranoja të ma prisnin gurmazin me gërshërë se sa të pranoja që prindërit e mi ishin tradhtarë të atdheut. Isha në hall të madh: si të shpëtoja pa i denoncuar prindërit siç do të ma kërkonte mësuesja nëpërmjet urdhrit për t'u treguar i sinqertë?

Dy-tri ditët e para, ma thotë mendja rastësisht, gishti i mësueses nuk u drejtua nga unë. Por unë isha gjatë gjithë kohës me gjak të ngrirë. Një mëngjes u ngrita nga shtrati i vendosur të mos shkoja në shkollë. Jam i sëmurë, i thashë nënës, pa guxuar t'i pohoja të vërtetën. Dhe ajo bëri sikur më besoi, madje pa më pyetur fare ku më dhembte. Nuk më çoi sigurisht as te mjeku. Dhe nuk tregoi asnjë kujdes të veçantë, siç do të kishte treguar po të kishte menduar se isha vërtet i sëmurë. Gjyshi me gjyshen po ashtu nuk bënë zë. As unë nuk u ankova e as nuk vazhdova të shtirem sikur po vuaja. Ishte si një marrëveshje e heshtur mes nesh. E mjaftueshme. Nuk shkova në shkollë gjatë gjithë javës, deri sa nisi të qetësohet disi fushata e luftës kundër fesë. Puna e madhe mbaroi. Kishat e xhamitë u dogjën e u rrafshuan deri në themel në mbarë krahinën dhe nuk mbeti më klerik për t'u shfaqur me shenjat e tij dalluese mbi faqe të dheut tonë.

Me sa mbaj mend, ajo është hera e parë që kam gënjyer dhe, për më keq, kam gënjyer me mirëkuptimin e pa pohuar të prindërve. Them se arsyeja kryesore pse u detyrova të gënjeja lidhet me përplasjen e papajtu-

eshme mes asaj çka mendoja unë se ishte sinqeritet në përgjigjen që do t'i kisha dhënë mësueses dhe asaj çka mësuesja quante sinqeritet në përgjigjen që priste prej meje. Në rrethana të tilla, ishte e qartë se o do të gënjeja veten dhe prindërit, duke u hequr si i sëmurë, o do të gënjeja mësuesen dhe shokët e klasës duke denoncuar prindërit e mi si tradhtarë të atdheut dhe sabotatorë të revolucionit. Me atë mendjen time të torturuar nga ankthi nuk isha në gjendje të gjeja një rrugë të tretë për t'i shpëtuar gënjeshtres. Nëna ime thoshte se gabimin e fal jo vetëm rob, por edhe Zoti. Gënjeshtren jo. Refleksi i kësaj edukate më tha se, duke gënjyer veten, unë në të vërtetë po bëja vetëm një gabim. Mirëkuptimi i heshtur që gjeta menjëherë te prindërit ma përforcoi bindjen se po bëja vërtet vetëm një gabim, të cilin ata të parët, domethënë prindërit, po ma falnin. Ishte një lehtësim i çmueshëm për ndërgjegjen time të trazuar thellë.

Vite më vonë, kur isha aftësuar tashmë për t'i analizuar gjërat, jam siguruar plotësisht se kisha bërë zgjedhjen më të përshtatshme për rrethanat. Gjyshja ime ka qenë e vetmja në trungun tonë që ka dhënë një shpjegim me zë të lartë për këto lloj shmangiesh të pjesëtarëve të familjes time nga ngjarjet ekzaltuese gatuar nga regjimi i kohës për ta përfshirë në faj gjithë njerëzinë, me të madh e të vogël. Na ka ndihmuar Zoti të ruajmë veten, thoshte ajo. I qofshim falë! Gjyshi, nëna apo babai nuk i komentonin kurrë monologët e saj. Gjatë rritjes time, unë nuk e kam marrë ndonjëherë vesh nëse edhe ata mendonin po ashtu si ajo. Por kjo hollësi nuk ka asnjë rëndësi për historinë. Gjyshja ime, - me siguri edhe shumë të tjerë si ajo, - e shihte kërdrinë që po zhvillohej nëpër rrugët e sheshet e qyteve dhe të fshatrave si një molepsje, nga e cila mund të mbroheshe vetëm me ndihmën e një fuqie mbinjerëzore. Për sa më përket mua, asokohe, doemos që nuk kisha asnjë gjykim për përfitimet që do të kishte regjimi duke e shtyrë një fëmijë të sajonte gjithë ato akuza kundër të mëdhenjve të familjes së vet. Po të shpreheshja për një çast me fjalët e gjyshes time, do të duhej të thosha se Zoti më ruajti pa hyrë në një lojë, që do të kishte qenë shumë e rëndë për t'u mbajtur në ndërgjegje në të ardhmen më së pari për vetë mua. Jo thjesht pse do i kisha poshtëruar prindërit faqe shokëve të mi e rrjedhimisht faqe gjithë njerëzisë. Në retrospektivë përfytyrohen pa zor të madh pasojat që do të bënin mbi ta si "armiç".

Bashkë me ta, në thesin që do të merrte rrokullimën drejt humnerës, do të ishim patjetër edhe unë e dy vëllezërit e mi më të vegjël. Unë nuk kam parasysh as edhe vetëm këto pasoja kur vlerësoj tani se ajo lojë do të kishte qenë tepër e rëndë më së pari për vetë karakterin tim. Qysh nga ai çast unë nuk do ta dija më kurrë me saktësi ç'lidhje kishte midis sinqeritetit dhe të vërtetës. Ky do të ishte një deformim me ndikim ndoshta të pashërueshëm në marrëdhëniet që fëmija i asaj kohe, që isha unë, do të kishte në vazhdim me të tjerët edhe kur të rritej e të mbërrinte në moshën e burrit.

Në familjen tonë myslimane prej gjashtë brezash, vetëm gjyshja ishte aq besimtare sa ta zbatonte në përditshmëri besimin e vet. Gjatë këtyre ditëve të rrënimit të kishave dhe të xhamive, veçanërisht ajo ishte bërë si e ndërkrjer. Por, ashtu si të tjerët në shtëpi, as ajo nuk fliste shumë. Vetëm shkante nga një dhomë në tjetrën duke mermëritur me vete: “Nuk bën shqiptari kështu. Nuk bën shqiptari kështu.” Pastaj ulej në një qosh të minderit, mbyllte sytë dhe vazhdonte të mermëriste me majat e buzëve si në një kllapi. Mendja më thotë se lutej. Më vonë e kam dëgjuar disa herë t'i shprehte nënës time brengën e vet të pangushëllueshme, të mbirë në shpirtin e saj të lodhur pikërisht gjatë ditëve të asaj batërdie: do të vdiste pa e mbajtur edhe njëherë ramazanin. Ishte një brengë që ia dinin edhe shumë të tjerë në lagje e më gjerë. Ajo nuk e fshehu kurrë që besonte në Zot. Por ramazanin nuk guxonte ta mbante. Kam frikë se i bëj dëm djalit, thoshte me këdo kur i binte fjala, duke pasur parasysh mirëfilli persekutimin që do të pësonte ai pse nuk kishte qenë në gjendje të edukonte nënën e vet. Babai im ishte djali i saj i vetëm. Frika e saj kishte arsytet e veta. I kishte qëlluar shumë herë gjatë periudhës së ramazanit ta provokonin duke e shtyrë të pinte kafe jo vetëm në shtëpitë e të tjerëve, ku mund të qëllonte për vizitë, por edhe brenda në shtëpinë e saj. “Vizitorë” të ardhur qëllimisht për të verifikuar, kur shihnin se ajo e merrte pa ngurrim kafenë, e pyesnin si me çudi pse po e prishte agjërimin.

- Nuk e mbaj më qysh se u ndaluan punët e Zotit, - u përgjigjej ajo me pak zë e duke rrëzuar sytë, si njeri i zënë në faj. Fytyra e saj mbështillej me një pikëllim naiv. – Kam frikë se i bëj dëm djalit, - shtonte përmes një ofshame edhe kur nuk e pyesnin përse kishte hequr dorë nga agjërimi.

Në vitin 1984 isha vendosur tashmë me punë si gazetar në Tiranë. Bashkë me gruan dhe djalin e sapolindur shkuam në vendlindjen time të festonim me familjen prindërore ardhjen e vitit të ri 1985. Në një nga bisedat që pata me gjyshen, - gjyshi kishte vdekur ndërkohë – e ftova të vinte tek unë në periudhën e ramazanit. Aty do të mund të agjëronte lirisht. Gjyshja, ndjesë pastë, më përfshiu me një vështrim të papërcaktueshëm. Ajo heshti një çast pa m'i shqitur sytë sikur po më hetonte, pastaj më drejtoi pyetjen më të papritur:

- A jeni me Enverin ju atje në Tiranë?

- I lëre Enverin në punë të vet! – iu shmanga unë përgjigjes. – Ti në shtëpinë time do të mbash ramazanin. Kjo të duhet ty. Këtë do ta kesh.

Ajo i dha vetes një grimë kohë, që nuk ishte kohë për t'u menduar para se të merrte vendimin. Ishte një kohë e nevojshme për t'u siguruar se më kishte dëgjuar mirë. Ose ishte një kohë, që ajo ia dha vetes për të shijuar një gëzim të pashpresuar. Fytyra e saj zuri të çelet, të mbushet me dritë dhe përsëri më befasoi.

- Jo, - tha, - nuk vij. Do të pres ditën të agjëroj këtu, në shtëpinë time. Zoti do të më japë frymë sa të vijë ajo ditë, e di. Dreqin s'e pollëm ne këtu, na e dërguan nga Tirana. – Kishte folur rreptë, aq sa iu tha pështyma në gojë. – Juve atje u paska dalë frika, Zot shyqyr! Nuk do të vonojë e kjo dallgë e mirë do të vijë deri këtu. Do ta pres, - theksoi plot vendosmëri, - nuk do të vdes pa mbërritur kjo dallgë e bekuar edhe këtu.

Tetë vjet më vonë, në mars 1992, diktatura kishte rënë tashmë dhe unë kthehesha në vendlindje si kandidat i Partisë Demokratike në zgjedhjet parlamentare. Ditën e votimeve gjyshja nuk pranoi ta shoqëronte as Kush në dhomën e fshehtë, veç meje. Ajo ishte analfabete dhe duhej ndihmuar të votonte, gjë që e parashikonte edhe ligji. Siç e pohoi pa ndonjë bezdi faqe babait tim dhe vëllezërve të mi, ma kishte borxh votën dhe donte të ma lante borxhin me dorën time. Dhe kujtoi me ngazëllim ftesën time për të agjëruar në shtëpinë time në Tiranë. Ishte e kotë t'i thosha se në të vërtetë unë i kisha asaj një borxh të madh, të pashlyeshëm.

Kjo histori e fëmijërisë më ka ndjekur si një parabolë për më shumë se dyzet vjet dhe ka pasur mbi mua, sidomos gjatë rinisë, ndikimin e një antidote kundër edukimit zyrtar, që isha i detyruar të merrja, si gjithë mo-



shatarët e mi. Disa nga dyshimet e mija, që do të më shtynin më vonë drejt vendimesh substanciale për jetën time, e kanë zanafillën si reflekse, pikërisht te vuajtja ime e turbullt e atyre javëve, siç mund të jetë e turbullt vuajtja e një djali të vogël, i cili nuk arrin dot ta kuptojë sado që ta shtrydhë trurin, pse sinqeriteti merr dy kuptime krejt të kundërta dhe madje pa shpresë për t'u pajtuar ndonjëherë: njërin brenda në shtëpi, ku isha "biri" e tjetri jashtë saj, atje ku isha "nxënësi". Gjyshja ime ka ndërruar jetë tashmë. Ajo arriti të agjëronte trembëdhjetë herë para se të mbyllte sytë, e lumtur. Por e di se, po të mundej të ndërhynte në përsiatjet e mia tani, do të më përsëriste pa asnjë mëdyshje se "Zoti e ndihmoi birin të fitonte mbi nxënësin".

Mr. Besim MEHMETI

## KONCEPTI I SHTETIT QYTETAR-KOMBËTAR DHE FEJA\*

### **Abstrakt**

Shteti kombëtar (kombëtar), i cili u krijua në botën islame gjatë shekullit të njëzetë, përballet me sfida të thella që kanë arritur në pikën e një krize gjithëpërfshirëse. Për sa i përket kushteve të tyre të brendshme, shumë nga këta vendeve janë në një situatë që rrezikohen të shemben dhe zhbëhen, nën peshën e shpërbërjes, trazirave, luftërave dhe konflikteve civile. Për sa i përket orientimeve dhe marrëdhënieve të tyre, ato nuk mundën t'i japin fund izolimit nga njëri-tjetri, por, përkundrazi e përforcuan atë izolim dhe i shtuan shkaqet e armiqësisë mes tyre, derisa çështja arriti në kufirin e konflikteve, pushtimeve dhe kërcënimit, dhe nganjëherë jo rrallë edhe te lufta. Kohët e fundit disa nga ata shtete janë zhytur në konflikte dhe luftëra të brendshme.

Kjo i shtyu disa studiues të shkruajnë për nevojën e rishqyrtimit të kushteve historike të formimit dhe sfidave me të cilat përballen këto vende, madje edhe nevojave të ringritjes apo rithemelimit.

Prandaj, Forumi i Abu Dhabit në vitin 2016 ka vendosur si synim të tij në qendër të shqetësimeve të tij për të rishqyrtuar një sërë konceptesh me bazë shariatike-ligjore, dhe për t'i nënshtuar ato studimit shkencor.

---

\* Temë e trajtuar në “Forum i për Promovimin e Paqes 2016”, mbajtur në Abu Dhabi më 18.12.2016.

Pra, në këtë forum u diskutua dhe debatua për një temë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme në kohën moderne, atë të shtetit kombëtar, e që në fakt është keqkuptuar te shumë myslimanë.

*Fjalët çelës: Shteti kombëtar, Paqja, Shteti Islamik, Dar Islam, Dar Harb, El Maslatha - Interesi, Imamati, Kalifati, Korrigjimi dhe racionalizimi i koncepteve, El Vela- besnikëria.*

### KONCEPTI - KORNIZA E FORUMIT TË TRETË<sup>1</sup>

Forumi për Promovimin e Paqes u krijua më shumë se dy vjet më parë, për të qenë një hapësirë për të menduar për mënyrat për t'i shuar zjarret në shoqëritë myslimane, dhe për ta rikthyer gjendjen në normalitet, pasi ato hynë në një tunel të errët të vetëshkatërrimit, dhe doli se erërat e ndryshimit që frynë me të ashtuquajturën “Pranverë Arabe” nuk mundën ta mbillnin një të ardhme të ndritur, dhe kjo në mungesë të një vizioni të qartë të identitetit, të realitetit në të gjitha nivelet dhe dimensionet e tij, si dhe të qasjes ndaj përparimit dhe reformës.

Kjo gjendje përhapri kaos dhe dëshpërim, duke i detyruar institucionet relevante në të gjitha fushat, qofshin ato politike, shtetërore, shoqërore, arsimore por edhe fetare që të ndërmarrin veprime dhe aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin e masave në vende të ndryshme.

Kështu që, Forumi në vitin 2016 e ka vendosur synimin e tij në qendër të shqetësimeve të tij, për të rishqyrtuar një sërë konceptesh me origjinë ligjore, si dhe për t'i nënshtruar ato studimit shkencor, të vetëdijshëm për dy konsiderata kryesore:

**E para:** natyra e tij - pra “forumi” - dhe funksioni i tij si forum intelektual dhe shkencor. Qëllimi i tij është të kontribuojë në shuarjen e zjarreve të umetit dhe shmangien e shpërthimeve, dhe si mjet ka ta rinovojë qasjen për ta kuptuar diskursin ligjor - shariatik dhe të kërkojë përkushtim ndaj rezultateve të tij. Forumi e kupton natyrën komplekse të arsyeve

<sup>1</sup> Abdullah bin Bejjah, Fjalimi hyrës në Forum, Abu Dhabi 18/12/2016.  
<https://binbayyah.net/arabic/archives/3772>.

që i çuan shoqëritë myslimane drejt asaj gjendje që kanë arritur; qofshin historike dhe momentale, subjektive dhe objektive, materiale dhe morale; Por ai beson se ndalimi i gjakderdhjes dhe sjellja e paqes është “detyrë e kohës” për studiuesit, udhëheqësit fetarë, mendimtarët dhe politikanët. Është një detyrë që meriton të bashkojë përpjekjet e të gjithë njerëzve të arsyeshëm nga radhët e bijve të umetit dhe atyre që e duan të mirën për mbar njerëzimit. Ky pozicion është arsyeja pse Forumi ka dëshmuar në takimet e tij intelektuale se është në zemër të Sheriatit. Ky Forum nuk është themeluar për të lavdëruar dikë, apo për të favorizuar një organizatë, ose për të qenë intolerant ndaj një sekti, apo për ta triumfuar një grup shoqëror mbi një tjetër...

Ngjarjet dhe faktet kanë vërtetuar se shoqëritë myslimane nuk kanë zgjidhje tjetër përveç opsionit të paqes në të gjitha dimensionet e saj, dhe gjithçka që kalon nga jeta e tyre në një drejtim tjetër, e sjell atë më afër asgjësimit njerëzor, rrënimit urban dhe ndarjes së shteteve.

**Së dyti:** rreziku i ideve dhe koncepteve në jetën e individëve dhe të kombeve. Sidomos pasi shumë nga konceptet të bazamenteve shariatike - ligjore po hiqen nga konteksti i tyre dhe po përdoren për gjera që bien ndesh me qëllimet e tyre. Kjo dukuri, shkaktoi shumë pasoja, nga më të pakta të saja është; thellimi i përçarjes dhe fragmentimit në shoqëritë myslimane, që janë ende në kërkim të stabilitetit shoqëror pas ndryshimit të sistemeve të tyre politike. Ndërsa, më e keqja e pasojave të kësaj dukurie është; ajo që po përjeton e gjithë bota e entiteteve parazitare që e paraqesin veten si një alternativë ndaj shteteve ekzistuese kombëtare; Përkundrazi, kërkon ta aneksojë atë në emër të “Kalifatit Islamik”. Këto entitete nuk tejkalojnë dëshirën e tyre përveç se për të përdorur terma dhe simbole shariatike - ligjore ose tradicionale islame, e që përputhet vetëm me dëshirën e tyre - kudo që ata gjejnë ose kanë ndjekës të vërtetë ose artificiale - për të shkelur çdo shenjtëri të fesë, veçanërisht shenjtërinë e shpirtit njerëzor, në mënyra dhe metoda të papara në shëmtinë dhe absurditetin e tyre.

Forumit fitoi një bindje të fortë se ndër idetë dhe konceptet që kontribuojnë në prodhimin e këtij realiteti janë ato që kanë të bëjnë me legjitimitetin e shtetit kombëtar në mendimin dhe ndërgjegjen bashkëkohore

islame. Pas rënies së “Kalifatit Osman”, shumë studiues dhe mendimtarë myslimanë mbetën në pritje të rikthimit të sistemit të Kalifatit, dhe u shfaqën lëvizje dhe parti që e mbrojtën këtë ide dhe punuan për të. Kjo kulturë ka kontribuar – ndër shumë faktorë – në dobësimin e besnikërisë ndaj shtetit kombëtar. Kështu që një konceptim i të ashtuquajturit “Shteti Islamik” ka kontribuar gjithashtu në literaturën intelektuale dhe partiake në dekadat e fundit, gjë që dhe ka rezonuar edhe të një grup studiuesish ulema. Është një perceptim, që ithtarët e tij deklarojnë ose aludojnë për jo legjitimitetin e shtetit qytetar- kombëtar siç ekziston në botën arabe dhe islame sepse nuk i përgjigjet perceptimit të tyre për specifikat shariatike - ligjore të shtetit.

Deklarata përfundimtare e forumit të dytë të “Forumi 2015” vuri gishtin mbi këtë pjese të sëmundjesh dhe shkeljesh të kulturës mbizotëruese juridike dhe theksoi qartë se “ka ardhur koha që myslimanët të pajtohen me shtetin e tyre qytetar-kombëtar, si një formë qeverisjeje që i nënshtrohet vetëm rregullave të interesit, luftimit të keqes, preferencave, ekuilibrave dhe një marrëdhënie kontraktuale që nuk e humb legjitimitetin e saj për shkak të gabimeve; e as dështimet e saj nuk përjashtojnë nga detyra e dialogut konstruktiv dhe këshilla të mençura ndërmjet palëve kontraktuese, në mënyrë që përpjekja e të gjithëve të jetë e qartë për të ndërtuar aftësi dhe mundësi, për të mbushur boshllëqet, për të bashkëpunuar në drejtësi dhe devotshmëri, për të aspiruar për udhëheqje dhe për të rivendosur pozitën e umetit i cili i është sjellë njerëzimit si mëshirë dhe këshill”.

Forumi ngre çështjen e legjitimitetit të shtetit qytetar-kombëtar për disa konsiderata, duke përfshirë:

- a) Se mos legjitimiteti i shtetit kombëtar është arsyeimi rreth të cilit mblidhen mijëra bijtë të umetit islam, dhe në veçanti rinia e tij, për t’iu bashkuar entiteteve që nuk kanë legjitimitet, ata nuk kanë legjitimitet as fetar e as popullor, dhe kështu për t’u bërë në emër të “shteti i kalifatit” një lëndë djegëse për luftërat që përgatisin aspektet e mbetura të mirëqenies dhe stabilitetit në shoqëritë myslimane, e në fund për të shkatërruar çdo gjë që i del përpara.

- b) Se mos legjitimimi i shtetit qytetar-kombëtar me argumente që nuk marrin parasysh kushtet subjektive dhe objektive të shtetit qytetar-kombëtar pengon përfshirjen e segmenteve të gjera të përbërësve të shoqërive myslimane në mbështetjen e përfitimeve, zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen pozitive në politikë. Dhe nxit dyfishimin e diskursit dhe paqëndrueshmërinë e pozicioneve dhe dobësimin e besimit të nevojshëm ndërmjet aktorëve politikë. Gjithashtu është një nga motivet më të forta për të kërkuar ndryshim të dhunshëm të regjimit-pushtetit, gjë që ka shkaktuar shumicën e kohës katastrofa të vështirë të riparueshme, efektet e të cilave në të tashmen dhe të ardhmen goditen shoqëritë myslimane, e që janë ende në proces të formimit.
- c) Ndryshimet rrënjësore që ndodhën në shoqëritë myslimane në sistemet e tyre politike dhe juridike, dhe në sistemet e tyre kulturore, intelektuale dhe arsimore pas fazës koloniale dhe natyrës së marrëdhënieve ndërmjet shtetit qytetar-kombëtar dhe sistemit politik ndërkombëtar... dhe ndikimi i gjithë kësaj për vendimet juridike, që lidhen me sistemin e qeverisjes dhe institucionet e tij, dhe ushtrimin e pushtetit dhe organizatave politike... Nuk është nxjerrë deri më tani në aspektin e teorizimit jurisprudencë se çfarë mund të konsiderohet një jurisprudencë-dispozitë vendimtare apo një opinion të prerë të obligueshëm ligjërish. Qëllimi i këtij pretendimi nuk është të nënvlerësohet vlera e asaj që është shkruar për shtetin nga këndvështrimi shariatik-juridik, nga literatura apo kërkimet, një sërë prej të cilave ndihmojnë në sqarimin e problemeve të përmendura më sipër; Por rezultati i asaj që u shkrua për këtë temë është ose një përshkrim i imazhit historik të shtetit, institucionet dhe funksionet e tij në trashëgiminë islame, ose perceptime teorike të një shteti të dëshiruar, e që është larg nga realiteti bashkëkohor i shoqërive myslimane, ose një trajtim i dukurive të pjesshme të lidhura me shtetin kombëtar që nuk synonin të arrinin në thelbin e problemit.

Në përpjekje për të vënë legjitimitetin e shtetit qytetar-kombëtar në sipërfaqen e kërkimit shkencor dhe debatit, studiuesit, mendimtarët, stu-

diuesit dhe aktorët politikë, më 19-18 dhjetor 2016, i studiuam temat e mëposhtme:

**Boshti i parë: Shteti në mendimin dhe përvojën historike të umetit, në të kaluarën dhe të tashmen**

Përvoja historike e umetit në tërësi ka një ndikim të madh në racionalizimin e përvojave të së tashmes dhe vizionet frymëzuese të së ardhmes. Vërehet se është e dukshme ajo që e nxit ndërjegjen e përgjithshme islame në dëshirën e saj për ta rikthyer umetin në pozitën pioniere, pra janë perceptimet selektive të periudhave historike të lavdishme dhe fitoreve, dhe të vetmit ent politik që i bashkon myslimanët. Megjithatë, studimi i përvojës historike të umetit me “Shtetin” na çon në një larmi të madhe formulash, dhe një ndërveprim me fazat e fuqisë dhe dobësisë, bashkimit dhe copëtimit, bashkëjetesës dhe konfliktit. Ky diversitet, nga ana tjetër, u pasqyrua në mendimin islam në drejtimet dhe rrjedhat e ndryshme të tij.

Ky bosht përfshin dy tema:

- a) Shteti në mendim dhe përvojë historike të umetit deri në fund të Perandorisë Osmane.
- b) Nga kalifati në shtetin qytetar-kombëtar.

E para i kushtohet monitorimit të tendencave kryesore intelektuale në teorizimin e çështjes së shtetit dhe legjitimitetit të tij në mendimin islam, dhe për përvojat e përgjithshme në ndërtimin e shtetit; Në diversitetin e tij dhe në marrëdhëniet me shoqërinë, umetin dhe tjetrin deri në fund të epokës së Perandorisë Osmane dhe hyrjes së kolonializmit të huaj.

E dyta synon të analizojë kushtet e përgjithshme për kalimin në një shtet qytetar-kombëtar dhe aspiratat intelektuale dhe rrymat politike shoqërore që dëshirojnë të rivendosin “Kalifatin”. Në këmbim të perceptimeve të ndërjegjshme të dimensioneve të transformimeve globale, dhe kërkimit të reformës brenda kornizës së harmonizimit dhe pajtimit.

### **Boshti i dytë: Shteti midis teksteve të pjesshme dhe qëllimeve totale**

Ebu El Ma'ali El Xhuvajni (vd. 478 H.)<sup>2</sup> përmbledhi mendimin në shumicën e çështjeve të “Imamatit” udhëheqjes së shtetit, duke pohuar se është: “Çështje e shkëputur nga dispozita përfundimtare e konfirmuar, cila arrin në shkallen e perceptimit përfundimtar dhe të sigurt”.<sup>3</sup>

Kjo deklaratë gjithëpërfshirëse rrjedh nga ekstrapolimi i Al Xhuvajninit të tërësisë së asaj që është cek rreth teksteve ligjore në çështjet e shtetit dhe qeverisjes, nga deduktimet dhe kuptimet duke filluar nga epoka e Kalifëve të Drejtë, r.a., dhe duke vëzhguar ndikimin e konteksteve historike tek ata që i paraprinë në shkrimet në fushën e “sijase sheri’ije” – Politikë ligjore”. Këtë ekstrapolim përforcon trashëgimia juridike islame, që është e mbushur me interpretime të ndryshme në të cilat fukahaja-juristët nuk konsideronin gjë tjetër veçse “gjelb mesalih” realizimin e interesave<sup>4</sup> - dobisë publike nga ekzistenca e shtetit, siç është ruajtja e pesë domosdoshmërive; përfshirë lejimin -për shembull-që të udhëheq fitimtari triumfuesi, ose heqja e konsideratës për prejardhjen nga loza e fisit kurejsh të sundimtarit, me qellim për të ruajtur paqen dhe sigurinë, dhe për të marrë parasysh efikasitetin dhe aftësinë për të menaxhuar punët e shtetit.

Ky hulumtim dhe studim në trashëgimin shariatike islame konfirmon se shoqëritë myslimane kanë hapësirë të gjerë rreth dispozitave shariatike në këtë fushë, dhe që legjitimiteti fetar i shtetit mos të lidhet me imazhmetoda të caktuara, por më tepër të lidhet me aftësinë e pushtetit për t’i

---

<sup>2</sup> Abd al-Melik bin Abdullah bin Jusuf bin Muhammed El Xhuvajni El Shafi'i El Esh'ari (Imam i dy haremeve) 419-478h. – 1028-1085g. nga Nishapuri i cili ndodhet në Iranin e sotëm. Një teolog dhe jurist islam i njohur për kontributet e tij në jurisprudencën islame (fiqh) dhe teologjinë (kalam), dhe luajti një rol kyç në formimin e shkollës Ash'ari të teologjisë islame.

<sup>3</sup> El Gjuvejni, Ebu El Meali, “Gijath el Umem fi et TIjath ez Zulem”, <https://shamela.ws/book/8323/1>

<sup>4</sup> Maslahatul Mursele në kuptimin terminologjik do të thotë: “Dobi (interes), e cila është brenda qëllimeve të Ligdhënësit, por për atë (dobi) nuk ekziston argument, i cili dëshmon se Ligdhënësi një gjë të tillë e konsideroi dobi, apo nuk e konsideroi si të tillë. Shih: <https://jusufzimeri.com/leksikon-i-sheriatit/#m>



arritur interesat e nevojshme, kryesorja e të cilave është sigurimi i paqes dhe i sigurisë për komunitetin, mirëpo duke e mos përfshirë atë nga përmbushja e pjesës së tjetër të përgjegjësisë, kryesorja e të cilave është administrimi i drejtësisë. Ky bosht i përfshin dy tema:

a) Shteti në tekstet juridike dhe Ixhtihad<sup>5</sup> të fukahave-juristëve

*E para* është të qartësohen tekstet juridike që rregullojnë çështjen e shtetit dhe të dallohen nivelet e definitives dhe qëndrueshmërisë në të, në dritën e të kuptuarit dhe jurisprudencës së imamëve të jurisprudencës islame.

b) Interesi dhe menaxhimi i shtetit në jurisprudencën politike islame

*E dyta* është sqarimi se interesi sheriatik-legjitim në jurisprudencën e shtetit dhe mundësitë e vazhdimësisë, përshtatjes, zhvillimit dhe përshtatjes së përvojës njerëzore të formulave, formave dhe mekanizmave në formimin e shtetit, funksionet dhe punën e institucioneve të saj është çështje themelore-qendrore; kjo varet nga ndryshimi në realitetin e tyre, sfidat me të cilat përballen dhe ku fizimet me të cilat përballen.

### **Boshti i tretë: Islamizimi i shtetit**

Në çdo forum të tij, Forumi ka trajtuar vazhdimisht keqkuptimet apo konfiskimet e koncepteve islame në rast të defektit në një nga elementët e formimit të tyre; “Pavarësisht nëse është kuptim të një rëndësie gjuhësore dhe juridike, ose janë qëllime dhe shkaqe që gjenerojnë dispozita – vendime, ose një realitet dhe një mjedis që janë objekt i praktikimit”. Duke qenë se konceptet që lidhen me politikën janë konceptet më tërheqëse për përdorim dhe shfrytëzim.

Idetë në lidhje me shtetin janë përhapur në kontekstin e legjitimitetit fetar të shtetit qytetar-kombëtar, duke përfshirë konsiderimin e “shtetit të kalifatit” si meritë të vetëm të legjitimitetit, ose përputhja midis “zbatimit të Sheriatit” dhe zbatimit të dispozitave të ndëshkimit sheriatike –ligjore,

<sup>5</sup> “Përpyjekja maksimale për të kuptuar dhe për të nxjerrë dispozitat e sheriatit islam, ose Dhënia e kontributit maksimal për të njohur dispozitën e sheriatit nga argumenti jo i prerë. Shih: <https://jusufzimeri.com/leksikon-i-sheriatit>.

ose vendosja e një konflikti ndërmjet besnikërisë ndaj shtetit qytetar-kombëtar dhe besnikërisë ndaj umetit islam. Ky bosht përfshin temat e mëposhtme:

#### **a) Kalifati dhe Islamizimi i Shtetit - Shteti Islamik.**

Tema e parë ishte zgjerimi i pikëpamjeve në lidhje me besueshmërinë e lidhjes ndërmjet legjitimitetit fetar të shtetit dhe të qenët shtet kalifat. Kjo do të thotë, a është e drejtë të konsiderohet kjo formulë historike të cilën umeti e ka provuar, dhe ka arritur qëllimet e tij në bashkimin e fjalës së myslimanëve në një kontekst të përshtatshëm historik, në të cilin fukahaja- juristët asokohe e ndanë botën nga konteksti i territoreve, si territore Islami “Dar Islam” dhe territore lufte “Dar Harb” si kusht i legjitimitetit e ndonjë vendi me shumicë myslimane? A nuk përfunduan fukahaja-juristët e sunitëve duke e miratuar pluralitetin e imamëve-domethënë ekzistimin e me shumë se një shteti për ta, – në rast se largësisë dhe ndarjes se vendeve, por me pas edhe atëherë ata hoqën dorë edhe nga ky kusht për t'u kujdesur për interesat publike?

A nuk u themeluan shtete të cilat ishin të pavarura nga kalifati në vendet të ndryshme nga lindja dhe perëndimi i botës islame dhe legjitimiteti i tyre u njoh nga dijetarët, gjykatësit dhe myftinjët e vendit? Pastaj duke supozuar se formula ideale për shtetin në fenë tonë është formula e “Shtetit Kalif; A e lejon konteksti aktual ndër-kombëtar krijimin e një shteti të tillë? Përkundrazi, a e lejon Sheriati luftimin e shteteve qytetare-kombe myslimane me qëllim të bashkimit të tyre në një shtet të bashkuar?”

#### **b) Legjislacioni dhe Islamizimi i Shtetit-Shteti Islam**

Tema e dytë kërkonte t'u përgjigjej pyetjeve që nuk mund të shtyeshin më, të tilla si: Çfarë do të thotë që një vend është “Islamik”? Aq më tepër që kjo përqindje nuk përmendej te të parët? Domethënë, a është e saktë të përshkruhet një shtet, - siç përshkruhen individët, - me Islam apo besim? Kjo do të thotë se, a janë Islami dhe besimi, dhe më pas devotshmëria, imoraliteti dhe përshkrimet e tjera, si dhe gradat e afërsisë dhe distancës nga feja, për ta përshkruar një entitet moral siç është shteti, siç

përshkruhet, për shembull, si një demokraci ose diktaturë në raport me sistemin e tij politik, apo liberal, apo socialist në raport me sistemin e tij ekonomik?

Atëherë, cili është kriteri i “Islamit”, nëse lejojmë, do të jetë atribut i shtetit? A është prania e një shumice myslimane dhe praktikumi i ritualeve? Apo zbatimi i dispozitave të caktuara? Nëse supozojmë se legjitimiteti fetar i shtetit është i lidhur me zbatimin e Sheriatit, çfarë do të thotë kjo përbërje shtesë? A është e mundur të reduktohen zbatimi i dispozitave të ndëshkimit? A mund ta konsiderojmë mos zbatimin e dispozitave shariatike vetëm një trill personal të sundimtarit, nëse thirrmi në ndikimin e ndryshimeve rrënjësore në balancën e fuqisë midis botës islame dhe perëndimit që nga koha moderne, si dhe karakteristikat dhe kufizimet të shtetit kombëtar në epokën e globalizimit, si dhe ekzistencën e institucioneve ndërkombëtare dhe kartave ndërkombëtare... Nëse kujtojmë ndikimin e të gjithë kësaj pra në sistemet juridike dhe zgjedhjet në botën islame?

### **c) Çështja “El vela” besnikërisë dhe Islamizimi i Shtetit - Shteti Islam**

Sa i përket temës së tretë, është korrigjimi i konceptit të umetit si fetar dhe jo politik dhe shpërbërja e perceptimeve që krijojnë një konflikt mes besnikërisë ndaj umetit dhe besnikërisë ndaj atdheut dhe shtetit kombëtar.

#### **Boshti i katërt: Shteti Kombëtar; Koncepti dhe Konteksti:**

Ky bosht përfshiu dy temat e mëposhtme:

##### **a) Koncepti i shtetit kombëtar**

Duke pas parasysh se shteti konsiderohet si përgjigje ndaj zhvillimit të njeriut dhe ballafaqimit me veten, nevojën e tij për familjen dhe shoqërinë, nevoja për bashkëpunim dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet, dhe për një palë që mbron të dobët dhe shmang luftërat dhe rivalitetet.

Ky sistem fatkeqësisht kërcënohet kohe pas kohe nga grupe që e përdorin edhe doktrinën fetare për t'i justifikuar veprimet e tyre të dëmshme për individin dhe shoqërinë, e që në fakt burojnë nga konceptet e gabuara të mësimave Islame nga grupet radikale dhe ekstremiste.

Andaj u diskutua koncepti i shtetit kombëtar si koncept qendror në këtë forum, duke hequr çdo konfuzion që mund të ndodhte rreth keqkuptimit të këtij koncepti siç është keqkuptimi i Sheriatit.

### **b) Karakteristikat e shtetit kombëtar në epokën moderne**

Nën këtë temë u dha një përpjekje për t'i sqaruar karakteristikat dalluese të shtetit kombëtar në epokën moderne dhe efektet e tij në strukturën kulturore, sociale, ekonomike dhe legjislativë të shoqërive myslimane; si sovraniteti jo i plotë në marrëdhëniet e tij me sistemin ndërkombëtar dhe balancën e fuqisë, si ekonomia e lidhur në mënyrë strukturore me ekonominë ndërkombëtare dhe luhatjet e saj, përzjerja e qenieve njerëzore, kulturave dhe besimeve, zhvillimi i mjeteve të komunikimit deri në një pikë, ku kontrolli arsimor mbi individët është i pamundur, ndikimi i individualizimit dhe rritja e idesë së "individit" në respektimin e rregullave të Sheriatit...

### **Boshti i pestë: Sovraniteti shtetëror në kontekstin e globalizimit**

Në dekadat e fundit sovraniteti i shtetit-komb ka pësuar shumë ndryshime të thella, duke përfshirë vendin, popullsinë, pushtetet dhe legjislativionin. Këto ndryshime mund të zgjerohen për disa arsye, duke përfshirë: ndikimin në rritje dhe fushën e punës së kompanive shumëkombëshe, dhe hyrjen e vendeve në angazhime të reja ndërkombëtare në bazë të përfshirjes së tyre në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare dhe nënshkrimin të marrëveshjeve dhe traktateve; Sidomos ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave, duke përfshirë shoqërimin e disa fenomeneve me vendet fqinje apo ndikimin e tyre në nivel ndërkombëtar, si çështjet e ujit dhe mjedisit; Pa harruar sfidat që disa dukuri i paraqesin sovranitetit të shtetit, siç janë pasojat e terrorizmit trans nacional.

Meqenëse shoqëritë myslimane janë të shqetësuara, ndoshta më shumë se të tjera me këtë fenomen, ky bosht do t'i kushtohet studimit të pasojave të mundshme të sovranitetit të shtetit-komb në kontekstin e globalizimit dhe mundësive të disponueshme për t'u përshtatur me të.

### **Boshti i gjashtë: Shteti kombëtar dhe forcimi i paqes**

Nga njëra anë, ky bosht përfshin një analizë të mjediseve kulturore të grupeve të armatosura që kërkojnë në emër të Islamit të krijojnë një “Shtet Islamik” ose një “Kalifat mbi metodën e profecisë”, për të cilin “Xhihadi” lejon për krijimin e tij të gjitha format e dhunës së ndaluar fetarisht dhe njerëzisht kundër myslimanëve, në radhë të parë, dhe kundër të tjerëve, dhe të gjitha mjeteve imorale për të siguruar vazhdimësinë dhe zgjerimin e këtij entiteti, dhe kërkon të sqarojë efektet e përhapjes së këtyre grupeve dhe polarizimit trans nacional të vendeve dhe kontinenteve që ata praktikojnë për të mobilizuar mbështetësit, dhe veprimtarinë e tyre ushtarake dhe praktikat që ata kryejnë – në territoret ku ata kontrollojnë - në shoqëritë myslimane në afat të shkurtër dhe afatgjatë.

Ky bosht ngre gjithashtu - nga ana tjetër - çështjen e shtetit kombëtar- qytetar, dhe rolin e tij në promovimin e paqes si një shtet në të cilin qytetarët janë të barabartë në të drejta dhe detyra, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare, edhe sepse është gjithashtu i vetmi i autorizuar për të përdorur dhunën, nëse është e nevojshme për të zbatuar ligjin dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë.

Ky bosht përfshiu dy temat e mëposhtme:

- a) Teza e shtetit fetar dhe justifikimi i dhunës.
- b) Shteti kombëtar dhe monopoli i dhunës.

### **Boshti i shtatë: Përvoja e Emirateve të Bashkuara Arabe në promovimin e paqes**

Forumi për Promovimin e Paqes vazhdon me këtë aks që nisi në takimin e tij të dytë (Forumi 2015), në monitorimin dhe demonstrimin e elementeve të shpresës për vendosjen apo forcimin e paqes sociale në realitetin bashkëkohor, veçanërisht në shoqëritë myslimane. Këtu vjen përvoja e shquar e Emirateve të Bashkuara Arabe duke përqafuar një spektër të gjerë kombësish dhe besimesh që bashkëjetojnë në një atmosferë tolerance, dhe të përforcuar nga nxjerrja e ligjit të parë arab për kriminalizimin e përbuzjes ndaj feve dhe shenjtërive, kriminalizimin e veprimeve dhe thënies të tekfirit, dhe luftimin e të gjitha manifestimeve të diskriminimit

dhe urrejtjes në bazë të fesë, besimit, sektit ose emërimit ose arsytimit të tjera të diskriminimit.

### **Boshti i tetë: “Deklarata e Marrakeshit”, dëshmi dhe sugjerime**

Që nga publikimi i “Deklaratës së Marrakeshit për të Drejtat e Pakicave Fetare” në fund të janarit të vitit 2016, ajo ka ndezur diskutime të thella shkencore në forume dhe arenë ndërkombëtare. Ky manifestim u zhvillua për faktin se kjo deklaratë është:

- a) Një deklaratë origjinale që buron nga vlerat e Kartës së Medinesë, të cilën Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, e shkroi pasi hyri në Medine, që të shërbejë si kushtetutë për një shoqëri multi-fetare dhe multietnike.
- b) Deklaratë e lëshuar me marrëveshjen dhe miratimin e të gjithë dije-tarëve dhe vendimmarrësve myslimanë dhe me bekimin e rreth dyzet përfaqësuesve të organeve fetare jomyslimane të të gjitha sekteve.
- c) Deklaratë që përfshinë hapat procedurale dhe rekomandimet e forta që synojnë garantimin e të drejtave të pakicave fetare në shoqëritë myslimane dhe promovimin e kulturës së bashkëjetesës dhe tolerancës në aspektin social, arsimor dhe ligjor.

Në funksion të diskutimeve që rezultuan nga “Deklarata e Marrakeshit”, dhe nismave të ndërmarra nga disa personalitete dhe organe që morën pjesë në të, ky bosht i kushtua dëshmime që konfirmojnë rëndësinë dhe specifikat e kësaj deklarate të rëndësishme, si dhe propozimeve për të aktivizuar përmbajtjen dhe rekomandimet e tij shkencërisht dhe praktikisht.

Duke pasur parasysh atë që u përmend më sipër, Forumi për Promovimin e Paqes që u zhvillua në dhjetor të vitit 2016 vuri për synim që në takimin e tij të tretë, të paraqesë temën e “Shtetit kombëtar në shoqëritë myslimane”, rëndësia e së cilës është e njohur për studiuesit, dhe ata që ndjekin rrjedhën e gjërave në sipërfaqen e kërkimit shkencor, dhe diskutimit intelektual midis studiuesve fetarë, mendimtarëve, studiuesve në shkencat politike dhe humane, ekspertëve në strategji dhe palëve të tjera të interesuara... për të kristalizuar perceptimet që kontribuojnë në arritjen e pajtimit midis shoqërive myslimane dhe shteteve të tyre kombëtare-qy-

tetare që rrjedhin nga qëllimet e Sheriatit të pastër, duke ekstrapoluar përvojat dhe mësimet e kaluara, si dhe duke evokuar rreziqet dhe kufizimet e perspektivave dhe mundësive të së tashmes dhe të së ardhmes.

Ky forum, pas diskutimeve dhe paraqitjeve të kumtesave të shumta prej dijetarëve, studiuesve dhe hulumtuesve, nxori një deklaratë tejet të rëndësishme në pikëpamjet dhe zhvillimet rreth perceptimeve të shtetit kombëtarë-qytetar dhe pikëpamjeve të sheriatit rreth kësaj çështjeje.

### **Deklaratë mbyllëse dhe konkluzat<sup>6</sup>**

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, dhe lutjet dhe paqja qofshin mbi zotërinë tonë Muhamedin, pejgamberin e mëshirës dhe ndër-mjetësuesin e umetit, mbi familjen e tij të pastër dhe shokët e tij të drejtë; Duke u bazuar në ajetin kuranor:

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْتُمُونَهُ

*“Dhe kur Allahu e mori zotimin prej atyre që u qe dhënë Libri, që gjithqysh t’ua publikoni atë njerëzve, dhe mos ta fshihni atë.”<sup>7</sup>*

Kjo u tha duke shfrytëzuar dhe përfitur nga pranimi që u prit mesazhi i Forumit në thirrjen e tij për ta ndaluar shkatërrimin e qenieve njerëzore dhe çdo gjë urbane, dhe për ta adoptuar paqen dhe mjedisin që krijon njohje, harmoni, dhe bashkëjetesë, si dhe faktin se ky pranim e ka tejkaluar shoqëritë myslimane, duke arritur edhe te kombet e tjera të ndryshme.

Një vazhdim i përpjekjeve që ka bërë Forumi për Promovimin e Paqes për vendosjen e koncepteve kryesore ligjore në kontekstin e tyre ekzakt shkencor, duke marrë parasysh përmasat e ndryshimit të madh që ka ndodhur në kohë, vend dhe njeri.

Si dhe, një rifillim të monitorimit të Forumit të mekanizmave të çekuilibrit dhe injorancës në përdorimin e këtyre koncepteve, dhe përfshirjes së tij të përmbajtjes së saktë në deklaratat e tij në përputhje me standardet që ai e miratoi në trajtimin e tij; Të tilla si koncepti i xhihadit, koncepti i

<sup>6</sup> <https://binbayyah.net/arabic/archives/3769>.

<sup>7</sup> Sure Al Imran, 187.

qytetarisë, koncepti i tekfirit, koncepti i bindjes, koncepti i besnikërisë dhe distancimit – diferencimit, dhe raporti ndërmjet diskursit të statusit dhe diskursit të obligimit, i cili përfaqëson një formulim të avancuar të kushteve kohore, hapësinore dhe njerëzore për zbatimin e dispozitave.

Dhe, i alarmuar për rrezikun e termave dhe koncepteve të paqarta që u shfaqën në mesin e myslimanëve në epokën moderne, të cilat u ngritën në një atmosferë reagimesh dhe zhgënjimi të bazuara në sfonde shkencore që nuk i respektonin parimet e sakta të trashëgimisë dhe nuk e përthithën ndryshimin që e pushtoi koha dhe realiteti, kështu që ai ra në formën e kontrastit midis binareve në një metodologji sipërfaqësore, sikurse, për shembull, islamizimi i shtetit kundrejt shekullarizimit dhe kalifatit, apo imamatit kundrejt shtetit-komb; Derisa ato terma dhe koncepte u bënë automatike dhe mbizotëruese sikur të ishin fakte shkencore ose koncepte të sakta pa verifikim dhe shqyrtim.

Dhe, sepse përhapja e këtyre koncepteve ka krijuar të atillë që dyshojnë dhe vënë në pikëpyetje legjitimitetin e shtetit kombëtar mysliman, madje edhe ata që flasin pa legjitimitetin e tij, me pasoja që shkaktojnë fyerjen cila arrin deri në humbje të shenjtërisë së atdheut dhe njeriut, prishjen e ndërtimit, infrastrukturës dhe shpërqendrim të umetit nga çdo çështje e rëndësishme, Sepse ai guxoi të derdhë gjak të pafajshëm, në kundërshtim të qartë me hadithin autentik: “Kushdo që mban armë kundër nesh nuk është prej nesh”<sup>8</sup>.

Dhe, nën hijen e kujdesit dinjitoz, të ripërtërirë dhe bujar të ofruar nga shkëlqesia e tij Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahjan, Ministri i Punëve të Jashtme të Emirateve të Bashkuara Arabe - Zoti e ruajtë!

Me ndihmën e Allahut, më 19 dhe 20 të Rabi'ul Evvel-it, muajit të lindjes së të Dërguarit të Zotit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, në vitin 1438 hixhrij, që korrespondon më 18 dhe 19 dhjetor 2016, në Abu Dhabi, kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, vendi i bashkëjetesës, tolerancës dhe sigurisë, vendi i dashurisë dhe i mençurisë së Zajed me sukses u mbajt takimi i tretë i “Forumit për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Myslimane”, me pjesëmarrjen e rreth 400 figurave shken-

<sup>8</sup> Transmeton Muslimi 101, shih: <https://dorar.net/hadith/sharh/78085>.



core dhe intelektuale, nga liderë të ndryshëm intelektualë dhe fetarë, për t'i mbështetur ata në përpjekjet e tyre, si dhe duke u ndjekur nga një grup ministrash dhe zyrtarësh në organizatat islame dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të temës qendrore të këtij forumi, “Shteti kombëtar në shoqëritë myslimane”, vëmendja e pjesëmarrësve u përqendrua në çështjet e mëposhtme:

1. Çështja e paqes mes pengesave dhe mundësive.
2. Korrigjimi i koncepteve që lidhen me shtetin në shoqëritë myslimane.
3. Deklarata e Marrakeshit: dëshmi dhe lëvdata.
4. Përvoja e Emirateve të Bashkuara Arabe në tolerancë.

Ishte e nevojshme të jepej një pasqyrë e metodologjisë së forumit në adresimin e koncepteve, korrigjimin, kontrollin dhe krijimin. Koncepti i shtetit, në historinë, format, themelet dhe funksionet e tij, ka zënë gjithashtu një pjesë të madhe të hulumtimit dhe diskutimit.

Studiuesit kanë arritur në përfundimin se shteti kombëtar, shumica e të cilëve lindi pas dëbimit të kolonialistëve nga shtëpitë e myslimaneve, në rrethana dhe forma të ndryshme, shtete në të cilat Islami është fe e shumicës. Ata arritën në përfundimin se, në realitetin aktual kohor dhe hapësinor, ato janë shtete legjitime në kuptimin juridik dhe fetar, dhe se legjitimiteti i tyre nuk cenon tekstet dhe praktikën historike. Ata arritën gjithashtu në përfundimin se kushtet teorike që përcaktojnë unitetin e umetit në një entitet dhe nën një sovranitet konsiderohen jashtë kontekstit kohor.

Studiuesit i ndërtuan këto përfundime duke u bazuar në ekstrapolim të shkrimeve që ishin shkruar në kapitujt e “Ahkam Sultanije – Parimet Sulltanore - udhëheqjes”<sup>9</sup> në trashëgiminë tonë islame, ku duket qartë se shteti si sistem, formë dhe autoritet që nuk është një nga bazat e akaidit - besimit në Islam. Përkundrazi është menaxhim njerëzor i rregulluar nga

<sup>9</sup> “Parimet Sultanore në Fikhun – jurisprudencën Islame” referohen në rregullat dhe udhëzimet që lidhen me marrëdhëniet midis autoritetit qeveritar (sultanit ose liderit të shtetit) dhe jurisprudencës islame (Fikhut). Këto parime trajtojnë se si autoriteti qeveritar duhet të zbatohet dhe të zbatohet ligji islami në aspekte të ndryshme të jetës shoqërore dhe ligjore.

rregullat e Ixhtihadit dhe ligjit i interesave “el mesalih”, dhe largimit të dëmeve “deru el mefasid”, dhe rekomandojnë vlerat fetare që kërkojnë drejtësi, mëshirë, mençuri dhe interes dhe që kjo e fundit - domethënë interesi - është në epiqendër dhe baza mbi të cilën vërtiten vendimet e shtetit.

Pjesëmarrësit vlerësuan gjithashtu përvojën e Emirateve të Bashkuara Arabe në zhvillimin e vlerave të tolerancës dhe bashkëjetesës, konsolidimin e rregullave të saj dhe kriminalizimin e fyerjes së të shenjtës ashtu siç është. Ata e konsideruan të denjë për t'u përmendur, ashtu siç e konsideruan përvojën e bashkimit vullnetar mbi bazën e të cilit u krijuan Emiratet e Bashkuara Arabe, si një përvojë e ndritshme në përvojat e vendeve arabe dhe myslimane.

Forumi ishte një mundësi e re për të aktivizuar kërkesat e Deklaratës së Marrakeshit për të Drejtat e Minoriteteve duke kujtuar veçantinë e dokumentit nga i cili buron e që është ai i “Karta e Medinës”, dokumenti i parë në histori që krijon një shtet civil të bazuar në shtetësinë, në të cilin njerëzit të feve dhe racave të ndryshme bashkëjetojnë, dhe janë të barabartë në të drejta, detyra dhe të drejta për dinjitetin njerëzor. Deklarata e Marrakeshit ende tërheq vëmendjen e organeve shkencore dhe organizatave ndërkombëtare dhe merr përsipër këtë dokument për aktivizim dhe studim nga shumë prej tyre.

Këto janë rezultatet më të rëndësishme të detajuara të temave të trajtuara në këtë forum:

## **Rezultatet**

### **Së pari - parimet, premiset dhe konceptet:**

- Dilemat e umetit islam nuk do të gjejnë zgjidhje pa fenë e tyre, të cilën Zoti ia ka pranuar me dëshmi të qarta dhe argumente të qarta, me kusht që qasja në trajtimin e teksteve të jetë e shëndoshë, thellësia e të kuptuarit të qëllimeve të sheriatit, dhe zbatimi i mirë i vendimeve të sheriatit në një realitet, veçoritë e të cilit janë të qarta dhe të kuptohen elementet dhe dimensionet e tij.
- Kriza e umetit nuk është në vlerat dhe dispozitat e fesë së tij, por në mungesën e integritetit në metodologjinë e trajtimit të tekstit ligjor.

- Krizat e umetit islam, edhe pse shumë shkakore dhe shumëdimensionale, çelësi i zgjidhjeve qëndron në ripërtëritjen e diskursit fetar për t'u shtruar njerëzve rrugët e paqes, bashkëjetesës dhe përparimit në mënyrat e nderimit të qenies njerëzore dhe ndërtimit të tokës.
- Një nga sfidat më serioze me të cilat përballet rinovimi i diskursit fetar është shtrembërimi i koncepteve, për shkak të mungesës së të kuptuarit të origjinës së tyre origjinale ose mosnjohjes së kushteve kohore dhe hapësinore që riformulojnë konceptin. Prandaj, nuk ka aspiratë për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për një kulturë paqeje pa çliruar konceptet nga nxitja e injorancës ose shtrembërimi i ekstremizmit.
- Fokusi i ripërtëritjes së diskursit fetar qëndron në formulimin e koncepteve në një formulim të pavarur dhe novator, ose në rishikimin e koncepteve të miratuara në fushat e synuara dhe vendimet që lindin për t'i rafinuar ato, dhe për t'i paraqitur ato përsëri në origjinalitetin e tyre nga njëra anë, dhe te rezultatet nga ana tjetër, të cilat mund të çojnë në modifikimin, ndryshimin, zhvillimin ose modifikimin dhe zëvendësimin e tyre.
- Koncepti i shtetit, dhe i shtetit kombëtar është një nga konceptet shpërthyes që duhet çmontuar dhe rindërtuar, sepse disa janë arsyetuar dhe kanë thirrur për atë, me synim të arritjes së qëllimeve që e legjitimojnë atë përmes teksteve të fragmentuara nga kontekstet e tyre, dhe përmes një neglizhence flagrante të rregullave më të ulëta të metodave të praktikimit të dispozitave, dhe koncepteve që dijetarët myslimanë i kanë analizuar në kohët e kaluara.
- Legjitimiteti i shtetit kombëtar sot dëmtohet nga kërkesa e kushteve ideale që nuk e kuptojnë logjikën e vetë shariatit apo logjikën e përvojës historike të umetit, aq sa dëmtohet nga kërkesa e identifikimit dhe konformitetit me zhvillimin e shtetit dhe i institucioneve të tij në përvojën moderne perëndimore.
- Kërkesa për të ndarë plotësisht fenë nga shteti, për të realizuar konceptin e shtetit është një perceptim i ngushtë, që nuk merr parasysh format e ndryshme të marrëdhënies së fesë me shtetin edhe në vetë vendet perëndimore, e as centralizimin e Islamit në kulturat e sho-

- qërive myslimane dhe specifika e zhvillimit shoqëror të shumë vendeve myslimane.
- Dallimi ndërmjet nivelit fetar dhe atij të kësaj bote (laik) në vendime – dispozita, është një qasje autentike peygamberike që u përvetësua nga paraardhësit e umetit, kështu që ata bënë dallimin midis asaj që është brenda fushëveprimit të “Tevkifit” diskrecionit, ndalimit<sup>10</sup> dhe asaj që është brenda fushës së “Ixhtihadit” të bazuar në sjelljen e interesave - përfitimeve dhe shmangien e se dëmit - të keqes, e që i nënshtrohet kërkesave të kohës, vendit dhe njeriut.
  - Shumë studiues janë të hutuar nga marrëdhënia ndërmjet fesë dhe laikes dhe referimi i ndërsjellë ndërmjet tyre në Islam, për shkak të njohurive të dobëta të metodave të deduksionit nga tekstet dhe qëllimet e Sheriatit , dhe mjetet e shpalljes në kontekste kohore dhe njerëzore. Prandaj përkufizohen në të “Zevahir” të shfaqurat e teksteve<sup>11</sup>, duke mos u marr edhe me qëllime, si dhe përkufizohen në degëzime dhe jo në bazamente, andaj futen në një mosmarrëveshje me çdo realitet të ripërtërirë.
  - Kjo referencë e ndërsjellë ndërmjet fetares dhe laikes së kësaj bote i bën ata që nuk janë të thelluar fort në njohuri që të gjykojnë se është thjesht vetëm fetare, ose thjesht vetëm laike, gjë që çon në shumë keqkuptime të teksteve, abuzim me realitetin dhe neglizhencë të interesave të krijimit.

**Së dyti - Në shkarkimin - praktikimin e metodologjisë së forumit mbi temën e shtetit kombëtar në kontekstin aktual:**

- Fikhu - Jurisprudenca e trashëguar islame nuk fliste për një shtet mysliman, por për vendbanimin e Islamit.

<sup>10</sup> Në kontekstin e jurisprudencës islame (fikhut), “التوقيف” (Ndalimi ose Tërheqja) është një term i përdorur për treguar se një rregull ose parim i caktuar ligjor nuk aplikohet në një situatë të veçantë për shkak të ndryshimeve ose kufizimeve që vlejné në këtë rast.

<sup>11</sup> Kjo shprehje mund të përdoret për të treguar se njerëzit kufizohen në të kuptuarit e dukurive të qarta dhe të evidentuara të tekstit, ndërsa nuk hulumtojnë dhe nuk i shfrytëzojnë qëllimet dhe hollësitë e thella të tekstit.

- Koncepti i përcaktimit të vendbanimit si vendbanim islam nuk është me dispozitat apo me pushtetarët, por më tepër ka të bëjë me popullsinë. Kjo do të thotë, me një shumicë myslimane që mund ta praktikojë fenë e saj.
- Shteti në të drejtën ndërkombëtare, siç përcaktohet nga Traktati i Montevideos<sup>12</sup> i vitit 1933, në Uruguai, është një kombinim i elementëve të mëposhtëm:
  1. Ekzistenca e tokës së kufizuar dhe specifike;
  2. Ekzistenca e një populli me banim të përhershëm në këtë tokë;
  3. Ekzistenca e një forme minimale të qeverisjes, dhe;
  4. Aftësia për të krijuar marrëdhënie me vendet e tjera.
- Çështja e shtetit nuk gjen vendin në aktet veprimet e adhurimit “Ibadat”, por është në qendër të “El Maslah” interesit – dobisë<sup>13</sup>, për të cilin kujdeset sheriati, dhe kjo çështje u është besuar dijetarëve që ta marrin në konsideratë dhe ta gjykojnë sipas qasjes së disiplinuar, e që e lejon qasjen për formulimin e një koncepti dhe imazhi të shtetit, dhe që nuk bien ndesh me kërkesat e Sheriatit dhe pajtohen me të dhënat e kohës.
- Tekstet e fukahave-juristëve islamë dëshmojnë se çështja e Kalifatit nuk lidhet me parimet e fesë, dhe nuk ngrihet në nivelin e bindjes së padiskutueshme.
- Nevoja për të pasur një autoritet që ruan interesat e njerëzve dhe kujdeset për punët e tyre është një çështje në të cilën nuk ka asnjë mosmarrëveshje në Sheriatin tonë, qoftë në fjalë -tekste, vepër dhe dispozita. Por nga kjo nuk do të thotë se kërkohet ndonjë specifikim

<sup>12</sup> Hersch Lauterpacht (2012). Recognition in International Law. Cambridge University Press. f.23.

<sup>13</sup> Dijetarët e Islamit besojnë se Sheriati ka ardhur për të përmbushur interesat e njeriut dhe për ta ruajtur atë nga dëmet. Ajo që provohet katërçipërisht se është e dobishme për myslimanët, si për fenë ashtu edhe për jetën e kësaj bote, ajo konsiderohet pjesë e përligjur nga Sheriati; po kështu ajo që provohet se është e dëmshme si për fenë ashtu edhe për jetën e kësaj bote, konsiderohet e ndaluar.

<https://dijaonline.com/duke-zbuluar-dhe-shpjeguar-sheriatin/>.

i natyrës së këtij autoriteti, as që ky autoritet është një shtet i bashkuar që mbledh myslimanët.

- Përvoja historike e umetit dëshmon shumësinë e vendeve-shteteve islame dhe shumësinë e imamëve- udhëheqësve të tyre, dhe nuk është vërtetuar-konfirmuar se dikush ka kërkuar t'i bashkojë vendet nën një flamur për shkak të detyrës doktrinarë, që qëndron në themel të parimit të obligimit të kalifatit dhe unitetit ndër një imam.
- Përvoja historike e umetit dëshmon shumësinë e vendeve islame, dhe shumësinë e imamëve të tij. Dhe nuk është vërtetuar-konfirmuar se dikush nga të parët ka kërkuar t'i bashkojë vendet nën një flamur për shkak të obligimit doktrinar të parimit të domosdoshmërisë së ekzistencës së kalifatit dhe unitetit nën udhëheqjen vetëm një imami
- Në Sheriatin tonë nuk ka asnjë vendim të caktuar dhe të detyrueshëm në lidhje me formën e pushtetit, kompetencat e tij, përbërësit dhe mënyrën e trajtimit të tij, përveç në masën që ai arrin sjelljen e interesit- dobisë ose parandalon dhe largon dëmin- të keqen, dhe është në përputhje me zakonet dhe kushtet e njerëzve, siguron paqen dhe ruan rendin, dhe është më afër frymës së Sheriatit në vendime.
- Baza e jurisprudencës shtetërore në Islam, është që legjislacioni dhe masat nuk bien ndesh me tekstet shariatike-ligjore; Dhe nuk është kusht që të përcaktohen ose të matet me tekste.
- Domosdoshmëria e ndërtimit të jurisprudencës shtetërore mbi bazën e mbrojtjes së interesave, është që koncepti juridik dhe politik i shtetit të zhvillohet sipas vullnetit dhe nevojave të njeriut, në mënyrë që shteti të jetë sipas vullnetit të tërësisë, i thjeshtë, federal ose konfederal. Pra, Islami nuk merret me formalitete, por me përmbajtje që u shërbejnë interesave.
- Në parim, të gjitha vendet që përqafojnë shoqëritë myslimane me shumicë janë vende myslimane, pavarësisht nëse e parashikojnë këtë në kushtetutat e tyre apo jo.
- Vënia në pikëpyetje e islamizmit të vendeve myslimane, vetëm për shkak të ekzistencës së disa ligjeve që bien ndesh me Sheriatin,

është befasuese ose injorim i afërsisë së epokës së katastrofës koloniale dhe karakteristikat e shtetit kombëtar në epokën moderne; Me të gjitha sfidat dhe kufizimet që ajo imponon në strukturën kulturore, sociale, ekonomike dhe legjislative të shoqërive myslimane.

- Është e gabuar të parashikohet që mos të shkelet asnjë tekst ligjor për ta konsideruar shtetin si mysliman, sepse Islami për individët vërtetohet nga dy dëshmitë “Shehadeti”. Kjo është ajo që tregojnë tekstet shariatike-ligjore, siç është thënia e Pejgamberit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, në hadithin autentik:

عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ : قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: مَنْ صَلَّى صَلَاتَنَا وَاسْتَقْبَلَ قِبْلَتَنَا، وَأَكَلَ ذَبِيحَتَنَا فَذَلِكَ الْمُسْلِمُ الَّذِي لَهُ ذِمَّةُ اللَّهِ وَذِمَّةُ رَسُولِهِ ، فَلَا تُخْفَرُوا اللَّهَ فِي ذِمَّتِهِ

*“Kush e fal namazin tonë, i drejtohet drejtimit (Kibles) tonë dhe i ha kurbanet tona, ai është mysliman, i cili është nën mbrojtjen (besën) e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, prandaj mos e thyeni besëlidhjen e Allahut për mbrojtjen e Tij.”<sup>14</sup>*

- Nëse është e mundur të gjykohet një ligj se është në përputhje ose në kundërshtim me shariatën, atëherë aktvendimit mbi këtë ligj i mungon një sistem tjetër, që rregullon disponueshmërinë e kushteve, mungesën e pengesave, ekzistencën e shkaqeve dhe marrëdhëniet ndërmjet lehtësirave fetare dhe dispozitave- vendimeve qëllimeve që bien nën diskursin e statusit.
- Shteti kombëtar në botën tonë islame, me format dhe imazhet e tij të ndryshme, janë sisteme legjitime që kanë të njëjtin legjitimitet si perandoritë e mëdha që kanë ekzistuar në histori, bazuar në ligjin e ruajtjes dhe sjelljes se dobisë-interesave dhe largimit të dëmit-të keqes, rreth të cilit vërtiten dispozitat e Sheriatit, kështu që nuk mund të derdhet gjak për të bashkuar shtetin, dhe paqja duhet të mbizotërojë.

<sup>14</sup> Ibën Rexhep, “Feth Al Bari”, v. II, f. 283.

- Shenjtëria e shteteve myslimane dhe e qytetarëve të tyre, nuk nënkupton aspak ndonjë inferioritet nga shenjtëria e shteteve të tjera, por është vetëm një përkujtim dhe vëmendje e veçantë e nevojshme për korrigjimin e keqkuptimeve që qarkullojnë në kontekstin aktual kulturor islam.
- Solidariteti dhe reforma e njësive kombëtare është e vetmja rrugëdalje nga kushtet kritike që jetojnë sot shoqëritë myslimane.
- Luftimi i terrorizmit, i cili është plaga dhe sëmundja e epokës e pashërueshme, kërkon intensifikimin e përpjekjeve të të gjithëve, materialisht dhe intelektualisht, dhe solidaritet me myslimanët, veçanërisht në rajonin arab, sepse ata janë të parët që preken nga terrorizmi.

#### **Rekomandimet:**

- Vazhdimi i kushtimit të vëmendjes ndaj koncepteve, keqkuptimi i të cilave çon në një shkëlqje të paqes sociale, civile ose globale.
- Më shumë koordinim me organe, organizata dhe përfaqësues të feve të ndryshme në fushën e përhapjes së vlerave të paqes, bashkëjetesës dhe vëllazërisë njerëzore.
- Forcimi i vlerave të shtetit kombëtar në kurrikulat e shoqërive myslimane dhe në departamentet e studimeve të Sheriatit.
- Nxitja e kërkimeve universitare në fushën e studimeve burimore për shtetin kombëtar, qëllime dhe histori.
- Ndarja e çmimeve të shoqërive kombëtare dhe myslimane për kërkime të dalluara në studimin e koncepteve juridike që lidhen me shtetin në shfaqjen dhe zhvillimin e tij dhe marrëdhëniet e tij me realitetin bashkëkohor.
- Publikimi i punës së këtij forumi në mjete të ndryshme, botime, publikimi elektronik dhe interaktiv në dobi të tij, dhe lejimi i komunikimit rreth tij me organet shkencore të “Forumit për Promovimin e Paqes”, dhe me kontribuuesit e tij me prezantime dhe kërkime.



Në përfundim të pranishmit i shprehën falënderimet e tyre të sinqerta për Emiratet e Bashkuara Arabe, për sponsorizimin bujar dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme për forumin.

---

**Referencat:**

1. Kuran.
2. Hersch Lauterpacht. *Recognition in International Law*. Cambridge University, (2012), Press. f. 23.
3. Abdullah Bin Bejjah, *Fjalimi hyrës në Forum*, Abu Dhabi 18/12/2016. <https://binbayyah.net/arabic/archives/3772>.
4. El Gjuvejni, Ebu El Meali, “*Gijath el Umem fi et Tljath ez Zulem*”. <https://shamela.ws/book/8323/1>.
5. Zimeri, Jusuf, <https://jusufzimeri.com/>.
6. <https://binbayyah.net/arabic/archives/3769>.
7. Muslimi, <https://dorar.net/hadith/sharh/78085>.
8. Ibën Rexhep, “*Feth Al Bari*”, v. II, f. 283.
9. Knowledge Exchange Program (www.kep.org.sa), iniciuar nga Ministria Çështjeve Islame në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Materiali u përkthye dhe u publikua nga Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë. Tiranë, 2014. <https://dijaonline.com/duke-zbuluar-dhe-shpjeguar-sheriatin/>.

Mr. Besim MEHMETI

## **THE CONCEPT OF CIVIC-NATION STATES AND RELIGION - FORUM FOR PROMOTION OF PEACE 2016**

### **Abstract**

The nation-state, which emerged in the Islamic world during the twentieth century, faces profound challenges, which have reached the dimensions of an overall crisis. Due to their domestic policies, many of these states are in a situation where they face collapse and ruin under the weight of disintegration, unrest, wars and civil conflicts. Due to their orientation and relations between them, they have failed to put an end to isolation but have increased it further, adding to the causes of enmity between them, and leading them to the brink of conflict and sometimes even war. Recently, some of these states have plunged into internal conflicts and wars.

This prompted some scholars to write about the need to reconsider the historical conditions of the formation and the challenges faced by these countries, even the need for re-establishment. Therefore, the Abu Dhabi Forum in 2016 set as its aim to reconsider a series of concepts based on Sharia law and to subject them to scientific study. Thus, in this forum, there was discussion and debate on a very important and necessary topic in modern times, that of the nation-state, which is actually misunderstood by many Muslims.

*Keywords: Nation-state, peace, Islamic state, Dar al-Islam, Dar al-Harb, El Maslatha - Interest, Imamate, Caliphate, Correction and rationalization of concepts, El Vela - Loyalty.*



## **VI. RECENSIONE**





# VEPËR E RËNDËSISHME NË FUSHËN E BESIMIT ISLAM

Naim ef. Tërnavë,  
“BESIMI ISLAM – SHTYLLAT DHE VEÇORITË I-II”,  
(botim i dytë) Shtëpia botuese “Dituria Islame”, Prishtinë 2023

Vepra “Besimi islam – shtyllat dhe veçoritë”, e autorit Mr. Naim ef. Tërnavë është një nga prurjet kapitale dhe tepër të rëndësishme për literaturën islame në gjuhën shqipe, veçanërisht për sferën e besimit islam. Mirëpo, para se t’i paraqesim disa analiza, vlerësime, kritika shkencore dhe pikëpamje kyçe të përmbajtjes së veprës, fillimisht duhet dhënë një pasqyrë njoftuese për strukturën e librit.

## Struktura e librit

Libri “Besimi islam - shtyllat dhe veçoritë”, botimi i dytë, është ndarë në dy vëllime: vëllimi i parë është shtruar në 447 faqe dhe i dyti në 455 faqe, i renditur dhe i sistemuar teknikisht dhe shken-cërisht sipas të gjitha normave akademike-shkencore. Autori ka përdorur citimet shkencore sipas stilit të Harvardit, ku brenda tekstit në kllapa jepet



mbiemri i autorit, viti i botimit dhe faqja, pastaj në literaturën e konsultuar në fund jepen informacione më të detajuara për burimin e plotë të cituar. Materia e librit është shtruar sipas renditjes kronologjike të tematikës së vetë shkencës së Akaidit. Vëllimi i parë është ndarë në gjithsej shtatë kapituj me shumë tituj dhe nëntituj të rëndësishëm për pesë shtyllat e para të besimit islam, duke filluar nga besimi në Allahun dhe deri te besimi në Jetën e Përtejme. Po ashtu, edhe vëllimi i dytë është shtruar në shtatë kapituj tjerë, por si vazhdimësi e librit të parë. Në këtë mënyrë të dy librat përbëhen nga gjithsej 14 kapituj të shkoqitur mirë. Përmbajtja e vëllimit të dytë është vijimësi e të parit, ku trajton çështje të Botës së Përtejme, për shtyllën e gjashtë të besimit islam, kadanë dhe kaderin, dhe shumë probleme tjera të eskatologjisë dhe të besimit islam në përgjithësi. Ajo që bie në sy në këtë vepër janë ndarjet e shpeshta të tematikave në sythe, për ta bërë më të lehtë dhe më të përdorshme për studiuesit e këtij lëmi.

### **Tematika dhe referimet ideore**

Tematika e librit është sistemuar dhe brumosur për t'u shërbyer të gjitha shtresave të lexuesve shqiptarë. Mjafton një lexues i thjeshtë të

shfletojë përmbajtjen e librit dhe do t'i mësojë shtyllat e besimit islam. Po ashtu, në anën tjetër libri ofron një materie tepër të avancuar për shtyllat e besimit edhe për lexuesit e avancuar, sepse trajton edhe këndvështrimet filozofike, kalamiste, logjike dhe hermeneutike të problematikave të Akaidit. Pra, në këtë vepër secili lexues do të gjejë atë që i duhet dhe askush nuk do të ndjehet i huaj.

Autori përgjatë përpilimit disa vjeçar të kësaj vepre ka shfrytëzuar mbi gjashtëdhjetë burime të ndryshme shkencore, kryesisht nga gjuha arabe dhe nga gjuha shqipe, por nuk mungon as literatura nga gjuha boshnjake dhe turke, edhe pse ndonjëherë këto të fundit të përkthyer në gjuhën shqipe. Pra, vepra nuk është vetëm fryt i një kontributi të thjeshtë shkencor, por një sintezë e regjur mirë e një aktiviteti jetik shkencor dhe praktik me problematikat në fjalë, ngase autori për dekada me radhë e ka ligjëruar lëndën e Akaidit në medresenë "Alaudin" dhe në Fakultetin e Studimeve Islame. Gjithashtu, krahas ligjërimit të kësaj lënde, autori ka qenë kryesuesi i përpilimit të programeve të lëndës së Akaidit nëpër të gjitha institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës. Kjo tregon se libri "Besimi islam" nuk është thjesht një pikë ku puqen vetëm disa citime nga li-

teratura islame, por është ajka e mundit disavjeçar të autorit të cilën ai e ka shtrydhur nga mësimet islame, nga trashëgimia jonë islame dhe nga vetë përvoja e tij personale.

Autori të gjitha mendimet dhe qëndrimet i ka mbështetur në formë profesionale në burimet e duhura, gjegjësisht në Kuran, në hadith mutevatir dhe në të gjitha burimet tjera të shkollës së imam Maturidiut. Materien e ka punuar në formë shteruese, sepse krahas burimeve parësore, ai nuk ka lënë pa trajtuar edhe një mori të mendimeve filozofike dhe logjike për problematikën e shtruar, jo për t’i bindur myslimanët, por për t’ua mbyllur derën ideve të ndryshme që mund të fusin huti në mesin e myslimanëve.

Mendimet akaidologjike të shkollës maturidite që ka paraqitur autori janë vazhdimësi e mendimeve besimore që ka promovuar vetë Ebu Hanifja, veçanërisht në kryeveprat si *El Fikhu El Ekber*, *El Ali-mu vel Muteal-lim* etj. Pra, në këtë mënyrë mban edhe koherencën mijërvjeçare të shkollës juridike të imam Ebu Hanifes me shkollën akaidologjike të imam Maturidiut, ku fatkeqësisht shumë libra të pakontrolluar sot mëtojnë ta humbin këtë lidhshmëri dhe këtë rrugëtim të përbashkët mes këtyre dy shkollave, madje më e keqja është se

këtë shkëputje e bëjnë në emër të sunetit dhe të “akides së pastër dhe të saktë”, por duke krijuar një boshllëk referues historik të paparë. Vepra e studiuesit Tërnavë, krahas vijimësisë tradicionale shqiptare në fushën e Akaidit, ka një vijimësi dhe lidhshmëri profesionale dhe autentike edhe me trashëgiminë e shëndoshë islame përgjatë çdo faze historike. Kjo përfaqet në referimet që autori i ka shfrytëzuar në shkrimin e këtij libri, sepse në formë profesionale ka përzgjedhur veprat nga të cilat ka cituar.

Literatura islame në gjuhën shqipe këto tri dekadat e fundit ka vërshuar gjithandej, madje e ka kaluar edhe literaturën e sferave të tjera shkencore. Megjithatë, lloji, kualiteti dhe profesionalizmi i tyre lënë shumë për të dëshiruar, veçanërisht në sferën e besimit islam (Akaidit).

### **Materializim i rrugëtimit akaidologjik**

Vepra “Besimi islam - shtyllat dhe veçoritë” është materializim, personifikim dhe formësim i dijes së Akaidit që është mësuar nëpër shkollat islame-shqiptare përgjatë gjithë historisë. Nëse u hidhet një vështrim planprogrameve të lëndës së Akaidit nëpër mektebe, medrese dhe fakultete islamike, atëherë do



të shohim se në çdo periudhë historike është mësuar e njëjta tematikë dhe me të njëjtin stil. Qysh në medresetë e para në Periudhën Osmane, në medresetë pasotomane dhe deri tek ato sot, literatura e Akaidit është po e të njëjtit stil, drejtim dhe metodologji. Librat tjerë të Akaidit të shkruar apo të përkthyer janë më të shkurtër, të orientuar vetëm në disa problematika të Akaidit apo të veshur me petkun e drejtimeve tjera akaidologjike, madje shpesh edhe me mendime të pakonsoliduara siç duhet, kurse vepra e profesor Naim ef. Tërnavës është një përmbledhje e gjerë, e hollësishme dhe renditur mirë e pothuaj të gjitha problematikave të besimit islam.

Ajo që e bën të veçantë këtë vepër është ndjekja e metodologjisë pejgamberike në trajtimin e çështjeve të besimit. Kur Muhamedi, a.s., u pyet nga meleku Xhibril për besimin islam, pat thënë: “Iman është të besosh Allahun, melekët, librat, pejgamberët, Botën e Përtejme dhe kadanë e kaderin.”, boshte të cilat e përbëjnë thelbin e këtij libri, ku secila shtyllë e besimit islam e artikular nga Pejgamberi, a.s. është titulli i një kapitulli të këtij libri, bile duke iu përmbajtur edhe renditjes së njëjtë. Pra, metodologjia e përdorur nga prof. Naim ef. Tërnavë dhe nga studiuesit tradicionalë shqiptarë të fushës së Akaidit qenka

e themeluar prej Muhamedit, a.s., dhe atë jo e stimuluar dhe e kërkuar prej sahabëve, po edhe prej vetë Xhibrilit, a.s., i cili ishte deleguar enkas për këtë punë nga Allahu i Madhërishëm.

Gjuha e autorit në këtë vepër është e qartë, e thukët, përmbledhëse dhe kuptimplote. Duket qartë se autori ka arritur që në formë të shkëlqyer të gërshetojë dy elementë të rëndësishëm në gjuhën e këtij libri: leksikun e literaturës tradicionale-islame-shqiptare dhe leksikun modern të gjuhës shqipe. Pra, krahas përmbajtjes, kjo vepër është model i shkrimit të një vepre islame në gjuhën shqipe që merr në konsideratë shumë dimensione, atë tradicional, kulturor, bashkëkohor dhe profesional. Vepra që po trajtojmë mund të merret si një burim i rëndësishëm për unifikimin e terminologjisë profesionale në fushën e besimit islam (Akaidit), ngase ajo është përpiluar nga një studiues serioz dhe nga veteran i Akaidit ndër shqiptarët i cili nuk i trilloi termat aty për aty, por i thithi ato nga literatura islame-tradicionale-shqiptare, i përdori ato për dyzet vjet me radhë me nxënësit dhe me studentët dhe në fund na i materializoi ato në formë margaritarësh në këtë vepër bazike të besimit islam në gjuhën shqipe.

Përderisa shumë libra të pacensuar, dhe jo çdoherë pa qëllim, përpiqen të nxjerrin si të gabuar besimin e myslimanëve shqiptarë për shekuj me radhë, ky libër i myftiut Tërnavë e konfirmon saktësinë e trashëgimisë sonë besimore për

shekuj me radhë, dhe atë nga pozicioni i një shkencëtari të denjë dhe nga pozita e një veterani apo prijësi i myslimanëve shqiptarë për disa dekada.


**Prof. Dr. Ziber LATA**



## DEFTERËT FLASIN SHQIP

**Sadik Mehmeti,**  
**“DEFTERI I POPULLSISË SË KAZASË SË GORËS (1833)**  
**(Luma, Opoja, Gora)”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2023, f. 624.**

Dr. Sadik Mehmeti është autor i kontributeve të shumta shkencore në fushën e studimeve albanologjike, qoftë në formatin monografik të studimit, qoftë në formatin e publikimit të materialeve me peshë për shqiptarët dhe për kulturën e tyre, sidomos atë të periudhës osmane, materiale të cilat nuk kanë qenë të qasshme për opinionin e gjerë shkencor. Si autor e bashkautor i 15 veprave studimore dhe vëllimeve me materiale të rëndësishme dokumentare, historike, bibliografike, filologjike, pedagogjike e kulturore, Sadik Mehmeti shquhet për një veprimtari të gjertanishme profesionale e shkencore që kap vëllimin e rreth 5000 faqeve të botuara. Punonjës profesional i Arkivit të Kosovës, ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, pastaj në Fakultetin e Studimeve Islame dhe viteve të fundit punonjës shkencor në Institutin Albanologjik, realizues i shumë projekteve shkencore, Dr. Asoc. Sadik Mehmeti, emër i njohur i studimeve albanologjike, orientalistike e ndërkulturore, është autor (ose bashkautor) i këtyre veprave: “*Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*”, Ar-



kivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 2008; “*Udhërrëfyes i fondeve dhe koleksioneve arkivore*”, vëllimi II, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 2003 (bashkautor); “*Udhërrëfyes i fondeve dhe koleksioneve arkivore*”, vëllimi III, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 2004 (bashkautor); “*Rrystem ef. Shportajeta dhe vepra (1865-1937)*”, BIRK, (bashkautor), Prishtinë, 2010; “*Transkriptimi i Mevludit të Tahir ef. Popovës*”, (bashkautor), BIRK, Prishtinë, 2008; “*Imamët dë-*

*shmorë në luftën e fundit në Kosovë 1989/1999* (monografi – bashkautor), BIRK, Prishtinë, 2010; *Bibliografi e revistës “Vjetar”-i (1965-2015)*, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, (bashkautor), Prishtinë, 2015; *Kontribute për historinë e Opojës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015; *Bibliografi e botimeve të veçanta të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës*, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, (bashkautor), Prishtinë, 2016; *Udhërrëfyes i fondeve dhe koleksioneve arkivore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave*, (bashkautor), Prishtinë, 2017; *Shkollat dhe Arsimi në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019; *Të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi (1989), dokumente*, (bashkautor), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019; *Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912) - sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman*, (bashkautor), BIRK, Prishtinë, 2021; *Sallnametë e Vilajetit të Prizrenit (1873-1874)*, vëllimi I-II, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame (bashkëpërgatitës dhe bashkautor), Prishtinë, 2023 dhe *Defteri i popullsisë së Kazasë së Gorës (1833) (Luma, Opoja, Gora)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2023.

Sadik Mehmeti është gjithashtu autor i më shumë se 200 njësive bibliografike (punime studimore, kumtesa shkencore, artikuj studimorë,

materiale, recensione shkencore etj., që e kanë parë dritën e botimit në revista të vendit, të rajonit dhe të botës. Po ashtu është pjesëmarrës në më se 100 aktivitete shkencore të rangut kombëtar dhe ndërkombëtar, në të cilat ka paraqitur rezultatet e tij nga fushat e albanologjisë, orientalistikës, islamistikës, raporteve ndërkulturore etj. Po ashtu shquhet edhe në fushën e përkthimeve nga arabishtja në gjuhën shqipe. Është bashkë përkthyes i gjash-të veprave nga fushat e shkencave dhe të kulturës islame të autorëve si: Muhamed Mufaku, Muhamed Muteveli Esh Sharavi, Abdulhamid Xhevdet Es Sehhar, Muhamed Ali Sabuni dhe Abdurrahman Hukiq.

Botimi më i ri “*Defteri i popullsisë së Kazasë së Gorës 1833 (Luma, Gora, Opoja)*” është projekt dyvjeçar i Sadik Mehmetit, i realizuar në kuadër të punës së tij hulumtuese studimore në Institutin Albanologjik, ndërsa është defteri i parë i botuar përgjithësisht në traditën 70-vjeçare të këtij instituti. Nevoja për burime të këtilla dokumentare ka qenë e vazhdueshme. Në mungesë të publikimeve të tyre në gjuhën shqipe (sikundër edhe në mungesë të posedimit të tyre në origjinal, apo edhe e pamundësisë që të lexohen në origjinal nga të gjithë dijetarët e historisë) studiuesit tanë shpeshherë janë bazuar në defterë që kombet e tjera i kanë përkthyer dhe përgatitur për nevojat vetjake.

Në raste jo të rralla përfundimet janë kushtëzuar pikërisht nga këto burime joadekuatë që vinin nëpërmjet një gjuhe të ndërmjetme, pa lënë anash edhe faktin se në to janë bërë edhe ndërhyrje e përshtatje tendencioze. Marrë parasysh këto aspekte, mund të thuhet me gojën plot se ishte një nismë e mbarë përfshirja në planin e punës të një projekti që ka të bëjë me defterin në fjalë, i cili në version e origjinalit ka këtë titull, e që del të jetë më i gjatë si tekst dhe më përshkruar: *“Defter i regjistrimit të banorëve myslimanë meshkuj, fëmijë dhe moshërritur, zotërues/banues të tokave të Kazasë së Gorës së Hasit të Prizrenit, viti 1833”*. Përfundimi i suksesshëm i projektit ishte i lidhur ngushtë me botimin e tij në gjuhën shqipe, kuptohet duke e shoqëruar edhe me faksimilet komplete të këtij defteri. Interesimi shumë i madh i studiuesve për ta pasur këtë defter në dorë e për ligji plotësisht vendimin për botimin e tij, duke ia dhënë një shtysë të madhe idesë për të vijuar më tej me defterë që kanë të bëjnë me hapësirën shqiptare. Si rrallë ndonjë botim yni tjetër, *“Defteri i popullsisë së Kazasë së Gorës (1833)”* zgjoi interesim, përveçse në qarqet shkencore shqiptare, edhe në mesin e studiuesve e intelektualëve goranë, të cilët që në ditët e para e përkthyen pjesën për Gorën dhe e shpërndanë gjithandej në rrjetet sociale. Me një fjalë interesimi i

madh për këtë materie u shtri gati njëkohshëm në tri shtete: Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Ky vëllim prej 624 faqesh, nga aspekti strukturor, ndahet në tri tërësi funksionale: parathënien e autorit, pjesën e përkthyer të defterit, ku hyjnë edhe referenca të shumta informuese, sqaruese dhe orientuese për lexuesin e tij në gjuhën shqipe dhe pjesën e tretë, ku përfshihet dokumenti origjinal i *Defterit...* në trajtë faksimilesh. Botimi i origjinalit është një vlerë e shtuar e vëllimit, sidomos për ata që janë njohës të osmanishtes dhe që duan të kenë qasje në lëndën burimore. Parathënia e këtij vëllimi përbën kontributin autorial të Sadik Mehmetit, i cili është përkujdesur që të qartësojë aspekte të ndryshme të këtij dokumenti të rëndësishëm dhe të dëshmojë rëndësinë e botimit të tij. Krahas qartësimit të motivit për t’u marrë me këtë materie, iu është kushtuar vëmendje e madhe aspekteve terminologjike që kanë të bëjnë me regjistrimin e asokohshëm të popullsisë, me aspekte metodologjike që janë zbatuar në procesin e sjelljes në variantin shqip të këtij defteri, me ndarjen territoriale të krahinave që janë pjesë e tij etj., duke përfshirë të dhëna të përgjithshme me interes për lexuesin e rëndomtë, por edhe për studiuesit që kanë synim të merren më imtësisht me këtë materie. Natyrisht një vëmendje e madhe iu kushtua edhe kontekstit

më të gjerë perandorak “të lindjes” së këtij lloji të defterëve. Kjo është parë si proces i lidhur ngushtë me reformat rrënjësore perandorake, të njohura si reformat e Tanzimatit, ku u përfshi edhe nevoja për një strukturë të re ushtarake, si pasojë e shkatërrimit të ushtrisë së jeniçerëve, e cila do të ishte e bazuar në potencialet e evidentuara të popullatës islame. Pra, nëse deri atëkohë, në regjistrë përfshihej vetëm kryefamiljari, defterët e rinj përmbanin të dhënat për të gjithë popullatën mashkullore, pa lënë anash as pleqtë, fëmijët, të paaftët për t’u angazhuar në ushtri etj. Autori Sadik Mehmeti e ndërlihd këtë transformim në planin ushtarak të Perandorisë Osmane edhe me një varg ndryshimesh të tjera, duke konstatuar si në vijim: “Qeveria Osmane ndërmori regjistrimin për të evidentuar popullsinë myslimane për nevojat e ushtrisë, përkatësisht regjistrimin e meshkujve të aftë për shërbimin ushtarak dhe të popullsisë tjetër për të nxjerrë taksat. Për këtë madje u bënë ndryshime edhe në menaxhimin e administratës dhe të librave të statistikave, u bë edhe ndarja e re territoriale e Perandorisë në vilajete, kurse në vitin 1831, u ngrit edhe Ministria e Regjistrimeve (Cerîde Nezâreti), e cila do të merrej me vlerësimin e regjistrimit të statistikave dhe me regjistrimin e popullsisë. Po në këtë vit (1831), u hartua edhe regjistri i popullsisë, që

shënon edhe censusin e parë (regjistrimin modern) në Perandorinë Osmane.”

Pavarësisht se është fjala për një defter, ku kanë gjetur vend të dhënat më kryesore mbi popullatën mashkullore të Kazasë së Gorës (1833), autori ka integruar në të dhënat hyrëse edhe përvojën e tij studimore që lidhet me zhvillimet historike të periudhës osmane dhe me strukturën e organizimit të Perandorisë Osmane. Mbase shumëkush i quan këto edhe si çështje të njohura, por, në të vërtetë, gjithnjë e më shumë, po kuptohet se sa pak është njohur, në disa prej sferave të jetës, periudha osmane ndër shqiptarët. Monografitë e tij *“Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës”*, *“Rrystem ef. Shporta- jeta dhe vep- ra (1865-1937)”* dhe sidomos vep- ra e tij më e rëndësishme e gjertanishme studimore *“Shkollat dhe arsimit në Kosovë (1830-1912)”* e dëshmojnë nivelin e lartë autorial të njohjes shkencore të kësaj periudhe, sidomos në sferat kulturologjike dhe pedagogjike, të cilat janë trajtuar në shkrimet tona pothuajse përciptazi.

Parathënia, e cila e hap vëllimin e këtij defteri, përmban të dhëna të shumta enciklopedike që lidhen me aspekte të organizimit territorial të viseve shqiptare në përgjithësi në rrafshin perandorak dhe me ato të Kazasë së Gorës në veçanti, pastaj bëhet fjalë lidhur me llojet e defte-

rëve, numrin e tyre të gjithmbarshëm dhe rëndësinë e secilit prej këtyre llojeve, numrin e popullsisë dhe një vështrim mbi pretendimet shtrembëruese të qarqeve të caktuara në këtë plan etj. Me interes janë edhe të dhënat që autori i ofron për anën teknike dhe sidomos për atë përmbajtjesore të Defterit të Kazasë së Gorës (1833). Aty jepen të dhëna për faktin se ky defter ruhet në Arkivin e Stambollit, se është i regjistruar me numër të signaturës 5732, se i ka përmasat 28 x 75 cm, se i ka 163 faqe, ndërsa bëhet fjalë edhe për llojin e shkrimit të defterit dhe madje edhe për ngjyrën e përdorur.

Ndonëse autori Sadik Mehmeti nuk ia ka bërë një analizë shteruese këtij defteri (synimi i tij ka qenë botimi si material), të dhënat e parathënies së tij janë mjaft orientuese për lexuesin. Po kështu vëllimi është pajisur edhe me një tabelë të fshatrave që bënin pjesë në Kazanë e Gorës më 1833, ku janë dhënë emrat sikundër ishin të shkruar në origjinal, pastaj në një shtyllë të veçantë është bërë transliterimi i tyre, për të vijuar me formatin e sotëm të këtyre toponimeve si dhe të dhënë se në varësi të cilës krahinë, përkatësisht strukturë organizative shtetërore janë sot ato fshatra. Kazaja e Gorës, sipas këtij defteri, kishte 85 fshatra dhe 7.574 banorë myslimanë meshkuj, nga të cilët 948 të regjistruar si të aftë për ushtri, 2.184

të sëmurë dhe pleq, përkatësisht të paaftë për ushtri, 4.246 fëmijë dhe 196 djem të spahinjve. Bazuar në këto të dhëna mbi regjistrimin e popullatës mashkullore dhe standardet e përlogaritjes edhe të pjesës tjetër të popullatës, autori konsideron se numri i përgjithshëm i popullsisë së Kazasë së Gorës do të ketë qenë rreth 15000. Gjithashtu mund të konstatohet se numri kaq i madh i myslimanëve në këto treva dëshmon se pranimi i islamit në shkallë të gjerë kishte marrë fund që atëbotë. Islamizimi i antroponomisë del në pah gjithandej, ndërkaq ka edhe disa emra të paktë të mbetur si shtresime të identitetit që mbartte popullata në kohë më të hershme. Ndër të dhënat e secilit prej banorëve të regjistruar, krahas emrit të personit dhe emrit të babait (në disa raste është përfshirë emri i gjyshit, ose i xhaxhait), moshës, ka edhe ndonjë përshkrim që lidhet me ndonjë veçori që ka të bëjë me mjekrën, ose mustaqet, që shpeshherë është edhe shprehje e moshës së të regjistruarit: p.sh. mustaqeholli, mustaqethinjuri, mjekërthinjuri. Në raste të pakta ka të dhëna të tjera dhe sidomos të tilla që lidhen me profesionin e imamatit, detyrën e myftarit, ndonjë profesion të caktuar, ose me ndonjë të metë fizike të personit të regjistruar. Pavarësisht që janë të rralla si shënime, edhe në bazë të kësaj mund të krijohet ndonjë ide themelore lidhur me kapaci-



tetet e kësaj popullate. Kështu, p.sh., lidhur me elitën fetare të Kazasë së Gorës ai konstaton se në kuadër të saj ishin “29 imamë, 27 imamë kanë qenë edhe myftarë (kryepaq) katundesh njëkohësisht, 20 myftarë, 7 persona për të cilët nuk shënon se kanë qenë imamë, por që kanë pasur titullin mulla, madje njëri prej tyre hoxhë, 4 myezinë, 3 dede, 3 shehlerë, 1 dervish dhe 1 haxhi.”

Pse është i rëndësishëm botimi i “*Defterit të popullsisë së Kazasë së Gorës (1833)*” dhe i defterëve osmanë përgjithësisht? Sigurisht se, në aspektin e sigurimit të një baze të qëndrueshme dokumentare, këto burime janë të pazëvendësueshme për t’i kuptuar më mirë e në mënyrë më të plotë aspektet të jetës, të strukturës së popullsisë, të organizimit asokohshëm shoqëror etj. Përgjithësisht literaturës sonë në gjuhën shqipe, që ka të bëjë me këtë periudhë, i kanë munguar të dhënat e këtilla. Duke u bazuar në defterët osmanë, në të vërtetë, historianët gjejnë mbështetje në fakte të verifikueshme dhe shmangin burimet që janë produkt i perceptimit individual dhe jo rrallë edhe i konceptimit tendencioz si rezultat i përfaqësimit të interesave të pjesshme të grupeve, etnive, a kombeve të caktuara e me qëllim të justifikimit të mësym-

jeve pushtuese mbi këto treva. Një vlerë tjetër e rëndësishme ka të bëjë me aspektin e identifikimit të rrënjëve të familjeve të mëdha të këtyre vendbanimeve dhe gjurmimit e tyre më në lashtësi. Kjo nuk është thjesht çështje kureshtjeje, veçse çështje e identitetit të pasardhësve të pjesëtarëve të përfshirë në këtë defter. Ky gjurmim, në ndonjë rast, vete gati një shekull përtej kufijve kohorë të defterit, duke përfshirë madje edhe fillimin e shekullit XVIII. Botimi i defterit, përveçse është afirmim i së vërtetës dokumentare, gjithashtu ua mbyll gojën trillimeve që kanë lëshuar rrënjë në historiografinë serbe mbi gjoja të asimilimit e vonshëm të popullatës “serbe” në këto krahina. Defteri, me këtë strukturë të popullsisë, dëshmon se një pretendim i tillë ishte i pabazë.


Mbi të gjitha botimi i këtij defteri, por edhe lëndës së shumtë arkivore të periudhës osmane që lidhet me shqiptarët, me viset e tyre, kulturën, historinë e personalitetet e tyre kanë vlerë të jashtëzakonshme, vlerë që garanton njohjen më të plotë të identitetit historik e kulturor shqiptar.

**Janar 2024**  
**Hysen Matoshi**

# RRËFIME TË BUKURA NGA SHTEGTIMI JETËSOR I MUHAMEDIT, A.S.

**Imam Vehbi Ismaili,  
“MUHAMEDI, A.S., PEJGAMBERI ISLAM”, Prishtinë, 2023**

Libri “Muhamedi, a.s., Profeti islam” i autorit Vehbi Ismaili, është një përpjekje e arrirë e autorit për t’i pasqyruar aspektet kryesore të jetës së të Dërguarit të Allahut të Madhëruar, të ilustruara me ngjarjet që e kanë përcjellë Pejgamberin, a.s. Shtegtimi jetësor i Pejgamberit, a.s., përmes rrëfimit është semantika e këtij libri. Jeta e pejgamberëve ka një ndjeshmëri të thellë të besimtarët, prandaj edhe autori ka bërë përpjekje që ta përdorë mjeshtërisht edhe formën e rrëfimit duke i paravënë dy personazhe: Luanin, i cili i rrëfen bijës së vet, Fatimes, në tri-dhjetë e një tregime të veçanta, e që e pasqyrojnë jetën e të Dërguarit, a.s. Kjo metodologji pedagogjike është e njohur në rrëfimet letrare, religjioze, dhe në shumë shkencë humane. Duke e përdorur gjuhën e thjeshtë tregimtare, me finesa të holla ndjeshmërie, autori ia ka dalë të na jap një vepër të kompletuar që lexohet me kureshtje, që përmes saj lexuesi mbushet me informata që depërtojnë bindshëm, të argumentuara dhe që janë mjaft prekëse. Vendosja e ngjarjes në kontekstin



shqiptar, qoftë kur bëhet fjalë për personazhet (Luani, Drita, Fatimja), qoftë kur bëhet fjalë për ambientin (Tirana, Medreseja, Xhamia “Et-hem Beu”, “Xhamia e Vjetër” etj.) përveçse shprehje e identitetit historik, kulturor e fetar islam, është edhe një shenjë se autori nuk i shkëputi asnjëherë rrënjët e tij me kulturën, gjuhën dhe vendin e vet. Ky kontekstualizim i rrëfimeve të tij flet për përkushtimin e madh që

e pati për Shqipërinë që në atë kohe të komunizmit, liria e ushtrimit të riteve fetare ishte e ndaluar. Autori librin e botoi për herë të parë në vitin, 1969 në Detroit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku shërbeu si imam dhe veprimtar i shquar, e që njëkohësisht ishte edhe themelues i Komuniteti Mysliman Shqiptar në ShBA.

Brenda librit lexuesi do të gjejë shumë informacione me vlerë. Interesante është se autori ka bërë përpjekje që teksa qëllimi kryesor është ta përshkruajë jetën dhe veprën e pejgamberit Muhamed, alejhi selam, shpeshherë edhe është ndalur edhe te shumë informacione që në dukje të parë janë periferike, mirëpo që janë mjaft domethënëse dhe në shërbim të plotësisht të madhështisë së një figure siç është Pejgamberi, a.s.

Informatat gjeografike janë një pjesë e asaj që e plotëson rrëfimin në këtë libër. Duke e përshkruar Gadishullin Arabik, vendin ku është lindur dhe rritur pejgamberi Muhamed, alejhi selam, autori ia ka dalë që ta shtyjë lexuesin të natyralizohet me vendbanimin e Pejgamberit, alejhi selam, ta ndiejë atë ambient teksa e përshkruan si vend me shkretëtirë, me rërë, po edhe me toka pjellore në të cilat rritet gruri, elbi, rrushi etj.

Anija e Saharasë, deveja, një mrekulli e krijimit të Allahut të Gjithëmeshirshëm, është një kuriozitet mbresëlënës që do ta mësojë lexuesi. Duke dhënë informacione të tilla në libër, autori e nxit kureshtjen, jep informacione rreth mrekullisë krijuese me të cilën Krijuesi i Gjithëfuqishëm e ka begatuar njeriun, e veçanërisht duke ia përshtatur krijimin e tij dhe të nevojave të njeriut, sipas kushteve në të cilat ai jeton. Në këtë rast veçantitë e krijimit të devesë e dëshmojnë një mrekulli të veçantë, në një mjedis të veçantë, për njerëz të veçantë.

Pasqyrim tjetër me rëndësi është edhe informatat demografike mbi arabët, të dhënat historike mbi fiset e tyre, zakonet, besimet dhe mënyrën e tyre të jetesës. Pra, një figurë madhore siç është Pejgamberi, a.s., nuk mund të shtjellohet pa u shtjelluar edhe mjedisi në të cilin ai u lind dhe u rrit. Kështu autori na jep detaje të shumta, e ku mbase njëra prej tyre është edhe se si Qabeja e bekuar ishte katandisur në një gjendje mjaft të vështirë, kur në vend se aty të madhërohet Allahu i Plotfuqishëm, aty ishin vendosur shumë figura idhujtarie, të cilat adhuroheshin në vend të Zotit Fuqiplotë. Kështu, lexuesi do të mësojë se arabët ishin edhe njerëz të ashpër, idhujtar, po edhe poetë të mëdhenj dhe oratorë të spikatur.

Pra, ata ishin me një lloj kulture të kultivuar dhe të përshtatur me kushtet e jetesës së tyre, në kohë trazirash dhe ashpërsish.

Rrëfimi me histori njerëzore është pjesa më interesante në këtë libër. Duke rrëfyer për historinë e pusit Zem-Zem, të cilin sipas librit e kishte hapur gjyshi i Pejgamberit, a.s., Abdyl Mutalibi, dhe kërkesa e tij që Zoti t'ia falte dhjetë djem për ta ndihmuar në hapjen e pusit, me premtimin se njërin prej tyre do ta bënte kurban, dhe pastaj, ai i bën kurban njëqind deve në mënyrë që mos të bëhej kurban Abdullahu, babai e pejgamberit Muhamed, alejhi selam, për lexuesin e ri po që është shumë interesante. Nga këtu nis, sipas mendimit tim, pjesa më interesante, e që është edhe syri shikues në këtë libër. Nis rrëfimi mbi lindjen e Pejgamberit, alejhi selam, një lindje e cila shpjegohet se ishte pa dhimbje, jo siç ndodh zakonisht në lindjet, pastaj qëndrimi i Pejgamberit te Halimeja, tek e cila në mënyrë të çuditshme shfaqet bereqeti dhe begatia në shtëpinë e saj, sepse aty ishte njeriu i zgjedhur prej Zotit të Plotfuqishëm. Pesë vjet të qëndrimit të Pejgamberit, a.s., te Halimeja ishin vite me begati, sipas librit, dhe pastaj me një shëndet të plotë dhe me një gjuhë të pastër Pejgamberi, a.s., kthehet tek Emineja, nëna e tij.

Vdekja e nënës dhe dy vjet më pas, dhe më vonë edhe vdekja e gjyshit të Pejgamberit janë ngjarjet më rrëqethëse të librit, dhe tashmë rrëfimi merr shtegtime gjithnjë e më të vështira, në harmoni të plotë me të dhënat faktike të historisë. I mbetur jetim si gjashtëvjeçar pa nënë, e pastaj, dy vjet më pas edhe pa gjyshin, ai kalon tek Ebu Talibi, xhaxhai i tij, dhe ai kujdeset për të. Nga këtu Pejgamberi, a.s., e njeh botën, shtegton rrugëve të jetës, e njeh tregtinë, gjithnjë nën kujdesin e xhaxhait; njihet edhe prej priftit Behira, me shenjën e pejgamberisë, një ngjarje kjo mjaft prekëse dhe interesante, si dhe shumë e shumë rrëfime të tjera.

Jeta sociale dhe rregullimi i saj është një nga rrëfimet mjaft kurioze. Kjo, në radhë të parë, sepse e tregon Pejgamberin, a.s., të përfshirë në këtë aspekt, si akter që jep kontribut ende pa u shpallur pejgamber, po edhe si njeri të zakonshëm me sjellje dhe cilësi të jashtëzakonshme. Libri na e paraqet Pejgamberin, a.s., si njeriun që asnjëherë nuk adhuroi idhuj, që kishte qëndrim kritik ndaj dukurive të këqija, të cilat e kishin mbuluar vendin e tij në atë kohë etj. Në libër tregohet edhe martesja e Pejgamberit, a.s., me Hadixhenë, martesë e cila e liroi Pejgamberin, a.s. nga gjendja e vështirë financiare.

Jeta e Pejgamberit si pejgamber është esenca e veprës. Ngjarjet që tashmë besimtari i fesë islame është mësuar t'i njohë, si vetëmimin e Pejgamberit, a.s., në shpellën Hira, pastaj ardhja e Xhibrilit, a.s., me shpallje prej Zotit të Lartëmadhëruar, si dhe kujdesi që pejgamberi Muhamed, a.s., tregoi për fenë e Allahut gjatë gjithë jetës së tij janë ngjarjet më të spikatura që një libër me të tilla histori mund t'i rrëfejë.

Lexuesi përmes këtij libri do të informohet për besimtarët e parë mundimet dhe sakrificat e tyre, boj-kotin që iu bërë Pejgamberit, a.s., dhe besimtarëve, ngjarjen e Taifit, si një ndër ngjarjet më të rënda në jetën e Pejgamberit, a.s., pastaj vdekjen e Hatixhesë dhe të Ebu Talibit, që ai vit u quajt viti i pikëllimit etj. Një vend kyç në këtë rrëfim e zë edhe hixhreti/shpërngulja e Pejgamberit, a.s. në Medine, një ngjarje madhështore që bëri kthesë historike, meqë dy qytetet e kërkonin Muhamedin, a.s. Meka, që donte ta zhdukte nga dheu, dhe Medineja, që donte ta kishte për vete, ta ndëronte dhe ta mbronte prej idhujtarëve. Medineja ishte realizimi i planit të formimit të shoqërisë islame me vëllazërimin mes ensarve/vendasve dhe muhaxherve/të shpërngulurve nga Meka; tutje Muhamedi, a.s., si burrë shteti, bëri hapa të rëndësishëm në mbarëvajtjen e qytetit dhe

të popullatës së saj, nën sloganin kuranor “Nuk ka dhunë në fe”, si dhe e bëri një traktat paqeje me jomyslimanët, duke i respektuar vlerat dhe të drejtat e tyre fetare dhe kombëtare. Përmes shëmbëlltyrave pasqyrohet vlera madhore dhe përgjegjësia që bartte mbi vete Pejgamberi, a.s. Lufta e tij për përhapjen e fesë, luftërat e jobesimtarëve kundër tij dhe gjithë ajo histori herë triumfale e herë me dhimbje të mëdha, janë insinuatat që vetëm përmbledhurazi e paraqesin të vërtetën e cila është shumë më e gjerë sesa mund të përfshihet në një libër.

Historia tregon se si shumë njerëz kanë bërë plane për ta përmirësuar gjendjen e popullit, apo të botës, mirëpo janë shumë të paktë ata që kanë arritur t'i shohin të zbatuara parimet dhe ëndërrimet e tyre gjatë jetës sa kanë jetuar. Nga ky grup nuk përjashtohen edhe pejgamberët, siç është rasti i Isait, a.s., i cili nuk arriti t'i shihte pasuesit e vet që t'i përqafojnë mësimet e tij. Muhamedi, a.s., është ndër ata pejgamberë dhe reformatorë të rrallë që arriti ta shihte në jetën e tij popullin e vet, pra, duke i përfaqësuar parimet që i predikoi, reforma këto që i përhapën mësimet e tij në tërë Arabinë dhe botën mbarë.

- Besimi në një Zot;
- Të gjithë besimtarët janë vëllezër;

- Prona, gjaku dhe nderi janë të shenjta;
- Lufta lejohet për ta mbrojtur lirinë;
- Paqja duhet të jetë në çdo kënd, edhe në përhëndetje;
- T'i jepet haku të varfrit, të dobët, të shtypurit;
- Të respektohet gruaja (deri në atë kohë keqtrajtohej);
- Ndalimi i gjërave të shëmtuara (dhuna, prostitucioni, alkooli);
- Dituria është adhurimi më i lartë, etj.

Këto ishin edhe mesazhet e Haxhit Lamtumirës, momente këto të ndjeshme për vetë Pejgamberin, a.s., dhe për të gjithë besimtarët. Ai aty ua kumtoi fjalën e Zotit: “Sot e përsosa për ju fenë tuaj, dhe i plotësova të mirat e Mia mbi ju, dhe e zgjodha Islamin fe për ju.”

Zbulimi i këtij ajeti nuk la dyshim fare se Pejgamberi, a.s., e kishite kryer misionin e tij dhe se ishte afruar koha që ta linte këtë botë, për t'u takuar me të Madhin Zot. Vdekja e Muhamedit, a.s., ishte një tronditje për çdo mysliman, përjetimet në xhaminë e Pejgamberit, a.s., nga ana e Omerit, r.a., ishin të një pikëllimi të papërshkruar, ndërsa kur erdhi Ebu Bekri, r.a., e puthi në ballë Pejgamberin, a.s., dhe i mbushur me lot i tha: “I këndshëm ishe i gjallë, dhe i këndshëm je i vdekur”, e pastaj doli në xhami dhe e

qetësoi situatën me fjalën e tij: “O popull, ata që i luten Muhamedit, le ta dinë se Muhamedi ka vdekur! E ata që i luten Allahut, le ta dinë se Allahu është i Gjallë nuk vdes kurrë...!”

Libri synon ta japë në formë të përsheptuar një pasqyrim të jetës së Pejgamberit, a.s., nga paralindja e tij, lindja, jeta dhe vdekja në mënyrë kronologjike, ndoshta një shpjegim më i thellë do shpaloste edhe më urtësi të ndritura për jetën dhe veprën e Muhamedit, a.s., por, niveli i këtij rrëfimi ishte i përshtatur për fëmijë dhe të rinjtë. Porositë morale të tij, të cilat ishin të gjithanshme dhe të bazuara në parimet e drejtësisë shoqërore, të solidarësisë ndërmjet kategorive të ndryshme, të mirëkuptimit dhe të dashurisë për mbrojtjen e të vërtetës së fesë së Zotit të Madhërishëm, për të mirat e Tij ndaj njerëzimit, për rrugën që e shtroi për njerëzimin me shëmbëllyrën e tij, janë perlat kryesore që autori i librit i jep për lexuesin. Autori në disa raste, në vend të emrit Zot e përmend emrin Perëndi, dhe për Muhamedin, a.s., të Dërguarin e Zotit, si pejgamberi Muhamed. Kjo duke ndodh duke e pasur parasysh kohën dhe vendin ku jetoj autori; megjithatë, kjo aspak nuk ia ul vlerën librit, që është për çdo lëvdatë, vlerë kjo që është e vazhduar

shme në kohë dhe në hapësira të ndryshme.

*Të njihemi me autorin!*

Imam Vehbi Ismaili lindi në Shkodër, në vitin 1919, nga një familje e njohur shkodrane. Mësi-met e para i mori në qytetin e lindjes, e shkollimin fillor, nga klasa e pestë, e kreu në Krujë, kurse mësimet e mëtutjeshme i ndoqi në Medresenë e Tiranës. Studimet universitare i kreu në Al Az'har të Kajros. Pas diplomimit qëndrimi në Shqipëri

ishite i vështirë, për shkak të rrethanave shoqërore-politike, nga çka pastaj u shpërngul në Detroit të ShBA-ve, ku e filloi mision e tij si imam, edukator dhe mësues në Komuniteti Mysliman Shqiptar. Ai ishte i shquar për shume aktivitete fetare dhe kombëtare, dhe njëkohësisht i njohur për shkrime dhe publikime. Imam Vehbi Ismaili ndërroi jetë më 18 maj 2008, në Detroit të ShBA-ve, ku edhe u varros.

**Haxhere Shabani**

# PËRMBAJTJA

<b>I. EDITORIAL</b> .....	<b>5</b>
TA RUAJMË FAMILJEN ME LIGJET E ZOTIT QË JANË TË PËRHERSHME DHE NUK NDRYSHOHEN DOT! .....	7
<b>II. ISLAMISTIKË</b> .....	<b>13</b>
Dr. Lulzim ESATI VEÇORITË E PEJGAMBERIT, A.S., NË KURANIN FAMËLARTË.....	15
Dr. Ajni SINANI PRETENDIMET E PAPRANUESHME TË ORIENTALISTËVE LIDHUR ME KURANIN FISNIK ....	37
<b>III. TEMA E NUMRIT: AGJËRIMI</b> .....	<b>63</b>
Dr. Muhamed STUBLLA VLERA DHE NORMAT JURIDIKE TË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT .....	65
Dr. Sedat ISLAMI KONCEPTI, VLERA DHE RËNDËSIA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT SIPAS BREZAVE TË HERSHËM TË DIJETARËVE MYSLIMANË .....	97
Mr. Driton ARIFI SËMUNDJA - ARSYE JUSTIFIKUESE PËR PRISHJEN E AGJËRIMIT .....	127
Dr. Ejup HAZIRI TRAJTESË FIKHORE RRETH SADAKASË SË FITRIT .....	143



<b>IV. KULTURË / TRASHËGIMI / ART</b> .....	<b>169</b>
Dr. Parim KOSOVA	
XHAMITË E PRIZRENIT GJATË SHEKUJVE (I) .....	171
Tatjana KATIĆ	
TË ARDHURAT E KADILLËKUT TË PRIZRENIT	
NGA TREGTIA E MËNDAFSHIT DHE MINIERËS	
SË KORISHËS (1525-1544) .....	203
Besnik JAHA	
KRITIKA SOCIALE NË LETËRSINË SHQIPE	
(INTRODUKTAT E FAN S. NOLIT) .....	219
<b>V. REFLEKSIONE</b> .....	<b>229</b>
Besnik MUSTAJ	
NË EMËR TË BIRIT OSE TË NXËNËSIT .....	231
Mr. Besim MEHMETI	
KONCEPTI I SHTETIT QYTETAR-KOMBËTAR	
DHE FEJA .....	241
<b>VI. RECENSIONE</b> .....	<b>267</b>
VEPËR E RËNDËSISHME	
NË FUSHËN E BESIMIT ISLAM.....	269
DEFTERËT FLASIN SHQIP .....	275
RRËFIME TË BUKURA NGA SHTEGTIMI	
JETËSOR I MUHAMEDIT, A.S. ....	281
PËRMBAJTJA .....	287